

# Reforma Policore në kuadër të reformës së sistemit të drejtësisë penale

Seri publikimi e DKT/NjçSP, Vëllimi 11

osce

Organization for Security and  
Co-operation in Europe



# Reforma Policore në kuadër të reformës së sistemit të drejtësisë penale

## Seri publikimi e DKT/NjÇSP, Vëllimi 11

- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) punon për **stabilitet, prosperitet dhe demokraci** në 57 shtete përmes dialogut politik për vlerat e përbashkëta dhe punës praktike që sjell ndryshimin e qëndrueshëm.

Vjenë, korrik 2013

© OSBE 2013

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret dhe kopjohet lirshëm për qëllime edukative dhe të tjera jo komerciale, me kusht që çfarëdo riprodhimi i tillë të shoqërohet me njohjen dhe pranimin e OSBE-së si burim.

ISBN 978-92-9234-513-6

Sekretariati i OSBE-së  
Departamenti kundër Kërcënimeve Transnacionale

Njësia për Çështje Strategjike Policore  
Wallnerstrasse 6  
A-1010 Vienna, Austria

Tel: +43-1 514 36 6942  
Fax: +43-1 514 36 6266  
E-mail: [spmu@OSBE.org](mailto:spmu@OSBE.org)  
<http://www.OSBE.org/spmu>  
<http://polis.OSBE.org>

# Përmbajtja

<b>Shkurtesat dhe akronimet</b> .....	5
<b>Parathënie</b> .....	7
<b>Falënderimet</b> .....	9
<b>Përmbledhje ekzekutive</b> .....	12
<b>I.Hyrje</b> .....	25
I.1 Objektivat e Udhëzuesit .....	28
I.2 Struktura e Udhëzuesit .....	29
<b>II.Terminologjia</b> .....	31
II.1 Drejtësia dhe sundimi i ligjit .....	31
II.2 Akterët e sistemit të drejtësisë penale .....	31
II.3 Forma të ndryshme të aranzhimeve të reformimit .....	33
<b>II.4 Qëllimet dhe parimet udhëzuese të RSDP-së</b> .....	37
<b>III. Vlerësimet e përgjithshme të sistemit të drejtësisë penale</b> .....	41
III.1 Planifikimi i vlerësimeve .....	42
III.1.1 Përbërja e ekipit vlerësues .....	42
III.1.2 Grupet e shënjestruara të vlerësimit .....	43
III.1.3 Fushat kryesore të vlerësimit .....	45
III.1.4 Metodologjia e vlerësimit .....	47
III.2 Pyetje vlerësuese për analizimin e marrëdhënieve mes institucioneve të ndryshme të SDP-së, agjencive tjera qeveritare dhe aktorëve joshtetërorë .....	52
III.2.1 Pyetjet për kontekstin socio-ekonomik, kulturor dhe politik .....	52
III.2.2 Pyetjet në lidhje me nevojat e publikut për siguri e drejtësi .....	53
III.2.3 Çështjet në lidhje me qeverisjen dhe kapacitetin e SDP-së .....	54
III.2.4 Pyetjet për iniciativa të tjera ndërkombëtare të RSDP-së .....	65
<b>IV. Zhvillimi i një strategjie reformuese dhe i planeve të zbatimit</b> .....	67
<b>V. Reformimi i kornizës ligjore</b> .....	71
V.1 Ligjet e zbatueshme që duhet të rishikohen .....	72
V.2 Rishikimi i dispozitave ligjore për të përmirësuar reagimin e SDP .....	75
V.2.1 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP .....	75
V.2.2 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP, agjencive tjera qeveritare, ofruesve joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, dhe shoqërisë civile .....	82
V.2.3 Aspektet e të drejtave të njeriut .....	83
V.2.4 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja .....	83
<b>VI. Zhvillimi/reforma e politikave, procedurave, rregullave dhe rregulloreve</b> .....	87
VI.1 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP .....	89
VI.2 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP, agjencive tjera qeveritare, ofruesve joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, dhe shoqërisë civile .....	90
VI.3 Aspektet e të drejtave të njeriut .....	90
VI.4 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja .....	92
<b>VII. Reforma strukturore dhe organizative</b> .....	95
VII.1 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP .....	97
VII.1.1 Themelimi i mekanizmave të bashkërendimit dhe bashkëpunimit në nivel strategjik / të politikave .....	97
VII.1.2 Themelimi i mekanizmave të bashkërendimit dhe bashkëpunimit në nivel operativ .....	101
VII.1.3 Mjekësia ligjore .....	110
VII.2 Bashkëpunimi i shtuar mes institucioneve të SDP-së dhe ofruesve zakonorë/joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë .....	113

VII.2.1	Grupet që ushtrojnë vetëgjyqësi/skemat e ruajtjes së lagjes .....	113
VII.2.2	Shërbimet civile private të sigurisë .....	117
VII.2.3	Ofruesit zakonorë/joshtetërorë të drejtësisë .....	118
VII.3	Bashkëpunimi i shtuar mes institucioneve të SDP-së dhe shoqërisë civile .....	120
VII.3.1	Puna policore në bashkësi .....	121
VII.3.2	Programet e diversionit .....	122
VII.3.3	Ndërmjetësimi në çështjet penale .....	124
VII.3.4	Parandalimi, hetimi dhe ndjekja penale e abuzimit seksual të fëmijëve në internet ..	128
VII.4	Aspektet e të drejtave të njeriut .....	130
VII.4.1	Qasja në drejtësi/sigurimi i ndihmës juridike .....	130
VII.4.2	Ndihma për viktimat .....	132
VII.4.3	Ndihma/mbrojtja e dëshmitarëve .....	136
VII.4.4	Menaxhimi i integruar i kryerësve të veprave penale .....	141
VII.4.5	Drejtësia për të mitur .....	141
VII.5	Llogaridhënia dhe Mbikëqyrja .....	142
VII.5.1	Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e policisë .....	143
VII.5.2	Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e gjyqësorit .....	145
VII.5.3	Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e sistemit të burgjeve .....	150
VII.5.4	Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e shërbimeve joshetërore të sigurisë .....	150
VII.5.5	Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e ofruesve zakonor/tradicional të drejtësisë .....	151
VII.5.6	Ballafaqimi i llogaridhënies dhe mbikëqyrjes me SDP-në .....	151
VII.6	Ndryshimet në SDP .....	154
VII.7	Trajnimi dhe zhvillimi profesional .....	157
VII.7.1	Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të SDP-së .....	159
VII.7.2	Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të SDP-së, agjencive tjera qeveritare, ofruesve joshetëror të sigurisë dhe drejtësisë, dhe shoqërisë civile .....	163
VII.7.3	Aspektet e të drejtave të njeriut .....	165
<b>VIII. Vlerësimi dhe rishikimi i RSDP-së</b> .....		171
VIII.1	Kriteret për vlerësim .....	172
VIII.2	Shtirja Gjeografike e nismave të RSDP-së .....	174
VIII.3	Qëndrueshmëria dhe faza e daljes .....	174
<b>IX. Qasjet e integruara të RSDP-së që përdoren nga organizatat ndërkombëtare që ofrojnë asistencë në procesin e reformave</b> .....		177
<b>X. Qasjet e integruara të RSDP në kuadër të organizatave ndërkombëtare për asistencë në reforma</b> .....		179
<b>Referenca</b> .....		182
Dokumente .....		182
Bibliografia .....		183
<b>Shtojca 1: Konventat, Udhëzimet dhe Zotime kryesore ndërkombëtare të aplikueshme për qeverisjen e funksionimit të SDP në Hapësirën e OSBE-së</b> .....		197
Instrumentet dhe dokumentet e Kombeve të Bashkuara .....		197
Dokumentet e CSCE, Vendimet dhe planet e veprimit të Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Përhershëm të OSBE-së .....		201
Dokumentet e Këshillit të Evropës .....		203
Dokumenti i Interpolit .....		205
<b>Shtojca 2: Pyetje të përgjithshme për aplikimin e Kornizës së Kapacitetit dhe Integritetit (KKI) të zhvilluar në Qendrën e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) ...</b>		206

# Shkurtesat dhe akronimet

<b>AZUP</b>	Asociacioni i Zyrtarëve Udhëheqës Policorë
<b>MAAD</b>	Mekanizmi i Automatizuar për Asistencë nga Donatorët
<b>KKI</b>	Korniza e Kapacitetit dhe Integritetit
<b>CJCC</b>	Komisionet për Bashkëndim të Drejtësisë Penale
<b>SDP</b>	Sistemi i Drejtësisë Penale
<b>RSDP</b>	Reforma e Sistemit të Drejtësisë Penale
<b>QKBKT</b>	Qendra Kombëtare Bashkënduese Kundër Terrorizmit
<b>KPP</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>ShPSC</b>	Shërbimet Private të Sigurisë Civile
<b>OTSK</b>	Organizata e Traktatit të Sigurisë Kolektive
<b>KDFA</b>	Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura
<b>KEPS</b>	Këshilli Ekzekutiv për Paqe dhe Siguri
<b>NjIF</b>	Njësia për Inteligjencë Financiare
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
<b>ISVA</b>	Këshilltarë të Pavarur kundër Dhunës Seksuale
<b>FVI</b>	Fondacioni për Vëzhgim të Internetit
<b>BLDP</b>	Bordi Lokal i Drejtësisë Penale
<b>TKPP</b>	Model i Kodit të Procedurës Penale
<b>BNDP</b>	Bordi Nacional për Drejtësi Penale
<b>OJQ</b>	Organizatë Joqeveritare
<b>MNR</b>	Mekanizmat Nacional të Referimit
<b>ZRDP</b>	Zyra për Reformë të Drejtësisë Penale
<b>ODIHR</b>	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut
<b>KAZh OBZhE</b>	Komisioni i Asistencës për Zhvillim i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>KBR</b>	Këshilli për Bashkërendim Rajonal
<b>PSV</b>	Procedurat Standarde të Veprimit
<b>TQNj</b>	Trafikimi me Qenie Njerëzore
<b>DKT</b>	Departamenti kundër Kërcënimeve Transnacionale
<b>DKT/NjVT</b>	Departamenti kundër Kërcënimeve Transnacionale/ Njësia për Veprim kundër Terrorizmit
<b>DKT/NjÇSP</b>	Departamenti kundër Kërcënimeve Transnacionale/ Njësia për Çështje Strategjike Policore
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>PKDKB</b>	Programi për Kontrollin Ndërkombëtar të Drogave i Kombeve të Bashkuara
<b>ZKBDK</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogave dhe Krimit
<b>KKBKOT</b>	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional
<b>IPShB</b>	Instituti për Paqe i Shteteve të Bashkuara
<b>TVG</b>	Task-Forca Virtuale Globale



# Parathënie

Gjatë dekadës së kaluar, praktikuesit e drejtësisë penale, politikëbërësit dhe akademikët kanë njohur dhe pranuar gjerësisht që reformat në një sektor të sistemit të drejtësisë penale (SDP) duhet të plotësohen dhe sinkronizohen me reforma në sektorë të tjerë në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti i tërë procesit të drejtësisë penale, të ritet qasja në siguri dhe drejtësi për popullatën dhe të sigurohet qëndrueshmëria e reformave të arritura në SDP.

Ky Udhëzues i identifikon marrëdhëniet në procesin e drejtësisë penale ndërmjet vetë institucioneve të ndryshme të SDP-së dhe ndërmjet tyre dhe agjencive të tjera relevante qeveritare, si dhe ofruesve joqeveritarë të sigurisë dhe drejtësisë dhe shoqërisë civile. Udhëzuesi shtjellon disa praktika të mira në adresimin e këtyre marrëdhënieve në hapa reformuese praktike dhe i identifikon opsionet për përforcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në përvetësimin e një qasjeje tërësore të reformimit të SDP-së. Angazhimi i OSBE-së për përpilimin e këtij Udhëzuesi është mirëpritur nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, organizata të tjera partnere ndërkombëtare dhe institucione huluntuuese, si dhe praktikues individualë të SDP-së, shumë prej të cilëve ishin mjaft të lumtur t'i ndajnë përvojat e tyre në zbatimin e një qasjeje të tillë të reformës tërësore.

Me miratimin e *Kornizës Strategjike të OSBE-së për Aktivitete të Ndërlidhura me Policinë* në vitin 2012, shtetet pjesëmarrëse e rikonfirmuan se e njohin rëndësinë e mbështetjes dhe plotësimit të reformave të policisë me angazhimet e ndërmarra në sektorët e tjerë të sistemit të drejtësisë penale dhe me këtë rast i dhanë detyrë OSBE-së të zhvillojë udhëzime për këtë çështje.

Udhëzuesi i ri ka për qëllim plotësimin e zbrazëtirës thelbësore ndërmjet reformës ekzistuese të sektorit të sigurisë (RSS) dhe dokumenteve udhëzuese të RSDP-së. Në veçanti, ai i adreson pikat ndërlidhëse ndërmjet akterëve relevantë të procesit të drejtësisë penale dhe siguron shembuj konkret të masave praktike se si të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet akterëve të ndryshëm.

Duke i njohur dhe pranuar dallimet rajonale në zonën e OSBE-së, siç janë traditat e ndryshme të drejtësisë penale, përfshirë këtu edhe sistemet e ndryshme ligjore, dhe rolet e ndryshme të institucioneve të SDP-ve dhe ofruesve joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, këta shembuj janë mjaftueshëm fleksibilë për t'u zbatuar në kushte të ndryshme rajonale, nacionale dhe kulturore. Ato gjithashtu u sigurojnë politikëbërësve dhe praktikuesve të drejtësisë penale një kornizë për zbatimin e reformës

policore në qasjen tërësore brenda reformimit të SDP-së.

Me shpresë, këta shembuj të praktikave të mira të reformimit do të përhapen dhe përdoren gjerësisht nga hisedarët ndërkombëtarë dhe vendorë të RSDP-së, si brenda ashtu edhe jashtë OSBE-së dhe do të nxisin më tej diskutime ndërmjet tyre rreth mënyrave më të mira për t'i zbatuar reformat.



Alexey Lyzhenkov

Koordinator i Aktiviteteve për Adresimin e Kërcënimeve Transnacionale

# Falënderimet

Ky Udhëzues është krijuar me angazhimin e përbashkët të një grupi ekspertësh të drejtësisë penale, me kërkesë të Këshilltarit të Lartë për Polici të OSBE-së, z. Knut Dreyer. Grupi i ekspertëve përfshinte zyrtarë policorë, prokurorë dhe gjyqtarë, avokues të të drejtave të njeriut, politikëbërës dhe hulumtues nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, struktura ekzekutive të OSBE-së, organizatat ndërkombëtare partnere, institucione hulumtuese dhe organizata joqeveritare (OJQ). Këshilltari i DKT/NjÇSP për hulumtim dhe analiza, z. Thorsten Stodiek shërbeu si hartues kryesor dhe redaktor i Udhëzuesit. Udhëzuesi i paraqet gjetjet dhe konkludimet e një hulumtimi të hollësishëm dhe një sërë takimesh dypalëshe dhe punëtorive shumëpalëshe të ekspertëve, ku përfshihet edhe takimin vjetor i ekspertëve policorë në Vjenë, mbajtur në shtator 2011. Drafti i parë dhe i dytë i Udhëzuesit janë shqyrtuar në dy punëtori online, gjegjësisht në vitin 2012 dhe 2013.

Koordinatori i aktiviteteve për adresimin e kërcënimeve transnacionale dhe Këshilltari i lartë për polici i falënderohen shumë ekspertëve pjesëmarrës për kontributin e tyre të çmuar dhe gjithëpërfshirës gjatë procesit.

Ekspertët që morën pjesë në procesin hartues janë:

- Z. René Bühler, Kryesues, Divizioni për çështje ligjore, Zyra Federale e Policisë, Departamenti federal i drejtësisë dhe policisë, Zvicër;
- Znj. Estela-Máris Deon, Zyrtare për parandalim të krimit dhe drejtësi penale, Seksioni i drejtësisë, Divizioni i Operacioneve, ZKBDK, Vjenë;
- Z. Timothy Del Vecchio, Zyrtar për çështje policore/Këshilltar për luftën kundër krimit, OSBE Departamenti kundër Kërcënimeve Transnacionale/ Njësia për Çështje Strategjike Policore (DKT/NjÇSP), Vjenë;
- Z. Mark Downes, Kryesues i Ekipit Këshillëdhënës për Sektorin e Sigurisë Ndërkombëtare (ISSAT), Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (KDFA), Gjenevë;
- Z. Knut Dreyer, Këshilltar i lartë i OSBE-së për Polici, OSBE DKT/NjÇSP, Vjenë
- Z. Bruno Hedermann, Këshilltar për çështje kufitare, Departamenti kundër Kërcënimeve Transnacionale i OSBE-së/ Njësia për Kufij, Vjenë;
- Z. Apollon Hoxha, Zyrtar nacional për analizë dhe raportim, Misioni i OSBE-së në Kosovë, Departamenti për Siguri dhe Rend Publik, Prishtinë;

- Z. Robert Hampshire, Zyrtar për Çështje Politike/Çështje Policore, OSBE DKT/NjÇSP, Vjenë;
- Z. Tor Tanke Holm; Kryesuesi departamentit të studimeve pasuniversitare, Kolegji Universitar për Polici i Norvegjisë, Oslo;
- Z. Øyvind Høyen, Zyrtar për të drejta të njeriut, OSBE ODIHR, Varshavë; 12
- Z. Oliver Janser, Këshilltar për polici dhe kundër-terrorizëm, Zyra e OSBE-së në Tagjikistan;
- Z. Robert Kerep, Kryesues i njësisë për zhvillim strategjik, Departamenti për Zbatim të Ligjit, Misioni i OSBE-së në Serbi;
- Z. Marco Kubny, Këshilltar për punën policore në bashkësi/ Zëvendëskryesues, OSBE DKT/NjÇSP, Vjenë;
- Z. Manuel L. Marion Mainer, Zyrtar i lartë i programit, OSBE Departamenti kundër Kërcënimeve Transnacionale/Njësia për Veprim kundër Terrorizmit, Vjenë;
- Znj. Susanna Naltakyan, Zyrtare nacionale e programit, Aktivitetet politiko-ushtarake, Zyra e OSBE-së në Jerevan;
- Znj. Joanna Perry, Zyrtare për çështje të krimeve nga urrejtja, OSBE ODIHR, Varshavë;
- Z. Valeri Petrov; Menaxher i programit, Zbatimi i ligjit, Misioni i OSBE-së në Mal të Zi;
- Znj. Tetyana Rudenko, Menaxhere nacionale e projektit, Koordinatore e projektit të OSBE-së në Ukrainë;
- Z. Per Håkon Sand, Hulumtues; Kolegji Universitar për Polici i Norvegjisë, Studimet Pasuniversitare Oslo;
- Z. Friedrich Schwindt, Polizeidirektor a.D., Këshilltar për të drejta të njeriut dhe reformë policore; Dyseldorf, Gjermani;
- Znj. Lucile Sengler, Këshilltare për çështje të kundër-terrorizmit, Departamenti për të drejta të njeriut, OSBE ODIHR, Varshavë;
- Znj. Kristina Simion, Zyrtare për sundim të ligjit, Akademia Folke Bernadotte (FBA), Stokholm;
- Znj. Hana Snajdrova, Zyrtare për çështje policore/Këshilltare për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, OSBE DKT/NjÇSP, Vjenë;

- Z. Thorsten Stodiek, Zyrtar për çështje policore/Këshilltar për hulumtim dhe analizë, OSBE DKT/NjÇSP, Vjenë;
- Z. Hiroyuki Yamamoto, Bashkëpunëtor ekspert në çështje të krimit të organizuar, Dega kundër Krimit të Organizuar, Divizioni për Çështje të Traktatit, ZKBDK, Vjenë;
- Z. Asen Yanchev, Këshilltar policor, Kërcënimet Transnacionale, OSBE, Zyra në Baku;
- Znj. Candice Welsch, Zyrtare për kontrollin e drogave dhe parandalim të krimit, Seksioni i Drejtësisë, Divizioni i Operacioneve, ZKBDK, Vjenë.

## **Përmbledhje ekzekutive**

Reformat në polici duhet të plotësohen dhe sinkronizohen me reformat në sektorët e tjerë të Sistemit të Drejtësisë Penale (në tekstin e mëtuftjeshëm 'SDP') në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti i tërë procesit të drejtësisë penale dhe t'i bëjë të qëndrueshme arritjet e reformës në sektorë të ndryshëm të SDP-së. Fokusi kryesor i një qasjeje të tillë tërësore reformuese duhet të qëndrojë në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe institucioneve të tjera të SDP-së, si dhe në bashkëpunimin e SDP-së me agjencitë e tjera qeveritare, ofruesit joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë dhe shoqërinë civile.

Hapat kryesorë për planifikimin dhe zbatimin e një qasjeje të tillë tërësore në reformën policore në kuadër të Reformimit të Sistemit të Drejtësisë Penale (në tekstin e mëtuftjeshëm 'RSDP') përfshijnë, si vijon:

### ***Vlerësimet tërësore të SDP-së***

Reforma tërësore e policisë në kuadër të RSDP-së duhet të bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të kontekstit të reformës nacionale, duke përfshirë kornizën ligjore, strukturat dhe akterët relevantë, performancën e tyre, e në veçanti nevojën publike për siguri dhe drejtësi, meqë përmirësimi i shërbimit të drejtësisë penale është në thelb të RSDP-së.

Grupet e synuara për një vlerësim të tillë duhet të jenë të gjitha institucionet relevante të SDP-së, me të cilat agjencitë e zbatimit të ligjit janë të ndërlidhura në procese të drejtësisë penale, siç janë: avokatët mbrojtës/odat e avokatëve, zyrat e prokurorisë, gjykatat dhe institucionet korrektuese. Në emër të institucioneve të ofrimit të sigurisë, mund të adresohen edhe ushtria dhe shërbimet kufitare gjithashtu.

Përveç Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë, të cilat kanë rol të drejtpërdrejtë në qeverisjen e SDP-së, duhet të afrohen edhe ministrinë e tjera relevante siç janë ajo e mbrojtjes, financave dhe punëve të jashtme, institucionet legjislativë dhe politikëbërëse, si dhe institucionet administrative dhe të mbikëqyrjes publike.

Shoqëria civile luan një rol kyç në sigurimin e një pasqyrimi gjithëpërfshirës të nevojave të publikut për siguri dhe drejtësi dhe perceptimit publik për performancën e SDP-së. Për të marrë një pasqyrim që paraqet nevojat dhe pikëpamjet e publikut, duhet të konsultohen një sërë organizatash dhe aktorësh që përfaqësojnë pjesë të ndryshme të shoqërisë.

Për të përcaktuar vlerën e shtuar të iniciativës të vetë RSDP-së dhe me qëllim të shmangies së duplikimit të angazhimeve të akterëve të tjerë ndërkombëtarë, kërkohet një analizë e thuktë e iniciativave të RSDP-

së e aktorëve të tjerë ndërkombëtarë. Kjo madje do t'i parandalojë edhe konceptet kontradiktore dhe kundërthënëse që mund të sjellin huti në mesin e përfituesve të asistencës. Vlerësimi gjithashtu duhet të ketë për cak shqyrtimin nëse asistenca ndërkombëtare mund të bashkërendohet, pasohet e madje edhe të kombinohet për të ndërtuar angazhime të përbashkëta dhe burime të sigurta.

### ***Krijimi i strategjisë për reformim dhe i planeve të zbatimit***

Bazuar në informacionet e mbledhura në procesin e vlerësimit, duhet të krijohet një strategji reformimi që i definon programet afatgjata dhe projektet afatshkurtra/vjetore, duke iu siguruar të gjithë hisedarëve kuptim të qartë të aktiviteteve të planifikuara.

Strategjia e reformimit duhet të përkufizojë objektiva realiste dhe të arritshme, standard dhe kritere të suksesit që duhet të arrihen brenda një afati të arsyeshëm kohor. Këto standard duhet të përdoren më pas për të vlerësuar suksesin dhe/ose ndikimin e zbatimit të programeve të RSDP-së.

Strategjia për reformim duhet të plotësohet me plane konkrete të veprimit për zbatim të strategjisë, të cilat ofrojnë përshkrim të hollësishtëm se si të vihen në praktikë hapat e ndryshme të zbatimit. Këto plane duhet gjithashtu të identifikojnë ndryshimet dhe burimet e kërkuara organizative për hapat e ndryshme me theks në përdorimin më efikas të burimeve në dispozicion, në vend të sigurimit të pajisjeve të reja.

Cilado strategji për reformim mund të zbatohet me sukses vetëm nëse ka vullnet politik për reforma nga qeveria dhe e mbështetur me zotim për sigurimin e fondeve dhe burimeve të nevojshme. Parakusht për të arritur përkrahje dhe pronësi lokale të plotë për reformën nga hisedarët nacional është që të përfshihen përfaqësuesit relevantë nga institucionet shtetërore si dhe nga shoqëria civile në zhvillimin e strategjisë që nga fillimi, si dhe të reflektohen interesat e të gjithë hisedarëve në programin reformues.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme që të merret parasysh natyra politike e reformës, duke përfshirë të mirat potenciale për akterët e ndryshëm në nivel lokal dhe nacional. Përforcimi i një aktori të SDP-së në kurriz të një aktori tjetër, qoftë ky i perceptuar ose real, mund të shkatërrojë bilancin delikat politik ndërmjet institucioneve dhe të shkaktojë rezistencë nga ana "humbëse".

Për më tepër, nëse publiku nuk vëren të mira të menjëhershme për të, me ndjenjën që reforma nuk e përmirëson dhe nuk do ta përmirësojë sigurinë e tyre dhe qasjen në drejtësi, ai nuk do ta përkrah procesin e reformës gjë që e pamundëson qëndrueshmërinë e reformës.

## ***Reformimi i kornizës ligjore***

Ligji i zbatueshëm i një vendi mund të ketë nevojë për modifikime për t'iu përshtatur më mirë të drejtave të njeriut dhe standardeve të drejtësisë penale të zbatuara botërisht, të miratuara nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara dhe në përputhje me zotimet e OSBE-së për të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe sundim të ligjit.

Më tej, ligji penal i një vendi mund të ketë nevojë të përditësohet për ta përshtatur atë me mjedisin ndryshues të normave sociale dhe zakoneve, si dhe për t'i adresuar kërcënimet e reja që dalin nga format e reja të terrorizmit dhe krimit, në veçanti krimi i organizuar. Si rrjedhim, ligjet e reja penale mund t'i adresojnë veprat e reja penale si dhe mjetet apo mënyrat e reja hetuese. Dispozitat e reja në ligjet e procedurës penale duhet të kontrollohen sa i përket ndikimit të tyre në marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-ve. Me prezantimin e detyrave, përgjegjësisve dhe mjeteve të reja për SDP-të, shpërndarja e re e definuar e pushtetit ndërmjet institucioneve të SDP-së mund të ketë nevojë për sqarim në ligjin e ri.

## ***Krijimi i politikave, procedurave, rregullave dhe rregulloreve***

Për ta përkthyer legjislacionin në vepra dhe zbatuar atë në praktikë, duhet të miratohen politika që e përkufizojnë se si do të zbatohet ligji. Për më tepër, politikat dhe masat e nevojshme për t'i zbatuar ato duhet të shprehen në "deklarata të qarta formale të politikave", të cilat do t'i sqaronin në disa fjalë të përmblëdhura objektivat që shteti dhe SDP përpiqen t'i arrijnë me futjen e politikave në fjalë.

Strategjitë dhe planet e veprimit për zbatimin e këtyre politikave dhe procedurave korresponduese, rregullave dhe rregulloreve, si dhe për monitorimin e zbatimit të tyre duhet të krijohen nga autoritetet shtetërore dhe SDP-të në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe ofruesit joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë.

Politikat duhet të njohin e pranojnë në mënyrë të qartë rëndësinë e komunikimit dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së dhe ndërmjet strukturave formale të SDP-ve dhe atyre joformale, si dhe shoqërisë civile përkritazi me efikasitetin dhe efektivitetin e shtuar të procesit të drejtësisë penale. Prandaj, politikat duhet gjithashtu të promovojnë dhe lehtësojnë zbatimin e nevojshëm të reformës organizative dhe strukturore për të siguruar mjedisin për bashkëpunim dhe komunikim të përmirësuar.

Veç kësaj, politikat për reformën organizative dhe strukturore të SDP-ve duhet t'i adresojnë çështje ndërsektoriale, si mbrojtja e të drejtave të njeriut, normëzimi gjinor në procesin e drejtësisë penale dhe krijimi ose shtimi i



procedurave dhe mekanizmeve të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes.

Në nivel operacional, duhet të futen rregulla, rregullore, procedura standarde të veprimit dhe udhëzues që drejtojnë operacionalizimin e ligjit dhe politikave në mesin e institucioneve të SDP-së gjatë procesit të drejtësisë penale.

### ***Reforma strukturore dhe organizative***

Ndryshimet në strukturë dhe organizim në institucione të ndryshme të SDP-së, e në veçanti në pikat takuese ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së, duhet të synojnë:

- sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit efikas dhe efektiv ndërmjet policisë dhe parterëve të saj në SDP, ndërmjet SDP-së dhe ofruesve zakonor dhe joshtetëror të sigurisë dhe drejtësisë si dhe shoqërisë civile;
- racionalizimin e resurseve në dispozicion;
- krijimin e shërbimeve dhe lehtësirave të përbashkëta, sipas nevojës;
- promovimin e respektimit të sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; dhe
- realizimin dhe sigurimin e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes demokratike të institucioneve të SDP-së.

Fushat kyçe të reformës strukturore dhe organizative janë, si vijon:

#### ***Bashkëpunimi me SDP***

Puna e përbashkët kërkon bashkëpunim ndërmjet agjencive, vizion të përbashkët për SDP efektive dhe respektim të punës së pavarur të secilit partner. Derisa llogaridhënia e përgjithshme politike për institucionet e hetuesisë, ndjekjes dhe gjykimit duhet të mbetet e ndarë, megjithatë ekziston nevoja për një mekanizëm që siguron një lloj drejtimi qendror dhe menaxhim të përbashkët të procesit të arritjes së objektivave të përbashkëta.

Në nivel strategjik dhe menaxherial, duhet të themelohen grupe drejtuese ndërinsticionale të SDP-së që bashkërendojnë dhe monitorojnë zbatimin e strategjive tërësore dhe planeve të punës të RSDP-së. Ato duhet të marrin në konsideratë ndikimin që do të kishin ndryshimet e bëra në një agjenci në një tjetër.

Në mënyrë që të institucionalizohet bashkërendimi ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së, do të mund të krijoheshin forume bashkërenduese ndërinsticionale, të përbëra nga përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve të ndryshme të SDP-së në nivel ministror dhe të menaxhmentit të agjencisë. Ato do të merrnin detyrën e sigurimit të udhëzimit të përgjithshëm të SDP-së.

Në nivel lokal, forumet bashkërenduese nacionale të drejtësisë penale duhet të kopjohen nga forumet lokale, të cilat në përbërje do të kishin, për shembull, kryesuesit lokalë të institucioneve të SDP-së, përfaqësues nga shërbimet shëndetësore, këshilla të delikuentëve së të miturve, agjenci të tjera komunale, ofruar joshitetëror të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

Në nivel operacional, bashkërendimi i aktiviteteve dhe bashkëpunimi në procedimin e rasteve mund të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme nëse krijohet infrastruktura fizike për takime, diskutime dhe shkëmbim të informacioneve dhe qëndrimeve ndërmjet aktorëve të institucioneve të ndryshme të SDP-së.

Disa prej intervenimeve me ndikim të gjerë në ngritjen e infrastrukturës fizike do të ishin: bashkimi i zyrave të policisë me ato të prokurorisë; vendosja e prokurorëve në zyra të policisë; dhe/ose themelimi i ekipeve speciale të përbashkëta të hetuesisë ose task-forca të vendosura në një zyrë. Edhe në raste kur themelimi i një infrastrukture të tillë fizike është i pamundur në një vend, shpesh ka, së paku, mundësi për të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme komunikimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm të SDP-së. Për shembull, kjo mund të arrihet duke caktuar takime të rregullta, e në veçanti përmes veglave të komunikimit që ruhen elektronikisht dhe që parandalojnë humbjen apo keqinterpretimin e informacionit.

### *Veglat për ruajtjen e shënimeve dhe shkëmbim të informacionit*

Mbajtja e shënimeve të sakta është e rëndësishme jo vetëm për ndërtimin efikas të rasteve të fuqishme kundër personave të akuzuar, por edhe për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurve për t'u mbrojtur, për shembull, duke ju ofruar atyre qasje në shënimet për veprimet e ndërmarra gjatë hetimit dhe gjetjet nga këto veprime.

Për t'i menaxhuar këto shënime, ato duhet të mbledhen dhe organizohen në baza elektronike të të dhënave. Teknologjia moderne e informimit dhe e komunikimit dhe provat digjitale i sigurojnë SDP-së mundësi për të racionalizuar dhe thjeshtëzuar sistemet dhe proceset administrative.

Megjithatë, duhet kushtuar kujdes që sistemet e të dhënave të institucioneve të ndryshme të SDP-së të jenë në gjendje të komunikojnë mes tyre për të mundësuar procedimin e integruar të të dhënave nga ngritja e akuzave e deri në përmbyllje. Mënyra më efektive dhe efikase e organizimit të një sistemi të menaxhimit të dosjeve të rastit do të ishte krijimi i një baze të përbashkët të dhënash ndërmjet institucioneve të SDP-së që do të lejonte shkëmbimin e të dhënave në dosje elektronike. Pasi të jetë krijuar, dosja e tillë duhet t'i përmbajë dhe regjistrojë të gjitha dokumentet dhe informacionet

për çdo rast dhe të ketë rrjedhë të shpejtë në tërë SDP-në. Qasja e të gjithë aktorëve të SDP-së në këto baza të dhënash të dosjeve të rastit gjithashtu do të lejonte edhe kategorizimin e informacioneve të lidhura me raste për të pandehurit, viktimat, rezultatet apo çdo gjë tjetër në sistem, informata këto që mund të jenë të rëndësishme në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të tjera.

Sistemet efektive të përcjelljes së rastit dhe menaxhimit jo vetëm që e shpejtojnë procesin e ndjekjes, por gjithashtu mundësojnë edhe vlerësim më të mirë të punës së hetuesve dhe prokurorëve, gjë shumë e rëndësishme kjo sa i përket llogaridhënies së SDP-së.

Sistemet e integruara të dosjeve të rastit mund të krijohen njëkohësisht ose në vazhdimësi, varësisht nga burimet financiare, për trajnim dhe menaxhim të ndryshimeve.

### *Kapacitetet mjeko-ligjore*

Shërbimet mjeko-ligjore janë tejet të rëndësishme për një sistem efektiv dhe të drejtë të drejtësisë penale meqë sigurojnë informacione objektive dhe me kohë që përdoren nga policia për t'i identifikuar të dyshuarit në fazën e hetuesisë dhe nga përfaqësuesit ligjorë dhe gjyqtarët gjatë fazës së gjykimit në procesin e drejtësisë penale. Rrjedhimisht, shërbimet mjeko-ligjore duhet të ofrohen nga një subjekt shumë i kualifikuar dhe i paanshëm në mënyrë efektive dhe efikase. Kjo kërkon ekspertë me shkollim përkatës të mirë dhe shkencor dhe praktikues të drejtësisë penale, të cilët i kuptojnë përfundimet që mund të dalin nga testimet shkencore, si dhe bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet të gjitha institucioneve gjegjëse të përfshira në njohjen, mbledhjen, analizimin, interpretimin dhe paraqitjen e provave mjeko-ligjore në procesin e drejtësisë penale.

### *Bashkëpunimi ndërmjet SDP-së dhe ofruesve zakonorë/joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë*

Në shtete ku ofruesit zakonorë dhe joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë kanë rol plotësues në ofrimin e sigurisë dhe drejtësisë, duhet të vendosen masa mbikëqyrëse të SPD-së dhe mekanizma për shkëmbim të informacioneve ndërmjet institucioneve zakonore e joshtetërore dhe SDP-së.

Përkitazi me ofrimin e sigurisë, organizatat e llojit të vetëgjyqësisë, duke përfshirë këtu skemat e rojeve të lagjes, mund të jenë instrumente të përshtatshme për përfshirjen e komunitetit në zgjidhjen e problemit, promovimin e komunikimit rutinë ndërmjet publikut dhe policisë, si dhe përforcimin e ndjenjës së përgjegjësisë së komunitetit për sigurinë e tyre. Duhet të miratohen rregullore të qarta dhe rigorozë për këto organizata

që i kufizojnë ato vetëm në rolin monitorues dhe raportues, derisa e drejta ekskluzive e forcës mbetet në duart e policisë. Policia duhet gjithashtu të ketë rol mbikëqyrës dhe bashkërendues, duke marrë përgjegjësi për veprimet e këtyre organizatave.

Kundrejt një pagese, shërbimet civile private të sigurisë ofrojnë shërbime që lidhen me siguri, siç janë mbrojtja ose ruajtja e njerëzve, mallrave, vendeve, lokacioneve, ngjarjeve të organizuara, proceseve dhe informacioneve kryesisht nga rreziqet që ndërlidhen me krim. Ato mund t'i mbështesin agjencitë e zbatimit të ligjit ose madje t'i plotësojnë aktivitetet e tyre, aty ku ligji e lejon. Sidoqoftë, roli, përgjegjësitë dhe raporti i tyre me policinë duhet të definohet qartë.

Mekanizmat tradicional të zgjidhjes së kontesteve, duke i përfshirë këtu gjykatat zakonore, gjithashtu kanë rol të rëndësishëm në disa shtete. Është e rëndësishme që të përcaktohet shkalla e përshtatshme e integritimit të sistemeve formale dhe zakonore/joshtetërore që mund të përfshijë juridiksion të kufizuar për sistemet zakonore të drejtësisë, zakonisht i kufizuar në krime të lehta; pranimi i zgjidhjeve zakonore si formë legjitime e marrëveshjes jashtëgjyqësore; ose inkorporimi i gjykatave zakonore në rangun më të ulët të gjyqësorit formal.

Sidoqoftë, praktikat e të gjithë këtyre ofruesve zakonorë dhe joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë duhet të jenë në vijë me standardet ndërkombëtare për të drejta të njeriut dhe duhet të jenë transparent dhe llogaridhënës në punën e tyre.

### *Bashkëpunimi ndërmjet SDP-së dhe shoqërisë civile*

Krahas përfshirjes së shoqërisë civile në krijimin dhe zbatimin e hapave të RSDP-së dhe zhvillimin e mbikëqyrjes së jashtme të SDP-së, ka disa fusha specifike që lidhen me sigurinë dhe drejtësinë ku bashkëpunimi i SDP-së me shoqërinë civile mund të përmirësojë në mënyrë domethënëse administrimin e drejtësisë penale. Shembujt karakteristik do të ishin, për shembull, parandalimi i krimit në kuadër të fushës së punës policore në bashkësi, ose përfshirja e shoqërisë civile në programe të diversionit ose ndërmjetësimit.

Parandalimi i krimit kërkon zotim dhe pronësi të përbashkët të policisë dhe publikut. Kjo mund të arrihet vetëm përmes partneriteteve të besueshme polici-publik, ku e tërë organizata policore, të gjitha agjencitë qeveritare dhe të gjithë segmentet e shoqërisë bashkëpunojnë në mënyrë aktive në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve. Puna policore në bashkësi është filozofi dhe strategji organizative që promovon një qasje të tillë bashkëpunuese të bazuar në partneritet. Programet ndërvetëpruese të kontaktimit të komunitetit, si krijimi

i forumeve formale dhe joformale për diskutime të hapura ndërmjet policisë dhe përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve janë posaçërisht të vlefshme për t'i marrë pikëpamjet e publikut dhe për promovimin e shkëmbimit të qëndrimeve dhe bashkëpunimit. Kjo mund të sjell përfshirjen e komunitetit në programet e parandalimit të krimit, duke përfshirë këtu edhe përmes ndërtimit të koalicioneve për zgjidhje të problemeve, si dhe për zhvillimin e një ndjenje të përgjegjësive së përbashkët për rritjen e sigurisë publike. Kërkohet kujdes i veçantë për të siguruar përfaqësimin në këto forume të një pjese të gjerë të shoqërisë, duke përfshirë pakicat dhe grupet e cënueshme.

Programi i diversionit të drejtësisë penale është një alternativë dhe/ose procedurë plotësuese për proceset e rëndomta penale, ku për zgjidhje të konfliktit shpesh përfshihet komuniteti. Programet e diversionit i sigurojnë të akuzuarit mundësinë e shmangies së dosjes së qasshme penale dhe marrjen e asistencës së duhur përmes rehabilitimit, këshillimit dhe/ose trajtimit, ndërsa viktimat ose komuniteti si tërësi përfitojnë nga donacionet ose puna pa pagesë në dobi të komunitetit tek shoqatat e ndryshme të bamirësisë ose projekte të komunitetit lokal. Programet e diversitetit për të mitur janë veçanërisht të rëndomta. Akterët e shoqërisë civile mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e programeve të diversitetit, meqë ata mund të punojnë, t'i rehabilitojnë dhe riintegrojnë kryerësit e veprave dhe të monitorojnë dhe ofrojnë përkrahje për pjesëmarrësit në programe të diversitetit.

Ndërmjetësimi në çështje penale është një tjetër opsion fleksibil, i orientuar në zgjidhje të problemit dhe pjesëmarrje që është plotësim ose alternativë ndaj procedurave tradicionale penale dhe shpesh përfshinë përfaqësues të shoqërisë civile si ndërmjetës.

Në të gjitha këto procedura alternative ndaj procedurave tradicionale penale, të drejtat e të dy palëve, si të viktimave ashtu edhe të kryerësve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe autoriteteve të drejtësisë penale dhe raporti i tyre i ndërsjellë duhet të përkufizohen qartë me ligj, politika, rregullore dhe procedura.

### *Aspekte të të drejtave të njeriut*

Sistemi i drejtë, efektiv dhe efikas i drejtësisë penale i mbron të drejtat e individëve për siguri personale, jetë dhe liri, si dhe siguron qasje në drejtësi dhe barazi para ligjit. Për më tepër, ai respekton të drejtat themelore të viktimave, dëshmitarëve, si dhe të dyshuarve dhe kryerësve, duke përfshirë në veçanti të drejtat e të miturve dhe të grupeve të tjera të cënueshme. Fushat e veçanta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ku bashkëpunimi efektiv ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së dhe shoqërisë civile është jetik, janë, mes tjerash, qasja në drejtësi dhe sigurimi i ndihmës juridike,

asistenca për viktimat, ndihma dhe mbrojtja e dëshmitarëve, menaxhimi i integruar i kryerësve të veprave, dhe drejtësia për të mitur.

### *Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e SDP-së*

Llogaridhënia nënkupton që institucionet e SDP-së – nga sjellja e një praktikuesi individual të SDP-së e deri te strategjitë për menaxhimin e procesit të drejtësisë penale, procedurat e emërimit ose menaxhimi i buxhetit – janë të hapura për mbikëqyrje nga institucione të ndryshme të mbikëqyrjes.

Legjislativi është përgjegjës për përcaktimin e kufijve të kornizës në të cilën operojnë institucionet e SDP-së. Ekzekutivi është përgjegjës për zbatimin e kornizës së SDP-së; dhe gjyqësori dhe legjislativi janë përgjegjës për të vlerësuar nëse korniza është zbatuar si duhet. Përveç këtyre tre shtyllave mbikëqyrëse të shtetit, ka struktura të ndryshme të jashtme joshtetërore si komisionet për të drejta të njeriut, bordet civile për shqyrtim të ankesave, avokatët e popullit dhe mediat që mund të luajnë rol thelbësor në mbikëqyrjen e SDP-së.

Organizatave të shoqërisë civile mund të zhvillojnë aktivitete të ndryshme të mbikëqyrjes si, p.sh, mbledhja e informacioneve dhe raportimi për shkelje të të drejtave të njeriut dhe forma të tjera të sjelljes së pahijshme nga institucionet e SDP-së, shqyrtimi i ngarkesës me lëndë, monitorimi dhe raportimi për kushtet në paraburgim dhe ato në burgje, pjesëmarrja dhe komentimi i gjykimeve, si dhe analizimi dhe raportimi për trendet e performancës në drejtësi penale.

Për ta përmbushur mandatin tyre të mbikëqyrjes në mënyrë efektive, institucionet e brendshme dhe të jashtme të mbikëqyrjes kanë nevojë për resurse të mjaftueshme, pushtet ligjor dhe pavarësi nga ndikimi i ekzekutivit.

### *Ndryshimi i kulturës së punës*

Të gjitha ndryshimet në strukturë dhe organizim në nivel operacional dhe menaxherial, në pajtim me ligjet e reja, politikatat dhe rregulloret, do të kenë ndikim të vogël pa një kulturë bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së.

Ndryshimi i kulturës së punës mund të kërkojë ngritje të nivelit të besimit të ndërsjellë, kuptim dhe vlerësim të rolit, përgjegjësive dhe nevojave të të gjitha institucioneve të SDP-së ndërmjet tyre, si dhe ndërtimin e një pikëpamjeje të përbashkët për thelbin e rendit dhe ligjit.

Nëse kërkesa për bashkëpunim dhe bashkërendim të shtuar i sfidon marrëdhëniet e pushtetit ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së, duhet pritur rezistenca nga ana "humbëse". Policia ose prokurorët mund gjithashtu të hezitojnë të përshtaten ndaj ndryshimeve, veçanërisht nëse përgjegjësitë për hetime janë transferuar nga njëra organizatë në tjetrën.

Për më tepër, një interpretim i caktuar i doktrinës së ndarjes së pushteteve që e përkrah kërkesën e gjyqësorit për pavarësi nga qeveria ekzekutive shpeshherë e pengon zhvillimin e frymës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet gjykatave dhe institucioneve të tjera të SDP-së.

Kultura e punës e institucioneve të SDP-së jo vetëm që duhet të ndryshohet përkitazi me qëndrimet e SDP-së për bashkëpunim të brendshëm, por gjithashtu edhe sa i përket ndërveprimit me publikun. Për ta inkurajuar publikun që të ndajë përgjegjësinë për ngritjen e cilësisë së jetesës së komunitetit, e me këtë të përkrahët në mënyrë aktive policia në përpjekjet e saj për kontrollimin dhe parandalimin e krimit, policia duhet të synojë vendosjen e një partneriteti të vërtetë me publikun. Vullneti për ta pranuar publikun si partner të barabartë varet gjithashtu nga ndryshimi i mendësive dhe qëndrimeve të policisë dhe aktorëve të tjerë të drejtësisë penale që mos të reagojnë më tepër se sa duhet ndaj kritikave të publikut lidhur me performancën e SDP-së, si dhe të bëhen më të hapur ndaj parimeve të llogaridhënies dhe transparencës.

Ndryshimi i kulturës së punës të institucioneve të SPD-së mund, megjithatë, të jetë detyrë sfiduese meqë aranzhimet organizative dhe pikëpamjet e punës të punonjësve të SDP-së mund të jenë aq shume të rrënjosura sa që është e vështirë të ndryshohen. Prandaj, reforma kërkon qasje të shëndoshë të ndryshimit të menaxhimit që merr parasysh rezistencën e trashëguar ndaj ndryshimeve si nga individët ashtu edhe nga organizatat, identifikimin e shtytësve të ndryshimeve dhe përkrahjen e tyre dhe kontrollin e planprishësve të mundshëm, si dhe komunikimin e gjerë të SDP-së për nevojën për ndryshim dhe përfitimet e mundshme nga kjo për të gjithë hisedarët dhe për rolin e aktorëve të SDP-së në zbatimin e ndryshimit. E fundit nga këto, do të përfshinte gjithashtu nxjerrjen e procedurave standard të veprimit (PSV) dhe sigurimin e trajnimit përkitazi me funksionalizimin e tyre.

### *Trajnimi dhe ngritja profesionale*

Për ta ndryshuar kulturën, duke përfshirë këtu qëndrimet dhe sjelljen e aktorëve të SDP-së, sigurimi i politikave, kodet e mirësjelljes dhe PSV-të, si dhe artikulimi i rregullt dhe konsistent i vlerave të lidhura duhet të plotësohen nga menaxhmenti me trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm në vend të punës dhe aktivitete të zhvillimit profesional. Në procesin e zhvillimit profesional, mbikëqyrësit mund t'i përforcojnë dhe mbajnë ndryshimet në

mesin e punonjësve dhe të sigurojnë sjellje të duhur përmes veprimeve të mentorimit, inkurajimit, shpërblimit dhe disiplinimit. Ndryshimi i vlerave dhe qëndrimeve, duke përfshirë këtu stereotipat që shpeshherë janë të rrënjësura në mesin e të rriturve, është posaçërisht sfidues dhe kërkon trajnues të shkathtë dhe procese afatgjata.

Praktikuesit e SDP-së duhet gjithashtu të informohen për kodet e procedurës penale që rregullojnë rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme të SDP-së, si dhe kontekstin në të cilin operojnë institucionet e tjera të SDP-së. Kjo është thelbësore për të ngritur vetëdijen për nevojat e të gjithë aktorëve të SDP-së që punojnë në pikat e përbashkëta takuese në mënyrë që të mundësohet një proces efektiv dhe efikas i drejtësisë penale.

Temat e përgjithshme ndërsektoriale të trajnimit për shtim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet institucioneve të SDP-së mund të përfshijnë trajnim të menaxhimit të përgjithshëm dhe të zhvillimit ekzekutiv, si dhe metodat e bashkëpunimit ndërinstitutional, përfshirë këtu përgatitjen e rasteve për t'i dërguar në gjykim.

Për praktikuesit e drejtësisë penale rekomandohet trajnim i përbashkët i specializuar i hetuesisë për trajtimin e krimeve specifike, si sulmet seksuale, dhuna familjare, trafikimi me qenie njerëzore, drogat dhe prekursorët e ndaluar me ligj, krimet ekonomike, krimet financiare duke përfshirë shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, korrupsioni dhe krimi kibernetik.

Për më tepër, trajnimi duhet t'i adresojë edhe kërkesat për shtim të bashkëpunimit të SDP-së me ofruesit joshitetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe me shoqërinë civile.

E fundit, por jo për nga rëndësia, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duhet të jenë pjesë përbërëse e të gjitha llojeve të kurseve të trajnimit bazik, të avancuar dhe të specializuar ose programeve edukative për punonjësit e SDP-së.

### ***Vlerësimi dhe shqyrtimi i RSDP-së***

Futja në zbatim e Reformës tërësore të Sistemit të Drejtësisë Penale është angazhim afatgjatë që ka nevojë për vlerësime ciklike, të cilat duhet të lidhen me ciklin e politikave, duke ia mundësuar nivelit strategjik përmirësimin sistematik dhe të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të SDP-së.

Duhet pasur kujdes për të siguruar që çfarëdo kornize monitoruese dhe vlerësuese të përmbajë gamë mjaftueshëm të gjerë të indikatorëve cilësorë dhe sasiorë. Kriteret e përgjithshme për vlerësimin e proceseve të zbatimit të RSDP-së, në përputhje me kriteret e Komisionit të Asistencës për Zhvillim (KAZh) të OBZhE-së për vlerësimin e asistencës për zhvillim, janë:



relevanca, efikasiteti, efektiviteti, ndikimi dhe qëndrueshmëria e iniciativave reformuese. Përfundimisht, kriter për vlerësimin e suksesit të iniciativave brenda institucioneve të ndryshme të SDP-së dhe për vlerësimin e ndikimit në procesin e drejtësisë penale në përgjithësi do të ishte shkalla e ndryshimeve strukturore dhe organizative që adreson themelimin e një kornize ligjore, lehtëson bashkëpunim dhe bashkërendimin e ngushtë brenda SDP-së, zhvillimin e strukturave të komunikimit dhe bashkërendimit, ndarjen dhe sigurimin e resurseve dhe trajnimeve, si dhe krijimin e mekanizmave transparente, të drejta dhe efektive të llogaridhënies.

Bazuar në vlerësimin e procesit të zbatimit dhe rezultateve të tij, duhet të fillohet procesi i shqyrtimit, i cili përfshin të gjithë hisedarët dhe që fokusohet në të gjitha fazat e procesit të zbatimit. Të gjitha aktivitetet strategjike, strukturore, organizative dhe operacionale që nuk janë dëshmuar të suksesshme në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të procesit të drejtësisë penale gjatë një periudhe më të gjatë kohore duhet të ridizejohen hollësisht.

### ***Qasjet e integruara të RSDP-së ndërmjet organizatave ndërkombëtare të asistencës për reformim***

Konsultimet e ngushta ndërmjet hisedarëve ndërkombëtarë të përfshirë në RSDP janë thelbësore për krijimin e synimeve tërësore dhe plotësuese të reformës dhe për t'iu dhënë homologëve nacionalë deklaratë koherente dhe të përbashkëta të synimeve dhe pritjeve, si dhe për të shmangur filozofinë kontradiktore të projekteve dhe metodologjive të zbatimit që mund të sjellin huti të konsiderueshme dhe frustrim në mesin e përfituesve të programit, duke i përfshirë këtu institucionet e SDP-së dhe shoqërinë civile. Duke i pasur parasysh resurset e pakta financiare e njerëzore, bashkëpunimi ndihmon në krijimin e angazhimeve të përbashkëta, në delegimin dhe ndarjen e detyrave, si dhe shmangien e dyfishimit të angazhimeve dhe donacioneve me pajisje të papërshtatshme.

Qartazi, përfituesit e asistencës ndërkombëtare të RSDP-së duhet të përfshihen në aktivitetet planifikuese dhe bashkërenduese ndërkombëtare të reformimit, posaçërisht për të promovuar pronësinë e tyre lokale të procesit të reformimit. Bashkërendimi në emër të përfituesve mund të lehtësohet nga celulat bashkërenduese ose grupet drejtuese brenda grupeve kyçe nacionale të zbatimit, ose nga ndonjë agjenci udhëheqëse në mesin e aktorëve ndërkombëtarë të përzgjedhur nga qeveria nikoqire që do fuqizohet dhe do të merrte përsipër bashkërendimin e aktiviteteve të të gjitha agjencive të jashtme dhe hisedarëve të përfshirë.

### ***Qasjet e integruara të RSDP-së brenda Organizatave ndërkombëtare të asistencës për reformim***

Qasja tërësore për reformën në polici brenda kornizës së RSDP-së natyrisht që kërkon një qasje të integruar në kuadër të një organizate që ofron asistencë, ku të gjitha departamentet e misionit dhe brenda selisë qendrore/ sekretariatit të organizatës i bashkërendojnë, sinkronizojnë dhe i plotësojnë ngushtë aktivitetet e tyre gjatë fazave të planifikimit, vlerësimit, zbatimit dhe shqyrtimit.

Për të siguruar një qasje të tillë tërësore, duhet të merret në konsideratë futja në funksion e njësive të RSDP-së, apo së paku pozitive të zyrtarëve të ndërlidhjes në misionet në terren, të cilët do të bashkërendonin dhe lehtësonin RSDP-në në shtetet e tyre dhe do të komunikonin ngushtë me homologët relevantë në selitë/sekretariatet e tyre qendrore. Këto njësi/ zyrtarë ndërlidhës duhet të gjenden në nivel strategjik në zyrën e kryesuesit të misionit për të siguruar që posedojnë fuqi të mjaftueshme politike dhe burokratike për të lejuar një qasje të bashkërenduar dhe plotësuese të departamenteve gjegjëse të misionit

Kërkesë themelore për një qasje konsistente dhe koherente tërësore nga organizatat ndërkombëtare është, së pari, që departamentet e ndryshme të misionit të jenë të bindura për nevojën për zbatimin e qasjeve të RSDP-së tërësore ndërsektoriale, dhe të kenë vullnet për integrimin e projekteve të tyre vetanake të reformimit në një qasje ndërdimensionale të misionit dhe, së dyti, të jenë të vetëdijshme për nevojat specifike dhe kornizat e kontekstit të institucioneve të ndryshme të SDP-së në vendet nikoqire dhe në departamentet e tjera të misionit. Dokumentet udhëzuese strategjike dhe operacionale për RSDP tërësore dhe përgatitjet e hollësishme të përbashkëta të stafit të misionit janë thelbësore për transmetimin e dijës dhe të menduarit të kësaj natyre.

# I. Hyrje

Reformimi i sistemit të drejtësisë penale (RSDP) është bërë prioritet për bashkësinë ndërkombëtare në angazhimet e saj të asistimit të shoqërive në tranzicion dhe atyre të dala nga konflikti në vendosjen ose rivendosjen e sundimit të ligjit. RSDP ndodh gjithashtu edhe në shumë demokraci të zhvilluara, ku identifikohet nevoja për përmirësim të efikasitetit dhe efektivitetit të procesit të drejtësisë penale.

Që nga viti 1998, aktivitetet e OSBE-së që lidhen me politika janë shndërruar në element kyç të kontributit të OSBE-së në këto angazhime ndërkombëtare. Disa nga mësimet e nxjerra në zbatimin e këtyre aktiviteteve janë që arritjet dhe qëndrueshmëria e tyre në përmirësimin e efektivitetit operacional të policisë mund të dobësohet nga zhvillimet e pamjaftueshme në reformimin e sistemit më të gjerë të drejtësisë penale, p.sh., në sistemin ligjor, gjyqësor dhe atë të korrektimit. Megjithatë, mungesa e reformës në fushat e tjera të drejtësisë penale kishte ndikim negativ në arritjet reformuese të policisë.

Për shembull, ka fare pak dobi nga sigurimi i ndërtimit të kapaciteteve të avancuara mjeko-ligjore për policinë nëse provat mjeko-ligjore nuk mund të shfrytëzohen në gjykatë për shkak të mungesës së bazës legjislative dhe shkathtësive të nevojshme profesionale të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Gjithashtu, mungesa e komunikimit ndërmjet policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve, duke përfshirë këtu edhe mekanizmat e pamjaftueshëm të ruajtjes dhe shkëmbimit të informacioneve dhe të përcjelljes së rasteve të veprave penale, e pengon mjaft bashkërendimin në procedura penale. Kjo mund të rezultojë në vonesa të procedurave penale dhe në krijimin e dosjeve të pakompletuara të hetimit që mund të çojë deri te pushimi i rasteve para ngritjes së akuzave, ose në vendime të nxjerra pa pasur njohuri se në mesin e të pandehurve ka recidivistë.

Për më tepër, të dyshuarit e kapur nga policia mund të lirohen rregullisht për shkak të gabimeve në procesin gjyqësor ose korrupsionit, ose thjeshtë për arsye se nuk ka qeli të mjaftueshme burgu në dispozicion.

Mungesa e gjyqtarëve, prokurorëve dhe, në disa raste, e avokatëve mbrojtës mund të rezultojë në situata ku të paraburgosurit mbahen në paraburgim shumë më gjatë se afati i caktuar ligjor prej 48 ose 72 orësh para se të ngritët akuza ndaj tyre, e madje edhe më gjatë para se të fillojë procesi gjyqësor ndaj tyre.

Sistemet jofunksionale të raportimit dhe menaxhimit të lëndëve dhe paraburgimi panevojshëm i zgjatur para gjykimit shkelin të drejtat e njeriut si të paraburgosurve ashtu edhe të viktimave përkritazi me qasjen në informatat lidhur me lëndën dhe procesin e rregullt penal, si dhe e dëmtojnë

besueshmërinë e tërë sistemit të drejtësisë penale.

Mungesa e progresit në reformimin më të gjerë të SDP-së, duke përfshirë ngecjen ndaj reformave në sistemin gjyqësor ose të korrektimit sa i përket reformës së policisë, mund të sjellë një ndjenjë të pandëshkueshmërisë në mesin e popullsisë dhe të frustrimit e cinizmit në mesin e zyrtarëve policorë, gjë që mund të çojë në sjellje të pahijshme dhe shkelje të ligjit nga këta të fundit.

Mosbesimi i publikut të gjerë në sistemin formal të drejtësisë penale (SDP) mund të sjellë edhe varësi ose mbështetje të shtuar të publikut në mekanizmat e drejtësisë joshjetërore, zakonore, procedurat dhe vendimet e të cilave, megjithatë, mund t'i shkelin dispozitat universale për të drejtat e njeriut.

Në mesin e praktikuesve të SDP-së, politikëbërësve dhe akademikëve është pranuar gjerësisht se reformat në një sektor të SDP-së duhet të plotësohen nga reformat në sektorë të tjerë në mënyrë që të përmirësohet procesi i drejtësisë penale përmes sistemit dhe arrijtet në reforma të bëhen të qëndrueshme.

Në vitin 2004, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara theksoi qartazi se “shtimi i kapaciteteve të policisë [...] për të kryer arrestime nuk mund të shihet si kontribut për sundim të ligjit nëse nuk ka ligje bashkëkohore që zbatohen, nuk ka objekte humane të paraburgimit të furnizuara dhe të pajisura me resurse të duhura dhe me mbikëqyrje ku do të mbahen personat e arrestuar, nuk ka gjyqësor funksional që do t'i gjykonte në mënyrë të drejtë dhe pa vonesa, si dhe nuk ka avokatë mbrojtës për t'i përfaqësuar ata”.<sup>1</sup>

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se rithemelimi i shërbimeve policore do të duhej plotësuar me angazhime për reformim përkthazi me “punën legjislative, parandalimin e krimit, zhvillimin gjyqësor, edukimin ligjor, reformat në burgje, kapacitetet prokuroriale, mbrojtën dhe përkrahjen e viktimave, përkrahjen e shoqërisë civile, rregullimin e shtetësisë dhe identifikimit, si dhe zgjidhjen e kontesteve pronësore”.<sup>2</sup> Për më tepër, strategjitë për RSDP gjithëpërfshirëse dhe tërësore<sup>3</sup> duhet të “përfshijnë vëmendje ndaj standardeve të drejtësisë, ligjeve që i kodifikojnë ato, institucioneve që i zbatojnë ato, mekanizmave që i

---

<sup>1</sup> Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Sundimi i ligjit dhe drejtësia tranzicionale në shoqëritë në konflikt dhe në ato pas konfliktit . Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, S/2004/616, 23 gusht 2004, paragrafi 30, f.10f.

<sup>2</sup> Po aty, paragrafi 24, f. 9.

<sup>3</sup> Qasja tërësore në RSDP bazohet në njohjen e ndërvarësisë së fuqishme ndërmjet elementëve të ndryshëm të SDP-së përkthazi me performancën e tërë SDP-së. Qasja e reformës tërësore, rrjedhimisht, promovon idenë e mos përqendrimit të ndarë apo të veçantë në pjesë të ndryshme të SDP-së, por të reformimit të sistemit si tërësi.

monitorojnë ato dhe njerëzve që duhet të kenë qasje në ato”.<sup>4</sup>

Rrjedhimisht, vendosja e sundimit të ligjit kërkon jo vetëm kapacitete të zbatimit të ligjit dhe ndërtim të institucioneve, por edhe përmirësime të krahasueshme dhe të sinkronizuara në tërë SDP-në, veçanërisht në pikat takuese që e lidhin punën e sektorëve të ndryshëm të SDP-së, si dhe SDP-në me ofruesit jostetërorë të sigurisë dhe drejtësisë gjatë procesit të drejtësisë penale.

Prandaj, qasja tërësore ndaj reformës policore brenda kornizës së RSDP-së kërkon aktivitete reformimi të harmonizuara dhe plotësuese brenda OSBE-së në mesin e komponentëve të saj tematik të ndryshëm, si dhe ndërmjet OSBE-së, organizatave partnere të saj ndërkombëtare dhe hisedarëve nacionalë të proceseve të reformimit.

Bazuar në kornizën e saj politike, qasjen gjithëpërfshirëse dhe ndërdimensionale të sigurisë zbatuar nga strukturat e ndryshme ekzekutive të organizatës dhe praninë e saj afatgjate në teren në disa shtete pjesëmarrëse, OSBE-ja është e pozicionuar mirë për t'i adresuar RSDP-të afatgjata në mënyrë tërësore.

Përderisa shumë organizata ndërkombëtare dhe nacionale kanë filluar të provojnë qasjen gjithëpërfshirëse në RSDP, dhe ndonëse sfidat në këtë qasje janë të njohura mirë në komunitetin ndërkombëtar, ende mungojnë udhëzimet praktike për zbatimin e një qasjeje të tillë tërësore. Në veçanti, nuk ka udhëzime që do t'i adresonin pikat takuese ndërmjet sektorëve të ndryshëm të SDP-së.

Duke i pasur parasysh sfidat e mësipërme të reformimit të policisë në kuadër të RSDP-së dhe bazuar në mandatin për t'i asistuar shtetet pjesëmarrëse në përkrahjen e sundimit të ligjit dhe forcimin e aftësive kyçe të punës policore<sup>5</sup>, dhe për të kushtuar “vëmendje të shtuar në politikat dhe aktivitetet e tij ndaj rolit kyç të sistemeve të drejtësisë penale [...], si dhe për të konsideruar më mirë ndërveprimin ndërmjet komponentëve të këtyre sistemeve”,<sup>6</sup> në vitin 2011, Njësia për Çështje Strategjike Policore e Departamentit të OSBE-së kundër Kërcënimeve Transnacionale (DKT/NjÇSP) iu përvesh punës për krijimin e Udhëzuesit për praktikën e mira në zbatimin e programeve të reformimit të policisë që ndjekin qasjen tërësore në reformimin tërësor të SDP-së. Kjo qasje, më pas, u aprovua nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në vitin 2012 me miratimin e *Kornizës Strategjike të OSBE-së për Aktivitetet që Lidhen me Policinë*, ku rikonfirmojnë se e njohin dhe pranojnë rëndësinë e përkrahjes dhe plotësimit të reformave policore me angazhimet e ndërmarra në sektorë

---

<sup>4</sup> Po aty, paragrafi 23, f. 9.

<sup>5</sup> Cf. OSBE, Strategjia e OSBE-së për adresimin e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe stabilitetit në shekullin njëzetentë, takimi i njëmbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Maastricht, 1 dhe 2 dhjetor 2003, paragrafi. 32

<sup>6</sup> OSBE, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 5/06, Krimi i organizuar, takimi i katërbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Bruksel, 5 dhjetor 2006, paragrafi 11.

të tjerë të sistemit të drejtësisë penale dhe e ngarkojnë OSBE-në me detyrë të krijimit të udhëzimeve në këtë drejtim.

## I.1 Objektivat e Udhëzuesit

Objektivat e Udhëzuesit janë të:

- ngritët vetëdija në mesin e hisedarëve relevantë, siç janë ligjberësit dhe politikëbërësit, donatorët, hulumtuesit, praktikuesit e drejtësisë penale të OSBE-së, organizatat e tjera ndërkombëtare, agjencitë qeveritare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në shtetet pjesëmarrëse, për nevojën e qasjeve tërësore të reformimit të policisë brenda kornizës së RSDP-së;
- identifikohen pikat takuese ndërmjet sektorëve relevantë të SDP-së, siç janë policia, prokuroria, mbrojtja, gjykatat dhe sistemi korrektues, si dhe ofruesit zakonorë dhe joshtetërorë të drejtësisë dhe sigurisë që duhet të adresohen; dhe
- sigurojnë udhëzim për strukturat relevante ekzekutive të OSBE-së, organizatat ndërkombëtare partnere dhe hisedarët relevantë në shtetet pjesëmarrëse se si të arrihen rezultate efektive dhe të qëndrueshme në reformën policore brenda kornizës së RSDP-së bazuar në:
  - aktivitete të harmonizuara (plotësuese dhe sinkronizuese) të reformimit të policisë me aktivitetet reformuese në sektorë të tjerë të SDP-së;
  - bashkëpunimin dhe bashkërendimin e shtuar ndërmjet strukturave të ndryshme ekzekutive të OSBE-së; agjentëve dhe donatorëve të tjerë ndërkombëtarë dhe nacionalë të reformimit, dhe hisedarët nacionalë;
  - bashkëpunimin dhe bashkërendimin e shtuar ndërmjet sektorëve të ndryshëm të SDP-së; dhe
  - bashkëpunimin dhe bashkërendimin e shtuar ndërmjet institucioneve të SDP-së, agjencive të tjera qeveritare, ofruesve joshtetëror të sigurisë dhe drejtësisë dhe shoqërisë civile.

Ka udhëzues të shumtë relevantë në dispozicion për Reformën në Sektorin e Sigurisë (RSS) dhe RSDP-së, në përgjithësi, dhe për reformën policore dhe reformën e elementëve të tjerë të SDP-së, në veçanti. Disa nga shembujt më gjithëpërfshirës dhe të dalluar në mesin e këtyre dokumenteve janë *KAZh OBZhE (Doracaku për reformimin e sistemit të sigurisë)*, Zyra e Kombeve

të Bashkuara kundër Drogave dhe Krimit (ZKBDK) *Vegla për vlerësimin e drejtësisë penale* dhe Udhëzuesi i ZKBDK-së për *Reformën e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti*, që përshkruan në hollësi elementet esenciale të reformimit të SDP-së.

Prandaj, ky Udhëzues nuk i përshkruan në hollësi hapat reformues në secilin prej sektorëve të ndryshëm të SDP-së. Në vend të kësaj, ai adreson shkurtimisht dhe në mënyrë të përmbledhur aspekte themelore të reformës në sektorë të ndryshëm të SDP-së dhe siguron referenca për në informacione të tjera të hollësishme në dokumente tjera. Udhëzuesi, gjithashtu, do të shërbejë si çelës për t'i hapur këto dokumente për lexuesin.

Qëllimi kryesor i Udhëzuesit është të plotësojë literaturën ekzistuese duke u fokusuar në pikat takuese ndërmjet sektorëve të ndryshëm të SDP-së në nivel legjislativ, strategji, procedure, organizimi dhe trajnimi që duhet të adresohen në qasjen tërësore të RSDP-së dhe duke siguruar një përmbledhje të praktikave të mira nga OSBE-ja, shtetet pjesëmarrëse dhe organizatat e tjera partnere ndërkombëtare dhe vendore se si të zbatohen hapat e reformës tërësore në mënyrë efektive dhe efektive.

Veç kësaj, pikëpamja kryesore që do të merret në këtë analizë dhe përmbledhje të praktikave të mira do të jetë ajo e policisë që i adreson kryesisht pikat takuese relevante ndërmjet policisë dhe homologëve të tyre në SDP, ofrues joshitetorë të sigurisë dhe drejtësisë dhe shoqërisë civile.

Ndonëse Udhëzuesi fokusohet në RSDP në nivelin nacional dhe lokal, ai megjithatë e njeh rëndësinë e shtimit të bashkëpunimit të SDP-së në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Pa një bashkëpunim efektiv ndërkufitar ndërmjet aktorëve të ndryshëm të SDP-së, kërcënimet transnacionale që burojnë nga terrorizmi dhe krimi i organizuar nuk mund të luftohen si duhet. Prandaj, Udhëzuesi adreson bashkëpunimin ndërkombëtar të SDP-së në kontekst të reformave ligjore dhe iniciativave të përbashkëta të trajnimit që synojnë zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare të bashkëpunimit të SDP-së, siç janë Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (KKBKOT), që kërkon nga shtetet ratifikuese miratimin e kornizave për ekstradim, asistencë të ndërsjellë juridike dhe bashkëpunim në zbatim të ligjit.

## **I.2 Struktura e Udhëzuesit**

Kapitulli II i këtij Udhëzuesi qartëson dhe përkufizon disa terma dhe norma relevante përkitazi me RSDP-në, duke i shtjelluar shkurtimisht elementët dhe parimet themelore të RSDP-së.

Kapitulli III shtjellon mbi elementët thelbësorë të vlerësimeve tërësore bazë të SDP-së që adresojnë, me sa vijon: legjislativin e SDP-së, politikën dhe rregulloret; strukturat organizative; strukturat për trajnim dhe avancim

profesional; si dhe strukturat e llogaridhënies dhe të mbikëqyrjes. Fokus më të veçantë do të kenë pikat takuese ndërmjet policisë dhe sektorëve të tjerë të SDP-së.

Kapitulli IV fokusohet në zhvillimin e strategjive dhe planeve të veprimit për reformën gjithëpërfshirëse dhe tërësore të policisë brenda kornizës së RSDP-së, duke i identifikuar objektivat, rolet dhe përgjegjësitë e hisedarëve ndërkombëtarë dhe vendorë të procesit të reformimit.

Kapitulli V shqyrton kornizën themelore ligjore të SDP-së të nevojshme për të siguruar përputhje të ligjit me normat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv dhe efikas ndërmjet të gjithë sektorëve të SDP-së dhe aktorëve të tjerë relevantë në procesin e drejtësisë penale siç janë agjencitë qeveritare, ofruesit joshitetorë të sigurisë dhe drejtësisë dhe shoqëria civile.

Kapitulli VI përshkruan mënyrat e përkthimit të dispozitave ligjore të drejtësisë penale në politika dhe rregullore për të mundësuar një bashkëpunim më të mirë ndërmjet të gjithë aktorëve relevantë me qëllim të përmirësimit të qasjes në siguri dhe drejtësi dhe rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të procesit të drejtësisë penale në përputhje me normat dhe standardet për të drejtat e njeriut.

Kapitulli VII siguron një pasqyrë të përgjithshme të shembujve praktikë të ndryshimeve organizative dhe strukturore të nevojshme për të mbështetur zbatimin e politikave dhe rregulloreve. Fokus do të jetë në disa fusha dhe mekanizma kyç të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të SDP-së dhe aktorëve joshitetorë dhe të shoqërisë civile me rëndësi për përmirësimin e qasjes në siguri dhe drejtësi dhe për efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të drejtësisë penale.

Kjo pasqyrë e përgjithshme mbulon gjithashtu fushën e iniciativave të trajnimit të përbashkët dhe avancimit profesional që e rrisin efikasitetin dhe efektivitetin funksional të SDP-së dhe të aktorëve të tjerë relevantë në procesin e drejtësisë penale.

Kapitulli VIII merret shkurtimisht me vlerësimin dhe shqyrtimin e RSDP-së.

Në të gjithë kapitujt e lartpërmendur, baza dhe parimet themelore të sundimit të ligjit dhe SDP-së demokratike, duke përfshirë të drejtat e njeriut, normëzimin gjinor, si dhe çështjet e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes adresohen vazhdimisht sipas nevojës.

Përfundimisht, Kapitulli IX i shtjellon elementët kyç të qasjes së integruar të RSDP-së ndërmjet aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë, derisa Kapitulli X i përshkruan shkurtimisht kriteret e një qasjeje të integruar brenda organizatave asistuese të SDP-së.



## II. Terminologjia

### II.1 Drejtësia dhe sundimi i ligjit

Drejtësia, siç përkufizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, “është ideal i llogaridhënies dhe i të qenit i drejtë në mbrojtjen me sukses të të drejtave dhe parandalimin dhe dënimin e së keqes. Drejtësia nënkupton respektim të të drejtave të personave të akuzuar, konsideratë për interesat e viktimave dhe për mirëqenien e shoqërisë në tërësi. Është koncept i rrënjosur në të gjitha kulturat dhe traditat dhe, ndonëse administrimi i saj zakonisht nënkupton mekanizma formal gjyqësorë, mekanizmat tradicionalë të zgjidhjes së kontesteve janë po aq të rëndësishëm.”<sup>7</sup>

Sekretari i Përgjithshëm e përkufizon sundimin e ligjit, si vijon: “Sundimi i ligjit është koncept në vetë zemrën e misionit të Organizatës. Ai i referohet parimit të qeverisjes në të cilin të gjithë personat, institucionet dhe subjektet, publike dhe private, duke përfshirë edhe vetë shtetin, japin llogari para ligjeve të shpallura publikisht, të zbatuara në mënyrë të barabartë dhe gjykuara në mënyrë të pavarur, dhe që janë konsistente me normat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ai kërkon, gjithashtu, masa për të siguruar respektim të parimeve të supremacisë së ligjit, barazisë para ligjit, llogaridhënie para ligjit, ndarje të pushteteve, pjesëmarrje në vendimmarrje, siguri ligjore, shmangie të arbitraritetit dhe transparencë procedurale dhe ligjore”.<sup>8</sup>

### II.2 Akterët e sistemit të drejtësisë penale

Në përputhje me Udhëzuesin e ZKBDK-së për *Reformimin e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti*, si dhe *Veglën për vlerësim të drejtësisë penale* të ZKBDK-së, në institucionet e ndryshme të SDP-së që adresohen nga ku Udhëzues përfshihet: policia, shërbimi prokurorial, avokatët dhe mbrojtja penale, gjykatat dhe shërbimet korrektuese (qendrat e paraburgimit dhe burgjet).<sup>9</sup>

Përveç institucioneve të lartpërmendura të SDP-së, ka të tjera institucione të rëndësishme shtetërore dhe joshtetërore që duhet të adresohen gjatë dhe në kontekst të RSDP-së tërësore:

---

<sup>7</sup> Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Sundimi i ligjit dhe drejtësia tranzicionale në shoqëritë në konflikt dhe në ato pas konfliktit (cituar në shënimin 1 më sipër), paragrafi.7, f. 4.

<sup>8</sup> Po aty, paragrafi 6, f. 4

<sup>9</sup> Cf. ZKBDK/Instituti për Paqe i Shteteve të Bashkuara, Reforma në drejtësinë penale në shtetet pas konfliktit. Udhëzues për praktikuesit, Nju Jork, shtator 2011, f. 9-11 dhe 14f.

- institucionet e menaxhimit të drejtësisë penale, si Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme që shpesh janë burimet kryesore të iniciativave legjislative dhe rregulluese dhe mund të kenë rol mbikëqyrës dhe/ose kontroll buxhetor mbi institucionet e drejtësisë, përkatësisht policisë;
- institucionet mbikëqyrëse, duke përfshirë organet e mbikëqyrjes së brendshme dhe të mbikëqyrjes së jashtme, siç janë ministrinë, parlamentet/komisionet parlamentare, këshillat nacional të sigurisë, avokati i popullit, komisionet nacionale për të drejtat e njeriut, organet e mbikëqyrëse të shoqërisë civile dhe mediat.<sup>10</sup>

Veç kësaj, në përputhje me deklaratën e mësipërme të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (Shih Kapitulli II.1), gjegjësisht, se mekanizmat tradicionale të zgjidhjes së kontesteve janë po aq relevante sa mekanizmat formal të gjyqësisë, ofruesit joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë si grupet e vetëgjyqësisë, grupet e rojeve të lagjes, shërbimet civile private të sigurisë dhe gjykatat zakonore mund të luajnë rol të rëndësishëm në ofrimin e sigurisë dhe drejtësisë në një vend të caktuar.

Në shoqëritë ku institucionet formale të sigurisë dhe drejtësisë janë shumë të kufizuara në mbulimin e tyre dhe vështirë të qasshme për shumicën e popullsisë, publiku varet në masë të madhe nga sistemet zakonore ose joshtetërore të drejtësisë për t'i zgjidhur të gjitha çështjet kontestuese, duke përfshirë edhe krimin.

Posaçërisht në shtetet pas konfliktit, ofruesit joshtetërorë të sigurisë shpesh luajnë rol më të rëndësishëm se sa aktorët shtetëror, meqë kanë më shumë vullnet dhe mundësi të ofrojnë siguri, përderisa aktorët shtetëror ose nuk kanë vullnet ose mundësi – për shkak të mungesës së besimit si rezultat i përfshirjes së mëparshme të paligjshme dhe njëanshme në konflikt, ose për shkak të mungesës së resurseve – për të ofruar në mënyrë të barabartë siguri për të gjitha komunitetet.<sup>11</sup>

Ndonëse në rajonin e OSBE-së përqindja e ofruesve zakonore dhe joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë është shumë më e ultë se në rajonet e tjera të botës,<sup>12</sup> ende ka shembuj, në disa prej shteteve pjesëmarrëse, ku institucionet formale të drejtësisë dhe sigurisë plotësohen në rolet e tyre përkatëse nga struktura zakonore dhe joshtetërore.

Në procesin e reformimit, shpërfillja e strukturave zakonore dhe joshtetërore që mund të gëzojnë më shumë legjitimitet se sa strukturat formale shtetërore

<sup>10</sup> Po aty, p. 12.

<sup>11</sup> Po aty, p. 103.

<sup>12</sup> Sipas ZKBDK-së, sistemet zakonore ose joshtetërore "janë mënyra kryesore e qasjes në drejtësi për 80 për qind të popullatës së botës", shih ZKBDK/IPShB, Reformimi i drejtësisë penale në shtetet pas konfliktit (cituar në shënimin 9 më sipër), f. 103.

mund, për rrjedhim, të çojë në përpjekje reformimi të parëndësishme për pjesë të mëdha të popullsisë dhe që i shpërfillin kërkesat e tyre të drejtësisë.

Për më tepër, sipas raportit të kohës së fundit të ZKBDK-së, ka “rritje substanciale të industrisë private të sigurisë në shumicën e vendeve” që i përgjigjet trendit të “privatizimit” të disa funksioneve të policisë, ku industria private civile e sigurisë e plotëson zbrazëtirën e mbetur si rezultat i mbingarkimit apo shpërhapjes së policisë dhe luan një rol në rritje në parandalim të krimit dhe sigurinë e komunitetit. Privatizimi i policisë është realizuar në disa nivele të caktuara. Ka pasur reduktime të ngarkesës, ku policia është tërhequr nga ofrimi i funksioneve të caktuara ndërsa industria private e sigurisë e ka plotësuar këtë zbrazëti; kontraktimi, ku shërbimet ende sigurohen nga policia por kontraktuesi përdoret për ta ofruar këtë shërbim; dhe pranimi i praktikave të sektorit privat nga policia, siç janë pagesa kundrejt shërbimeve dhe pranimi i sponsorizimit.”<sup>13</sup>

Zakonet dhe praktikat e ofruesve zakonorë dhe joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë duhet megjithatë të jenë përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duhet të jenë transparente dhe llogaridhënëse në punën e tyre, duke siguruar edhe mundësinë për t’u ankuar në vendimet e tyre, në mënyrë që të shërbejnë si element plotësues i pranueshëm krahas strukturave formale. Në këtë libër do të jepen disa udhëzime të përgjithshme rreth mënyrës se si të adresohen ofruesit zakonorë dhe joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë.<sup>14</sup>

### **II.3 Forma të ndryshme të aranzhimeve të reformimit**

*RSDP në skenarë pas konfliktit, shtete në tranzicion dhe demokraci të avancuara*

Meqë qëllimi i këtij Udhëzuesi është përkrahja e aktiviteteve të reformimit tërësor të policisë brenda kornizës së RSDP-së në tërë zonën e OSBE-së, ai do t’i adresojë sfidat dhe kërkesat nga reformimi me të cilat mund të përballen aktorët e reformimit në demokraci të avancuara. Ai gjithashtu do t’i adresojë sfidat më specifike që shpeshherë janë karakteristike për shtetet pas konfliktit, ose shtetet në tranzicion në kontekst të shkallës së lartë të dështimit të institucioneve kyçe shtetërore të SDP-së.

---

<sup>13</sup> ZKBDK, Shërbimet private civile të sigurisë: Roli i tyre, mbikëqyrja dhe kontributi në parandalimin e krimit dhe sigurinë e komunitetit, materiale shtesë për takimin e grupit të ekspertëve për shërbimet private civile të sigurisë, Vjenë, 24 gusht 2011.

<sup>14</sup> Për analizë gjithëpërfshirëse të të mirave dhe kufizimeve të sistemeve joformale të drejtësisë zakonore, shih UNODC/USIP, Reformimi i drejtësisë penale në shtete pas konfliktit (cituar në shënimin 9 më sipër), f. 103-113

Në skenarë pas konflikti, kornizat ligjore shpesh karakterizohen me shtrembërime politike dhe shpërfillje të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. “Ligjet emergjente dhe dekretet ekzekutive janë shpesh praktikë ditore. Aty ku ka ligje të duhura në letër, publiku i përgjithshëm mund të mos ketë dijeni për ato dhe aktorët zyrtarë mund të mos kenë kapacitete e as mjete për zbatimin e tyre. Sistemet nacionale gjyqësore, policore dhe korrektuese në mënyrë tipike mbesin pa resurse njerëzore, financiare dhe material të domosdoshme për funksionimin e duhur të tyre.”<sup>15</sup> Prandaj, agjencive të drejtësisë penale shpesh u mungon legjitimiteti nëse bëhen instrument të represionit gjatë konfliktit, ose janë të përfshira në krim të organizuar.

Skenarët pas konflikti gjithashtu dhe shpeshherë veçohen për nga disponueshmëria e gjerë e armëve, dhuna e papërmbajtur me bazë gjinore dhe seksuale, eksploatimi i fëmijëve, përndjekja e minoriteteve dhe grupeve të cënueshme, kontrabandimi, trafikimi me qenie njerëzore dhe aktivitete të tjera kriminale. “Në situatë të tilla, grupet e krimit të organizuar shpeshherë kanë më shumë resurse se sa qeveritë lokale dhe janë më mirë të armatosura se sa organet lokale të zbatimit të rendit dhe ligjit<sup>16</sup>.”

Ndonëse reforma e SDP-së mund t’i adresojë zakonisht lidhjet ndërmjet institucioneve të ndryshme, duke përfshirë përvijimin dhe, sipas nevojës, ridefinimin e roleve dhe përgjegjësive, në skenarët pas konfliktit, këto definicione të reja të drejtësisë penale dhe ofruesve të sigurisë mund të jenë edhe më jetike. Për shembull, në këtë rast, shpesh ka nevojë të ripërcaktimit të vijave ndarëse ndërmjet ushtrisë dhe policisë (përkitazi me ofrimin e zbatimit të ligjit vendor dhe të jashtëm), ose ndërmjet policisë dhe shërbimeve korrektuese për të siguruar baraspeshë të pushtetit ndërmjet institucioneve të drejtësisë penale.<sup>17</sup>

### *RSDP në sisteme të ndryshme juridike*

Një qasje reformimi posaçërisht e menduar natyrisht që duhet të marrë parasysh sistemin juridik nacional, që mund të ketë pasoja për përcaktimi e roleve, detyrave dhe përgjegjësive të aktorëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë penale.

Diferencimi më i zakonshëm në klasifikimin e sistemeve juridike bëhet ndërmjet traditës Anglo-Saksone të drejtës precedentale dhe traditës

---

<sup>15</sup> Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, Sundimi i ligjit dhe drejtësia tranzicionale në shoqëritë në konflikt dhe në ato pas konfliktit (cituar në shënimin 1 më sipër), para 27, f. 10.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> CF, PZKB, Reforma e sektorit të sigurisë dhe drejtësia tranzicionale. Qasja programatike në një krizë pas konfliktit, mars 2003, f. 9.

Evropiane-kontinentale të drejtës civile. E drejta precedentele zakonisht nuk është e kodifikuar dhe nuk bazohet në përmbledhje gjithëpërfshirëse të rregullave dhe statuteve ligjore. Ndonëse e drejta precedentele mbështetet në disa statute të përhapura, që janë vendime legjislative, ajo kryesisht bazohet në precedencë, më saktë në vendime gjyqësore që janë nxjerrë në raste të ngjashme. Precedenca ruhet me kalimin e kohës përmes shënimeve të gjykatave, si dhe dokumentohet historikisht në përmbledhje të praktikave gjyqësore në formë të vjetarëve ose raporteve. Precedenca që zbatohet në vendimin për çdo lëndë të re përcaktohet nga gjyqtari kryesues. Si rezultat i kësaj, gjyqtarët kanë një rol shumë të madh në formësimin e ligjit. Prandaj, dallimi kryesor në traditat e këtyre dy sistemeve është se në traditën e së drejtës precedentele gjyqësori e “krijon” kornizën ligjore nacionale sipas precedencës. Prandaj, gjyqtarët *de facto* shërbejnë si ligjbërës, me pushtetin legjislativ që miraton ligje që krijojnë të drejtën.<sup>18</sup>

“Për dallim, në traditën kontinentale Evropiane, ligjvënësi është ligjbërësi kryesor” dhe gjyqtarët veprojnë brenda një kornize ligjore që “është e përcaktuar në kode të mëdha që përmbajnë dispozita të sistemuara ligjore që përfshijnë apo zgjerohen në fusha të mëdha dhe të përcaktuara mirë. Stili i vendimeve të gjykatës në sistemin kontinental favorizon minimizimin e rolit të gjyqtarëve individualë, duke e zmadhuar nga ana tjetër kornizën ligjore.”<sup>19</sup>

“Në disa sisteme ligjore, veçanërisht në ato me ndikim ose traditë nga e drejta civile, hetimet penale udhëhiqen nga prokurori ose gjyqtari hetues, të cilit ligji i jep pushtet për të drejtuar hetimet e policisë ose, në disa raste, kompetencës speciale policore të gjyqësorit. Policia duhet t'i kryejë çfarëdo hetimesh të urdhëruara nga prokurori ose gjyqtari hetues dhe t'i raportojë atij/asaj. Në sisteme të tjera, veçanërisht ato me ndikim ose traditë të së drejtës precedentele, policia është përgjegjëse për hetimin penal në tërësi. Në fund të hetimit, policia mbledh prova dhe i paraqet ato në organin kompetent prokurorial të shtetit, i cili më pas e merr përsipër ndjekjen e rastit. Këto qasje dallojnë në zbatim, por parimet themelore mbesin të njëjta: të identifikohet autori i krimit dhe të sjellët para drejtësisë.”<sup>20</sup>

Për më tepër, sistemet juridike në vende të ndryshme mund të kenë dallime

---

<sup>18</sup> Cf. Blank, J.L.T. (ed.), *Sigurimi dhe performanca publike*. Amsterdam 2000, f. 18, cituar në: Kuhry, Bob, *Performanca e sektorit publik. Krahasimi ndërkombëtar i arsimit, shëndetësisë, rendit dhe ligjit*, si dhe administratës publike, zyrës për planifikim shoqëror dhe kulturor, Hagë, shtator 2004, f. 189

<sup>19</sup> Blank, *Sigurimi dhe performanca publike* (cituar në shënimin 18 më sipër), f. 18, cituar në: Kuhry, *Performanca e sektorit publik* (cituar në shënimin 18 më sipër), p. 189.

<sup>20</sup> ZKBDK, “Puna policore. Siguria publike dhe ofrimi i shërbimeve nga policia”, në: *Vegla për vlerësimin e drejtësisë penale*, Nju Jork, 2006, f. 13; shih gjithashtu ZKBDK, “Puna policore. Hetimi i krimit”, në: *Vegla për vlerësimin e drejtësisë penale*, Nju Jork, 2006, f. 1; dhe ZKBDK, “Qasja në drejtësi. Shërbimi i Prokurorisë”, në: *Vegla për vlerësimin e drejtësisë penale*, Nju Jork, 2006, f. 7

të mëdha përkitazi me parimin e ligjshmërisë dhe parimin e oportunitetit që rregullojnë fuqinë e lirisë së veprimit të prokurorëve. Përderisa parimi i ligjshmërisë kërkon nga prokurori që t'i ngre akuzat kurdo që ka prova të mjaftueshme për fajësinë e të dyshuarit, parimi i mundësisë i jep prokurorit më shumë liri veprimi për të vendosur në çdo rast individual nëse ka interes publik në ndjekje.<sup>21</sup>

Ka një dallim klasik të sistemeve juridike ndërmjet procedurave akuzatore dhe procedurave inkuizitore: në të parin, gjyqtari është tradicionalisht më pasiv, duke luajtur një rol neutral ndërmjet mbrojtjes dhe prokurorit, i cili është më aktiv në paraqitjen e rastit; në këtë të fundit, gjyqtari pritet të jetë më aktiv në mbledhjen dhe organizimin e provave për dhe kundër fajësisë së të pandehurit.<sup>22</sup> Roli i gjyqtarëve mund gjithashtu të dallojë shumë nëse juritë ose gjyqtarët porotë luajnë rol të rëndësishëm në procedurat gjyqësore.<sup>23</sup>

Një aspekt tjetër i specifikave të caktuara të sistemeve të ndryshme juridike është që, në disa vende, e drejta zakonore dhe rregullat fetare ose e drejta fetare (p.sh. e drejta e Sheriatit Islamik) mund ta plotësojë deri në një masë të drejtën apo ligjin formal. Megjithatë, është gjithashtu e mundshme që e drejta zakonore nuk e plotëson ligjin formal, por, në vend të kësaj, punon paralelisht me atë, ose madje në kundërshtim me atë.

Ofruesit e ndihmës për reformën e drejtësisë penale duhet të jenë të vetëdijshëm që secili sistem i drejtësisë penale është unik dhe pasqyron historinë autoktone të vendit, por edhe shtresimin e sistemeve të importuara në të kaluarën.

Duke qenë të vetëdijshëm për sistemet dhe traditat e ndryshme juridike në OSBE, tërësia e shembujve të dispozitave ligjore për avancimin e efektshmërisë dhe efikasitetit të procesit të SDP-së, të cilat paraqiten në këtë Udhëzues, mund të ofrojnë shembuj të thjeshtë të modifikimeve të ligjeve e procedurave, ose nëse nuk konsiderohen të përshtatshëm për përfshirje në kontekstin vendor, së paku mund të shërbejnë si burim frymëzimi për hartuesit dhe zbatuesit e politikave për ndryshimin e dispozitave ligjore.

---

<sup>21</sup> Cf. Aromaa, Kauko et al, Krimi dhe drejtësia penale në Evropë dhe Amerikë Veriore 1995-1997: Raporti për anketën e gjashtë të Kombeve të Bashkuara për trendët e krimeve dhe sistemet e drejtësisë penale, Instituti i Evropës për Parandalim dhe Kontroll të Krimin, e lidhur me Kombet e Bashkuara (HEUNI), Seri publikimi nr. 40, Helsinki 2003, f. 15; shih gjithashtu: Kuhry, Performanca e sektorit publik (cituar në shënimin 18 më sipër), f. 190

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Cf. Kuhry, Performanca e sektorit publik (cituar në shënimin 18 më sipër), f. 190

## II.4 Qëllimet dhe parimet udhëzuese të RSDP-së

Me pak fjalë, synimi i RSDP-së është që të sigurojë ofrimin efektiv dhe efikas të sigurisë dhe drejtësisë për popullatën në përgjithësi, në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse, në pajtim me sundimin e ligjit si dhe në përputhje me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore<sup>24</sup>.

Më në veçanti, qëllimi i RSDP-së duhet të jetë zhvillimi i një SDP-je demokratike që përmbush parimet vijuese të qeverisjes së mirë<sup>25</sup>:

- Institucionet e SDP-së funksionojnë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtën vendore kushtetuese.
- Institucionet e SDP-së japin llogari para ligjit dhe para publikut, si dhe operacionet e tyre mbikëqyren nga gjyqësori dhe publiku, duke përfshirë autoritetet civile të zgjedhura dhe shoqërinë civile. Informatat për planifikimin, buxhetimin dhe operacionet e institucioneve të SDP-së janë në dispozicion brenda qeverisë si dhe për publikun; duhet vendosur një qasje gjithëpërfshirëse dhe të disiplinuar të menaxhimit të të gjitha resurseve.
- Policia dhe agjencitë tjera të zbatimit të ligjit zbatojnë ligjin pa diskriminim, si dhe ndërmarrin veprimet e duhura kundër shkeljeve të pohuara të ligjit; mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të individëve dhe komuniteteve; parandalojnë dhe zbulojnë krimin; zvogëlojnë frikën; si dhe ofrojnë ndihmë e shërbime për publikun.
- Gjyqësori ekziston si trup i pavarur i aftë për të nxjerrë aktvendime e aktgjykime gjyqësore të barabarta për të gjithë brenda kompetencave të tij, në mënyrë të paanshme dhe pa ndikime apo ndërhyrje të jashtme.
- Shërbimet korrektuese sigurojnë sistem të sigurt e njerëzor të burgjeve e rehabilitimit, duke përfshirë alternativat ndaj privimit të lirisë dhe masave të diversionit.
- Personeli që punon në institucionet e SDP-së është trajnuar në masë adekuate për të ushtruar detyrat në mënyrë profesionale, në pajtim me

<sup>24</sup> Cf. Hartog, Merijn (ed.), Reforma e sektorit të sigurisë në Azinë Qendrore: Hulumtimi i nevojave dhe mundësive, Qendra për Studime Evropiane të Sigurisë, Groningen 2010, f. 8.

<sup>25</sup> Cf. DFID, Reforma e sektorit të sigurisë dhe menaxhimi i shpenzimeve ushtarake: Rreziqet e larta për donatorë, Shkalla e lartë e kthimit për zhvillim, Raporti për një simpozium ndërkombëtar sponsorizuar nga Departamenti Britanik për Zhvillim Ndërkombëtar (UKAID), Londër, shkurt 2000, f. 46; Cf. Kombet e Bashkuara, Shënim udhëzues i Sekretarit të Përgjithshëm. Qasja e Kombeve të Bashkuara për Ndhimën për Sundimin e Ligjit, Nju-Jork, prill 2008, ff. 6f; dhe Cf. OSBE, Udhëzues për policinë demokratike, nga Këshilltari i Lartë i Policisë për Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së, Seria e publikimeve SPMU Vëll. 1, botimi i dytë, Vjenë, Maj 2008, f. 15.

obligimet e procesit të rregullt e në kohë të arsyeshme, si dhe me të drejtat e njeriut, në përputhje edhe me kodet e udhëzimet profesionale e etike.

- Individëve u garantohet procesi i rregullt, përfaqësimi juridik dhe trajtimi i barabartë në procedura të parashikueshme, të drejta e transparente juridike. Ndhima juridike dhe para-ligjore është e qasshme për ata që nuk kanë mundësi ta sigurojnë vetë.

Për të arritur këto synime, duhen aplikuar parimet vijuese të reformës, të cilat janë në përputhje si dhe plotësojnë Shënimin Udhëzues të vitit 2008 nga Sekretari i Përgjithshëm: Qasja e OKB-së për Ndhimën në Sundim të Ligjit, nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara<sup>26</sup>:

- RSDP duhet të bazohet në norma e standarde ndërkombëtare. Themeli normativ i RSDP-së duhet të jetë Karta e Kombeve të Bashkuara, së bashku me të drejtën ndërkombëtare për të drejta të njeriut, të drejtën penale ndërkombëtare, si dhe të drejtën ndërkombëtare për refugjatë.
- Përveç instrumenteve, deklaratave, udhëzimeve, e tërësive parimore të Kombeve të Bashkuara, ndihma e OSBE-së në RSDP duhet udhëzuar gjithashtu sipas normave, parimeve e standardeve të definuara nga Akti Final i Helsinkit, Dokumenti i Kopenhagës dhe vendimet e ndryshme të OSBE-së në lidhje me aktivitetet policore<sup>27</sup>.
- Barazia gjinore dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve të cenueshme janë elemente themelore të të drejtave të njeriut, si dhe si të tilla duhen promovuar në procesin reformues.
- Llogaridhënia dhe transparencja e SDP-së, bashkë me mbikëqyrjen e tij, janë gjithashtu elemente përbërëse të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, si dhe duhen promovuar si të tilla në procesin reformues.
- RSDP duhet të marrë parasysh kontekstin socio-politik si dhe nevojat për siguri e drejtësi në kontekstin specifik të secilit vend nikoqir, bashkë me natyrën dhe gjendjen e sistemit juridik, si dhe kulturën, traditat e institucionet mbi të cilat është themeluar sistemi.
- Qasja ndaj RSDP-së duhet të ketë në qendër njerëzit, si dhe të jetë në pronësi vendore, por edhe e mbështetur për të reaguar në mënyrë

<sup>26</sup> Cf. Kombet e Bashkuara, Qasja e Kombeve të Bashkuara për ndihmën në sundim të ligjit (citat i shënimit 25), ff. 1-4.

<sup>27</sup> CF, OSBE, Korniza strategjike e OSBE-së për aktivitetet policore, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 1049, Mbledhja plenare e 922-të, Vjenë, 26 korrik 2012, Para. 10.

Një listë e konventave, udhëzimeve e zotimeve në fuqi për orientimin e punës së SDP-së në zonën e OSBE-së gjendet në shtojcën 1.



adekuate ndaj nevojave të përfituesve, si dhe të ketë baza të mira për qëndrueshmëri. Shoqëria civile përbën element thelbësor të palëve vendore në procesin reformues. Për më tepër, pronësia kuptimplote kërkon fuqizimin ligjor të të gjitha segmenteve të shoqërisë.

- Qëndrueshmëria e arritjeve të reformës duhet përforcuar më tutje duke zhvilluar kapacitetet njerëzore dhe duke përforcuar proceset buxhetore dhe menaxhimin financiar<sup>28</sup>.
- Reforma e SDP-së kërkon qasje të orientuar kah institucioni, por edhe të orientuar kah procesi. Derisa e para fokusohet tek rishikimi i ligjeve, politikave e rregulloreve, ofrimin e trajnimeve, ndërtimin e infrastrukturës dhe ofrimin e mbështetjes materiale, e dyta synon të përmirësojë efektshmërinë dhe marrëdhënien funksionale mes institucioneve të drejtësisë penale, institucioneve mbikëqyrëse, sistemeve formale e jo-shtetërore të drejtësisë penale, si dhe marrëdhënien mes palëve në drejtësinë penale si dhe publikut. Për të siguruar arritje të qëndrueshme të reformës, duhet gjetur baraspesha mes qasjes me orientim institucional dhe asaj me orientim kah procesi<sup>29</sup>.
- RSDP-ja gjithëpërfshirëse shpesh kërkon edhe angazhimin e palëve të shumta ndërkombëtare e vendore, të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet e tyre dhe të zhvillojnë strategji të gjera për të ofruar ndihmë plotësuese, të sinkronizuar, efektive e efikase, si dhe të qëndrueshme.

Të gjitha qëllimet dhe parimet udhëzuese të RSDP-së të përmendura si më lart do të merren parasysh në kapitujt vijues.

---

<sup>28</sup> Cf. OECD, OECD DAC Doracak për Reformën e sistemit të sigurisë. Mbështetja për siguri e drejtësi, Paris, 2007, ff. 63-67

<sup>29</sup> Cf. Banka Botërore, Raporti i Zhvillimit të Botës, 2011, Konflikti, siguria dhe zhvillimi, Uashington, DC 2011, f. 5.



### III. Vlerësimet e përgjithshme të sistemit të drejtësisë penale

Reforma e tërësore e policisë, brenda kornizës së RSDP-së, duhet bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të kontekstit vendor të reformës. Kjo përfshin edhe kornizën ligjore dhe strukturat përkatëse, por edhe palët e përfshira dhe performancën e tyre. Në veçanti, ajo bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të nevojave të publikut për drejtësi e siguri, sepse përmirësimi i shërbimeve të SDP-së është thelbi i RSDP-së. Adresimi i nevojave të publikut është gjithashtu parakusht për arritjen e pronësisë së gjerë vendore të reformës.

Analiza e thellë e kontekstit socio-ekonomik gjithashtu është e nevojshme për të identifikuar pozitat e ndërhyrjes dhe mundësitë e ndryshimit, por edhe kufizimet, pengesat e problemet e mundshme në procesin e reformës. Pasi që reforma e SDP-së mund të ndikojnë në marrëdhëniet e pushtetit, sidomos në shoqëri të dala nga konflikti, është me rëndësi themelore të vlerësohet efekti i mundshëm i ndihmës ndërkombëtare në dinamikën e konfliktit<sup>30</sup>.

Informatat sasiore e cilësore të mbledhura në një vlerësim të tillë të nivelit rrënjësor gjithashtu duhen shfrytëzuar në zhvillimin vijues të standardeve e kriteve në planin operacional, për të vlerësuar suksesin dhe/ose ndikimin e iniciativave për RSDP, si për të përgatitur strategjitë dalëse për përmbushjen/arritjen e standardeve (shih edhe kapitullin IV).

OECD DAC bën dallime mes katër llojeve të vlerësimit, varësisht nga konteksti lokal, por edhe kohës dhe resurseve në dispozicion<sup>31</sup>:

- Analiza joformale paraprake, e cila ofron një pasqyrë të gjerë të kontekstit lokal dhe mjedisit politik për të siguruar vendimmarrjen nëse duhet angazhuar apo jo në RSDP;
- Një studim fillestar i fushëveprimit, i cili identifikon aktivitetet e RSDP-së, duke përfshirë palët dhe aktorët kryesorë, arritjet dhe sfidat me të cilat përballen, si dhe informon vendimmarrësit për vlerën e shtuar të iniciativës së re, si dhe pikat fillestare;
- Një vlerësim i plotë, i cili ofron vlerësim gjithëpërfshirës të kontekstit të RSDP-së, duke marrë parasysh zhvillimet në kontekstin e reformës që ka pasuar analizën paraprake

<sup>30</sup> Cf. OECD, OECD DAC Doracak për reformat në sistemin e sigurisë (op. cit. note 28), p. 41.

<sup>31</sup> Ibid, f. 45-48.

joformale dhe studimin e fushëveprimit;

- Vlerësimet e sektorit apo problemit, i cili synon një analizë edhe më të thellë të sektorëve specifikë të SDP-së të identifikuar si caqe prioritare të reformës, ose të çështjeve të caktuara të sigurisë dhe rendit, për të identifikuar iniciativat e domosdoshme të reformës në sektorët përkatës të SDP-së.

Sipas OECD DAC, implementimi i renditur i vlerësimeve të ndryshme do të duhej të ofronte një pasqyrë të gjerë të informatave relevante, e cila është e nevojshme për të ndërmarrë një program gjithëpërfshirës të RSDP-së.

Një përshkrim i hollësishëm i hapave të ndryshëm të vlerësimit, duke përfshirë edhe fazat paraprake dhe fillestare të vlerësimit, ofrohet nga OECD, Ekipi Këshillues Ndërkombëtar për Sektorin e Sigurisë në DCAF, si dhe Akademia Suedeze Folke Bernadotte, mes tjerash<sup>32</sup>. Ky Udhëzues pra koncentrohet tek aspektet kryesore të fazës së vlerësimit të thellë mbi ato aspekte të vlerësimit që kanë rëndësi për analizën e përgjithshme të marrëdhënieve dhe ndërveprimit të policisë me institucionet tjera relevante të SDP-së si dhe aktorët jo-shtetërorë.

### III.1 Planifikimi i vlerësimeve

#### III.1.1 Përbërja e ekipit vlerësues

Qasja tërësore ndaj reformës policore në kuadër të RSDP-së natyrisht kërkon një ekip vlerësues të ekspertëve të shumë disiplinave në fushat e ndryshme të SDP-së, si dhe në shkencat sociale, menaxhimit, financave dhe qeverisë. Për më tepër, ekipi i vlerësimit duhet të ketë aftësitë gjuhësore për të komunikuar me palët vendore, duke përfshirë segmente të gjera të shoqërisë civile. Ekipi duhet të udhëhiqet nga një Ekspert i lartë i drejtësisë penale, i cili duhet të jetë i respektuar dhe i njohur nga palët e nivelit të lartë në shtetin nikoqir. Për të ndërtuar dhe siguruar pronësinë lokale, do

<sup>32</sup> Shih, për shembull, OECD, OECD DAC Doracak i reformës së sistemit të sigurisë (citat i shënimit 24), ff. 42-52;

<sup>33</sup>CAF, Shënim udhëzues operacional: Procedimi i një propozimi për vlerësimin e sigurisë dhe drejtësisë, Ekipi Ndërkombëtar Këshillues për Sektorin e Sigurisë (ISSAT), Shënimet udhëzuese operacionale të ISSAT-it (OGN), Përkrahja e kapaciteteve të bashkësisë ndërkombëtare në RSS, Gjenevë, 2010; dhe Akademia Folke Bernadotte/Grupi Suedez i Kontaktit, Reforma e sektorit të sigurisë. Korniza vlerësuese, Stokholm.

të preferohej edhe një ekspert i kualifikuar nga shteti nikoqir që e udhëheq ekipin.

Në kuptimin e fushave të gjera të vlerësimit të RSDP-së tërësore, që kërkon ekipe të mëdha shumë-disiplinore të ekspertëve, duhet marrë parasysh edhe themelimi i ekipeve të përbashkëta të vlerësimit, të përbërë nga përfaqësues të palëve të ndryshme vendore e ndërkombëtare. Kjo mund të ofrojë “mundësi unike për të ndërtuar një mirëkuptim të përgjithshëm për sfidat specifike të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe reagimet përkatëse, por edhe për të avancuar bashkëpunimin”<sup>33</sup>. Puna e këtyre ekipeve të përbashkëta vlerësuese megjithatë mund të pengohet nga interesat e anëtarëve të ndryshëm që nuk pajtohen dhe kompetencat e të cilëve nuk janë plotësuese.

### *III.1.2 Grupet e shënjestruara të vlerësimit*

#### *Ofruesit shtetërorë të drejtësisë dhe sigurisë*

Qasja e përgjithshme ndaj reformës policore në kuadër të RSDP-së gjithashtu kërkon që jo vetëm të konsultohen agjencitë e zbatimit të ligjit, por edhe institucionet tjera relevante të SDP-së, me të cilat agjencitë e zbatimit të ligjit janë të ndërlidhura në procesin e drejtësisë penale, siç janë shoqatat apo odat e avokatëve, prokuroritë, gjykatat dhe burgjet. Sa i përket institucioneve që ofrojnë siguri, edhe ushtria edhe shërbimet kufitare mund të kenë nevojë të konsultohen<sup>34</sup>.

#### *Ofruesit jo-shtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë*

Në vendet ku kanë rol të rëndësishëm në ofrimin e sigurisë dhe drejtësisë, ofruesit zakonorë dhe jo-shtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë gjithashtu duhen vlerësuar. Ato mund të përfshijnë, për shembull, grupet e rojave të lagjes, grupet e vetëgjyqësisë dhe kompanitë civile private të sigurimit; si dhe gjykatat tradicionale, mekanizmat e zgjidhjes alternative të konflikteve, si dhe shërbimet para-juridike<sup>35</sup>.

#### *Strukturat qeveritare dhe parlamentare*

Përveç ministrisë së brendshme dhe asaj të drejtësisë, që kanë rol në qeverisjen e SDP-së, vlerësimet e gjera do të mbulonin edhe ministritë tjera relevante, si ajo e drejtësisë, financave, shëndetësisë dhe punëve të

<sup>33</sup> DCAF, Procedimi i një propozimi për vlerësimin e sigurisë dhe drejtësisë (op. cit. note 32).

<sup>34</sup> Cf. OECD, OECD DAC Doracak për reformat në sistemin e sigurisë (op. cit. note 28), p. 48).

<sup>35</sup> Ibid.

jashtme. Për më tepër, institucionet relevante ligjvënëse dhe politikëbërëse si dhe institucionet publike të mbikëqyrjes dhe administratës, duke përfshirë parlamentin, komisionet parlamentare, partitë politike, politikanët individualë, si dhe strukturat administrative në nivel shtetëror, rajonal dhe lokal, duhet gjithashtu të intervistohen.

### *Shoqëria civile*

Siç përmendet më herët, shoqëria civile luan rol thelbësor në ofrimin e një vështrimi gjithëpërfshirës dhe reprezentativ të nevojave të popullatës për siguri e drejtësi, si dhe perceptimin publik mbi funksionimin e SDP-së, si dhe në sigurimin e pronësisë lokale dhe qëndrueshmërinë e reformave. Shoqëria civile gjithashtu mund të jetë e dobishme në përfitimin e një pamjeje të strukturave zakonore dhe jo-shtetërore të drejtësisë dhe sigurisë. Për rrjedhojë, duhet konsultuar një spektër i gjerë i organizatave e aktorëve që përfaqësojnë segmente të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë në veçanti përfaqësuesit e grupeve të cenueshme, si pakicat apo grupet e veçuara. Perspektiva gjinore në vlerësim do të adresonte veçanërisht nevojat për siguri e drejtësi të grave e vajzave, si dhe burrave e djemve të marginalizuar. Aktorët e shoqërisë civile gjithashtu do të përfshinin organizatat e mbikëqyrjes publike, organizatat fetare, institucionet akademike, sektorin privat afarist, si dhe mediat<sup>36</sup>.

### *Aktorët tjerë ndërkombëtarë*

Për të përcaktuar vlerën e shtuar të një iniciative të vetme të RSDP-së, si dhe për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë, ka nevojë për një analizë të thuktë të iniciativave për RSDP të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë. Kjo gjithsesi do të parandalonte ofrimin e koncepteve kundërthënëse e konfliktuoze për reformë, gjë që mund të krijojë huti tek pranuesit e ndihmës. Vlerësimi gjithashtu duhet të synojë të marrë informata mbi atë se si do të mund të bashkërendohej, renditej apo edhe kombinohej ndihma ndërkombëtare për të krijuar sinergji e resurse të mira. Në kuptimin e përpjekjeve tejet të mëdha që nevojiten për reformimin e të gjithë SDP-së, një organizatë e vetme ndërkombëtare ka pak gjasë të mbajë gjithë këtë barrë. Idealisht, partnerët e mundshëm ndërkombëtarë do të duhej të bashkoheshin brenda një vlerësimi<sup>37</sup>.

Në të gjitha grupet e shënjestruara e të përmendura më lart, është me rëndësi të konsultohen gratë dhe përfaqësuesit e pakicave dhe grupeve të

---

<sup>36</sup> Ibid, ff. 48f.

<sup>37</sup> Ibid, f. 49.

margjinalizuara, nëse mundet, për të marrë qëndrimet dhe këndvështrimet më të gjera të mundshme nga një larmi palësh; përndryshe, këndvështrimet e grupeve të cenueshme dhe të margjinalizuara mund të anashkalohen.

### *III.1.3 Fushat kryesore të vlerësimit*

#### *Konteksti socio-ekonomik, kulturor dhe politik*

Analiza e kontekstit socio-ekonomik, kulturor dhe politik do të mundësojë zhvillimin e një profili të vendit, duke përfshirë, mes tjerash, gjendjen e sigurisë, përbërjen etnike dhe demografinë e popullatës, rolin e shoqërisë civile, sistemin politik dhe qeverisjen në SDP, si dhe legjitimitetin e institucioneve të shtetit dhe atyre të SDP-së. Përveç këtyre, në rastin e shoqërive pas konfliktit, do të analizohet historia e konfliktit, duke përfshirë shkaqet rrënjësore të tensioneve dhe nxitësve të konfliktit të dhunshëm, me fokus të veçantë në rolin e SDP-së në konflikt. Në rastin e skenarëve post-konfliktuozë, vlerësimet duhet të ndihmojnë në përcaktimin se si RSDP mund të shmangë përkeqësimin e tensioneve mes SDP-së dhe popullit, ose brenda SDP-së për të arritur rehabilitimin e qëndrueshëm pas konfliktit. Kjo qasje kërkon identifikimin e pengesave të mundshme ndaj procesit reformues, por edhe stimujt për ta, ashtu që të mos pengojnë reformën<sup>38</sup>. Një numër pyetjesh ilustruese në këtë fushë vlerësimi mund të gjenden në Doracakun e OECD DAC për reformën e sistemit të sigurisë (ff. 52f).

#### *Nevojat e publikut për siguri e drejtësi*

Analiza e nevojave të publikut për siguri e drejtësi do të mundësojë identifikimin e brengave më madhore të sigurisë dhe drejtësisë, duke përfshirë ato të grupeve të margjinalizuara, perceptimin mbi performancën e institucioneve të SDP-së, e kështu edhe mangësive të SDP-së, ku të gjitha zbulojnë nevojat për reformë dhe pikat e mundshme të intervenimit për reformë<sup>39</sup>. Analiza e motivimit të popullsisë mbi atë se a i drejtohen apo jo ofruesve specifikë të sigurisë dhe drejtësisë do të zbulonte edhe cilat institucione formale të SDP-së dhe ofrues joshitetorë të drejtësisë dhe sigurisë janë më të rëndësishmit për publikun, duke kërkuar kështu edhe vëmendje të veçantë në procesin e reformës. Fokusi i motivimit të disa kategorive të shoqërisë që të mos i drejtohen ofruesve specifikë të sigurisë dhe drejtësisë gjithashtu mund të zbulojë perceptime në lidhje me gjininë, etninë apo ndonjë kategori sociale tjetër.

---

<sup>38</sup> Ibid, p. 50.

<sup>39</sup> Ibid, p. 51.

### *Qeverisja dhe kapaciteti i SDP-së*

Analiza e qeverisjes dhe kapacitetit të SDP-së do të adresojë kornizën ligjore përkatëse, politikat dhe rregulloret, si dhe strukturat organizative, menaxheriale, operacionale dhe trajnuese të institucioneve të ndryshme të SDP-së. Ajo gjithashtu do të adresojë strukturat e brendshme dhe të jashtme të mbikëqyrjes që sigurojnë llogaridhënien e SDP-së para njerëzve që u shërben.

Kuadri ligjor i mandatit të SDP-së përfshin kushtetutën, ligjet e veçanta dhe aktet nën juridiksionin e institucioneve relevante të SDP-së, si dhe kodet penale e kodet e procedurës penale. Rishikimi i kornizës ligjore duhet gjithashtu të fokusohet tek shkalla në të cilën ligjet, aktet dhe kodet janë në përputhje me konventa ndërkombëtare. Analiza e kornizës ligjore gjithashtu duhet të sigurojë një pamje të qartë të roleve, detyrave, përgjegjësive dhe të drejtave të institucioneve të ndryshme të SDP-së.

Analiza e politikave dhe rregulloreve më tutje do të duhej të përcaktonte se si rolet, përgjegjësitë dhe të drejtat bëhen funksionale brenda SDP-së, duke përfshirë edhe çështjen se si rregullohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së në procesin e drejtësisë penale.

Analiza e strukturave të SDP-së duhet të adresojë ndërtimin, madhësinë, si dhe resurset njerëzore, fizike dhe financiare, bashkë me vijat e komunikimit dhe komandës të institucioneve të ndryshme të SDP-së.

Duke marrë parasysh autorizimet detyruese të institucioneve dhe palëve në SDP, ekziston nevoja themelore që të ketë mbikëqyrje të pavarur të performancës së SDP-së. Kështu, analiza e strukturave të brendshme dhe të jashtme të mbikëqyrjes është shumë e afërt me analizën e strukturave të SDP-së, me qëllim të sigurimit të kontrollit dhe llogaridhënies së SDP-së.

Një element i rëndësishëm i ndërthurrur në vlerësimin e shumë fushave të lartpërmendura duhet të jetë edhe fokusi tek të drejtat e njeriut dhe aspektet gjinore.

Përfundimisht, siç edhe theksohet në kapitullin III.1.2, vlerësimi gjithashtu duhet të marrë parasysh iniciativat për RSDP nga aktorët tjerë ndërkombëtarë dhe vendorë, bashkë me programet tjera zhvillimore politike, sociale apo ekonomike në vendin nikoqir që do të mund të kishin lidhje me RSDP-në. Kjo do të mundësonte arritjen e rezultateve reciprokisht mbështetëse dhe qëndrueshmërinë e nismave të ndryshme të reformave.



### *III.1.4 Metodologjia e vlerësimit*

#### *Studimet në zyrë*

Për të përgatitur hulumtime e intervista vlerësuese, duhet bërë së pari një studim gjithëpërfshirës në zyrë, ashtu që të nxirren informata fillestare për fushat e ndryshme të vlerësimit. Studimi në zyrë do të bazohet mbi një analizë të një tërësie burimesh të hapura, si dhe sipas mundësisë, edhe të dhënat konfidenciale nga qeveria.

Dokumentet relevante që duhen analizuar përfshijnë, mes tjerash: kushtetuta e vendit; ligjet dhe aktet e policisë; kodet penale dhe kodet e procedurës penale; strategjitë shtetërore për institucione të ndryshme të SDP-së; politikat, rregulloret dhe procedurat standarde të veprimit (PSV); strukturat organizative; planprogramet dhe doracakët e trajnimit; statistikak e krimit<sup>40</sup>; studimet e viktimizimit; përqindjet e rasteve të zgjidhura; numri i rasteve të pazgjidhura penale; statistikak si numri i të burgosurve dhe kohëzgjatja e mbajtjes policore dhe paraburgimit, raporti i të burgosurve kundrejt numrit të popullsisë së përgjithshme, si dhe raportin e të burgosurve të mitur dhe femra në krahasim me të burgosurit në përgjithësi; raportet nga inspektorati policor dhe organet e mbikëqyrjes së jashtme; si dhe OJQ-të, mediat dhe raportet e vendeve donatore, si dhe raportet nga organizatat ndërkombëtare.

#### *Intervistat dhe hulumtimet*

Intervistat duhen bërë me individë që përfaqësojnë palë kyçe të procesit të reformës, që përfaqësojnë shtetin (pra institucionet) dhe shoqërinë civile. Pyetjet duhen bazuar tek gjetjet e studimit në zyrë, si dhe duhen përdorur për t'i vërtetuar ato, ose për të qartësuar çështjet që theksohen. Intervistat kanë zakonisht strukturë të çlirët, në bazë të pyetësorëve gjysmë të strukturuar. Intervistat duhet të jenë fleksibile për të adresuar, në mënyrë spontane dhe të ndjeshme, çështjet më brengosëse, si dhe të mbledhin informata. Kryerja e intervistave me një fushëveprim mundëson kontrollimin e tërthortë dhe në trekëndësh të informatave. Pyetje mund të ju parashtrihen edhe grupeve të individëve me intervista në fokus-grupe.

Informatat nga grupet e mëdha të mostrës mund të mblidhen përmes anketave të opinionit publik, të cilat më së shpeshti administrohen në formë të shkruar dhe të strukturuar. Anketat e opinionit publik duhen bazuar tek një

---

<sup>40</sup> Kur përdoren statistikak e krimit, duhet gjithmonë të kihet parasysh problemi i besueshmërisë dhe integritetit, pasi që ato mund të jenë të vështira të interpretohen saktësisht. Për shembull, shifrat e ulëta të krimit mund të tregojnë ose që pak krime kryhen, ose pak krime raportohen. Kjo e fundit pastaj mund të tregojë që njerëzit nuk i besojnë policisë, ose nuk shohin ndonjë dobi në informimin e policisë, për shkak të reagimit të dobët policor. Për shkak të problemit të saktësisë dhe sfidave në interpretimin e statistikave, statistikak nga një burim duhen krahasuar me statistikak përkatëse nga një burim tjetër, kur janë në dispozicion.

mostër reprezentative të njerëzve nga kategori të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë grupet e cënueshme dhe të veçuara, për të zhvilluar një pamje të “plotë” dhe reprezentative të qëndrimeve të ndryshme në shoqëri. Vegla specifike për këto anketa mund të jenë për shembull auditimet e sigurisë lokale<sup>41</sup> si dhe anketat për viktimizim<sup>42</sup>.

### *Identifikimi i institucioneve/aktorëve të SDP-së*

Një element thelbësor në identifikimin tërësor të përgjegjësive ligjore të institucioneve të ndryshme të SDP-së në ofrimin e shërbimeve specifike të sigurisë dhe drejtësisë është që të përcaktojë marrëdhëniet ekzistuese mes palëve, si dhe mënyrën në të cilën ato janë ndërtuar në kuptimin e legjislacionit, rregulloreve e politikave, çështjeve organizative dhe operative, si dhe trajnimit.

Përveç identifikimit të përgjegjësive ligjore të institucioneve të ndryshme të SDP-së, identifikimi duhet të fokusohet veçanërisht tek ajo se kush në fakt ofron këto shërbime në praktikë, dhe si. Për shembull, derisa policia është formalisht i vetmi operator i sigurisë së brendshme sipas ligjit, grupet vetëgjyquese mund të kenë marrë përsipër ofrimin e sigurisë në hapësira ku policia nuk është e pranishme, ose reagimi policor është tejet i dobët. Një shembull se si ofrimi i sigurisë dhe drejtësisë mundën në fakt të anashkalojnë rregullat formale janë rastet në të cilat policia arreston hajnin e pohuar dhe e mban atë në arrest deri sa të paguajë kompensimin për viktimën, pa e angazhuar fare prokurorinë, për arsye të ndryshme, siç është largësia e prokurorit<sup>43</sup>.

Informatat e mbledhura nga aktorët e ndryshëm të SDP-së si dhe nga shoqëria civile në këtë identifikim mund të krahasohen me strukturat organizative zyrtare, por edhe me rregulloret për bashkëpunim. Si rezultat, sugjerimet pastaj mund të ofrohen mbi mundësitë e përmirësimit në bashkëpunim, si dhe pikat e intervenimit për reformë.


Pakoja e veglave të UNODC-së për Vlerësimin e Drejtësisë Penale ofron një ilustrim të dobishëm të ndërveprimit kompleks mes institucioneve të ndryshme të SDP-së, që mund të përdoret për identifikimin e marrëdhënieve sektoriale në SDP (shih Figurën 1 në f. 54).

<sup>41</sup> Shih: Forumi Evropian për Siguri Urbane, Udhëzim për auditimet lokale të sigurisë – Kompilacion praktikash ndërkombëtare, Paris 2007.

<sup>42</sup> Shih UNODC/UNECE, Doracak për anketat e viktimizimit, Gjeneva 2010.

<sup>43</sup> Downes, Mark, Dokument për mbledhjen e OSBE-së “Reforma e policisë brenda reformës së sistemit të gjërë të drejtësisë penale”, OSBE, Vjenë, shtator 2011, f. 3.

Figura 1. Vendimmarrja në procesin e drejtësisë penale



Burimi: UNODC, "Policia. Shërbimet forenzike dhe infrastruktura", në: UNODC, Pakoja e veglave të vlerësimit të drejtësisë penale, Nju-Jork, 2010, f. 57.

Në kuptimin e procesit të reformës së ardhshme, identifikimi nuk duhet thjesht të krijojë një pamje statike të ndërveprimit të palëve, por edhe të kuptojë që marrëdhëniet mes aktorëve mund të ndryshojnë, si dhe që vetë aktorët mund të marrin role të ndryshme derisa iniciativat reformuese zbatohen.

Sa i përket çështjes së mbikëqyrjes brenda SDP-së, identifikimi gjithashtu duhet të synojë të identifikojë se kush ka autoritetin për të mbikëqyrë kë, si dhe çfarë mekanizmash të mundshëm korrigjimi dhe/ose sanksionimi ekzistojnë<sup>44</sup>.

Pasi të jenë identifikuar të gjitha palët e SDP-së si dhe ofruesit jo-shtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, bashkë me ndërthurjet dhe marrëdhëniet e tyre, duhet vlerësuar puna e tyre, si dhe shkaqet e identifikuara që janë rrënja e mangësive të perceptuara.

Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) propozon të analizohet performanca e institucioneve dhe aktorëve të SDP-së në dy fokuse kryesore: kapaciteti dhe integriteti, duke kuptuar që zhvillimi i kapaciteteve nuk mund të jetë i qëndrueshëm në kohë pa llogaridhënie dhe integritet. Për këtë aktivitet, DCAF, në bazë të një modeli që është paraqitur në Raportin e OHR-së për Misionin Policor të Vazhdueshëm në UNMIBH si dhe Task-forcën Policore Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara<sup>45</sup>, ka zhvilluar Kornizën e Kapaciteteve dhe Integritetit (CIF) që grupon së bashku pyetjet përkatëse nga këndvështrimi i kapaciteteve dhe integritetit:

1. Tre nivelet organizative të një institucioni:
  - 1.1. individuale: edukimi, zotësitë
  - 1.2. organizative: mandati, resurset, strukturat, politikat dhe procedurat
  - 1.3. të jashtme: marrëdhëniet e tij me institucionet tjera
2. dy nivelet cilësore të një institucioni:
  - 2.1. kapaciteti: resurset ekzistuese (njerëzore, fizike dhe


<sup>44</sup> Ibid, ff. 4f.

<sup>45</sup> Cf. Holm, Tor Tanke/Monk, Richard/Rumin, Serge, Raporti i OHR-së për Misionin e Vazhdueshëm Policor në UNMIBH dhe Task-Forcën Policore Ndërkombëtare të OKB-së, Sarajevë, nëntor 2001.

teknike), strukturat dhe procedurat

2.2. integriteti: respektimi i normave dhe vlerave themelore në ushtrim të funksioneve të veta.

### *Korniza e kapaciteteve dhe integritetit*



Kjo kornizë gjithashtu mund të përdoret për analizimin e mangësive dhe ndërthurjeve në ofrimin e shërbimeve ndërmjet aktorëve të të njëjtit sektor të drejtësisë penale – pra mes degëve të ndryshme të një agjencie policore, në nivel lokal, rajonal apo shtetëror – si dhe në mes të institucioneve të ndryshme të sistemit të drejtësisë penale, duke përfshirë hierarkitë dhe linjat e paqarta të komunikimit mes aktorëve të ndryshëm. Kjo gjithashtu përfshin kultura të ndryshme institucionale që mund të pengojnë bashkëpunimin. Përveç dimensioneve të CIF-së, gjetjet e analizave të kontekstit socio-ekonomik gjithashtu fitojnë rëndësi kur ka nevojë të shpjegohen disa prej mangësive në veprimtarinë e SDP-së.

Pyetje më të përgjithshme për aplikimin e CIF-së janë të dhëna në Shtojcën 2.

Pasi të jenë grumbulluar informatat nga analiza e qeverisjes dhe kapaciteteve, si dhe veprimin e identifikimit, këto duhen krahasuar, kontrolluar në mënyrë të ndërthurur dhe trekëndëshe<sup>46</sup> me rezultatet nga analiza e nevojave publike dhe perceptimit. Interesat dhe motivimet politike, ekonomike, sociale, etnike apo të tjera që vijnë nga burimet e vlerësimit gjithashtu duhen marrë parasysh.

### **III.2 Pyetje vlerësuese për analizimin e marrëdhënieve mes institucioneve të ndryshme të SDP-së, agjencive tjera qeveritare dhe aktorëve joshtetërorë**

UNODC, OECD dhe organizata të tjera<sup>47</sup> kanë ndërtuar një tërësi gjithëpërfshirëse të pyetjeve vlerësuese për institucione të ndryshme të SDP-së. Pjesa vijuese bazohet në këtë tërësi pyetjesh, si dhe ofron një përmbledhje të atyre pyetjeve të cilat i adresojnë fushat e ndryshme të vlerësimit. Theksi vihet tek raportet në zinxhirin e drejtësisë penale, ndërmjet policisë dhe institucioneve të ndryshme shtetërore dhe joshtetërore, si dhe çështjet e ndërthurura, siç janë të drejtat e njeriut, aspektet gjinore dhe mbikëqyrja. Këto pyetje mund të ndryshohen për t'iu përshtatur konteksteve të veçanta shtetërore.

#### *III.2.1 Pyetjet për kontekstin socio-ekonomik, kulturor dhe politik*

- Në çfarë faze është zhvillimi socio-ekonomik dhe politik i vendit?
- Cili është konteksti historik i vendit, sidomos në kuptimin e ligjit në fuqi si dhe traditës së ofrimit të shërbimeve formale dhe jo-shtetërore të sigurisë dhe drejtësisë?
- A ekziston ndarja e pushtetit mes degëve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore?
- Cili është niveli i kontrollit politik të institucioneve të SDP-së?

---

<sup>46</sup> Kontrollimi në trekëndësh i informatave do të thotë që dy këndvështrime kundërtënëse baraspeshohen nga i treti, që preferohet të jetë këndvështrim i pavarur që mund të shpjegojë perspektivat kundërtënëse. Cf. Downes, Dokument për takimin e OSBE-së "Reforma policore brenda reformës së sistemit të gjerë të drejtësisë penale" (op. cit. note 43), f.8.

<sup>47</sup> Përveç listave të UNDOC-it dhe OECD-së të pyetjeve vlerësuese, tërësi gjithëpërfshirëse të pyetjeve ofrohen edhe nga: Akademia Folke Bernadotte/Grupi Suedez i Kontaktit, Reforma e Sektorit të Sigurisë. Korniza e vlerësimit (op. cit. note 32); Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit, Departamenti Amerikan i Shtetit, Vegla e rangimit të vlerësimeve të sektorit të drejtësisë penale, Uashington, D.C., qershor 2006; si dhe Rausch, Colette (ed.), Luftimi i krimeve të rënda në shoqëri pas konflikti. Doracak për politikë-bërësit dhe praktikuesit, Instituti Amerikan i Shtypit të Paqes, Uashington D.C., 2006, ff. 17-38.

- Sa të angazhuar në politikë janë ofruesit formalë të sigurisë dhe drejtësisë?
- Cili është niveli i legjitimitetit të sistemit politik tek popullsia?
- A ekziston mirëkuptimi i përgjithshëm për konceptin e sundimit të ligjit në shoqëri, si dhe a ndjehet respektimi i ligjit tek njerëzit?
- Cili është niveli i legjitimitetit të institucioneve të ndryshme të SDP-së dhe ofruesve jo-shtetërore të sigurisë dhe drejtësisë tek popullsia (shih edhe kapitullin III.2.2)?
- Sa e prek korrupsioni SDP-në?
- Sa të ndryshme janë bashkësitë e ndryshme etnike të përfaqësuara në SDP?
- Sa janë të përfaqësuara gratë në SDP?
- Cilët janë penguesit e mundshëm të RSDP-së?
- Cilat janë vlerat, ideologjitë dhe perceptimet e ndryshme të palëve kryesore të reformës?
- Cilët janë stimujt dhe dekurajimet e palëve të ndryshme në mbështetje të reformës?

### *III.2.2 Pyetjet në lidhje me nevojat e publikut për siguri e drejtësi*

- Cilët janë llojet më të shpeshta dhe më serioze të rreziqeve të sigurisë dhe padrejtësive?
- A ka grupe të caktuara që preken më shumë se të tjerët?
- A ka grupe që identifikohen si viktime të krimeve nga urrejtja?
- Sa janë gratë, burrat dhe fëmijët të cenueshëm ndaj llojeve të ndryshme të rreziqeve të sigurisë dhe padrejtësive?
- Cili është perceptimi publik për SDP-në? Sa konsiderohet i drejtë, efektiv dhe efikas? Sa i besojnë njerëzit SDP-së? Nëse nuk i besojnë, pse? Cilat janë çështjet kryesore që hasen nga SDP-ja? A ka grupe të veçanta që ndjehen të diskriminuara nga SDP-ja?
- Si i sheh publiku institucionet e ndryshme të SDP-së? Cili institucion merr besimin më të lartë të të qenit fer, efektiv, efikas dhe kompetent?
- A konsideron publiku që SDP-ja merret me korrupsionin publik në mënyrë efektive?
- Sa është i vetëdijshëm publiku për funksionet që kryhen nga institucionet

e ndryshme të SDP-së?

- Sa është i vetëdijshëm publiku për aktivitetet e SDP-së për përafrim me komunitetin?
- Sa ndjen publiku që është i angazhuar me SDP-në në trajtimin e prioriteteve të drejtësisë penale? Çfarë duhet bërë me grupet e pakicave dhe ata të veçuar?
- A vihen para rreziqeve pjesëtarët e shoqërisë civile nëse bashkëpunojnë me institucionet e sigurisë dhe drejtësisë? A duhet të brengosen ata për pikat në vijim: shkeljet e të drejtave të njeriut; sulmet hakmarrëse të kriminelëve; veprimet kryengritëse të shoqërisë së gjerë nëse SDP-ja nuk ka legjitimitet; si dhe mungesa e mbrojtjes së SDP-së ndaj sulmeve të tilla hakmarrëse apo veprimeve kryengritëse të shoqërisë?
- Sa ka qasje publiku në informata publike në lidhje me rastet penale?
- Sa është i angazhuar publiku në mbikëqyrjen e SDP-së?
- Mbi cilat institucione të SDP-së kërkojnë njerëzit më shumë kontroll apo ndikim?
- Në çfarë masë mbështetet popullata tek ofruesit joshitetorë të shërbimeve të sigurisë dhe drejtësisë? Cilat janë arsyet që për këtë (p.sh. afërsia, shpenzimet e vogla, traditat, besimet fetare, mungesa e qasjes në institucione formale të SDP-së, mungesa e besimit në institucione formale të SDP-së)? A ekzistojnë ofrues të caktuar joshitetorë të shërbimeve të sigurisë dhe drejtësisë që kanë kontroll mbi komunitete, territore apo resurse të caktuara?

### *III.2.3 Çështjet në lidhje me qeverisjen dhe kapacitetin e SDP-së*

#### a) Korniza ligjore e SDP-së

##### Aspektet e përgjithshme

- A ka legjislacion (kushtetuta, ligjet, policia, drejtësia, aktet e burgimit dhe sprovimit, kodi penal, kodi i procedurës penale, rregulloret gjyqësore) që përcakton, mes tjerash, përgjegjësitë themelore dhe kompetencat e institucioneve të ndryshme të SDP-së në lidhje me ndihmën për viktimat dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve? A është ai lloj legjislacioni në përputhje me konventat dhe rregullat përkatëse



ndërkombëtare ?<sup>48</sup>

- A e njuh legjislacioni ekzistencën e ofruesve jo-shtetërorë/zakonorë të shërbimeve të sigurisë dhe drejtësisë? A ka kufizime ndaj llojeve të veprave që trajtohen nga ofruesit jo-shtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe ndaj llojeve të ndëshkimeve apo dënimeve që vendosen nga këta ofrues jo-shtetërorë/zakonorë të drejtësisë?
- Kur janë shqyrtuar korniza ligjore apo elementet e saj më së fundmi?

### Procedura penale

- A është e definuar me kod apo ligj mënyra në të cilën duhet ndërmarrë hetimi penal dhe nga kush?
- Sipas ligjit, a ka gjyqtarë hetues brenda SDP-së? Cili është roli i tyre? Sa prej tyre janë emëruar dhe në çfarë niveli të sistemit gjyqësor?
- A ka ndërhyrje mes përgjegjësive të prokurorëve, apo mangësi që krijojnë paqartësi apo pasiguri juridike?
- Pozita e prokurorisë është vendosur tek dega ekzekutive apo gjyqësore e pushtetit?
- Në çfarë mase është i pavarur funksioni i prokurorisë nga degët e ekzekutivit dhe gjyqësorit?
- Kush udhëheq hetimet?
- A përcakton ligji alternativa kundrejt ndjekjes penale, si ndërmjetësimi, trajtimi dhe/ose shërbimi për komunitetin?
- A ka dallim të kuptueshëm mes fazës paraprake (apo përgatitore) të rastit dhe fazës së hetimit?
- A ka dispozita në ligj për shfrytëzimin e provave fizike dhe shërbimeve forenzike?
- Sa e rregullon ligj themelimin, funksionimin dhe financimin e shërbimeve forenzike, si dhe shfrytëzimin dhe pranueshmërinë e provave materiale në procedurë gjyqësore?

### Aspektet e të drejtave të njeriut

- A gjendet koncepti i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në

---

<sup>48</sup> Për listën e konventave ndërkombëtare kryesore, udhëzimet dhe zotimet që vlejnjë për udhëheqjen e SDP-së në zonën e OSBE-së, shih Shtojcën 1.

### legjislaçionin vendor?

- A është SDP-ja i obliguar të mbrojë dhe respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore?
- Cilat obligime sipas ligjit i kanë institucionet e SDP-së për viktimat dhe dëshmitarët e krimeve në raste penale? A përcaktohen me ligj masat për mbrojtjen e dëshmitarëve, si mbrojtja fizike, shtrembërimi i zërit, video-konferencat, seancat e mbyllura dhe zhvendosja, etj.?
- Çfarë garancish për qasje në shërbime juridike ka për të paditurit e varfër?
- Cilat janë bazat për paraburgim sipas ligjit?
- A janë të caktuara me legjislaçion afatet e arrestit policor dhe paraburgimit? A janë të njëjta ato për të miturit dhe për të rriturit?
- A ka afate kohore brenda të cilëve rasti penal duhet të trajtohet në gjykim dhe të zgjidhet si i tillë (p.sh. të shpallet vendimi apo dënimi)?
- A parashihet shprehimisht me legjislaçion ri-arrestimi me të njëjtat akuza (në rastin që afatet e mbajtjes policore kanë mundur lirimin, ose kur gjykata ka liruar një person të akuzuar)?

### Llogaridhënia dhe mbikëqyrja

- A ka kode të etikës për personelin e institucioneve të ndryshme të SDP-së?
- A janë të themeluar mekanizma ligjorë për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimeve të institucioneve të SDP-së?
- A munden që shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga zyrtarët e SDP-së të parashtrihen në gjykata të pavarura?
- A ka referencë specifike ndaj korrupsionit në lidhje me institucionet e SDP-së?
- A ekziston pushteti mbikëqyrës i prokurorisë mbi degët tjera të pushtetit?

### b) Politikat dhe rregulloret:

#### Aspekte të përgjithshëm

- A ka strategji e plan veprimi të shkruara shtetërore të drejtësisë penale?
- A ka strategji e plane veprimi kombëtare për institucione të ndryshme

të SDP-së?

- Kur janë shqyrtuar së fundmi politikat dhe rregulloret?
- A është siguria shtetërore përgjegjësi e një agjencie policore apo është funksion i ndarë? Nëse është funksion i ndarë, a rregullohen hetimet me të njëjtat rregulla si për policinë?
- A e avancojnë procedurat operative bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së apo e ngadalësojnë atë?
- A ka takime të rregullta të bashkërendimit në nivel të lartë mes prokurorëve dhe policisë?
- Si ndërvepron SDP-ja formale në kuptimin procedural me ofruesit jo-shtetërorë të shërbimeve të sigurisë e drejtësisë? A referohen rastet specifike ndërmjet tyre?
- A janë çështjet gjinore të standardizuara brenda politikave, rregulloreve e kulturës organizative në lidhje me rekrutimin, avancimin në karrierë, kushtet e punës dhe mbajtjen e personelit, sidomos në kuptimin e grave dhe pakicave etnike?

#### Procedurat penale

- Si procedohet rasti penal – nga pretendimi apo dyshimi për një vepër penale dhe ofrimi i këshillave për hetues, deri tek aktakuza formale, gjykimi dhe përfundimi?
- Kush udhëheq hetimin – oficeri i lartë policor, prokurori apo gjyqtari?
- Sa është filozofia e shërbimit prokurorial për hetimet penale në përputhje me qasjen që përdoret nga policia?
- Si i ndahen hetimet hetuesve?
- Cilat lloje të rasteve i ndahen vertikalisht prokurorëve, pra prokurori është përgjegjës për rastin përgjatë gjithë procedurës penale, që nga hetimi deri tek parashtrimi i aktakuzës, deri në gjykim dhe dënim.
- Në sistemet ku ka gjyqtar hetues, në çfarë faze ky zyrtar bëhet përgjegjës për zhvillimin, hetimin apo grumbullimin e provave në rastin penal? Cili është roli i policisë gjyqësore, nëse ka të tillë, në lidhje me gjyqtarin hetimor?
- Kush ndan rastet e reja?
- Kush përgatit shkresat e lëndës?
- Cilat lloje të të dhënave vihen brenda shkresave të lëndës?

- Kush mbikëqyr shkresat e lëndës?
- Çfarë lloji provash për grumbullimin e të cilave kërkohet urdhri nga gjyqtari? Kush parashtron kërkesën për atë urdhër, policia apo prokurori?
- A i jep prokurori këshilla policisë në kuptimin e kohës se kur kërkohet urdhri?
- Kush ka autorizimin për të arrestuar njerëz?
- Cilat janë përgjegjësitë e reaguesve të parë (oficerët policorë) kur arrijnë në skenën e krimit?
- A ka mirëkuptim të drejtë ndërmjet institucioneve të SDP-së për kontributin që mund të ofrohet nga qasja forenzike për procedurën gjyqësore?
  - A ka kërkesa në kornizë të politikave për të siguruar që reaguesit e parë në skenën e krimit, hetuesit policorë dhe prokurorët ta kuptojnë potencialin dhe kufizimet e provave forenzike dhe hetimeve të vendit të krimit, si dhe që institucionet e drejtësisë të kuptojnë peshën e provave forenzike?
  - A ka ndoshta edhe politika që sigurojnë që ekspertët e forenzikës të kuptojnë shfrytëzimin e të dhënave forenzike në procedurën penale si dhe implikimet e përfundimeve të bazuara mbi analizat dhe ekzaminimet forenzike?
- Sa e rregullojnë procedurat operacionale trajtimin e mirëfilltë të provave të mbledhura (grumbullimi, ruajtja, regjistrimi, paketimi dhe depozitimi) si dhe zinxhirin e mirëfilltë të kujdesit<sup>49</sup> për ato prova?
- Si regjistrohen, shënohen e paketohen provat dhe dëshmitë nga hetuesit?
- Si bashkërendohet puna – ndërmjet hetuesve, prokurorëve dhe laboratorëve forenzikë?
- Sa kanë qasje laboratorët tek materialet dhe/ose koleksionet referuese për punën në raste? Kush është i autorizuar të përdorë materialet referente? A krijon kjo qasje e referimit ndaj burimeve vonesa në raste?

---

<sup>49</sup> "Zinxhiri i kujdesit" i referohet procedurave dhe dokumenteve që sigurojnë integritetin e provave materiale duke përcjellur trajtimin dhe depozitimin e tyre që nga grumbullimi e deri tek disponimi me to. Dy terme tjera që përdoren janë "zinxhiri i provave" si dhe "vazhdimësia e provave" – shih UNODC, "Policia: Shërbimet dhe infrastruktura forenzike", tek: UNODC, Pako e vlerësimit të drejtësisë penale, Nju-Jork, 2010, f. 53.

- A janë prokurorët ligjërisht të lidhur me rezultatet e hetimit policor?
- A kanë policia dhe prokurorët lirinë e veprimit që të heqin rastet nga procedura penale apo që të lejojnë lirimin me dorëzani? (kjo mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në ngarkesën me raste si dhe numrin e të burgosurve apo kushteve në burgje)
- Çfarë autorizimesh kanë policia, prokurorët apo agjentët tjerë të drejtësisë penale në lirimin e personit që është mbajtur për marrje në pyetje para parashtrimit të aktakuzës?
- A ekziston ndonjë prezumim juridik në të mirë të dorëzanisë apo alternativave të reja ndaj paraburgimit, siç është mbikëqyrja/kufizimi i lirisë?
- A ka prokurori autorizim ligjor që t'i referojë rastet e alternativave kundrejt ndjekjes penale, si ndërmjetësimi, trajtimi apo shërbimi në komunitet? Nëse po, a ka nevojë për aprovim nga gjykata? A kufizohen alternativat e tilla tek kategori të caktuara të kryesve dhe veprave (p.sh. të miturit, shëndeti mendor, veprat me droga, apo dhuna në familje)?
- A ka prokurori autorizim ligjor që të negociojë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe si duket korniza rregullative e kësaj?
- Cilat lloje të veprave trajtohen nga ofruesit jo-shtetërorë/zakonorë të drejtësisë?
- Kush mund të propozojë përfshirjen e një dëshmitari në programet e mbrojtjes së dëshmitarëve, si dhe kush është përgjegjës për pranimin e dëshmitarit në atë program, si dhe përfundimin e tij?
- Kush është përgjegjës për vlerësimet e kërcënimeve, si dhe për vendosjen e masave mbrojtëse për dëshmitarë në procedurë penale?
- Kush është përgjegjës për ofrimin e sigurisë në gjykatë?
- Kush është përgjegjës për transportimin e të burgosurve drejt gjykatës, si dhe kush ofron sigurinë gjatë transferimit?

#### Aspektet e të drejtave të njeriut

- A munden që afatet kohore për mbajtje policore dhe paraburgim të zgjaten?

#### Kush vendos dhe mbi çfarë baze?

- A ka prokurori autorizim ligjor për të urdhëruar zgjatjen e paraburgimit të të dyshimtit? (kjo mund të përbëjë çështje të të drejtave të njeriut, në

rastet kur prokuroria gjithashtu heton krimin.)

#### Llogaridhënia dhe mbikëqyrja

- A kanë prokuroria dhe gjykatat politika mbi provat e siguruar në mënyrë të paligjshme, si dhe si duket kjo në kuptimin etik, ligjor dhe procedural? A mund të jenë të pranueshme provat e mbledhura në mënyrë të paligjshme?
- Cilat politika dhe procedura rregullojnë shqyrtimin e pretendimeve për gabime gjyqësore, si dënimet e gabueshme ose keqpërdorimi i lirisë/detyrës prokuroriale? A mund të bëhet testimi i ADN-së në këto raste? A ruhen provat fizike për përdorim në këtyre raste?
- Cilat dispozita ndërlidhen me procedurat e brendshme apo të jashtme të inspektimit të vendeve të mbajtjes së përkohshme?
  - A mundësohet me procedura dhe/ose rregullore që të themelohet një mekanizëm i pavarur monitorues i hapësirave të mbajtjes dhe paraburgimit?
  - A mundësohet me procedura dhe/ose rregullore që monitoruesit e jashtëm të bëjnë vizita të paparalajmëruara?
- Pasi parashtrohet aktakuza, a bëhet kjo informatë publike dhe vihet në dispozicion për mediat?
- A mbikëqyret përgatitja e shkresave për sigurim të cilësisë?
- A është policia e obliguar të mbajë regjistra të mbajtjes për të gjithë të dyshuarit e mbajtur? Cilat informata mbahen në këta regjistra të mbajtjes?
- A mundësojnë procedurat/rregulloret themelimin e një mekanizmi të pavarur të monitorimit të gjykimeve?

#### c) Strukturat

##### Aspektet e përgjithshme

- Nëse ka sistem federal, si e plotëson SDP-ja federal SDP-në në nivel lokal apo rajonal?
- Në çfarë niveli i koordinojnë institucionet e SDP-së aktivitetet e tyre – shtetëror, rajonal e lokal? Çfarë forme merr ai, me grupe punuese ad-hoc apo komisione formale?
- A ekzistojnë sisteme të menaxhimit të brendshëm të SDP-së (struktura menaxheriale, sistemet informative, procesi vendim-marrës, menaxhimi

- i performancës, etj.) e struktura komunikimi? A e lehtësojnë apo pengojnë ato efikasitetin e procesit/bashkëpunimit në drejtësi penale ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së?
- A mbajnë hetuesit policorë dhe prokurorët takime koordinuese për të diskutuar rastet në trajtim?
  - A është hetuesi kryesor (prokurori apo gjyqtari) i vendosur bashkë me policinë apo në afërsi të saj?
  - A ka struktura partneriteti me departamentet tjera të shërbimit publik, me ofrues jo-shtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe me grupet e shoqërisë civile?
  - Cila është marrëdhënia funksionale dhe ndarja e përgjegjësive mes ofruesve publikë dhe privatë të sigurisë?
  - Si janë ofruesit shtetërorë të sigurisë të angazhuar në trajnimin, licencimin dhe mbështetjen e ofruesve privatë të sigurisë ?
  - A ka mekanizma bashkëpunimi të vendosur me shërbimet sociale apo të sprovimit, kur ato ofrohen?
  - Sa e përshtatshme dhe optimale është ndarja e resurseve dhe ngarkesës së punës mes institucioneve të ndryshme të SDP-së për të siguruar proces efektiv dhe efikas të drejtësisë penale?
  - Cili është raporti mes prokurorëve/gjyqtarëve hetues dhe hetuesve policorë?

### Procedurat penale

- A ekziston sistemi i raportimit të krimeve?
- A ka ndonjë databazë për dënimet penale? Nëse po, a përmban ajo të dhëna personale të referencuara me të dhëna tjera të kryesit? A mund të shlyhet dosja penale, sidomos dosja e të miturve?
- A ekziston databaza forenzike e shenjave të gishtërinjve, ADN-së, balistikës dhe/ose të dhënave tjera (p.sh. gjurmët e këpucëve, gjurmët e rrotave, qelqit, ngjyrës, fijeve, profileve kimike të eksplozivëve apo drogave e prekursorëve të drogave)?<sup>50</sup>
  - A ndahet kjo bazë e të dhënave me institucionet e ndryshme të SDP-së?

<sup>50</sup> Për një pasqyrë më gjithëpërfshirëse të fushëveprimit të mundshëm të shërbimeve forenzike, shih: UNODC, "Policia: Shërbimet dhe infrastruktura forenzike" (op. cit. note 49), f. 48.

- Kush është përgjegjës për mirëmbajtjen, kopjet rezervë, ngarkimin dhe përditësimin, plotësinë, integritetin dhe autorizimin e qasjes në baza të të dhënave forenzike?
- A janë shërbimet e hetimit të vendit të ngjarjes pjesë e agjencisë policore, apo pjesë e një institucioni më të gjerë forenzik?
- Nga cilat agjenci ofrohen shërbimet forenzike – publike (nën cilën ministri) apo private?
- Cilat mundësi ekzistojnë për ekzaminimin forenzik të një skene krimi? A ndahen ato hapësira nga policia dhe prokuroria?
- A janë laboratorët forenzikë të pavarur nga policia?
- A ekzistojnë sisteme elektronike të menaxhimit të rasteve për menaxhimin e hetimeve të rasteve madhore? A përfshijnë sistemet e tilla të menaxhimit të rasteve informata policore, oraret e gjykatës, depozitimet përfundimtare të rasteve, si dhe informatat e paraburgimit?
- Cilat informata ndahen mes institucioneve të SDP-së dhe në çfarë niveli mbrohen informatat konfidenciale të rasteve? A mundet mbrojtja të parashtrijë kërkesë të zbulimit për të vështruar provat që prokuroria synon të përdorë?
- A ka personel të mjaftueshëm për të përdorur sistemet elektronike të menaxhimit të dosjeve të rastit?
- A ka pasur masa të vendosura në vitet e fundit për të përmirësuar menaxhimin e rrjedhës së rasteve (p.sh. përpjekje për të zvogëluar numrin e njerëzve në paraburgim, apo që presin vendimet e një mekanizmi inspektues)?
- A ka mënyrë të besueshme të njohjes se kur arrihet një periudhë e caktuar kohore në hetim dhe gjykim të një rasti penal?

#### Trajnimi

- A ka trajnime të përbashkëta e të specializuara në dispozicion për policinë, prokurorinë dhe gjyqtarët, në lidhje me hetimin e krimit (të organizuar)?
- Sa janë të përfshira çështjet e ndërthurura, si të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, standardizimi gjinor, si dhe etika e llogaridhënia e SDP-së në temat përkatëse të planprogrameve trajnuese bazë dhe të avancuara (të përbashkëta) të institucioneve të ndryshme të SDP-së?
- Aspektet e të drejtave të njeriut



- A janë garancitë e të drejtave të njeriut të mbështetura nga mekanizma të qëndrueshëm implementimi, apo prirjen të mbeten deklarative?
- A ekzistojnë qeli të veçanta të mbajtjes policore, paraburgimit dhe burgimit për fëmijë dhe të mitur, si dhe për burra e gra?
- A ofrohen avokatë mbrojtës për të varfrit?
  - Cilat janë masat mbrojtëse për të siguruar pavarësinë e avokatit të caktuar?
  - A ka kategori të të paditurve që nuk mund të mohojnë të drejtën e tyre për avokat?
  - A munden të miturit të mohojnë të drejtën e tyre për avokat?
- A ekzistojnë rregullore të mbrojtjes së të dhënave që rregullojnë trajtimin e mirëfilltë të të dhënave të të dyshimtëve dhe të dënuarve nga zyrtarët e SDP-së, në pajtim me parimet ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave? Përveç kësaj, a kufizojnë ato përdorimin e të dhënave personale deri në masën e domosdoshme për arritjen e qëllimeve të ligjshme, legjitime dhe specifike?

#### Llogaridhënia dhe mbikëqyrja

- Kur policia tejkalon juridiksionin e mbajtjes së të dyshimtit në polici, çfarë arsytimi ofrojnë për këtë?
- Cilët janë mekanizmat dhe strukturat për monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të institucioneve të SDP-së? Sa është e përfshirë shoqëria civile në monitorimin e institucioneve të SDP-së?
- A janë implementuar në të vërtetë?
- A ekzistojnë politika për mbrojtje të alarmuesve/informatorëve brenda sistemit të drejtësisë penale që bëjnë ankesa për sjelljet e pahijshme të zyrtarëve të SDP-së?
- A ekziston ndonjë sistem ankesash që i mundëson publikut të ankohet për qasje në SDP, ofrimin e shërbimeve të SDP-së, si dhe sjelljen e aktorëve individualë të SDP-së? Sa funksionon ai?
- A lejohen mediat të marrin pjesë në gjykime?

#### d) Veprimtaria e institucioneve të SDP-së

## Procedurat penale

- A funksionojnë mirë organet e bashkërendimit?
- A ka konflikt mes rregullave formale të bashkëpunimit dhe normave kulturore ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së?
- A bëjnë hetuesit krahasime e lidhje ndërmjet rasteve aktive dhe atyre historike?
- Pasi të kryhen ekzaminimet dhe analizat forenzike, a dorëzohen raporte/ rezultate? Nëse po,
  - Tek kush? (p.sh. policia, hetuesit penalë, prokurorët, gjyqtarët, të dyshimtit, avokatët mbrojtës, viktimat, dhe/ose të tjerë)?
  - Njëkohësisht ose në kohë të ndryshme, si dhe në çfarë rendi?
- Cili është numri i rasteve që i dorëzohen laboratorëve forenzikë në vit, si dhe koha e kthimit të rezultateve?
- A përdoren pa kriteret e në mënyrë arbitrare autorizimet e policisë dhe agjencive tjera të zbatimit të ligjit për arrestime?
- A mbahen regjistra të mbajtjes policore? Çfarë cilësie janë informatat e regjistruara?
- A ka ngarkesë të rasteve të pazgjidhura? Sa raste penale presin për procedurë ankimore?
- Sa shpesh aplikohen masat alternative/diversitetit nga sistemi i drejtësisë penale në praktikë nga policia dhe/ose prokurorët dhe aktorët tjerë të drejtësisë penale? Çfarë masash alternative përdoren më së shpeshti?

## Aspektet e të drejtave të njeriut

- A përdoren qelitë policore për periudha të gjata për shkak të mungesës së hapësirës në paraburgim apo mungesës së burgjeve?
- A ndahen gjithmonë të miturit në mbajtje policore dhe paraburgim nga të rriturit?
- Cila është përqindja e të mbajturve të mitur dhe të rritur në polici dhe paraburgim që kanë përfaqësim juridik?
- A perceptohen avokatët e caktuar si të pavarur?
- A respektohen afatet e mbajtjes policore dhe paraburgimit?

Nëse jo, sa shpesh mbahen të burgosurit përtej afateve të caktuara me ligj?

Cilat janë arsytet për tejkalimin e afateve kohore?

- Kur ekziston një afat mbajtjeje, si dhe gjykata liron të burgosurit mbi këtë bazë, ose kur gjykata liron personin e akuzuar, a mundet policia ta arrestojë prapë të akuzuarin, si dhe ta riakuzojë për të njëjtin krim? Nëse ndodh, sa shpesh ndodh kjo?
- A përdorin ofruesit jo-shtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë praktika që shkelin ligjet formale dhe normat ndërkombëtare?

Llogaridhënia dhe mbikëqyrja

- Cilat janë aktivitetet e SDP-së në lidhje me edukimin publik për funksionet e tij, si dhe sa mirë funksionojnë ato? A ekzistojnë aktivitete të përafritit me publikun? Sa bën përpjekje SDP-ja për të angazhuar komunitetin në adresimin e prioriteteve të drejtësisë penale? Si? A afrohet ai me komunitetet etnike, fetare e ato pakicë me të njëjtin nivel përpjekjesh?
- Sa mundëson apo kufizon SDP-ja qasjen në informata në lidhje me rastet që i ka nën hetim? A ekzistojnë kapacitete të informimit publik ashtu që shtypi dhe qytetarët të mund të marrin informata publike për rastet? Cila është marrëdhënia me shtypin?
- A ka personel në SDP për t'iu përgjigjur pyetjeve të publikut në lidhje me të drejtën penale?
- Sa rregullisht informojnë hetuesit policorë viktimat për përparimin e arritur në rast?
- A vendosen matës performance nga SDP-ja për personelin e vet? Nëse po, cilët janë ata? A përfshijnë ato edhe ndërveprimin e institucioneve të SDP-së?

#### ***III.2.4 Pyetjet për iniciativa të tjera ndërkombëtare të RSDP-së***

- Çfarë aktivitetesh janë tashmë në zbatim e sipër për RSDP?
- Cilat agjenci ndërkombëtare e vendore janë të angazhuara në reformë?
- Sa pajtohen aktorët e ndryshëm ndërkombëtarë për synimet e përgjithshme të RSDP-së?
- Sa i kuptojnë aktorët e reformës synimet dhe përgjegjësitë e veta? A zbatohet qasje tërësore e shumë-disiplinore e gjithëqeveritare, duke përfshirë iniciativat politike e zhvillimore? A adresojnë ato marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së? Sa koordinohen këto

aktivitete? A ekziston ndonjë mekanizëm i bashkërendimit? A ka ndonjë agjenci udhëheqëse?

- A ekzistojnë mekanizma që sigurojnë qëndrueshmërinë e secilit aktivitet dhe donacion të përbashkët?

## IV. Zhvillimi i një strategjie reformuese dhe i planeve të zbatimit

Kur hartohet strategjia për një iniciativë të RSDP-së, rezultatet e mbledhura të një vlerësimi bazë duhen konsoliduar në atë mënyrë që nevojitet nga publiku, si dhe perceptimet të mund të përdoren për të gjetur pikat ku mund të ndërhyhet. Pikat e ndërhyrjes duhen zgjedhur aty ku ka dobi të menjëhershme për qytetarë. Në kuptimin e qasjes së nevojshme afatgjate ndaj RSDP-së, gjithmonë duhet pasur parasysh qasja tërësore. Pra, strategjitë duhet të përcaktojnë programe afatgjata dhe projekte afatshkurtra/vjetore që do t'i ofronte të gjithë aktorëve kuptim të qartë të aktiviteteve të planifikuara. Kjo sidomos ka rëndësi në kuptimin e rotacioneve të pashmangshme të personelit në mision dhe tek palët tjera ndërkombëtare dhe vendore<sup>51</sup>.

Në bazë të informatave cilësore dhe sasore të mbledhura në procesin e vlerësimit, strategjia reformuese duhet të caktojë synime, standarde e kritere realiste dhe të arritshme që duhen arritur brenda një afati realist kohor. Këto standarde duhen përdorur më tutje për të vlerësuar suksesin dhe/ose ndikimin e implementimit të programeve të RSDP-së, si dhe nëse arrihen, të fillojnë edhe fazën përmbyllëse. Strategjia e fazës përmbyllëse duhet të jetë aq fleksibile sa t'i përshtatet zhvillimeve të ardhshme.

Afatet kohore duhet të reflektojnë gjendjen lokale të SDP-së, si dhe të sigurojnë më shumë kohë në një mjedis ku kushtet për implementim janë të vështira. Më së paku tri deri në pesë vjet kërkohen në mjedise të tilla sfiduese.

Për më tepër, strategjitë reformuese duhen plotësuar me plane konkrete veprimi për zbatimin e strategjisë. Këto plane veprimi duhet të ofrojnë plane të hollësishme veprimi apo operacionale, të cilat tregojnë se si të vihen në praktikë hapat e ndryshëm të implementimit.

Këto plane duhet të përshkruajnë ndryshimet dhe resurset e nevojshme organizative (personeli, burimet materiale dhe financiare) për hapat e ndryshëm. Theksi duhet vënë fuqimisht tek shfrytëzimi më efikas i mundshëm i resurseve të disponueshme, e më pak tek sigurimi i pajisjeve të reja. Derisa shumë institucione të SDP-së do të kenë kërkesa legjitime për infrastrukturë e pajisje për të përkrahur zhvillimin e kapaciteteve, pajisjet

---

<sup>51</sup> Për një pasqyrë më gjithëpërfshirëse të hapave praktikë në zhvillimin e strategjisë së reformës, shih edhe Hansen Annika S./Wiharta, Sharon/Claussen, Bjorn R./Kjeksrud, Stian, Tranzicioni drejt një rendi të drejtë – Krijimi i pronësisë lokale pas konfliktit. Udhëzues praktik, Botimet e Akademisë Folke Bernadotte, Stokholm 2007, ff. 29-36; dhe

<sup>52</sup> Harris, Frank, Roli i zhvillimit të kapaciteteve në reformën policore, Misioni i OSBE-së në Kosovë, Departamenti për Edukim dhe Zhvillim të Policisë, Prishtinë 2005, ff. 23-29.

e tilla duhen ofruar vetëm deri në masën e plotësisht të nevojave qartësisht të identifikuar në vlerësimin e nevojave dhe në planin përcjellës zhvillimor. Kjo gjë duhet komunikuar qartë që në fillim të cilitdo program reforme, ose premtimi për resurse materiale mund të devijojë ose të nënvlerësojë kërkesat më të rëndësishme të reformës institucionale<sup>52</sup>.

Kur OSBE-ja është e angazhuar në aktivitete reformuese, planet e veprimit i duhen referuar drejtpërdrejt procesit vjetor të “Buxhetimit Programor me bazë performance”, i cili kërkon definimin e qartë të arritjeve, rezultateve dhe ndikimit të programeve, ashtu si dhe indikatorëve për matjen e përparimit<sup>53</sup>.

Siç përmendet më lart, për të krijuar pranueshmërinë dhe pronësinë e reformës brenda vendit nga të gjitha palët relevante vendore, është qenësore që të angazhohen përfaqësuesit relevantë nga institucionet shtetërore por edhe nga shoqëria civile në zhvillimin e strategjisë që nga fillimi, si dhe të reflektohen interesat e të gjitha palëve në programin reformues. Megjithatë, arritja e pajtueshmërisë ndërmjet të gjithë aktorëve në reformë mund të jetë e vështirë për shkak të përbërjes normalisht heterogjene të shoqërisë civile, gjë që ka gjasë të shfaqë interesa të ndarë mes këtyre përfaqësuesve, por edhe interesa të ndryshëm edhe ndërmjet institucioneve të SDP-së.

Megjithatë, është prapë e domosdoshme që të sigurohet pajtimi i përbashkët mbi prioritetet e reformës dhe renditjen e implementimit në kuptimin e resurseve dhe kapaciteteve zakonisht të kufizuara në implementim të reformës. Këto sfida gjithashtu kërkojnë që të gjithë aktorët të përkushtohen ndaj respektimit të marrëveshjeve.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme që të merret parasysh edhe natyra politike e reformës, duke përfshirë dobitë potenciale për aktorë të ndryshëm në nivel lokal, rajonal e shtetëror. Përforcimi i një pale në SDP në dëm të perceptuar apo të vërtetë të palës tjetër mund të shkatërrojë baraspeshën delikate politike ndërmjet institucioneve, si dhe të shkaktojë rezistencë nga pala “e dëmtuar”.

Për më tepër, nëse publiku nuk ndjen ndonjë dobi të drejtpërdrejtë për vete, duke pasur ndjenjën që reforma nuk po përmirëson e as nuk pritet

---

<sup>52</sup> OSBE, Implementimi i programeve të ndërlidhura me policinë. Mësimet e nxjerra në Evropën Juglindore, Botim i SPMU, vëllimi 7, Vjenë, dhjetor 2008, ff. 25-27 a. 39-41; shih edhe

<sup>53</sup> NODC/USIP, Reforma e drejtësisë penale në shtetet pas konfliktit (op. cit. note 8), ff. 27-35.

<sup>53</sup> Për një pasqyrim më gjithëpërfshirës të vlerësimeve të projekteve dhe PBPB, shih:

<sup>53</sup> OSBE, Buxhetimi Programor në bazë të Performancës, Vjenë, 2007;

<sup>53</sup> OSBE, Udhëzues për përdorimin e treguesve të performancës në OSBE, Njësia për përkrahjen e programimit dhe vlerësimin, Vjenë, mars 2009; dhe

<sup>53</sup> OSBE, Menaxhimi i projekteve në OSBE. Doracak për menaxherët e programeve dhe projekteve, Vjenë, 2010.

të përmirësojë sigurinë dhe rendin e tyre, nuk do ta përkrahë procesin e reformës, gjë që do ta bëjë qëndrueshmërinë e reformës të pamundur. “Projektet e ndikimit të shpejtë” që përfundojnë brenda disa muajsh pas fillimit të procesit të reformës mund të prodhojnë disa përmirësime të menjëhershme e të dukshme të gjendjes së sigurisë e rendit<sup>54</sup>.

Aspekte tjera që duhen mbajtur mend janë teknike, si për shembull: kapaciteti absorbues i një vendi në pranimin e ndihmës; nevoja për pranimin e paqartësive, duke pasur nevojë kështu për një “qasje procesi” fleksibile; si dhe nevoja e të qenit realistë në kuptimin e asaj se çfarë mund të arrihet vërtetë.

---

<sup>54</sup> Projektet e ndikimit të shpejtë mund të përfshijnë elemente infrastrukturore, si zhvillimi apo renovimi i stacioneve policore apo gjykatave, për të avancuar qasjen në siguri apo drejtësi; dhurimi i pajisjeve themelore për të avancuar punën e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë; trajnimi i përsheptuar i oficerëve të zbatimit të ligjit apo korrektues për të drejtat e njeriut, apo trajtimin e grupeve të cënueshme; si dhe përkrahja e komisioneve të pavarura që përcjellin trajtimin e njerëzve në mbajtje, apo trajtimin e përgjithshëm të grupeve të cënueshme; për më shumë shembuj, shih UNODC/USIP, Reforma e drejtësisë penale në shtetet pas konfliktit (op. cit. note 9), ff. 33 dhe 84.





## V. Reformimi i kornizës ligjore

Në përputhje me parimet e sundimit të së drejtës se “të gjithë personat, institucionet dhe subjektet, publike dhe private, duke përfshirë edhe vetë shtetin, janë përgjegjës ndaj ligjeve që miratohen në mënyrë publike, që zbatohen në mënyrë të barabartë dhe në bazë të së cilave gjykohet në mënyrë të pavarur”<sup>55</sup>, reforma e ligjit të sistemit të drejtësisë penale është një parakusht për përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të SDP dhe prandaj është hapi i parë në zbatimin e RSDP-së.

Në shumë territore që kanë dalë nga konflikti, reforma ligjore është gjithashtu e nevojshme për shkak se nuk ka qartësi se cila e drejtë duhet të zbatohet. Ky ishte një problem i madh për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ku gjyqtarët shqiptarë refuzuan njohjen e së drejtës jugosllave të vitit 1999 për shkak se ata ndiheshin të diskriminuar dhe të shtypur nga ajo.<sup>56</sup> Praktika e hartimit të një përmbledhje të veçantë të së drejtës ekzistuese para konfliktit si “e drejtë e zbatueshme, me kusht që të jetë në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, megjithatë shpesh ka krijuar më pak siguri ligjore e jo më shumë.<sup>57</sup>

Në përgjithësi, e drejta penale në fuqi në një vend do të duhet të përditësohet për ta përshtatur ligjin ndaj mjedisit në ndryshim e sipër të normave shoqërore dhe zakoneve, si dhe për të trajtuar kërcënimet e reja që burojnë nga format e reja të terrorizmit dhe krimit, e posaçërisht krimit të organizuar. Prandaj ligjet e reja penale mund të trajtojnë veprat e reja penale si dhe mjetet e reja të hetimit. Veprat e reja penale mund të përfshijnë dhunën në familje apo të bazuar në gjini, krimet e nxitura nga urrejtja dhe korrupsionin, si dhe trendët e reja të krimit të organizuar të tillë si shpëlarja e parave, financimi i terrorizmit, trafikimi me qenie njerëzore. Ato mund po ashtu të përfshijnë trafikimin e mallrave të caktuar, për shembull të drogës ose të prekursorëve dhe armëve.

Këto vepra penale duhet të përfshihen në ligj për t’ju mundësuar institucioneve të SDP të reagojnë ndaj tyre. Me qëllim që t’i mundësojmë SDP të reagojë në mënyrë efektive dhe efikase ndaj këtyre veprave penale, në ligj do të duhej të përfshiheshin mjetet e reja të parandalimit të krimit dhe hetimit. Mjetet e tilla mund të përfshijnë teknikat e reja të hetimit (p.sh.,

---

<sup>55</sup> Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve Bashkuara, Sundimi i së drejtës dhe drejtësia Kalimtare në shoqëritë në konflikt dhe pas konfliktit (fusnota 1 cituar më sipër), paragrafi 6.

<sup>56</sup> Cf. Stodieck Thorsten, “Forcat Policore Ndërkombëtare në Operacionet e Paqes” në: Harvey Langholtz/Boris Kondoch/Alan Well (bot.), Paqëruajtja Ndërkombëtare: Vjetari i Operacioneve Ndërkombëtare të Paqes, vëllimi 9 (2005), f. 97, dhe cf. Rausch, Luftimi i Krimit të Rëndë në Shoqëritë pas Konfliktit (fusnota 47 cituar më sipër), f. 51.

<sup>57</sup> Cf. ZKBDK/IAP, Reforma e Drejtësisë Penale në shtetet pas konfliktit (fusnota 9 cituar më sipër), f. 63.

vëzhgimin elektronik, operacionet e fshehta, dërgesat e kontrolluara dhe analizat mjeko-ligjore), masat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe sistemet e reja të menaxhimit të lëndëve.

Sa i përket qasjes tërësore ndaj reformës, ajo çka duhet të merret parasysh është se ndryshimet në një fushë të së drejtës zakonisht kanë ndikime në fushat e tjera të së drejtës. Dispozitat e reja duhet të kontrollohen në lidhje me ndikimin e tyre në raportet mes institucioneve të ndryshme të SDP dhe ndërveprimit mes tyre. Me paraqitjen e detyrave të reja, përgjegjësi dhe mjeteve për SDP, shpërndarja e re e përkufizuar e kompetencave ndërmjet institucioneve të SDP-së do të duhet të sqarohet me anë të ligjit të ri.

Për më tepër, implikimet financiare të ligjeve të reja gjithashtu duhet të merren parasysh për të peshuar meritat teorike të ligjeve të reja kundrejt jetësimit të tyre praktik.

Pjesët në vijim së pari do të shtjellojnë ligjet e zbatueshme që duhet të rishikohen në procesin e reformës dhe më pas do të përqendrohen në disa dispozita ligjore që trajtojnë bashkëpunimin mes institucioneve të SDP-së për të reaguar në mënyrë efektive dhe efikase kundër veprave penale.

## V.1 Ligjet e zbatueshme që duhet të rishikohen

Ligjet e zbatueshme të një vendi “përfshijnë ligjet e brendshme të vendit dhe të drejtën ndërkombëtare që përcaktojnë detyrimet e tij në nivel ndërkombëtar që duhet të respektohen në vend”.<sup>58</sup>

Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, baza e përgjithshme normative për reformën e ligjit duhet të jetë *Karta e Kombeve të Bashkuara*, e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e drejta ndërkombëtare humanitare, e drejta penale ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare për refugjatët. Kjo mori e të drejtave përfaqësojnë standardet e zbatueshme universale të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë penale që janë miratuar nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, reforma e ligjit të drejtësisë penale në zonën e OSBE-së gjithashtu duhet të jetë në përputhje me zotimet e OSBE-së ndaj të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe sundimit të së drejtës siç janë mishëruar në *Aktin Final të Helsinkit*, *Dokumentin e Kopenhagës*, *Kodin e Mirësjelljes për Aspektet Politiko-Ushtarake të Sigurisë* dhe vendimet e ndryshme të OSBE-së për veprimtaritë e ndërlidhura me policinë.<sup>59</sup>

---

<sup>58</sup> Po aty, f. 57.

<sup>59</sup> Shih Shtojcën 1 për një listë të konventave, udhëzimeve dhe zotimeve kryesore që zbatohen për drejtimin e punës së SDP në zonën e OSBE-së.

Ligjet që duhet të rishikohen gjatë RSDP tërësore janë<sup>60</sup>:

- Kushtetutat e shtetit,
- Dekretet presidenciale apo mbretërore në shtetet ku ato miratohen,
- Kodet penale,
- Kodet e procedurës penale,
- Ligjet e veçanta për llojet e posaçme të krimit,
- Kodet e kundërvajtjes që përfshijnë veprat dhe kompetencat në lidhje me rendin publik,
- Kodet e drejtësisë për të miturit,
- Legjislacionin relevant për procedurën penale në shtetet që nuk e kanë të miratuar kodin e procedurës penale,
- Ligjet për ekzekutimin e sanksioneve penale (nëse nuk janë të përfshira në kodin e procedurës penale),
- Ligjet për gjykatat dhe përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve,
- Ligjet për policinë,
- Ligjet për shërbimin sprovues dhe të burgut,
- Ligjet që rregullojnë shërbimet e inteligjencës dhe të policisë së fshehtë,
- Ligjet për mbrojtjen e të dhënave dhe sistemet e informatave digjitale,
- Ligjet që rregullojnë forcat ushtarake të vendit kur ato kanë të bëjnë me çështje të tilla si rendi publik, paraburgimi apo hetimi ndërlidhur me çështjet penale të civilëve,
- Ligjet që lidhen me praktikën ligjore në vend duke përfshirë ligjet për ndihmë juridike dhe ligjet për odën e avokatëve,
- Ligjet për viktimën dhe mbrojtjen dhe ndihmën e dëshmitarëve,
- Ligjet kundër diskriminimit,
- Kodet gjegjëse të etikës për gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe policinë,
- Ligjet për institucionet mbikëqyrëse (p.sh., ligji për avokatin e popullit),
- Ligjet për edukimin ligjor,

---

<sup>60</sup> Cf. ZKBDK/IAP, Reforma e Drejtësisë Penale në Shtetet pas Konfliktit (fusnota 9 cituar më sipër), f. 58 dhe Rausch, Luftimi i Krimit të Rëndë në Shoqëritë pas Konfliktit (fusnota 47 cituar më sipër), f. 43-45.

- Ligjet për drejtësinë joshtetërorë dhe ofruesit e sigurisë dhe për raportin mes këtyre sistemeve dhe sistemit shtetëror zyrtar,
- E drejta zakonore apo tradicionale në çështjet penale, nëse zbatohet sipas ligjit,
- Ligjet për ofruesit privat të sigurisë,
- Ligjet për imunitetin e personaliteteve shtetërore dhe shërbyesve publikë,
- Ligji për lirinë e asociimit (duke përfshirë OJQ-të), dhe
- Ligjet për themelimin e gjykatave të posaçme apo të mekanizmave të drejtësisë tranzicionale.

Në shtetet pas konfliktit, korniza ligjore mund gjithashtu të përfshijë dispozitat e përkufizuara në marrëveshjet e paqes dhe në rezolutat/mandatet e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.<sup>61</sup>

Sic u cek më sipër, në disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së korniza ligjore mund të përbëhet, përveç ligjeve zyrtare të miratuara, edhe nga një mori e traditave zakonore dhe të bazuara në fe dhe ligje që mund të ndikojnë në ofrimin e sigurisë dhe drejtësisë.

Përveç përcaktimit të përshtatshmërisë së ligjeve të lartcekura për mundësimin e një procesi efektiv dhe efikas të drejtësisë penale, rishikimi i ligjit duhet njashtu të përcaktojë nëse dhe në çfarë shkalle kanë pasur ndikim ligjor në procesin e drejtësisë penale detyrimet juridike të shtetit që burojnë nga traktatet ndërkombëtare. Për shembull, nëse një vend e ka nënshkruar dhe e ka ratifikuar Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar, atëherë e ka miratuar ai legjislacionin për veprat penale materiale dhe dispozitat procedurale që përcaktohen me Konventë duke përfshirë gjithashtu krijimin e kornizave për ekstradim, ndihmë juridike reciproke dhe bashkëpunim reciprok mes agjencive të zbatimit të ligjit në nivel ndërkombëtar?<sup>62</sup>

Përveç traktateve ndërkombëtare, një shtet gjithashtu mund të ketë nënshkruar dhe ratifikuar traktate të detyrueshme rajonale a bilaterale me shtete tjera apo organizata që mund të kenë efekte juridike në procesin vendor dhe transnacional të drejtësisë penale.

Përfundimisht, ligjet e zbatueshme zyrtare dhe jozyrtare duhet të rishikohen përkitazi me përputhshmërinë e tyre me standardet e lartcekura ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe drejtësisë penale, me qëllim

---

<sup>61</sup> Po aty, f. 43.

<sup>62</sup> Po aty, f. 40.

të trajtimit të çështjeve të ndërthurura të tilla si respektimi i të drejtave të njeriut gjatë veprimtarive të SDP duke përfshirë mbrojtjen e grupeve të cenueshme, normëzimin gjinor dhe promovimin e llogaridhënies së SDP dhe mbikëqyrjes.

Përveç këtyre çështjeve të ndërthurura, pjesa në vijim do të trajtojë kryesisht aspektet e reformës ligjore ku shtjellohen masat për përmirësimin e bashkëpunimit mes institucioneve të ndryshme të SDP, agjencive të tjera qeveritare, ofruesve joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë si dhe shoqërisë civile për ta bërë procesin e drejtësisë penale më efektiv dhe më efikas.

## **V.2 Rishikimi i dispozitave ligjore për të përmirësuar reagimin e SDP**

### *V.2.1 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP*

Reforma e kornizës ligjore për SDP duhet të mëtojë lehtësimin e krijimit të politikave të integruara dhe procedurave për ministritë, agjencitë dhe funksionet e përfshira në procesin e drejtësisë penale.

Duke qenë se reforma e kornizës ligjore duhet t'i përshtatet kontekstit vendor dhe duke qenë se raporti mes institucioneve të ndryshme të SDP mund të ndryshojë nga vendi në vend, fushat shqetësuese në vijim janë të përgjithshme në karakter dhe të zbatueshme në kontekste të ndryshme vendore.

Për më tepër, shembujt të dispozitave ligjore për përmirësimin e bashkëpunimit të SDP janë marrë kryesisht nga *Kodi Model Penal* (KPM) dhe *Kodi Model i Procedurës Penale* (KMPP) që janë hartuar nga Instituti Amerikan për Paqe dhe Qendra Irlandeze për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me Zyrën e OKB-së për Drogat dhe Krimin dhe Zyrën e Komisarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Këto dispozita mund të përshtaten dhe përfshihen në ligjin e ri vendor ose së paku mund të përdoren si burim i frymëzimit në procesin e reformave ligjore.<sup>63</sup>

Gjithashtu u rekomandohet personave të cilët rishikojnë dhe hartojnë ligjet e reja që të përdorin *Udhëzuesin e Referencave në Procedurën Penale*<sup>64</sup> që

---

<sup>63</sup> Cf. Instituti Amerikan për Paqe, *Kodi Model Penal, Kodet Modele për Drejtësinë Penale Pas Konfliktit, vëllimi I*, Uashington D. C, 2007; dhe Instituti Amerikan për Paqe, *Kodi Model i Procedurës Penale, Kodet Modele për Drejtësinë Penale Pas Konfliktit, vëllimi II*, Uashington D. C, 2007.

<sup>64</sup> Cf. OSBE, *Udhëzuesi i Referencave në Procedurën Penale, seri e botimeve të NJÇPS, vëllimi 2, Vjenë, dhjetor 2006.*

u nis dhe mbështet nga Kryesia belge dhe spanjolle e OSBE-së, dhe që u hartua mes viteve 2006-2007 nga Njësia e OSBE-së për Çështje Policore Strategjike në bashkëpunim të ngushtë me Grupin e Punës të Nivelit të Lartë për Procedurën Penale. Grupi i punës përbëhej nga ekspertët e drejtësisë penale nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që përfaqësonin sistemet e ndryshme të drejtësisë penale në kuadër të zonës së OSBE-së, si dhe që garantonte njohjen e normave dhe standardeve të drejtësisë penale të pranuar në nivel ndërkombëtar. *Udhëzuesi i referencave në procedurën penale* rendit disa dispozita të përgjithshme për të cilat ranë në ujdi përfaqësuesit e sistemeve të ndryshme të drejtësisë penale.

Duke qenë se dallimi mes të drejtës civile dhe të drejtës anglosaksone shpesh përzihet në legjislacionin vendor, për shkak të huazimeve nga sistemet e ndryshme gjatë reformës së ligjit të mëparshëm, ligjet vendore shpesh kanë një karakter hibrid; prandaj hartuesit e ligjit të ri mund të zgjedhin dhe të përziejnë tiparet dhe dispozitat juridike nga traditat e ndryshme që funksionojnë më së miri në kontekstin vendor.<sup>65</sup>

### *Marrëdhënia mes institucioneve të SDP*

Në përgjithësi, reforma e kornizës ligjore duhet të sigurojë që legjislacioni vendor në mënyrë të qartë t'i përkufizojë përgjegjësitë kryesore, kompetencat dhe detyrat e institucioneve të ndryshme të SDP në lidhje arrestimin, paraburgimin, hetimin dhe procedurat gjyqësore, si dhe në lidhje me ndihmën për viktimë dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dënuar me burg.

Ky hap i reformës duhet gjithashtu të mëtojë mënjanimin e pasigurisë ligjore rreth përgjegjësisë duke eliminuar mbivendosjen e përgjegjësisë mes institucioneve të ndryshme të SDP në një anë, dhe në anën tjetër të ngushtojë hendekun e përgjegjësisë mes institucioneve të ndryshme të SDP. Në shtetet federale, kjo po ashtu kërkon dispozita të qarta përkitazi me përgjegjësitë e institucioneve të SDP të degëve të njëjta në nivel qendror/kombëtar dhe në nivel rajonal.

Për më tepër, kodet e procedurës penale apo ligjet gjegjëse duhet të përkufizojnë mënyrën se si duhet të kryhet hetimi penal, për shembull se kush e udhëheq hetimin. Kodet dhe ligjet duhet njashtu të promovojnë në mënyrë të qartë bashkëpunimin e ngushtë mes institucioneve të ndryshme të SDP.

---

<sup>65</sup> Cf. Instituti Amerikan për Paqe/Instituti për Operacione të Paqeruajtjes dhe Stabilitetit i Ushtrisë Amerikane, *Parimet Udhëzuese për Stabilizim dhe Rindërtim*, Uashington D.C., 2009, f. 73.

Reforma e kornizës ligjore duhet gjithashtu të sigurojë që legjislacioni vendor garanton pavarësinë e gjyqësorit nga degët e zbatimit të ligjit dhe që në mënyrë të qartë të përkufizojë përgjegjësitë e ofruesve zakonor dhe joshitetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes tyre dhe institucioneve zyrtare të SDP.

Në lidhje me përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme të SDP në procesin e drejtësisë penale, KMPP përcakton disa dispozita:<sup>66</sup>

- Neni 45 i KMPP përkufizon detyrat e prokurorisë,
- Neni 46 i KMPP përkufizon detyrat e prokurorëve individual,
- Neni 53 i KMPP përkufizon detyrat e policisë,
- Neni 91 KMPP përkufizon kryerjen e hetimeve penale,

KMPP e njej se në disa SDP policia është përgjegjëse për tërë hetimin e një vepre penale të supozuar dhe për ruajtjen e provave para se rasti t'i dorëzohet prokurorisë, e cila më pas vendos nëse ka prova të mjaftueshme për të nisur ndjekjen penale; në anën tjetër, në sistemet e tjera prokuroria gjithashtu drejton hetimin dhe është përgjegjëse për krijimin e rastit dhe për ruajtjen e provave.<sup>67</sup>

- Neni 93 i KMPP përkufizon masat e hetimit të policisë para nisjes zyrtare të hetimit.
- Ligji Model i Mbrojtjes së Dëshmitarëve, i vitit 2000, i Programit të Kombeve të Bashkuara për Kontrollin Ndërkombëtar të Drogës (UNDCP) ofron legjislacionin model për përgjegjësitë e institucioneve të SDP për nisjen, zbatimin dhe përfundimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve.<sup>68</sup>

---

<sup>66</sup> Duke qenë se do të ishte përtej qëllimit të këtij Udhërrëfytyesi për të paraqitur të gjitha dispozitat gjegjëse të KMPP, lexuesit inkurajohen që të studiojnë KMPP.

<sup>67</sup> Instituti Amerikan për Paqe, Kodi Model i Procedurës Penale (fusnota 63 cituar më sipër), f. 103.

<sup>68</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Kontrollin Ndërkombëtar të Drogës, Ligji Model për Mbrojtjen e Dëshmitarëve 2000, 2000.

## ***Shembujt e reformës ligjore për përgjegjësitë e SDP-së***

### *Hyrje në hetimet e udhëhequra nga prokuroria*

Në Bosnje dhe Hercegovinë, hetimet e udhëhequra nga prokuroria u paraqitën më 2003/04.<sup>69</sup> Qëllimi i bartjes së përgjegjësisë të hetimit nga gjykatat në prokurori ishte që drejtësia penale lokale të bëhej më efikase dhe më kompetente në ndjekjen e krimeve duke përfshirë krimet e luftës.<sup>70</sup> Procedurat e reja penale përcaktuan një prokuror me përgjegjësi dhe kompetenca të zgjeruara në planifikimin, menaxhimin dhe drejtimin e hetimeve. Prokurori ishte gjithashtu në gjendje që të barte kompetencat e tij/saj tek “zyrtarët e tjerë publikë të autorizuar”. Në një anë, kjo fuqizoi rolin e zyrtarëve publik të autorizuar; në anën tjetër, kjo kërkonte më shumë iniciativë nga ana e tyre. Gjykatat nuk kryenin më hetime por kontrollonin nëse veprimet dhe masat e kryera gjatë hetimit, të cilat kufizonin të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, ishin të arsyetuara.<sup>71</sup>

Në Serbi, Kodi i ri i Procedurës Penale u miratua në vitin 2012 dhe paraqiti procedurën e re penale të hetimeve të udhëhequra nga prokurori. Qëllimi ishte që prokurorëve t’ju jepej një rol udhëheqës në hetimet dhe në gjetjen e provave. Atyre gjithashtu u ishte caktuar një rol më aktiv në procedurat gjyqësore me qëllim të vërtetimit të fakteve në gjykim. Kjo procedurë e re ndikoi edhe në rolin e policisë në procesin e hetimit, posaçërisht në lidhje me marrjen në pyetje të të dyshuarve, dëshmitarëve dhe viktimave, etj. Ajo çka mbeti për t’u parë ishte nëse prokurorët në mënyrë proaktive do të kërkonin prova dhe do të udhëzonin policinë për të ndërmarr masa të veçanta të hetimit, ose nëse ata do të mbështeteshin kryesisht në veprimet e nisura nga policia. Duke qenë se zbatimi i procedurës së re filloi në vitin 2012, fillimisht kryesisht e kufizuar në zyrat e prokurorive speciale dhe departamentet e gjykatave që merren me krimin e

<sup>69</sup> Kodi i Procedurës Penale i Bosnje dhe Hercegovinës (BH), në fuqi që nga 1 marsi 2003, Gazeta Zyrtare e BH, nr. 36/2003. Shih po ashtu: Radulovic, Drago, “Koncepti i hetimit në procedurën penale në kuptim të legjislacionit të ri për procedurën penale” në Petrovic, Ana/Jovanovic, Ivan, Trendët e ri në Ligjin e procedurës penale të Serbisë dhe pikëpamjet rajonale. Aspektet normative dhe praktike, Misioni i OSBE-së në Serbi, Beograd, 2012, f. 14; dhe Dodik, Bozidarka, “Hetimi prokurorial – përvojat nga Bosnje dhe Hercegovina” në Petrovic/Jovanovic, Trendët e ri në Ligjin e procedurës penale të Serbisë dhe pikëpamjet rajonale (po aty), f. 26.

<sup>70</sup> Cf. DeNicola, Christopher, “Reforma e procedurës penale në Bosnje dhe Hercegovinë: mes minimalizmit organik dhe maksimalizmit jothelbësor”, 2010, f. 32.

<sup>71</sup> Cf. Dodik, Bozidarka, “Hetimi prokurorial – përvojat nga Bosnje dhe Hercegovina” në Petrovic/Jovanovic, Trendët e ri në Ligjin e procedurës penale të Serbisë dhe pikëpamjet rajonale (fusnota 69 cituar më sipër), f. 37.



organizuar, rezultati dhe ndikimi i procedurave të reja nuk mund të vlerësohet në vitin 2013.

Në Zvicër, Kodi zviceran i Procedurës Penale u ndryshua në vitin 2007 (ai është në fuqi që nga 1 janar 2011) me qëllim të bashkimit të procedurës penale në nivel shtetëror (Bund) dhe nivel rajonal (Kanton). Si pasojë e kësaj, institucioni i gjyqtarëve hetues u shfuqizua dhe të gjitha përgjegjësitë hetuese (duke përfshirë ato parahetuese) iu bartën prokurorëve. Qëllimi ishte që të bëhej më efikas procesi i procedurës penale duke ia caktuar të gjitha përgjegjësitë Zyrës së Prokurorisë, nga faza para hetuese deri në ngritjen e aktakuzës.<sup>72</sup>

Me ndryshimin e kompetencave të institucioneve gjegjëse të drejtësisë penale në procesin e drejtësisë penale, agjencisë së cilës i janë caktuar përgjegjësi të reja duhet t'i jepet kohë e mjaftueshme, trajnime dhe burime për t'ju përshtatur detyrave dhe përgjegjësi të reja. Në lidhje me paraqitjen e hetimeve të udhëhequra nga prokurori, një mësim i nxjerrë në disa shtete pjesëmarrëse ishte se prokurorët ishin të mbingarkuar me rolet dhe përgjegjësitë e tyre të reja duke qenë se ata nisnin hetime, kryenin të gjithë punën hetuese, shkruanin aktakuzat, dorëzonin lëndët në gjykatë dhe kryenin marrjen e tërthortë në pyetje në gjykim. Policia shpesh bëhej shumë pasive dhe fajësonte prokurorinë se nuk e kishte lejuar atë të kryente punën hetuese në mënyrë të pavarur.<sup>73</sup>

### ***Shembull i reformës ligjore për të përshpejtuar procedurat penale***

#### *Procedurat e përshpejtuara të hetimit në Bullgari*

Me qëllim të përshpejtimit të procedurave penale, neni 356 i Kodit të Procedurës Penale të Bullgarisë përcaktoi "procedurat e përshpejtuara të hetimit". Sipas këtyre procedurave, të cilat u ndryshuan në vitin 2006, hetimet duhet të kryhen nga hetuesit brenda shtatë ditëve dhe prokurori duhet të vendos për hapat vijues brenda tre ditëve tjera.

<sup>72</sup> Schweizerischer Bundesrat, Botschaft zur Vereinheitlichung des Strafprozessrechts (StPO), Zyra Federale e Drejtësisë, Bashkimi i Procedurës Penale, 21 dhjetor 2005, f. 1105ff.

<sup>73</sup> Kjo është në bazë të intervistave me këshilltarët për reforma nga shtetet e ndryshme pjesëmarrëse.

Neni 356 (1) përcakton procedurat e përshpejtuara në rastet kur:

- Një person është kapur gjatë apo menjëherë pas kryerjes së veprës penale,
- Në trupin a rrobat e personit ka gjurmë të dukshme të veprës penale,
- Personi është paraqitur pranë organeve gjegjëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme, organit hetues ose prokurorit duke pranuar kryerjen e veprës penale,
- Dëshmitari identifikon personin si kryerës të një vepre penale.

Sipas nenit 357 (1) prokurori mbikëqyrës vendos, brenda tre ditëve pas përfundimit të hetimit, nëse do të:

- Pushojë procedurën penale (në bazë të paragrafit 1 të nenit 24 të KPP),
- Pezullojë procedurën penale (sipas kushteve të përcaktuara në nenet 25 dhe 26 të KPP),
- Ngrit aktakuzë dhe do të paraqet rastin për gjykim në gjykatë,
- Paraqet rastin me një urdhër për lirimin nga përgjegjësia penale dhe shqiptimin e gjobës administrative, ose me një propozim për marrëveshje mbi zgjidhjen e rastit ose
- Nis hetime shtesë për të mbledhur prova të reja ose për të mënjanuar shkeljet e rënda të pranuar të rregullave procedurale dhe të përcaktojë një afat prej jo më shumë se shtatë ditë.

Në pjesën e parë të vitit 2012, procedurat e përshpejtuara të hetimit u urdhëruan për rreth 4,900 raste e që përbënin përafërsisht 8 për qind të të gjitha hetimeve në atë periudhë kohore. Në 1,180 prej 4,900 rasteve, prokurori nisi hetime shtesë sipas procedurave të zakonshme të hetimit.<sup>74</sup>

### *Aspektet teknike të procedurave penale*

Në përgjithësi reforma e kornizës ligjore duhet të sigurojë se legjislacioni vendor:

- Përkufizon krijimin e bazave të dhënave për menaxhimin e lëndëve

<sup>74</sup> Zyra e Prokurorit të Republikës së Bullgarisë, raport përmbledhës për punën e Zyrës së Prokurorit për pjesën e parë të vitit 2012.

si dhe përdorimin e këtyre bazave të dhënave mes institucioneve ndryshme të SDP,

- Përkufizon ndarjen/shkëmbimin e informatave/inteligjencës mes institucioneve të ndryshme të SDP,
- Përkufizon përdorimin e provave fizike dhe shërbimeve të mjekësisë ligjore,
- Rregullon themelimin, funksionimin dhe financimin e shërbimeve të mjekësisë ligjore, si dhe përdorimin dhe pranueshmërinë e provave fizike në procedurat gjyqësore.

Në lidhje me menaxhimin e lëndëve:

- Neni 102 i KMPP përshkruan kriteret për policinë dhe prokurorinë për të mbajtur raporte me shkrim për çdo veprim të ndërmarrë në hetimin penal dhe që raportet me shkrim për ato veprime të futen në dosjen e lëndës.

*Udhëzuesi i referencave në procedurën penale* më tej shtjellon përmbajtjen e dosjen e lëndës.<sup>75</sup>

- Neni 101 i KMPP propozon që secila dosje e lëndës duhet të jetë në posedim të prokurorit, i cili do të ishte “përgjegjës për mbajtjen, ruajtjen dhe sigurinë e të gjitha informatave, provave dhe materialeve fizike të marra gjatë hetimit derisa nuk ofrohet si dëshmi në gjykatë”.<sup>76</sup> Sipas KMPP, çdo provë që merret gjatë veprimit hetues nga policia duhet të dorëzohet në prokurori në përputhje me nenin 91 të KMPP.<sup>77</sup>
- Neni 37 i KMPP përshkruan përgjegjësitë e gjykatave për të mbajtur procesverbalin e procedurave gjyqësore dhe bartjen e procesverbalit të procedurave gjyqësore tek prokuroria, avokati mbrojtës dhe “në rastet e duhura të mbrojtësit e viktimës”.<sup>78</sup>

Në lidhje me mbledhjen dhe përdorimin e provave në gjykatë:

Nenet 106-146 të KMPP përshkruajnë në hollësi rrethanat dhe procedurat e nevojshme që përcaktohen për mbledhjen e provave që janë të pranueshme në gjykatë. Nenet që trajtojnë masat e reja hetuese dhe mjetet janë:

- Nenet 116-117 të KMPP që kanë të bëjnë me mbledhjen e informatave nga të dyshuarit, viktimat dhe personat e tjerë duke përfshirë fotografimin dhe marrjen e gjurmëve të gishtërinjve të personave të arrestuar dhe

---

<sup>75</sup> Cf. OSBE, Udhëzuesi i referencave në procedurën penale (fusnota 64 cituar më sipër), f. 19.

<sup>76</sup> Cf. IAP, Kodi Model i Procedurës Penale (fusnota 63 cituar më sipër), f. 166.

<sup>77</sup> Po aty, f. 166 dhe 168.

<sup>78</sup> Po aty, f. 82.

personave të tjerë,

- Nenet 128-130 të KMPP që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe qasjen në të dhënat kompjuterike dhe të dhënat e trafikut të telekomunikacionit,
- Nenet 134-140 të KMPP që përshkruajnë masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit,
- Nenet 142-145 të KMPP që përshkruajnë masat hetuese mjeko- ligjore.

Nenet 106-146 të KMPP janë të plotësuar nga:

- Nenet 228-237 të KMPP që përkufizojnë rregullat për përdorimin dhe përjashtimin e provave në gjykim. Më shumë dispozita të përgjithshme për përdorimin dhe përjashtimin e provave mund të gjenden në *Udhëzuesin e Referencave në Procedurën Penale*.<sup>79</sup>

-

### *V.2.2 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP, agjencive tjera qeveritare, ofruesve joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, dhe shoqërisë civile*

Reforma e kornizës ligjore duhet gjithashtu të mëtojë mundësimin e bashkëpunimit më të mirë mes institucioneve të SDP, agjencive tjera qeveritare (p.sh., për shëndetësi, arsim dhe zhvillim), ofruesve joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë dhe shoqërisë civile në përgjithësi me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe ofrimit të sigurisë dhe drejtësisë. Shtetet anëtare të OKB-së në *Deklaratën e San Salvadorit për Strategjitë Gjithëpërfshirëse për Sfidat Globale: Parandalimi i krimit dhe sistemet e drejtësisë penale dhe zhvillimi i tyre në një botë në ndryshim*, theksuan se “përmes ndarjes reciproke dhe efektive të informatave, njohurive dhe përvojave, dhe përmes veprimeve të përbashkëta dhe të bashkërenduara, qeveritë dhe bizneset mund të zhvillojnë, përmirësojnë dhe zbatojnë masat për parandalimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e krimit duke përfshirë sfidat në lindje dhe në ndryshim e sipër”.<sup>80</sup> Rezoluta 2002/13 e Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së, e cila është ngushtë e lidhur me Deklaratën e San Salvadorit përkitazi me parandalimin efektiv të krimit, gjithashtu promovon “bashkëpunimin/partneritetet mes ministrive dhe autoriteteve, organizatave të komunitetit, organizatave joqeveritare, sektorit afarist dhe qytetarëve”. Për më tepër,

<sup>79</sup> Cf. OSBE, Udhëzuesi i referencave në procedurën penale (fusnota 64 cituar më sipër), f.31ff.

<sup>80</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, Deklarata e San Salvadorit për Strategjitë Gjithëpërfshirëse për Sfidat Globale: Parandalimi i krimit dhe sistemet e drejtësisë penale dhe zhvillimi i tyre në një botë në ndryshim, Kongresi i dymbëdhjetë i OKB-së për parandalimin e krimit dhe drejtësinë penale, Shtojcë, Rezoluta A/RES/65/230, seanca e gjashtëdhjetë e pestë, 1 prill 2011, paragrafi 34.

bashkërendimi mes agjencive të drejtësisë dhe profesionistëve të tjerë, të tilla si shërbimet shëndetësore dhe sociale, njashtu përcaktohet me anë të *Parimeve dhe Udhëzimeve të OKB-së për Qasjen në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale*.<sup>81</sup>

### V.2.3 Aspektet e të drejtave të njeriut

Në lidhje me të drejtat e njeriut, reforma e kornizës ligjore duhet të sigurojë që legjislati vendor:

- Në mënyrë të duhur dhe gjithëpërfshirëse zbaton konceptin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në përputhje me standardet dhe detyrimet ndërkombëtare,
- Shprehimisht i kërkon institucioneve të SDP që të mbrojnë dhe respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore,
- Shprehimisht i kërkon institucioneve të SDP që të marrin parasysh çështjet gjinore si dhe të drejtat dhe interesat e ligjshme të grupeve të cenueshme duke përfshirë fëmijët dhe pakicat,
- Përkufizon afatet kohore për mbajtje në ndalim policor dhe në qendrat e paraburgimit,
- Përkufizon detyrimet e institucioneve të SDP ndaj viktimave të krimit dhe dëshmitarëve në rastet penale.

Me rastin e respektimit të drejtave të dëshmitarit për të pasur anonimitetet mund të shfaqen sfida përderisa duhet të respektohen të drejtat e palës së akuzuar për të thirrur, për të pyetur apo për të kërkuar të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij/saj.<sup>82</sup>

### V.2.4 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja

Legjislati vendor duhet njashtu të përcaktojë kontrollin politik demokratik të institucioneve të SDP dhe integrimin e SDP me shoqërinë civile.

---

<sup>81</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, Udhëzime për parandalimin e krimit, Shtojcë, Rezoluta 2002/13 e KES, Veprim për të promovuar parandalimin efektiv të krimit, Nju Jork, 24 korrik 2002, paragrafi 9; dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së për qasjen në ndihmë juridike në sistemet e drejtësisë penale, Vjenë, 25 prill 2012, paragrafi 55 (c), f. 16.

<sup>82</sup> Shih, për shembull, Organizata e Kombeve të Bashkuara, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Nju Jork, 16 dhjetor 1966, neni 14 (3) (e); Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, neni 67 (1) (e), ose Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut/Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950), neni 6 (3) (e).

Në përgjithësi, reforma e kornizës ligjore duhet të sigurojë se legjislacioni vendor:

- Siguron zhvillimin e kodeve të dhura të etikës dhe të sjelljes për personelin e institucioneve të ndryshme të SDP,
- Trajton luftën kundër korrupsionit në sektorin publik duke përfshirë institucionet e SDP,
- Siguron që shërbimet gjyqësore/prokuroriale kanë pushtet mbikëqyrës ndaj degëve të tjera të qeverisë, dhe
- Themelon mekanizmat e SDP për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien e tyre, duke përfshirë mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm për të monitoruar dhe mbikëqyrur drejtimin dhe financimin e institucioneve të SDP.

Institucionet gjegjëse mbikëqyrëse që themelohen me anë të ligjit mund të jenë nga dega ekzekutive (kontrolli i politikave, kontrolli financiar dhe mbikëqyrja horizontale nga agjencitë qeveritare), dega legjislative (deputetët e Kuvendit, komisionet hetimore parlamentare), dega e gjyqësorit<sup>83</sup>, si dhe komisionet për të drejtat e njeriut, bordet civile për shqyrtim të ankesave apo institucioni i pavarur i avokatit të popullit. Për më tepër, media mund të luajë një rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve për veprimtaritë e policisë. Megjithatë, është e rëndësishme që mediat të punojnë sipas një kodi profesional të sjelljes dhe se informatat e publikuara nuk komprometojnë hetimet e policisë dhe informatat e fshehta të rëndësishme për ruajtjen e sigurisë publike apo prezumimin e pafajësisë.<sup>84</sup> Institucionet e brendshme të mbikëqyrjes, të cilat duhet të plotësojnë punën e institucioneve të jashtme mbikëqyrëse, mund të përfshijnë njësitë e brendshme të hetimit ose komisionet disiplinore të atypëratyshme që përbëhen nga zyrtarët e lartë të drejtësisë penale.

Legjislacioni që ndërlidhet me llogaridhënien dhe mbikëqyrjen mund t'i referohet dhe duhet të jetë në përputhje me kodet gjegjëse të sjelljes për zyrtarët e SDP të pranuar në nivel ndërkombëtar (shih po ashtu kapitullin VI. 4).

Në Zvicër, Ligji i ri për Organizimin e Institucioneve të Drejtësisë Penale, i miratuar në vitin 2010, që hyri në fuqi bashkë me Kodin e Procedurës Penale në vitin 2011 ia përcaktoi përgjegjësinë vetëm

<sup>83</sup> Cf. Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2001) nr. 10 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për Kodin Evropian për Etikën në Polici (2001), paragrafët 60 dhe 62.

<sup>84</sup> Cf. OSBE, Udhërrëfyes për Policim Demokratik (fusnota 25 cituar më sipër), f. 39 dhe 43.

Parlamentit Federal (Bundesversammlung) për mbikëqyrjen e punës së Prokurorisë Federale. Parlamentit iu caktua përgjegjësia për zgjedhjen dhe mbikëqyrjen e Zyrës Federale të Prokurorit të Përgjithshëm. Ky ndryshim u paraqit me qëllim të garantimit të pavarësisë së Zyrës nga dega ekzekutive.<sup>85</sup>

Pas rishikimit të kornizës ligjore, hapat vijues të reformës do të jenë që: të përkthehet ligji në politika dhe procedura; të sigurohen mekanizmat organizativ dhe strukturor për zbatimin e ligjit; të përgatitet personeli i SDP përmes trajnimeve dhe zhvillimit profesional për atë se si të zbatohet ligji; të vlerësohet se si ligji i ri, politikat dhe rregulloret po zbatohen në praktikë nga institucionet e SDP si dhe në bazë të këtij vlerësimi të modifikohet procesi i reformave me qëllim që të rritet efektiviteti, efikasiteti dhe qëndrueshmëria e tij.

Të gjithë këta hapa të reformës do të përshkruhen në kapitujt në vijim.

---

<sup>85</sup> Asambleja Federale, Komisioni për çështje ligjore, 3 qershor 2009: 08.066 s Ligji për Organizimin e Institucioneve të Drejtësisë Penale; Zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm Federal dhe Mbikëqyrja e Prokurorit të Përgjithshëm, paragrafi 3, f. 2-5.





## **VI. Zhvillimi/reforma e politikave, procedurave, rregullave dhe rregulloreve**

Me qëllim të përkthimit të legjislacionit në vepër dhe jetësimit të tij në praktikë, duhet të miratohen politikat që përkufizojnë atë se si do të zbatohet ligji. Për më tepër, politikat dhe masat që nevojiten për t'i zbatuar ato duhet të shprehen në “deklarata të politikave” të qarta dhe zyrtare. Deklaratat e politikave duhet të përfshijnë edhe një vizion dhe një deklaratë misioni që do të shpjegonin, me pak fjalë, qëllimet që shteti dhe SDP po përpiqen të arrijnë me miratimin e politikave. Vizioni dhe deklaratat e misionit duhet të kenë edhe një karakter normativ.<sup>86</sup> Politikat dhe masat e zbatimit duhet të mbështeten haptazi nga udhëheqësit politik dhe udhëheqja e institucioneve të SDP.<sup>87</sup> Për më tepër, udhëheqësit e institucioneve të SDP do të duhet të inkurajojnë të gjithë aktorët e SDP për të zbatuar politikat dhe për të siguruar mbështetjen e tyre (shih po ashtu kapitullin IV).

Strategjitë dhe planet e veprimit për zbatimin e këtyre politikave dhe procedurave, rregullave dhe rregulloreve përkatëse, dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre duhet të hartohen nga autoritetet shtetërore dhe SDP në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe ofruesit joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë. Strategjitë dhe planet e veprimit duhet t'ju referohen gjetjeve të vlerësimeve themelore të SDP dhe supozimeve kritike gjegjëse për përmirësimin e procesit të drejtësisë penale. Këto supozime duhet të përfshijnë deklarata të qarta për kapacitetet e nevojshme në çdo institucion të drejtësisë penale, mënyrën se si institucionet e ndryshme duhet strukturuar apo ristrukturuar dhe shumën e burimeve financiare dhe të personelit që nevojitet për zhvillimin dhe mbajtjen e këtyre kapaciteteve.<sup>88</sup> (shih po ashtu kapitujt IV dhe VII).

Në kontekst të reformës tërësore të policisë në kuadër të kornizës së RSDP, politikat duhet shprehimisht të njohin rëndësinë e komunikimit dhe bashkëpunimit të ngushtë mes institucioneve të ndryshme të SDP, dhe mes strukturave zyrtare dhe joshtetërorë të SDP si dhe të shoqërisë civile me qëllim të përmirësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të procesit të drejtësisë penale.

Prandaj politikat duhet gjithashtu të promovojnë dhe mundësojnë zbatimin e

---

<sup>86</sup> Cf. OSBE, Praktika të mira në ndërtimin e partneritetit polici-publik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, seri e botimeve të NJÇPS, vëllimi 4, Vjenë, maj 2008, f. 36 dhe 38.

<sup>87</sup> Cf. OSBE, Komisionari i Lartë për Pakicat Kombëtare, Rekomandimet për Policim në shoqëritë shumetnike, Hagë, 2006, f. 10.

<sup>88</sup> Cf. Ball, Nicole/Fayemi, Kayode (bot.) Qeverisja e Sektorit të Sigurisë në Afrikë: doracak, Qendra për Demokraci dhe Zhvillim, kapitulli 4. Zhvillimi dhe zbatimi i politikave (2004).

hapave reformues organizativ dhe strukturor për të siguruar një mjedis për komunikim dhe bashkëpunim të përmirësuar. Kjo mund të përfshijë, ndër të tjera, themelimin e grupeve drejtuese për SDP, të përbërë nga shumë agjenci, dhe të mekanizmave të veçantë për bashkëpunim dhe bashkërendim në procesin e drejtësisë penale; futjen në përdorim të sistemeve të reja të menaxhimit të rasteve; dhe zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve të përbashkëta të trajnimit për të gjithë aktorët relevant në ndërveprimin operativ të SDP. Këto kurse do të mund të trajtojnë aspektet menaxheriale të procesit të drejtësisë penale dhe do të ofronin trajnime të përgjithshme të hetimit dhe trajnime të specializuara të hetimit për format e ndryshme të veçanta të krimeve të reja, për të cilat duhet zbatuar teknikat e reja të hetimit dhe mjetet si dhe përdorimin e formave të reja të provave në gjykata/gjykime.

Për më tepër, politikat për reformat organizative dhe strukturale të SDP duhet të trajtojnë çështjet e ndërthurura, të tilla si: mbrojtjen e të drejtave të njeriut; normëzimin gjinor në procesin e drejtësisë penale; krijimin a përmirësimin e procedurave të llogaridhënies dhe mekanizmave për tërë SDP, dhe organin e pavarur monitorues dhe shqyrtues të politikave dhe praktikave të policisë.

Zbatimi i politikave, procedurave, rregullave dhe rregulloreve mund të mbikëqyret dhe bashkërendohet më së miri nga një Grup Bazë Zbatues që do të krijonte mekanizmat për komunikim, mbikëqyrje dhe vlerësim, si dhe që do ta kishte përgjegjësinë kryesore për zbatim. Ky grup bazë duhet të përbehet nga përfaqësuesit e SDP dhe të shoqërisë civile dhe duhet të ketë normëzim gjinor. Ai duhet të drejtohet nga zyrtarët e lartë të SDP dhe duhet të kenë një mandat me autoritet të mjaftueshëm për të nisur, përgatitur dhe zbatuar ndryshimet e nevojshme institucionale përballë kundërshtimit të pashmangshëm. (Shih kapitullin VII. 6 për një përshkrim të shkurtër të sfidave në menaxhimin e ndryshimit). Grupi Bazë Zbatues gjithashtu duhet që, herë pas herë, të vlerësojë zbatimin praktik të përmbajtjes së politikave nga institucionet e SDP me qëllim të identifikimit të mundësive për përmirësimin e punës së tyre.<sup>89</sup>

Në nivel operativ, do të duhet të paraqiten rregulla dhe rregullore, procedura standarde të veprimit dhe udhërrëfyes që rregullojnë operacionalizimin e ligjit dhe të politikave mes institucioneve të SDP gjatë procesit të drejtësisë penale.

---

<sup>89</sup>Cf. OSBE, Praktika të mira në ndërtimin e partneritetit polici-publik (fusnota 86 cituar më sipër), f. 39.

## VI.1 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP

Shembujt e rregullave dhe rregulloreve model që mbulojnë aspektet e ndryshme të hetimeve si dhe të procedurave para gjykitimit dhe gjatë gjykitimit janë të paraqitura në KMPP. Në pjesën në vijim do të paraqiten disa rregulla dhe rregullore model që trajtojnë punën e bashkëveprimit të SDP:

- Neni 91 i KMPP propozon procedurat për komunikim mes prokurorisë dhe policisë duke siguruar “një sistem më fleksibël të komunikimit ku prokurori mund të nxjerrë urdhra me shkrim, me gojë dhe madje me postë elektronike. Për të siguruar se ky sistem funksionon, duhet të ushqehet bashkëpunimi institucional mes zyrës së prokurorisë dhe policisë dhe duhet të krijohen mekanizma për të lehtësuar bashkëpunimin ndërinstitucional. Mund të jetë e nevojshme që të hartohen protokolle, procedura standarde të veprimit, kode të mirësjelljes ose marrëveshje të tjera për të vendosur një raport efektiv institucional ashtu siç përvijohet në KMPP.”<sup>90</sup>
- Neni 102 i KMPP përcakton përshtime të përgjithshme për atë se si regjistrat e hetimeve penale duhet të trajtohen nga policia dhe prokuroria. Këto përshtime mund “të plotësohen nga procedurat standarde të veprimit a memorandumet e marrëveshjeve mes policisë dhe prokurorisë për regjistrimin e veprimeve hetuese dhe bartjen dhe ruajtjen e regjistrave me shkrim dhe provave të nxjerra gjatë kryerjes së këtyre veprimeve”.<sup>91</sup>
- “Dispozitat e veçanta për raportim mbi dhunën në familje përcaktohen me anë të *Kornizës për legjislacionin model kundër dhunës në familje të hartuar nga Raportuesi Special i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj gruas, shkaqet dhe pasojat e saj* (dokument i OKB-së E/CN.4/1996/53/Add.2). Ajo ofron udhëzime të veçanta për hartimin e një raporti për veprën e dhunës në familje (paragrafët 22-25). Dokumenti kornizë gjithashtu përfshin udhëzime të dobishme për detyrat e zyrtarëve policorë përkitazi me dhunën në familje (paragrafët 13-17) dhe të drejtat e viktimave të dhunës në familje (paragrafi 21).”<sup>92</sup>
- Nenet 106-146 të KMPP, përkitazi me mbledhjen e provave, përmbajnë aq shumë hollësi sa që mund të përdoren për hartimin e PSV apo ndonjë rregulloreje tjetër sqaruese që i bashkëngjitet një kodi të procedurës penale.<sup>93</sup>

<sup>90</sup> IAP, Kodi Model i Procedurës Penale (fushnota 63 cituar më sipër), f. 155.

<sup>91</sup> Po aty, f. 158.

<sup>92</sup> Po aty, f. 157.

<sup>93</sup> Po aty, f. 175.

## **VI.2 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP, agjencive tjera qeveritare, ofruesve joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, dhe shoqërisë civile**

Në lidhje me bashkëpunimin e SDP me agjencitë e tjera qeveritare, ofruesit joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë dhe shoqërisë civile, politikat, procedurat, rregullat dhe rregulloret duhet të rregullojnë:

- Çështjet e mbikëqyrjes nga SDP të ofruesve joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë si dhe procedurat për ndarjen e detyrave të caktuara të sigurisë dhe administrimin e drejtësisë,
- Masat për mbrojtjen e bashkëpunëtorëve me SDP (shih po ashtu kapitullin VI.3),
- Procedurat e bashkëpunimit të strukturave të partneritetit polici-publik që mbulojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e aktorëve të ndryshëm (p.sh., në grupet këshilluese/punuese polici-publik ose programet e masave alternative të dënimit), dhe
- Procedurat për informimin e medias/publikut për veprimtaritë e SDP.

## **VI.3 Aspektet e të drejtave të njeriut**

Politikat, procedurat, rregullat dhe rregulloret përkitazi me aspektet e të drejtave të njeriut në procedurën penale, të cilat janë të rëndësishme për bashkëpunimin mes institucioneve të ndryshme të SDP, duhet të trajtojnë çështjet si në vijim:

Drejtësia për të miturit:

- Neni 322 i KMPP përkufizon përbërjen dhe detyrat e kolegjeve të veçanta për të miturit,
- Neni 323 i KMPP përkufizon juridiksionin mbi fëmijët dhe të miturit,
- Neni 325 i KMPP përshkruan qëllimin e drejtësisë për të miturit: “Sistemi i drejtësisë për të miturit duhet të theksojë mirëqenien e të miturve dhe duhet të sigurojë se çfarëdo reagimi ndaj personave të mitur është gjithnjë në proporcion me rrethanat si për të miturit ashtu edhe për veprën penale”.<sup>94</sup>
- Neni 326 i KMPP përshkruan parimet e zbatueshme për drejtësinë për të miturit,

---

<sup>94</sup> Po aty, f. 466.

- Neni 328 i KMPP përkufizon kontaktet me policinë dhe prokurorinë, dhe
- Neni 338 i KMPP përkufizon lirimin me kusht nga burgosja për të miturit.

Procedurat e zbatueshme për paraburgim dhe afatet:

- Neni 172 i KMPP përshkruan procedurat pas arrestimit duke përfshirë dispozitën që personi i arrestuar “duhet të silltet me shpejtësi para gjykatësit jo më vonë se shtatëdhjetë e dy orë pas arrestimit me qëllim që gjykatësi të vlerësojë ligjshmërinë e arrestimit”,<sup>95</sup>
- Neni 175 i KMPP ka të bëjë me shqyrtimin fillestar para gjykatësit pas arrestimit me qëllim të rishikimit të ligjshmërisë së arrestimit dhe me përcaktimin e asaj nëse ka baza për paraburgim, dorëzani ose ndonjë mase kufizuese përveç paraburgimit a dorëzani,
- Neni 185 i KMPP shtjellon kërkesat e prokurorisë për paraburgim, dorëzani ose masa kufizuese përveç paraburgimit gjatë shqyrtimit fillestar sipas nenit 175,
- Neni 188 i KMPP ka të bëjë me seancat dëgjimore për vazhdimin e paraburgimit ose për vazhdimin e arrestit shtëpiak, ku përshkruhen procedurat për parashtrimin e kërkesës për vazhdimin e paraburgimit a për vazhdimin e arrestit shtëpiak për një të dyshuar ose të akuzuar,
- Neni 189 i KMPP përshkruan afatin kohor për paraburgim ose arrest shtëpiak, dhe
- Neni 190 i KMPP përshkruan procedurat për vazhdimin e afatit kohor për paraburgim apo arrest shtëpiak.

Detyrimet e SDP në lidhje me viktimat e krimit janë të përkufizuara nga:

- *Rekomandimi nr. R (85) 11 i Këshillit të Evropës për Pozitën e Viktimës në Kuadër të së Drejtës dhe Procedurës Penale (1985),* nenet 1-4,
- *Rekomandimi (2006) 8 i Këshillit të Evropës për Ndhimën ndaj Viktimave të Krimit (2006),* nenet 2 dhe 3,
- *Deklarata e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit,* Nju Jork, 29 nëntor 1985,
- *Udhëzimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që përfshijnë Fëmijët Viktimat dhe Dëshmitarë të Akteve*

---

<sup>95</sup> Po aty, f. 287.

*Kriminale*, Vjenë, 25 maj 2005,<sup>96</sup> dhe

- Nenet 72-74 të KMPP që përshkruajnë përgjegjësitë e gjykatave, prokurorëve dhe policisë lidhur me viktimat në procedurën penale.

Dispozitat për mbrojtjen e dëshmitarëve janë të përkufizuara nga:

- *Rekomandimi nr. R (97) 13 i Këshillit të Evropës mbi Frikësimin e Dëshmitarëve dhe të Drejtën për Mbrojtje*, 1997, nenet 14-15 dhe 51,
- *Rekomandimi (2005) 9 i Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë (2005)*, nenet 1, 2 dhe 8-28,
- *Udhëzimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që përfshijnë Fëmijët Viktimat dhe Dëshmitarë të Akteve Kriminale*, Vjenë, 25 maj 2005<sup>97</sup>, dhe
- Nenet 141-161 dhe nenet 254-259 të KMPP me të cilat përshkruhen masat e mbrojtjes që mund të urdhërohen nga një gjyqtar në dobi të dëshmitarit, i cili është kërcënuar apo të një “dëshmitari të cenueshëm” duke përfshirë mbrojtjen e dëshmitarit gjatë seancave dëgjimore si dhe bazat dhe procedurat për të kërkuar një urdhër për masat mbrojtëse.

## VI.4 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja

Në lidhje me llogaridhënien, kodet e etikës dhe të sjelljes për policinë, prokurorët, gjyqtarët, personelin e gjykatës, avokatët mbrojtës dhe personelin e burgjeve duhet në mënyrë të veçantë të përcaktojnë sjelljen e pranueshme dhe të papranueshme, si dhe duhet të nënvizojnë parimet të cilat duhet t'i respektojë personeli i SDP.

Udhëzime të dobishme për hartimin e kodeve të tilla jepen, ndër të tjera, në:

<sup>96</sup> Cf. Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (85) 11 i Këshillit të Evropës për Pozitën e Viktimës në Kuadër të së Drejtës dhe Procedurës Penale (1985), nenet 1-4;

Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 8 i Këshillit të Evropës për Ndhimën ndaj Viktimave të Krimin (2006), nenet 2 dhe 3;

Organizata e Kombeve të Bashkuara, Deklarata për Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit të Pushtetit, Nju Jork, 29 nëntor 1985; dhe

Këshilli Ekonomik dhe Social i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Udhëzimet për Drejtësinë në Çështjet që përfshijnë Fëmijët Viktimat dhe Dëshmitarë të Akteve Kriminale, Vjenë, 25 maj 2005.

<sup>97</sup> Cf. Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (97) 13 mbi Frikësimin e Dëshmitarëve dhe të Drejtën për Mbrojtje, 1997, nenet 14-15 dhe 51; dhe Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2005) 9 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë (2005), nenet 1, 2 dhe 8-28. Organizata e Kombeve të Bashkuara, Udhëzimet për Drejtësinë në Çështjet që përfshijnë Fëmijët Viktimat dhe Dëshmitarë të Akteve Kriminale, Vjenë, 25 maj 2005 (fusnota 96 cituar më sipër).

- *Kodin e mirësjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Udhërrëfyesit për Zbatimin Efektiv të Kodit të Sjelljes,*
- *Parimet e Bangalorit të Sjelljes Gjyqësore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara,*
- *Parimet Themelore për Pavarësinë e Gjyqësorit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara,*
- *Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,*
- *Kodin e Mirësjelljes të OSBE-së për Aspektet Politiko-Ushtarake të Sigurisë,*
- *Rekomandimin nr. R (2000) 10 i Këshillit të Evropës, Komiteti i Ministrave për Shtetet Anëtare për Kodin e Mirësjelljes për Zyrtarët Publik,*
- *Rekomandimin Rec nr. (2001) 10 të Këshillit të Evropës, Komiteti i Ministrave për Shtetet Anëtare për Etikën në Polici,*
- *Rekomandimin 1713 (2005) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Mbikëqyrja Demokratike e Sektorit të Sigurisë në Shtetet Anëtare, Strasburg, 23 qershor 2005.*

Në vendet ku ofruesit zakonor dhe joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë, duke përfshirë edhe shërbimet private të sigurisë, kanë një rol plotësues ndaj institucioneve zyrtare të sigurisë dhe drejtësisë, ato duhet gjithashtu të respektojnë kodet e etikës dhe të mirësjelljes. Shtetet mund edhe të shqyrtojnë përcaktimin e standardeve të punës për ofruesit privat civil të sigurisë, me të cilat caktohen standardet minimale të së drejtës për ata të cilët ofrojnë shërbime private civile të sigurisë duke përfshirë kontrollimin paraprak të pronarëve të shërbimeve të tilla për të parandaluar kontrollin kriminal të shërbimeve private civile të sigurisë.

Në çdo politikë dhe procedurë duhet të përfshihen motivimet dhe ndëshkimet për të promovuar integritetin dhe zotësinë në çdo aspekt të SDP.<sup>98</sup>

---

<sup>98</sup> Cf. ZKBDK/IAP, Reforma e Drejtësisë Penale në shtetet pas konfliktit (fusnota 9 cituar më sipër), f.79.





## VII. Reforma strukturore dhe organizative

Në mbështetje të bazës ligjore të reformës, masat strukturore dhe organizative në reformën tërësore të policisë, në kuadër të SDP, mëtojnë të përmirësojnë efektivitetin dhe efikasitetin e procesit të drejtësisë penale.

Mangësitë kryesore të procesit të drejtësisë penale që janë të dukshme në shumë vende janë:

- Në përgjithësi, mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit mes institucioneve të ndryshme të SDP si dhe
- Në veçanti,
  - numri i madh i hetimeve dhe i rasteve të pazgjidhura të prokurorisë që rezultojnë në
  - paraburgimin që vazhdohet pa nevojë e që përbën shkelje të drejtave të njeriut të personit të paraburgosur si dhe të drejtave të viktimës, dhe
  - raportim dhe sisteme jofunksionale të menaxhimit të lëndëve që çojnë në dyfishim të punës, mosplotësim të informatave dhe vonesa në përpunimin e informatave, të cilat rezultojnë në raste të vonuara dhe ndonjëherë keq të përgatitura si dhe shkeljen e të drejtave të akuzuarit dhe të avokatëve të tyre për të pasur qasje në informata për qëllime të mbrojtjes.

### *Raportet posaçërisht sfiduese mes policisë dhe shërbimeve të inteligjencës*

Në shumë vende, policia si dhe shërbimet civile dhe ushtarake të inteligjencës mund të kenë kapacitete dhe role të mbivendosura të inteligjencës. Përkufizimi i rolit të shërbimeve të ndryshme dhe i kornizës për bashkëpunim, si dhe sigurimi i asaj se shërbimet e inteligjencës janë nën kontroll të pavarur civil/parlamentar është një sfidë e përbashkët. Sipas *Doracakut për Reformën e Sektorit të Sigurisë* të OECD DAC, “parimi duhet të jetë ai që vetëm agjencitë me kompetenca policore kanë përgjegjësinë dhe të drejtën për të kryer hetime penale, dhe prandaj autoriteti i tyre – posaçërisht në lidhje me teknikat proaktive hetuese, të tilla si përgjimi telefonik,

duhet të jenë më të kufizuara dhe nën kontroll të rreptë”.<sup>99</sup> Për më tepër, çështjet e ndjeshme të ndarjes së informatave mes policisë dhe shërbimeve të inteligjencës, dhe përdorimi i informatave nga shërbimet e inteligjencës apo nga burimet e treta që bashkëpunojnë me ato gjatë hetimeve policore dhe në gjykatë, si dhe mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve dhe identitetit të tyre, shpesh çon në sfida në raportet mes policisë, gjyqësorit dhe shërbimeve të inteligjencës.

Trajtimi i këtij mjedisi jashtëzakonisht të ndërlikuar është përtej qëllimit të këtij Doracaku.

Në pajtim me parimet udhëzuese të RSDP (shih po ashtu kapitullin II.4), ky kapitull do të përqendrohet në ndryshimet strukturore dhe organizative në institucione të ndryshme të SDP, e posaçërisht në ndërveprimin mes institucioneve të ndryshme të SDP që mëtojnë:

- Të sigurojnë bashkërendim dhe bashkëpunim efikas dhe efektiv mes policisë dhe partnerëve të tyre në SDP, dhe mes SDP dhe ofruesve zakonor dhe joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë si dhe shoqërisë civile,
- Të racionalizojnë burimet në dispozicion,
- Të krijojnë shërbime dhe hapësira/objekte, ku është e nevojshme,
- Të promovojnë respektimin dhe mbrojtjen e sundimit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe
- Të vendosin dhe sigurojnë llogaridhënien demokratike dhe mbikëqyrjen e institucioneve të SDP.

Përveç ndryshimeve infrastrukturore të nevojshme për të arritur synimet e lartcekura, në këtë kapitull do të trajtohen masat për krijimin e një kulture organizative dhe operative në SDP që promovon dhe mbështet bashkëpunimin, bashkërendimin dhe llogaridhënien mes institucioneve të ndryshme të SDP, si dhe mes tyre dhe aktorëve të tjerë gjegjës në procesin e drejtësisë penale. Diskutimi në vazhdim i këtyre masave do të bëjë dallimin mes hapave të reformës në nivelin drejtues, operativ dhe atij të trajnimit.

<sup>99</sup> OECD, OECD DAC, Doracak për reformimin e sistemit të sigurisë (fusnota 28 cituar më sipër), f. 164.

## VII.1 Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve të SDP

“Puna e përbashkët kërkon bashkëpunim mes agjencive të ndryshme, një vizion të përbashkët të një sistemi efektiv të drejtësisë penale, respektim të fushës së pavarur të çdo partneri [...] dhe udhëheqje frymëzuese”.<sup>100</sup> Përderisa llogaridhënia e përgjithshme politike për institucionet e hetimit, ndjekjes penale dhe gjykimin duhet të mbetet e veçantë, ende ekziston nevoja për një mekanizëm për të siguruar udhëzime nga qendra dhe menaxhim të përbashkët të procesit për të arritur synimet e përbashkëta”.<sup>101</sup>

### VII.1.1 Themelimi i mekanizmave të bashkërendimit dhe bashkëpunimit në nivel strategjik / të politikave

Në nivel strategjik dhe drejtues, duhet të themelohen grupe drejtuese të përbëra nga shumë agjenci të SDP që bashkërendojnë dhe monitorojnë zbatimin e strategjive tërësore të RSDP dhe të planeve të punës. Ato gjithashtu duhet të marrin parasysh ndikimin që mund të kenë ndryshimet brenda një agjencie në agjencitë e tjera. Hartimi dhe ndryshimi i rregullave dhe i mënyrës së punës në një organizatë, pa i kontrolluar ato me standardet dhe metodat e punës në një institucion tjetër të SDP, mund të dëmtojë rëndë bashkëpunimin dhe bashkërendimin (shih po ashtu kapitullin IV).

Për më tepër, me qëllim të institucionalizimit të bashkërendimit mes institucioneve të ndryshme të SDP, në nivel ministror dhe të drejtuesve të agjencive mund të krijohen forume bashkërenduese të agjencive të ndryshme (p.sh., komisionet e përhershme, komisionet ndërlidhëse dhe bordet e drejtësisë penale që përbëhen nga përfaqësuesit e nivelit të lartë të institucioneve të ndryshme të SDP). Ky drejtim do të mbështetet në nevojat e identifikuara më herët të bashkërendimit dhe bashkëpunimit, si dhe në strategjitë e përkufizuara më parë për përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit duke përfshirë ndarjen e buxheteve të shumta për fuqizimin e ndërveprimit mes agjencive të ndryshme.

Nëse niveli i bashkërendimit është shumë i lartë, atëherë këto forume mund të jenë në gjendje që të hartojnë plane të zbatimit për integrimin e punëve të administratës mes partnerëve të drejtësisë penale.<sup>102</sup>

<sup>100</sup> Berry, Jan. Njësitë e drejtësisë penale dhe ndërtimi i rastit. Zvogëlimi i burokracisë në veprimet policore, mars 2010, f. 1.

<sup>101</sup> Sir Robin Ernest Auld, “Sistemi i Drejtësisë Penale” në Auld, Sir Robin Ernest, Rishikim i gjykatave penale në Angli dhe Uells, Ministria e Drejtësisë, kapitulli 8, f. 315-366, shtator 2001, f. 320 dhe 331.

<sup>102</sup> Cf. Berry, Njësitë e drejtësisë penale dhe ndërtimi i rastit, (fusnota 100 cituar më sipër) f. 2.

Niveli i lartë i integritimit gjithashtu mundëson përdorimin e buxheteve të ndryshme dhe grumbullimin e burimeve. Çështja kryesore është se si të krijohen stimujt e duhur për departamentet që të shpenzojnë paratë në programet që janë të rëndësishme për synimet dhe objektivat e një SDP më efektiv.<sup>103</sup>

Në nivel lokal, forumet kombëtare të bashkërendimit të drejtësisë penale duhet të kopjohen nga forumet lokale. Anëtarësia e tyre mund të përfshijë, ndër të tjera, komandantin lokal të policisë, kryeprokurorin lokal, drejtuesit lokalë të gjykatave penale, shërbimit të burgut, shërbimit shëndetësor, zyrtarët kryesorë të shërbimit sprovues, përfaqësuesit nga bordet e delikuencës së të miturve, odën e avokatëve, agjencitë e tjera komunale, ofruesit joshitetorë të sigurisë si dhe përfaqësuesit nga shoqëria civile duke përfshirë strukturat mbikëqyrëse.<sup>104</sup>

### *Shembujt e mekanizmave të bashkërendimit dhe bashkëpunimit në nivel strategjik/të politikave*

#### *Zyra për Reforma në Drejtësinë Penale, Bordi Shtetëror i Drejtësisë Penale dhe Bordet Lokale të Drejtësisë Penale në Mbretërinë e Bashkuar*

Zyra për Reforma në Drejtësinë Penale (ZRDP) është një grup i përbërë nga departamente të ndryshme që lehtëson komunikimin dhe bashkëpunimin mes Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe agjencive të tjera të drejtësisë penale për të punuar në partneritet. Në nivel shtetëror, ZRDP është e mbështetur nga Bordi Shtetëror i Drejtësisë Penale (BSHDP) dhe në nivel lokal nga Bordet Lokale të Drejtësisë Penale (BLDP).<sup>105</sup> BSHDP përbëhet nga ministrat e SDP, drejtuesit e agjencive të SDP, sekretariatet e përhershme dhe zyrtarët e lartë për politika dhe përkrah një komitet të Kabinetit të Kryeministrit. Roli i BSHDP është që të sigurojë se “departamentet e qeverisë qendrore, politikanët dhe zyrtarët, të cilët administrojnë drejtësinë penale, veprojnë si një, shtyjnë dhe lehtësojnë ndryshimet”.<sup>106</sup> Në nivel lokal të drejtësisë penale, zyrtarët kyç nga

<sup>103</sup> Cf. Auld, “Sistemi i Drejtësisë Penale “ (fusnota 101 cituar më sipër), f. 332.

<sup>104</sup> Po aty, f. 333.

<sup>105</sup> Cf. Berry, Jan, Zvogëlimi i burokracisë në veprimet policore, raporti i plotë, nëntor 2009, f. 16 dhe Zyra për Reforma në Drejtësinë Penale, ueb faqja në: <http://www.ocjrcommsjobs.co.uk>.

<sup>106</sup> Komisioni i Auditimit, Bordet Lokale të Drejtësisë Penale: mbështetja e menaxhimit të ndryshimit, Londër, 2003, f. 4

agjencitë lokale kryesore të SDP janë anëtarë bazë të BLDP e që përfshijnë policinë, shërbimin prokurorial mbretëror, shërbimin sprovues, gjyqtarët dhe gjykatat. BLDP gjithashtu përfshijnë zyrtarët e lartë nga Shërbimi i Burgut dhe ekipet e të rinjve që shkulin ligjin (një përfaqësues në çdo BLDP) dhe kanë mundësinë që të përfshijnë pjesëtarë nga agjencitë e tjera. BLDP janë njashtu përgjegjëse ndaj BSHDP. Planet e përbashkëta të zbatimit përcaktojnë atë se si ata do të arrijnë të gjitha synimet e tyre dhe identifikojnë zyrtarët kryesorë për qëllimet e ndryshme, si dhe veprimet kyçe dhe momentet kryesore.<sup>107</sup> Qëllimi kryesor i BLDP është që të zbatojë synimet e Marrëveshjes së Shërbimit Publik (MShP) të SDP, të përmirësojë ndarjen e drejtësisë dhe shërbimet që ju ofrohen viktimave dhe dëshmitarëve, dhe ta fitojë besimin e qytetarëve. Këto synime janë caktuar për të gjitha agjencitë e SDP dhe janë në pronësi të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamentit të Lordit Kancelar dhe Prokurorit të Përgjithshëm (është me rëndësi të theksohet se gjyqësori nuk mund të caktojë synime të tilla si numri i dënimeve). Ndonëse synimet e MShP përcaktohen në nivel shtetëror, me miratimin e Qeverisë, BLDP vendosin se si do t'i arrijnë ato dhe, në shumicën e rasteve, pajtohen edhe për nivelin e përmirësimit<sup>108</sup>.

Në vitin 2007, ZRDP botoi *Planin Strategjik të Drejtësisë Penale 2008-2011* duke përcaktuar atë se si SDP në Angli dhe Uells do të punonin bashkë për të ndarë drejtësinë dhe për të plotësuar nevojat e viktimave, për të angazhuar qytetarët dhe për të përmirësuar besimin publik në paanshmërinë dhe efektivitetin e SDP gjersa do të shfrytëzonin në mënyrën më të mirë burimet, ekspertizën dhe teknologjinë.<sup>109</sup>

#### *Komisionet e përhershme të zyrtarëve kyç ekzekutiv të sistemit të drejtësisë penale në Uellsin e Ri Jugor, Australi*

Në Uellsin e Ri Jugor, u themelua një komision i përhershëm i zyrtarëve kyç ekzekutiv të sistemit të drejtësisë penale që përbëhet nga Departamenti i Prokurorit të Përgjithshëm, Departamenti i Shërbimit Korrektues, Departamenti i Administrimit të Gjykatave, Shërbimit Policor, dhe Zyrës së Drejtësisë për të Miturit. Ai gjithashtu përfshin vëzhgues nga Zyra e Kabinetit, Departamenti i Kryeministrit, dhe Byroja e Statistikave të Krimin dhe Kërkimeve. Qëllimi i tij është

<sup>107</sup> Cf. Po aty, f. 5-7.

<sup>108</sup> Po aty, f. 8

<sup>109</sup> Zyra për Reforma në Drejtësinë Penale, Të punojmë bashkë për të ulur shkallën e krimin dhe për të ndarë drejtësi. Plani strategjik për 2008-2011, nëntor 2007, f. 7ff

që të përmirësojë komunikimin dhe të bashkërendojë më mirë veprimtaritë e agjencive të ndryshme.<sup>110</sup>

#### *Komisionet Bashkërenduese të Drejtësisë Penale (KBDP) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

KBDP janë forume jozyrtare dhe zyrtare që mbledhin përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme të SDP, institucionet që nuk kanë të bëjnë me drejtësinë, administratën si dhe komunitetin për të analizuar problemet e krimit dhe për të përmirësuar reagimin e përbashkët të SDP. KBDP mund të themelohen në nivel federal, shtetëror/rajonar dhe në nivelet e agjencive lokale të drejtësisë penale.

Instituti Korrektues Kombëtar Amerikan hartoi udhërrëfyesit për strukturën, detyrat dhe përgjegjësitë ideale të KBDP, si dhe parimet udhëzuese për punën/funksionimin e KBDP.<sup>111</sup>

#### *Konferenca bashkërenduese e drejtësisë dhe policisë në Zvicër*

Kjo konferencë mbahet rregullisht dhe aty takohen të gjitha autoritetet shtetërore dhe rajonale dhe aktorët e përfshirë në çështjet e sigurisë dhe në bashkërendimin e çështjeve të SDP. Aty gjithashtu trajtohen çështjet e bashkëpunimit, financimit të përbashkët të infrastrukturës dhe vështirësitë me autoritetet federale. Sekretari i përgjithshëm i konferencës siguron se temat e ngritura, apo të diskutuara në konferencë janë gjithnjë të trajtuara.

#### *Këshilli kombëtar për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore në Serbi*

Në Serbi në vitin 2012 u hartua *Strategjia dhe Plan i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtje të Viktimave*. Sipas planit, një Këshilli kombëtar në nivel ministror vepron si grup drejtues dhe Koordinatori kombëtar, me një ekip zbatues, është përgjegjës për zbatimin e strategjisë në nivel operativ. Organizatat joqeveritare u përfshinë në hartimin e planit të veprimit dhe njashtu do të marrin pjesë në ekipin zbatues. Ndër shumë çështje, plani i veprimit parasheh themelimin e grupeve punuese mes agjencive për luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (TQNJ) dhe për mbrojtjen e

<sup>110</sup> Cf. Glanfield, Lauri, "Planifikimi Strategjik për Sistemin e Drejtësisë Penale" në Biles, David/McKillop, Sandra (bot.), Planifikimi i drejtësisë penale dhe bashkërendimi, diskutimet e konferencës së mbajtur më 19-21 prill 1993, Kanberra, Instituti Australian i Kriminologjisë, Kanberra, 1997, f. 27

<sup>111</sup> Cf. Cushman, R.C., Udhërrëfyes për zhvillimin e një komiteti bashkërendues të drejtësisë penale, Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve, Instituti Korrektues Kombëtar, janar 2002, Uashington DC.

viktimave të TQNJ që do të udhëhiqet nga Zyra e Prokurorit.

### *Qendra Kombëtare Bashkërenduese kundër Terrorizmit (QKBT) në Spanjë*

QKBT u themelua në Spanjë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të Spanjës, i datës 28 maj 2004. Qendra, e cila i raporton Ministrisë së Punëve të Brendshme, është një organ inteligjence, bashkërendues dhe strategjik që ka për detyrë marrjen, përpunimin dhe vlerësimin e informatave strategjike të ndërlidhura me terrorizmin dhe kryerjen e vlerësimeve të rrezikut dhe planifikimit kundër terrorizmit. Në këtë aspekt, ajo bashkërendon informatat operative të mbledhura gjatë hetimeve kundër terrorizmit.

Qendra po ashtu përkufizon dhe zhvillon strategjinë gjithëpërfshirëse të Spanjës kundër terrorizmit dhe radikalizimit. Ajo i ofron këshilla nivelit politik mbi kërcënimet e ardhshme dhe gjendjen duke përdorur teknikat e analizimit afatgjatë që mëtojnë të zbatojnë katër shtyllat e strategjisë: parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin.

Në mënyrë që të përmbushë detyrat e saja, në QKBT punojnë ekspertë nga agjencitë e zbatimit të ligjit (Garda Civile dhe Policia Kombëtare), Qendra Kombëtare e Inteligjencës dhe Shërbimi i Burgut.

### *VII.1.2 Themelimi i mekanizmave të bashkërendimit dhe bashkëpunimit në nivel operativ*

Në nivel operativ, bashkërendimi i veprimtarive dhe bashkëpunimi në hetimin/përpunimin e rastit mund të përmirësohet dukshëm nëse krijohet infrastruktura fizike për mbledhje, diskutim dhe këmbim të informatave dhe pikëpamjeve mes aktorëve të institucioneve të ndryshme të SDP.

Disa nga ndërhyrjet më të thella në krijimin e infrastrukturës fizike do të ishin: bashkimi i zyrave të policisë dhe prokurorisë; vendosja e prokurorëve në zyrat e policisë; dhe/ose themelimi i ekipeve speciale të përbashkëta apo grupeve të punës që gjenden në një zyre.

Për të siguruar një bashkëpunim të rrjedhshëm në ekipet e tilla të përbashkëta, duhet të zhvillohen kushtet dhe standardet e përbashkëta të punës.<sup>112</sup>

<sup>112</sup> Cf. Berry, Njësitë e Drejtësisë Penale dhe ndërtimi i rastit (fusnota 100 cituar më sipër), f. 1.

## *Shembujt e mekanizmave të bashkërendimit dhe bashkëpunimit të SDP në nivel operativ*

### *Puna e integruar e prokurorisë dhe policisë/"hetimet me dy shtigje" në Norvegji*

Në Norvegji, puna e policisë dhe prokurorisë është shumë e integruar në nivel komune/qarku. Në 27 qarqe të policisë në vend, Eprorët e Policisë – të cilët gjithashtu kanë një diplomë nga fusha juridike – kanë autoritetin policor dhe atë prokurorial. Prandaj eprorët e policisë kanë autoritetin për procedurat penale në polici në nivel qarku.<sup>113</sup> Ata mund ta delegojnë autoritetin e tyre prokurorial tek policët e tjerë me diplomë juridiku, të tillë si zëvendës eprorët e policisë, asistent eprorët e policisë dhe policët juristë.<sup>114</sup> Autoriteti prokurorial në polici, në bashkëpunim me hetuesit e policisë, vendos për nisjen dhe vazhdimin e një hetimi. Autoriteti prokurorial në polici, ose gjykatat vendosin për përdorimin e masave të shtrëngimit; megjithatë, autoritetet policore mund të vendosin për këtë vetëm në raste emergjente.

Përkitazi me çështjet e ndjekjes penale, Eprorët e Policisë janë megjithatë ende nën udhëheqjen e Prokurorit Publik të Qarkut (një shkallë më lartë në hierarki) dhe të Drejtorit të Prokurorisë Publike (dy shkallë më lartë në hierarki). Drejtori i Prokurorisë Publike dhe Prokurorët Publik të Qarkut të dhjetë zyrave rajonale të prokurorisë publike kanë autoritet udhëzues për procedurat penale në polici dhe mund ta kryejnë rishqyrtimin gjyqësor.

Pas disa debateve për veçimin e autoriteteve të policisë dhe prokurorisë, Qeveria më 1988 emëroi një Komision për të shqyrtuar sistemin dhe për ta krahasuar atë me të vendeve të tjera. Konstatimi i komisionit ishte se sistemi duhej mbajtur ashtu siç është dhe kjo gjë u mbështet nga Qeveria dhe Parlamenti.

<sup>113</sup> Cf. Akti i Procedurës Penale, paragrafi 55, 22 maj 1981, Norvegji. Në disa raste, Eprorët e Policisë nuk kanë diplomë nga fusha juridike por së paku kanë studiuar lëndë të caktuara të fushës së juridikut. Në kombinim me përvojën e tyre të gjerë policore, kjo ende ua jep atyre të drejtën për të ushtruar autoritetin prokurorial.

<sup>114</sup> Cf. Akti i Procedurës Penale, paragrafi 67, 22 maj 1981, Norvegji.



### *Themelimi i mekanizmave të komunikimit*

Edhe nëse krijimi i infrastrukturës së lartcekur fizike nuk është i mundshëm në një vend të caktuar, ekzistojnë shpesh së paku mundësi për të përmirësuar ndjeshëm komunikimin në ndërveprimin mes aktorëve të ndryshëm të SDP, për shembull duke mbajtur mbledhje të rregullta, në veçanti përmes mjeteve të komunikimit elektronik që mund të ruhen për ta parandaluar humbjen apo keqinterpretimin e informatave.<sup>115</sup>

Masat për të përmirësuar mbajtjen e saktë dhe efikas të regjistrave dhe menaxhimit të dosjeve të rasteve, të cilat janë të rëndësishme thelbësore për përgatitjen e një rasti me baza të fuqishme, mund të çojnë në një shkallë më të lartë të dënimeve, ulje të numrit të rasteve të pazgjidhura, dhe shkurtim të kohës së paraburgimit të dyshuarve (dhe kështu të shtohet besueshmëria e tërë sistemit të drejtësisë penale).<sup>116</sup>

### *Mbajtja e regjistrave*

Mbajtja e regjistrave të saktë nuk është i rëndësishëm vetëm për përgatitjen efikase të rasteve me bazë të fuqishme kundër personave të akuzuar, por edhe për mbrojtjen e të drejtave të vetë pandehurve dhe të drejtave të tyre për mjete të duhura për ta bërë një gjë të tillë. Ata duhet të kenë “qasje në regjistrat e veprimeve që janë ndërmarrë gjatë hetimeve, gjetjet e veprimeve të tilla dhe provat që mund të jenë mbledhur, përveç atyre që i nënshtrohen përjashtimeve për zbulim”<sup>117</sup> ashtu siç përcaktohet me ligj.

Me qëllim të menaxhimit efikas dhe efektiv të këtyre regjistrave, ato duhet të mbliidhen dhe organizohen në baza elektronike të të dhënave. Të dhënat e ndërlidhura me veprat penale mund të përfshijnë, ndër të tjera, raportet e incidentit, informatat mbi kryerësin-rastin; regjistrin e historisë penale të individëve duke përfshirë aktakuzat, dënimet, të dhënat dhe rezultatet e ankesave si dhe mostrat e ADN-së, të dhënat balistike, gjurmët e gishtërinjve dhe të dhënat/provat e tjera mjeko-ligjore (p.sh., gjurmët e gomave, xhamit, ngjyrës, fibrat si dhe profilet kimike të eksplozivëve apo

---

<sup>115</sup> Cf. IAP, Kodi Model i Procedurës Penale (fusnota 63 cituar më sipër), f. 155; dhe Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Trekëndëshi i brishtë: Koordinimi i Policisë, Gjyqtarëve dhe Prokurorëve gjatë Procedurës Penale në Kosovë, Kërkime Politike 2010/01, Prishtinë, shkurt 2010, f. 17f.

<sup>116</sup> Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Haiti: Reforma e Drejtësisë dhe Kriza e Sigurisë, Raport për Politikën, Raporti nr. 14 për Amerikën Latine/Karaibet, Port-au-Prince/Bruksel, 2007, f. 2; dhe USAID Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm, Auditim i Programit të USAID për Drejtësinë në Haiti (fusnota 113 cituar më sipër), f. 1.

<sup>117</sup> IAP, Kodi Model i Procedurës Penale (fusnota 63 cituar më sipër), f. 168.

substancave narkotike dhe prekursorëve). Shfrytëzimi i këtyre të dhënave mund të përmirësojë dukshëm hetimet penale.

### *Shembujt e bazave të dhënave për veprat penale*

#### *Sistemi i bazës së të dhënave mbi veprat penale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

Sistemi Informativ i Drejtësisë Penale në Shtetin e Konektikatit përbëhet nga aplikacionet kryesore si në vijim:<sup>118</sup>

- Sistemi përcjellës në bazë të kryerësit;
- Sistemi i automatizuar i identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve;
- Sistemi elektronik i përpunimit të dhënave të komunikimit i agjencive të zbatimit të ligjit të Konektikatit;
- Sistemi mobil i komunikimeve të dhënave.

#### *Bazat e të dhënave të Interpolit*

Në nivel ndërkombëtar, Interpoli ka krijuar një gamë të gjerë të bazave të dhënave penale në të cilat shtetet anëtarë kanë qasje të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë. Informata shpërndahet përmes sistemit të sigurt të komunikimit mes policive, të quajtur rrjeti I-24/7, që është fleksibël dhe mund të përshtatet sipas nevojave. Bazat e të dhënave përfshijnë si në vijim:

- *Të dhënat personale – më shumë se 155,000 regjistra për kriminelët e njohur ndërkombëtar, personat e zhdukur dhe kufomat, së bashku me historitë e tyre penale, fotografitë, gjurmët e gishtërinjve, etj.;*
- *Profilet e ADN-së – rreth 136,000 profile të ADN-së nga 67 shtete. Profilet e ADN-së janë grupe të koduara me numër të treguesve gjenetik të individëve që mund të përdoren për të*

<sup>118</sup> Cf. Zyra e Politikave dhe Menaxhimit/Divizioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Politikave të Drejtësisë Penale, Plani Gjithëpërfshirës për Sistemin e Drejtësisë Penale në Konektikat, mars 2007, f. 52.

*zgjidhur krimet dhe për të identifikuar personat e zhdukur dhe kufomat e paidentifikuara;*

- *Gjurmët e gishtërinjve – më shumë se 171,000 gjurmë të gishtërinjve që janë dorëzuar nga 172 vende që menaxhohen nga Interpoli përmes sistemit të automatizuar të identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve;*
- *Pamjet e shfrytëzimit seksual të fëmijëve – në fund të vitit 2012, u identifikuan përafërsisht 2,900 viktima nga më shumë se 40 vende dhe 1,579 kryerës;*
- *Armët e zjarrit – më shumë se 250,000 referenca të armëve të zjarrit dhe 57,000 pamje të cilësisë së lartë që menaxhohen nga Tabela e Referencës së Armëve të Zjarrit të Interpolit, e cila i mundëson hetuesve të identifikojnë në mënyrë të duhur armën e zjarrit të përdorur në një vepër penale (prodhuesin, modelin, kalibrin, etj.). Rrjeti i Informatave Balistike i Interpolit është një platformë për shkëmbimin ndërkombëtar të dhënave balistike në shkallë të gjerë dhe për krahasim, ku ruhen më së shumë 130,000 regjistra;*
- *Task Force i përbashkët – bazë e të dhënave me më shumë se 11,000 persona të cilët dyshohet se kanë lidhje me veprimtaritë terroriste; aktualisht, 105 shtete anëtare japin kontributin e tyre në çështjet përkitazi me terrorizmin.*

Bazat e tjera të dhënave të Interpolit përmbajnë informata për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit, dokumentet administrative të vjedhura, automjetet e vjedhura dhe veprat e vjedhura të artit.<sup>119</sup>

*Ndarja e të dhënave për parandalimin e dhunës – partneriteti mes policisë dhe institucioneve të kujdesit shëndetësor në Mbretërinë e Bashkuar*

*Sipas Doracakut për Trajnim për Policim në Hapësirat Urbane, Seria e Doracakëve të Drejtësisë Penale të ZOKBDK, Programi për Parandalimin e Dhunës në Kardif (PPDhK), i përqendruar në qytetin e Kardifit në Mbretërinë e Bashkuar, u krijua për të studiuar nëse*

<sup>119</sup> Cf. Interpol, Bazat e të dhënave me fakte, COM/FS/2012-02/GI-04, f. 1f.

partneriteti mes zyrtarëve shëndetësor, të policisë dhe qeverisë për ndarjen e të dhënave do të parandalonte dhunën, për dallim nga partneriteti me qytetet ku të dhënat nga departamentet emergjente nuk mblidhen dhe nuk përdoren. Një analist i kombinoi të gjitha të dhënat dhe inteligjencën e policisë për të prodhuar azhurnime të vazhdueshme për pikat e kritike të dhunës, përdorimin e armëve dhe llojin e dhunës. Partnerët, duke përfshirë sektorët e arsimit dhe transportit, u takuan rregullisht për të diskutuar të dhënat, për të këmbyer strategjitë e parandalimit dhe për të modifikuar strategjitë e veprimeve policore. “Programi çoi në një ulje të dukshme të lëndimeve të dhunshme dhe ishte i shoqëruar me regjistrimin nga ana e policisë të sulmeve të lehta në qytet”.<sup>120</sup>

Analizimi i këtyre të dhënave nga administratorët e SDP, drejtuesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile/instituteve kërkimore mundëson: identifikimin e trendeve dhe karakteristikave të veprave penale; identifikimin e mangësive në reagimin e institucioneve të ndryshme të SDP; zhvillimin e politikave dhe rregulloreve të reja për përmirësim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit; zhvillimin e parashikimeve që parashohin kërkesat e ardhshme operative nga SDP; zhvillimin e trajnimeve gjegjëse dhe të strategjive/masave për zhvillim profesional dhe ndarjen më të mirë/efektive të burimeve për institucionet e ndryshme të SDP për ta përmirësuar reagimin e tyre.

Teknologjia moderne informative dhe e komunikimit dhe provat digjitale i japin SDP mundësi për të racionalizuar dhe drejtuar sistemet dhe proceset administrative. Teknologjitë e reja mund të transformojnë atë se si çdo agjenci e SDP i kryen detyrat e veta në kuptim të shpejtësisë, besueshmërisë dhe efikasitetit me të cilat përpunohen të dhënat nga pranimi deri në përdorim.<sup>121</sup>

Megjithatë, shpeshherë, institucionet e ndryshme të SDP-së kanë baza të ndara të të dhënave, ndonëse “shumë informata që këto baza i përmbajnë janë, ose do të duhej të ishin, identike”.<sup>122</sup> Si rrjedhojë e sistemeve të paintegruara të përpunimit të të dhënave, përpjekjet për grumbullimin e informatave mund të dyfishohen. Për më tepër, të dhënat e fragmentuara

<sup>120</sup> Cf. ZOKBDK, Doracak për Trajnim për Policim në Hapësirat Urbane, Seria e Doracakëve të Drejtësisë Penale, Nju Jork 2013 (që do të botohet), f. 25. Për më shumë informata, shih: Florence, Curtis dhe të tjerët: Efikasiteti i ndarjes së informatave anonime dhe përdorimi në partneritetin mes shërbimit shëndetësor, policisë dhe qeverisë lokale për parandalimin e lëndimeve të ndërlydhura me dhunën: Studim eksperimental dhe analizë intervale serike kohore, Kërkimi BMJ, 2011.

<sup>121</sup>Cf. Auld, “Sistemi i Drejtësisë Penale “ (fusnota 101 cituar më sipër), f. 353.

<sup>122</sup> Po aty, f. 355.

të institucioneve të ndryshme mund të mos përputhen me njëra-tjetrën.<sup>123</sup> Madje, sistemet e ndryshme nëpër institucione të ndryshme të SDP-së mund të mos lejojnë fare që informacioni i ruajtur në sistem t'ju komunikohet drejtpërdrejt në mënyrë elektronike agjencive të tjera në nevojë. Edhe brendapërbrenda institucioneve të caktuara të SDP-së, sidomos atyre në shtete federale, mund të ketë sisteme të ndryshme të vëna në përdorim.<sup>124</sup>

Në sistemet e paintegruara, "ecuria e rastit mund të monitorohet vetëm brendapërbrenda agjencisë, si dhe vetëm nga agjencia, për aq kohë sa ta ketë ajo informacionin. Përgjegjësitë për menaxhimin e rasteve janë shpërhapura, duke shkaktuar kështu ndërprerje të mëdha në rrjedhën e informacionit dhe hedhje faji sa herë që diçka shkon keq. Po ashtu, nuk është e mundur që informatat rreth të pandehurve, viktimave, rezultateve apo çfarëdolloj informacioni tjetër që përmbajnë sistemet e ndryshme të bashkohen, meqë çdo agjenci e përkufizon përmbajtjen e dosjeve në mënyrën e vet."<sup>125</sup> Kjo mund të çojë në paraqitjen e situatave ku gjyqtarët nxjerrin vendime gjyqësore pa qenë në dijeni se a janë të pandehurit në fjalë recidivistë apo jo.<sup>126</sup>

Ndërsa rasti kalon nga njëra fazë procedurale në tjetrën, të dhënat e rastit nga dosjet e një agjencie kopjohen me dorë apo në mënyrë elektronike dhe i kalohen agjencisë tjetër. "Shpesh, nuk ka asnjë organ që do ta monitoronte apo siguronte cilësinë apo njëtrajtësinë e bartjes së informacionit, e as një të tillë që do ta menaxhonte ecurinë e gjithmbarshme të rastit duke filluar nga ngritja e aktakuzës deri te zgjidhja e tij. Veç kësaj, rrjedhën e punës nëpër këtë sistem e dikton shumë edhe struktura e çdo departamenti apo agjencie. Të dhënat të cilat kalojnë nëpër sistem vazhdimisht pësojnë ndryshime, qoftë për shkak të veprimit të ndonjërit prej agjencive (p.sh. i pandehuri arrestohet sërish me një akuzë të re) apo për shkak të ndonjë ngjarjeje të jashtme (p.sh. një dëshmitar ndryshon adresën). Zakonisht vetëm njëra nga agjencitë do të vihet në dijeni të ndryshimeve të tilla, dhe, pastaj, duhet të sigurojë që kjo t'ju komunikohet në mënyrë efektive gjithë tjerave të cilat mund të jenë të përfshira. Të gjithë agjencitë e tjera duhet të ndjekin

---

<sup>123</sup> Cf. Hudzik, Xhon K., "Planifikimi i drejtësisë penale gjithëpërfshirëse: Sukseset, dështimet dhe mësimet nga përvoja amerikane", në: Bajlls, Dejvid/Makillop, Sandra (eds.),

*Planifikimi dhe bashkërendimi i drejtësisë penale*, Punimet nga konferenca e mbajtur më 19-21 prill 1993, Kanbera, Instituti Australian i Kriminologjisë, Kanbera, 1994, f. 1-16, këtu f. 10.

<sup>124</sup> Cf. Auld. "Sistemi i drejtësisë penale" (cituar në shënimin e 10-të më sipër), f. 353; dhe Moskoviç, Albert, *Sfidat dhe përparësitë në ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të trafikimit të njerëzve*, studim i prezantuar në "Forum për hulumtimin dhe të dhënat rreth trafikimit të njerëzve", nëntor 2008, f.6.

<sup>125</sup> Auld, "Sistemi i drejtësisë penale" (cituar në shënimin e 101-të më sipër), f. 355f.

<sup>126</sup> Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, *Trekëndëshi i brishtë. Bashkërendimi mes policisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë procedurave penale në Kosovë* (cituar në shënimin e 114-të më sipër), f. 8f.

procedurën e verifikimit dhe mënyrën e vet për të siguruar përfshirjen me kohë të ndryshimeve të verifikuara në dosjen përkatëse. Në rastin më të mirë, sistemi është joefikas dhe me shumë shpenzime; e, në rastin më të keq, ai bën që agjencitë kyçe të kenë informata kundërthënëse.<sup>127</sup>

Për përmirësimin e raporteve të tilla jofunksionale mes institucioneve të drejtësisë penale duhet bërë përpjekje për të ngritur dhe menaxhuar sisteme menaxhimi të dosjeve të lëndëve të integruara mes policisë, prokurorisë, gjykatave, mbrojtjes, si dhe sistemit të burgjeve. Sistemet efektive të përcjelljes së ecurisë dhe menaxhimit të rasteve jo vetëm që përshpejtojnë procesin e ndjekjes penale por mundësojnë edhe vlerësim më të mirë të punës së hetuesve dhe prokurorëve (shih gjithashtu kapitullin VII.5.6).

### *Sistemet e menaxhimit të dosjeve të lëndëve*

Mënyra më efektive dhe efikase e organizimit të sistemit të menaxhimit të dosjeve të lëndëve do të ishte që të krijohet një bazë e të dhënave e përbashkët për institucionet e SDP-së, e që do t'ua bënte atyre të mundur "t'i këmbëjnë të dhënat me njëra-tjetrën në një dosje elektronike të përbashkët, në vend se t'ua kalojnë ato secilës agjenci veç e veç. Pasi të krijohet, kjo dosje do të duhet që të përmbajë dhe t'i ketë të regjistruara të gjitha dokumentet dhe informatat për secilën lëndë veçmas, dhe të mund të bartet shpejtë dhe me pak shpenzime nëpër gjithë sistemin e drejtësisë penale. Pasi që njëra pjesë e sistemit të mbaronte punë me lëndën, dosja e saj do të duhet të jetë e qasshme në formë elektronike për pjesën e radhës – në formë të dhënash të sakta, të plota dhe të përditësuara, të gatshme për vëmendjen nga grupi i radhës i profesionistëve. Çdo agjenci do të duhet që gjatë punës së vet ta përdorte dosjen e përbashkët, duke e përditësuar atë ashtu që të paraqiteshin gjitha ndryshimet e iniciuara nga agjencitë tjera, dhe duke e ndryshuar a plotësuar ashtu që të pasqyroheshin ndryshimet e nisura nga vet agjencia, apo ato për të cilat është vënë në dijeni. Çdo pjesë e informacionit do të duhet të regjistrohet vetëm njëherë të vetme."<sup>128</sup>

Me lejen për qasje në pjesë të caktuara jokonfidenciale të atyre dosjeve për të cilat kanë të drejtë, dëshmitarët, viktimat dhe të pandehurit/avokatët do të mundnin gjatë fazës së menaxhimit të lëndës para fillimit të shqyrtimit gjyqësor t'i merrnin informatat e tilla përkatëse në mënyrë të shpejtë. Për të kontrolluar nëse ka qasje të mirëfilltë në dosjet e lëndëve është e nevojshme që të ketë teknologji sigurie.

Me rastin e krijimit të bazës së përbashkët të të dhënave të TI-së, sistemi duhet t'i plotësojë disa kushte të përbashkëta dhe jo medoemos individuale. Duhet të krijohen përkufizime të përbashkëta për të dhënat përkatëse që do

<sup>127</sup> Auld, "Sistemi i drejtësisë penale" (cituar në shënimin e 101-të më sipër), f. 355

<sup>128</sup> Po aty, f. 358.

të regjistrohen në dosjet e lëndëve, siç janë formularët e standardizuar të regjistrimit të të dhënave për incidente, të dyshuar, viktima dhe dëshmitarë. Çdo agjenci duhet të pranojë dhe të nënshkruajë protokolle për regjistrimin dhe standardet e të dhënave.<sup>129</sup>

Përveç sigurimit të infrastrukturës fizike (harduerë dhe softuerë), kusht tjetër kryesor për krijimin e suksesshëm të një sistemi të tillë të përbashkët e të integruar do të ishte trajnimi i të gjithë personelit të SDP-së në klasifikim të mirëfilltë të dosjeve të lëndëve në një mënyrë që përputhet me standardet administrative dhe që gjithë institucioneve të SDP-së u siguron informatat që u duhen, duke u bazuar në njohuritë mbi kontekstin në të cilin veprojnë institucionet e tjera të SDP-së (shih gjithashtu kapitullin VII.7). Kusht kryesor tjetër do të ishte që në mesin e institucioneve të SDP-së të krijohet një kulturë pune që i inkurajon tërë akterët për t'i këmbyer informatat lidhur me lëndët me njëri-tjetrin, pavarësisht qëllimit të gjyqësorit për të vepruar si i pavarur.

Sistemet e integruara të menaxhimit të dosjeve të lëndëve mund të krijohen përnjëherësh apo në vazhdimësi, varësisht nga disponueshmëria e burimeve financiare, burimeve për trajnime apo për menaxhim të ndryshimit.<sup>130</sup>

### *Shembull i një qasjeje alternative ndaj sistemeve të integruara*

#### *Qasja alternative ndaj sistemeve të integruara në Mbretërinë e Bashkuar*

Në vend se të përpiqet për të krijuar një sistem të përbashkët për 43 forca policore dhe agjenci tjera ndihmëse, Agjencia Kombëtare për Përmirësimin e Punës Policore në Mbretërinë e Bashkuar po krijon një sërë standardesh kombëtare të cilat duhet t'i plotësojnë sistemet e TI-së. Standardet përfshijnë regjistrim të të dhënave njëburimore dhe kyçje të njehershme, kushte lidhur me përputhshmërinë dhe fleksibilitetin, si dhe kapacitet për zgjerim. "Tërë këto do të jenë të mirëseardhura për policët e vijës së parë, të cilët vazhdimisht përpiqen të vënë në shërbim të punës së tyre një kompjuter, irritohen që u duhet ta regjistrojnë të njëjtin informacion disa herë me radhë nëpër baza të ndryshme të të dhënave dhe të mbajnë mend shumë fjalëkalime, të cilat, për arsye sigurie, duhet të ndryshohen rregullisht".<sup>131</sup>

<sup>129</sup> Po aty f.360 dhe

Berry, *Njësitë e drejtësisë penale dhe ndërtimi i rastit* (cituar në shënimin e 100-të më sipër), f. 3

<sup>130</sup> Auld, "Sistemi i drejtësisë penale" (cituar në shënimin e 101-të më sipër), f. 361.

<sup>131</sup> Berry, *Zvogëlimi i burokracisë në punën policore* (cituar në shënimin e 105-të më sipër), f. 25.

### VII.1.3 Mjekësia ligjore

Shërbimet mjeko-ligjore janë çelës për një sistem efektiv dhe të drejtë të drejtësisë penale, sepse sigurojnë informata objektive dhe me kohë për fazat e shumëfishta në stadi të ndryshme të procesit të drejtësisë penale. Për shembull, gjatë fazës së hetimeve të procesit të drejtësisë penale, ato përdoren nga policia për t'i identifikuar të dyshuarit, ndërsa gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor të këtij procesi, i përdorin avokatët e gjyqtarët. "Synim themelor i shkencës mjeko-ligjore është të kontribuojë në gjetjen e së vërtetës, ose, thënë më saktë, t'i japë përgjigje sistemit të drejtësisë penale duke përdorur prova objektive dhe përmes pyetjeve që për qëllim kanë përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë së kryerësit."<sup>132</sup> Andaj, është thelbësore që shërbimet mjeko-ligjore të kryhen nga një subjekt me kualifikim të lartë dhe i paanshëm, në mënyrë efektive dhe efikase. Për këtë nevojiten jo vetëm institucione kompetente të drejtësisë penale dhe ekspertë shkencorë të kualifikuar, por edhe bashkëpunim i mirë mes të gjitha institucioneve përkatëse të përfshira në pranimin, grumbullimin, analizimin, interpretimin dhe paraqitjen e provave mjeko-ligjore në procesin e drejtësisë penale.

Shërbimet mjeko-ligjore i kryejnë kryesisht laboratorët, të cilët janë ose pjesë e sektorit publik qoftë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, qoftë në kuadër të asaj të Drejtësisë, të Shëndetësisë, të Arsimit, dhe të Hulumentit, ose pjesë e sektorit privat dhe punojnë në këmbim pagese. Rrjedhimisht, qasja tërësore ndaj RSDP-së duhet t'i adresojë gjithë akterët përkatës publik dhe privat të përfshirë në shërbimet mjeko-ligjore.

Meqë komunikimi midis njerëzve që nuk merren me shkencë (p.sh. hetues, avokatë, prokurorë dhe gjyqtarë) dhe shkencëtarëve mjeko-ligjorë gjatë trajtimit të provave mjeko-ligjore mund të përcillet me vështirësi për arsye të terminologjisë shkencore e cila përdoret shpesh, këta mbështeten te personeli laboratorik për informata dhe përgjigje të kuptueshme në pyetjet e tyre.

Hetuesit, prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët mbrojtës duhet t'i kuptojnë përfundimet të cilat mund të nxirren nga testet shkencore, dhe kufijtë e këtyre testeve. Shpesh, vendimet janë të bazuara në informatat shkencore të dhëna nga laboratorët. Personeli i laboratorëve duhet të komunikojë në mënyrë efektive me policinë, avokatët dhe anëtarët e tjerë të gjyqësorit, ashtu që laboratorit të mund t'i ofrojë shërbimet e duhura. Për t'i shmangur boshllëqet e mundshme në komunikim, është me rëndësi që të ngrihen mekanizma që gjithë palëve të interesit në SDP ua bëjnë të mundur të punojnë në partneritet. Kjo duhet të përfshijë krijimin e një baze të dhënash

---

<sup>132</sup> ZKBDK, "Puna policore, shërbimet mjeko-ligjore dhe infrastruktura" (cituar në shënimin e 49-të më sipër), f. 1.



mjeko-ligjore dhe hapësirave për ruajtjen e provave fizike në të cilat duhet të kenë qasje institucionet e SDP-së, si dhe përfshirjen e mirëfilltë të provave mjeko-ligjore në dosjet e lëndëve. Laboratorët mund ta shtojnë edhe më tej komunikimin mes institucioneve të ndryshme të SDP-së, duke ju ofruar si për shembull trajnime zyrtarëve policor, avokatëve mbrojtës, prokurorëve dhe gjyqtarëve sa u përket teknologjive të reja dhe përdorimit të mundshëm të tyre (shih gjithashtu kapitulli VII.7). Gjithashtu, laboratorët mund t'ua bëjnë të mundur hetuesve që gjatë hetimeve të këshillohen me personelin laboratorik dhe/ose të caktojnë personel laboratorik për të marrë pjesë në ekipet hetuese. Pavarësisht mekanizmit të përdorur, është thelbësore që laboratorët të marrin përsipër një rol aktiv, duke ju ndihmuar gjithë anëtarëve të SDP-së për t'i përdorur provat shkencore në mënyrë të duhur.

Hapat e reformës tërësore duhet të përqendrohen në:

- procedurat për sigurimin e integritetit dhe identitetit të provave gjatë tërë procesit mjeko-ligjor;
- shkallën e cilësisë së shërbimeve mjeko-ligjore dhe punën drejt akreditimit;
- disponueshmërinë e pajisjeve adekuate të cilat i shërbejnë qëllimit të tyre, koleksioneve të mostrave dhe bazave të të dhënave për referencë, si dhe përkushtimin dhe burimet për mirëmbajtjen e tyre;
- komunikimin efektiv midis profesionistëve të SDP-së dhe shkencëtarëve mjeko-ligjorë;
- mundësi edukimi dhe trajnimi për shkencëtarët, zyrtarët policorë dhe profesionistët tjerë të drejtësisë penale;
- kapacitetin për të prodhuar dhe për t'i integruar informatat mjeko-ligjore (“inteligjencë mjeko-ligjore”) në kornizat e parandalimit të krimit.<sup>133</sup>

---

<sup>133</sup> Po aty, f. 2f.

*Ndihma e OSBE-së për Republikën e Serbisë në shtim të kapacitetit mjeko-ligjor*

Misioni i OSBE-së në Serbi, shpesh në bashkëpunim me partnerë të jashtëm si Qeveria e Norvegjisë dhe Suedisë, në periudhën 2004-2009, ka zbatuar në Republikën e Serbisë një program për mjekësi ligjore në vendngjarje të krimit, “për t’i fuqizuar kapacitetet për kryerjen e hetimeve shumë profesionale dhe të avancuara mjeko-ligjore, në mënyrë që të sigurohen prova të cilësisë së lartë që mbështesin një proces gjyqësor të drejtë dhe sundimin e ligjit në Serbi”.<sup>134</sup> Programi përbëhej prej katër shtyllave kryesore: pajisja e laboratorëve të mjekësisë ligjore dhe zyrtarëve të HVNK-së; trajnimi i personelit laboratorik dhe zyrtarëve të HVNK-së; ngritja e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) për analiza laboratorike dhe HVNK; dhe vendosja e bashkëpunimit ndërkombëtar të institucioneve serbe të mjekësisë ligjore me institucione të huaja homologe.

Në kuadër të programit janë ngritur apo modernizuar në shkallë të konsiderueshme dy laboratorë rajonalë dhe një kombëtar i mjekësisë ligjore, ndërsa personeli është trajnuar në përdorimin e pajisjeve të sjellura rishtas për kryerje të hetimeve në vendin e ngjarjes së krimit të cilat janë sjellë rishtas dhe në testime laboratorike, siç janë marrja e shenjave të gishtave, analizat e shenjave të gishtave, analizat grafoskopike, mekanoskopike dhe fiziokimike, testimi i elementëve në gjurmë dhe analizat kimike. Janë organizuar dhe lehtësuar trajnime për hetuesit në vendin e ngjarjes së krimit, personelin laboratorik dhe mjekët ligjorë.

Programi është përqendruar edhe në hartimin e politikave gjithëpërfshirëse të hetimit në vendin e ngjarjes së krimit, si dhe në futjen në përdorim të sistemit të menaxhimit të cilësisë (SMC), gjegjësisht standardit ISO 17025, për të mundësuar një zinxhir të pandërprerë të ruajtjes së provave, duke filluar nga vendi i ngjarjes së krimit deri te paraqitja e tyre në gjykatë. Përgatitjet për projektin e ngritjes së SMC-së kanë përfshirë vlerësimin e laboratorëve me qëllim verifikimin e kapacitetit e tyre për zbatim të standardit ISO 17025, si dhe integrimin e institucioneve serbe të mjekësisë ligjore

<sup>134</sup> OSBE, *Përkrahja e OSBE-së për shtimin e kapaciteteve mjeko-ligjore në Policinë e Serbisë në periudhën 2004-2009. Raport përmbyllës, Programi i mjekësisë ligjore në vendngjarje të krimit, Misioni i OSBE-së në Serbi, Departamenti për Zbatim të Ligjit, Beograd 2010, f. 5.*

në Rrjetin Evropian të Institucioneve të Shkencës Mjeko-Ligjore (RREISHML), gjë që ishte konsideruar si vendimtare për sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional përmes shkëmbimit të informatave dhe njohurive të fundit. Zbatimi i plotë i SMC-së nuk arriti të bëhej deri në fund të programit. Suedia ka vazhduar me zbatimin e SMC-së në kuadër të një programi tjetër bilateral.

## **VII.2 Bashkëpunimi i shtuar mes institucioneve të SDP-së dhe ofruesve zakonorë/joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë**

Siç u përmend më sipër, ka nevojë që të krijohen mekanizma bashkërendimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve zyrtare të SDP-së dhe ofruesve zakonorë/joshtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë në mënyrë që të përmirësohet efektshmëria dhe efikasiteti i procesit të drejtësisë penale.

Sa u përket ofruesve të sigurisë, këta mekanizma duhet t'i adresojnë posaçërisht masat e mbikëqyrjes nga ana e policisë, si dhe krijimin e mekanizmave/rrjeteve për shkëmbim të informatave, duke saktësuar llojet e ndryshme të informatave dhe shkallën e qasjes së ofruesve joshetërorë të sigurisë në këto informata.

### *VII.2.1 Grupet që ushtrojnë vetëgjyqësi/skemat e ruajtjes së lagjes*

“Organizatrat me natyrë vetëgjyqëse shfaqen shpesh aty ku ka perceptim të shtimit të kriminalitetit ose devijimit shoqëror që kërcënon të çoj në trazira shoqërore. Këto grupe lulëzojnë jo vetëm në ato vende ku shtetit i mungojnë kapacitetet për mbrojtjen e qytetarëve nga krimet, por edhe nëpër vendet ku është krijuar besimi se shteti është i korruptuar dhe nuk mund t'i zihet besë.”<sup>135</sup>

Megjithatë, në disa vende, policia është përballur me situata ku krijimi i marrëdhënieve të vazhdueshme me këto grupe ka pasur arsyeshmëri taktike në përpjekjet për të rivendosur rendin publik. Ndonëse kjo mund t'ia mundësojë policisë që të vendosë kontakte në zonat e mbizotëruara nga grupet e këtilla, policia përballet me sfida të konsiderueshme në këtë drejtim, përfshirë dëmtimin e legjitimitetit të tyre dhe forcimin e organizatave

<sup>135</sup> Kantor Ana/Person, Mariam, *Kuptimi i vetëgjyqësisë. Ofruesit joformal të sigurisë dhe reformimi i sistemit të sigurisë në Liberi*. Akademia Folke Bernadote, Stokholm, 2009, f.12.

që do të mund të përfshiheshin në aktivitete të tjera të kundërligjshme.<sup>136</sup>

Skemat e ruajtjes së lagjes mund të shërbejnë si instrumente të përshtatshme për përfshirjen e komuniteteve në zgjidhjen e problemeve, meqë mund të kontribuojnë në përkrahjen e policisë, nxisin komunikimin e rregullt midis publikut dhe policisë, dhe shtojnë ndjenjën e përgjegjësisë në komunitet për sigurinë e tyre. Për t'iu shmangur rrezikut se pjesëtarë të skemave të ruajtjes së lagjes mund të provojnë që ta marrin ligjin në duart e tyre apo të ushtrojnë vetëgjyqësi, apo të shfrytëzohen për qëllimet e tyre nga grupe me influencë në komunitet, atyre duhet t'ju bëhet gjithmonë e qartë se ata kanë vetëm rol raportues dhe se monopoli mbi ushtrimin e forcës i takon policisë. Andaj, është e këshillueshme që të vendosen rregulla të qarta dhe të rrepta për skemat e ruajtjes së lagjes dhe që t'ju caktohet si mbikëqyrës apo koordinator një zyrtar policor që do të marrë përgjegjësinë për veprimet e tyre.

*Shembull i mekanizmit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit midis institucioneve të SDP-së dhe ofruesve joshitetërorë të sigurisë*

*Bashkëpunimi midis policisë dhe patrullave civile (“druzhiny”) në Kirgizstan*

Në kohën e Revolucionit të Prillit në Kirgizstan në 2010, kur policia nuk ishte në gjendje që të ruante rendin publik dhe sigurinë nëpër rrugë, strukturat e ashtuquajtura “druzhiny” (në njëjës, *druzhina*) të patrullave civile, të krijuara qysh në kohën e Bashkimit Sovjetik, u ringjallën nga disa civilë, për t'i mbrojtur nga plaçkitjet e mëtutjeshme objektet shtetërore, bizneset private dhe pronat private në zonat e banuara në Bishkek, kryeqytetin e vendit.

Gjatë regjimit sovjetik, *druzhiny* përfaqësonin grupe të vogla të njerëzve të cilët bashkëpunonin me policinë duke i vëzhguar rrugët dhe duke ia raportuar incidentet e sigurisë. Prania e tyre kishte efektin e kontrollit shoqëror mbi gjithfarëloj ngatërrestarësh. Anëtarët e *druzhina* pajiseshin me dokumente identifikimi dhe distinktiv të veçantë.<sup>137</sup> Gjatë revolucionit të marsit 2005, grupe të ngjashme të patrullave civile u patën formuar tashmë për t'u dhënë

<sup>136</sup> ZKBDK-UNHABITAT, *Doracak hyrës për punën policore në hapësira urbane*, Botim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Nju Jork 2011, f. 22f.

<sup>137</sup> Cf. Sharshenova, Aijan, *Ofruesit joshitetërorë të sigurisë në Kirgizstan: Druzhina*, dokument pune i hulumtimit, Qendra për Hulumtime Sociale, Universiteti Amerikan i Azisë Qendrore, maj 2011, Kirgizstan, f. 6.

fund plaçkitjeve në Bishkek, por më pas i ndalën aktivitetet.

Në prill të vitit 2010, lëvizja *druzhina* u shndërrua në fenomen masiv. Në Bishkek u themeluan me dhjetëra *druzhiny*, ca prej të cilave kishin lidhje me partitë politike, ndërsa të tjerat kishin kryesisht të përbashkët vendin e banimit apo anëtarësinë në të njëjtin klub sporti. Grupi më i madh ishte *druzhina* “Patrioti”, i përbërë prej anëtarëve me prejardhje shoqërore, përkatësi gjinore dhe moshë të ndryshme, dhe nga vendbanime të ndryshme. Për një ditë të vetme, grupi arriti që t’i mblidhte 8,000 anëtarë në radhët e tij. Ata i mbrojtën rrugët krahë për krahë me zyrtarët policorë, shumë prej të cilëve i kishin hequr uniformat për arsye sigurie.<sup>138</sup>

Për dallim nga 2005-ta, shumë grupe vazhduan aktivitetin e tyre edhe pas përfundimit të Revolucionit të Prillit dhe ofruan shërbime të sigurimit sidomos gjatë zgjedhjeve të ndryshme. Gjithashtu, disa *druzhiny* patën një rol të rëndësishëm në parandalimin e dhunës në disa qytete në jug të Kirgizistanit gjatë përplasjeve ndëretnike në qershor të vitit 2010.<sup>139</sup>

Në qershor të vitit 2012, Qeveria e Përkohshme Kirgize nxori *Dekretin për rregullimin e druzhiny*, që zëvendëson një dekret më të vjetër të qeverisë nga viti 1994. Dekreti përcaktonte qëllimin, detyrat, funksionet, përbërjen dhe strukturat organizative e udhëheqëse të *druzhiny*, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të *druzhina*. Detyrat e identifikuar përfshinin: patrullimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave të tjera publike; ndihmën për zyrtarët policorë; dhënien e sqarimeve për qytetarë; dhe shfrytëzimin e medieve për t’i parandaluar kundërvajtjet dhe krimet. Gjithashtu, dekreti përmbante edhe një dispozitë që u lejonte *druzhiny* të armatosen në raste të emergjencave. Veç kësaj, dekreti vinte theksin mbi domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ngushtë mes *druzhiny* dhe policisë, dhe rolin primar të udhëheqjes së aktiviteteve të *druzhiny* nga ana e policisë.<sup>140</sup>

Pavarësisht këtyre rregulloreve, ekspertët ligjorë kirgizë vazhduan prapëseprapë të rekomandonin miratimin e një ligji kornizë që do ta përcaktonte bazën normative dhe ligjore të veprimtarisë së *druzhiny*. Edhe zyrtarët policorë patën rekomanduar rregulla më precize dhe kufizim të kompetencave të *druzhiny*, për t’i shmangur

<sup>138</sup> Po aty, shënimi i 142-të, f. 7f; dhe UNHCR, *Raporti CORI për Kirgizistanin, Kirgizistan Jugor, i porositur nga UNHCR, dhjetor 2010*, f. 62f.

<sup>139</sup> Cf. Sharshenova (cituar në shënimin e 137-të më sipër), f. 8

<sup>140</sup> Po aty, f. 8f.

shpërdorimet dhe për të siguruar që, në asnjë rrethanë, anëtarëve të *druzhiny* të mos u jepet e drejta për të bartur dhe përdorur armë.<sup>141</sup> OSBE kishte rekomanduar gjithashtu hartimin e një ligji dhe i kishte siguruar Qeverisë një draft të tekstit rregullativ kornizë.

Gjithashtu, OSBE kishte propozuar të krijohet një organ bashkërendues i përbërë prej sektorëve të ndryshëm shtetërorë, duke përfshirë, në veçanti, zyrtarë të Ministrisë së Brendshme (MB) të cilët do të bartnin përgjegjësinë për bashkërendimin e gjithmbarshëm të *druzhiny* anekënd vendit. Qeveria e aprovoi këtë ide dhe në kuadër të MB-së krijoi Njësinë për Bashkërendim me ministrin e brendshëm në krye të saj.

Veç kësaj, OSBE-ja kishte vënë theksin mbi nevojën për ndërtim të kapaciteteve të anëtarëve të *druzhiny* dhe për krahu një varg trajnimesh bazë dyditore për anëtarët e *druzhiny* në tërë vendin. Trajnimi përmbante seanca mbi kuadrin ligjor për subjektin e patrullave qytetare, shkathtësitë në negociim dhe ndërmjetësim, të drejta të njeriut, zgjidhje konfliktesh dhe ndihmë të parë. Trajnimet i kryen trajnerët nga MB-ja, Akademia Policore dhe sektori i OJQ-ve. Gjithsej 1,200 anëtarë të *druzhiny* e përfunduan këtë trajnim në 2010. OSBE-ja mbajti gjithashtu një seminar për menaxherët e mesëm dhe të lartë të qytetit Osh dhe departamentet policore të provincave, për të siguruar se policia i kuptonte modalitetet e bashkëpunimit midis policisë dhe *druzhiny* dhe për të vendosur bashkërendim dhe komunikim më efektiv mes policisë, strukturave të punës policore në bashkësi, siç janë qendrat për parandalim të krimit, dhe *druzhiny*.

Në 2012, roli pozitiv i *druzhiny* ishte pranuar gjerësisht nga hisedarët vendorë dhe ndërkombëtare, por kishte ende nevojë për krijimin e një kuadri rregullator të fuqishëm të kontrollit dhe mekanizmave për ngritjen e vetëdijes në mesin e anëtarëve të *druzhiny* përkitazi me strategjitë e patrullimit dhe treguesit e tensioneve. Veç kësaj, duhej të zhvilloheshin shkathtësitë për t'u marrë me komunitetet dhe për të adresuar sfida të tilla si trazirat publike, diskriminimi dhe korrupsioni.

---

<sup>141</sup> Po aty, f.9.

## VII.2.2 Shërbimet civile private të sigurisë

Sipas një raporti të Grupit të ekspertëve për shërbime civile private të sigurisë, të ngritur nga Komisioni për Parandalim të Krimit dhe Drejtësi Penale, shërbimet civile private të sigurisë (SHCPS) janë “subjekte juridike [private] ose individë që ofrojnë shërbime në këmbim të pagesës. [...] Ato mund të përfshijnë firma afariste dhe organizata jofitimprurëse, si dhe individë.” SHCPS -të “ofrojnë shërbime të sigurisë me qëllimin e përgjithshëm të mbrojtjes apo sigurimit të njerëzve, mallrave, objekteve, lokacioneve, ngjarjeve, proceseve dhe informatave nga rreziqet kryesisht të lidhura me krimin. [...] Shërbimet e ofruara nga shërbimet civile private të sigurisë mund të jenë të natyrës parandaluese, mund të mbështesin agjencitë e zbatimit të ligjit dhe, aty ku lejohet, mund t’i plotësojnë ato të agjencive të zbatimit të ligjit.”<sup>142</sup>

“Në disa shtete, shteti apo autoritetet lokale i ngërthejnë SHCPS-të në planet e tyre të reagimit ndaj katastrofave, dhe u caktojnë SHCPS-ve detyrën për të bashkëpunuar dhe për t’ju ndihmuar zyrtarëve publikë të zbatimit të ligjit.” Në shtete të caktuara, SHCPS -të janë integruar plotësisht në formë të partneriteti nëpër tërë nivelet dhe gjithë sektorët, ku edhe japin kontribut domethënës. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, udhëzimet përkatëse e inkurajojnë një përqasje të këfillë. Përveç promovimit të kontributit të SHCPS-ve në parandalim të krimit, bashkëpunimi i ngushtë me policinë mundëson gjithashtu monitorim më të mirë të SHCPS-ve nga ana e policisë, duke e fuqizuar kështu mbikëqyrjen.”

Në disa shtete, SHCPS -të kanë për “detyrë që të bashkëpunojnë me dhe/ ose të ndihmojnë policinë në forma të ndryshme të tjera, siç janë dhënia e informatave rreth aktiviteteve kriminale dhe ndihma në grumbullimin e provave. [...] Shkëmbimi i informatave është aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit mes akterëve shtetërorë të sigurisë dhe SHCPS -ve. Shpesh, SHCPS-të janë të obliguara që t’ju japin organeve publike të sigurisë informata rreth kërcënimeve dhe dobësive për të cilat kanë dijeni.” Në disa shtete, “organet publike të sigurisë i shkëmbejnë informatat e pranuar nga SHCPS-të.”<sup>143</sup>

Problemet në lidhje me rolin e SHCPS-ve në disa vende, në shkallë të ndryshme, “kanë përfshirë, mes tjerash, infiltrimin kriminal dhe përfshirjen e krimit të organizuar në këtë industri; korrupsionin; fare ose pak trajnim për rojet private të sigurisë; shpërdorimin e kompetencave dhe përdorimin e forcës së tepërt nga ana e personelit; standarde profesionale përgjithësisht

<sup>142</sup> ZKBDK, *Raport mbi mbledhjen e grupit të ekspertëve për shërbime të sigurisë, të mbajtur në Vjenë më 12-14 tetor 2011*, Vjenë, 28 tetor 2011, f. 2f.

<sup>143</sup> ZKBDK, *Shërbimet civile private të sigurisë* (cituat në shënimin e 13-të më sipër), f. 12.

të ulëta; mekanizma joadekuatë të llogaridhënies; dhe mosrespektimin e ligjit”.<sup>144</sup>

Për t'i sqaruar rolet dhe përgjegjësitë e SHCPS-ve dhe raportet e tyre me policinë, si dhe për të siguruar llogaridhënie dhe mbikëqyrje të SHCPS-ve, ka nevojë që të nxirren ligje (shih gjithashtu kapitullin V.2). Gjithashtu, personeli i SHCPS-ve duhet të trajnohet për zbatimin e mirëfilltë të roleve, detyrave dhe përgjegjësiave të tyre.

### VII.2.3 Ofruesit zakonorë/joshtetërorë të drejtësisë

Në disa shtete, ofruesit zakonorë/joshtetërorë të drejtësisë kanë legjitimitet të madh në mesin e popullsisë, veçanërisht nëpër zonat rurale, si rrjedhojë e perceptimit të shkallës më të ulët korrupsionit, si dhe fokusit të tyre mbi drejtësinë restorative dhe pajtimin.

Dilemë e shpeshtë në raportet midis sistemit zyrtar dhe atij zakonor të drejtësisë është shkalla e përshtatshme e integritimit të këtyre dy sistemeve, e që mund të përfshijë:

- kompetenca të kufizuara për sistemet zakonore të drejtësisë, zakonisht të kufizuara vetëm në krime të vogla;
- pranimi i vendimeve zakonore si formë legjitime e marrëveshjeve jashtëgjyqësore;
- përfshirja e gjykatave zakonore në kuadër të instancës më të ulët të sistemit zyrtar të gjyqësisë.

Sa u përket raporteve midis ofruesve zakonorë/joshtetërorë të drejtësisë dhe institucioneve zyrtare të drejtësisë, Komiteti për të Drejtat e Njeriut pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në *Komentin e tij të përgjithshëm nr. 32 për nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për Drejtat Civile dhe Politike*, thotë që “nëse shteti, në kuadër të rendit të tij juridik, i njej gjykatat që kanë për bazë të drejtën zakonore, ose gjykatat fetare, dhe u ka besuar atyre funksione gjyqësore [...], duhet të sigurohet që gjykatat e tilla të mos mund të nxjerrin vendime të plotfuqishme të pranuar nga shteti pa i plotësuar kushtet në vijim: procedurat para gjykatave të tilla të kufizohen vetëm për vepra më të lehta civile dhe penale, t'i përmbushin kërkesat themelore për shqyrtim gjyqësor të drejtë dhe garancitë e tjera përkatëse të Paktit, dhe vendimet e tyre të vërtetohen nga gjykatat shtetërore në dritën e garancive të përcaktuara me Paktin Ndërkombëtar për Drejtat Civile dhe Politike, si dhe të mund të ankimohen nga palët në procedurë, e cila zhvillohet në përputhje

<sup>144</sup> Po aty, f. 3, shih gjithashtu ZKBDK -UNHABITAT, *Doracak hyrës për punën policore në hapësira urbane* (cituar në shënimin e 137-të më sipër), f. 22.



me kërkesat e nenit 14 të Paktit. Sido që të jetë, këto parime përbëjnë detyrim të përgjithshëm të shtetit për t'i mbrojtur të drejtat e parapara me Paktin të gjithë personave të prekur nga veprimi i gjykatave zakonore dhe fetare.”<sup>145</sup>

“Derisa gjetja e zgjidhjes për marrëdhënien midis sistemit zakonor dhe atij zyrtar të drejtësisë penale do të marrë kohë të gjatë, mund të jetë e mundshme që të bëhen përmirësime në nivelin lokal menjëherë. Opsionet programatike mund të përfshijnë:

- punën me autoritetet zakonore dhe akterët shtetërorë në nivel lokal, për të vendosur kriteret të përshtatshme për të përcaktuar se kur është e mundur që lëndët penale t’ju lihen në duar autoriteteve zakonore me qëllim të shmangies së dyfishimit të kompetencave dhe që të mos ketë gjykime më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale;
- punën me autoritetet zakonore, akterët shtetërorë dhe shoqërinë civile për t’i përfshirë parimet restorative të kompensimit dhe pajtimit në rastet që ndiqen penalisht nga shteti.”<sup>146</sup>

Vendimet e drejtësisë zakonore duhet gjithashtu të dokumentohen dhe të regjistrohen nëpër dosje, në mënyrë që të parandalohet hetim apo ndjekje penale e mëtejme nëse çështja tashmë është zgjidhur në nivel lokal.

Në rastet ku praktikantët zakonore shkelin normat dhe standardet e të drejtave të njeriut, aktivitetet e reformës duhet të mëtojnë “mbrojtjen e atyre në pozitë të cënueshme dhe promovimin e ndryshimit nga brenda, si për shembull, përmes:

- punës me komunitetet për t’i inkurajuar që, në vend të praktikave të dëmshme, të krijojnë alternativa të pranueshme në kuptimin kulturor; dhe
- krijimit të alternativave domethënëse në vend të drejtësisë alternativave për ata që janë viktimat e praktikave të dëmshme dhe të shkeljeve të standardeve ndërkombëtare nga ana e këtyre sistemeve, për shembull, duke ofruar ndihmë juridike dhe burime

---

<sup>145</sup> Komiteti për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara, *Komenti i përgjithshëm nr. 32, neni 14: E drejta në barazi para gjykatave dhe tribunaleve dhe në proces gjyqësor të drejtë*, U.N. Doc. CCPR/C/GC/32 (2007), Gjenevë 2007, paragrafi i 24-t; shih gjithashtu

Kombet e Bashkuara, *Politika mbi komponentët e drejtësisë në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara*, UNDPKO, Departamenti për përkrahje në terren, Ref. 2009.30, 1 dhjetor 2009, f. 9.

<sup>146</sup> ZKBDK/IAP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti* (cituar në shënimin e 9-të më sipër), f.111.

shtesë që do t'jua bëjnë atyre të mundur qasjen në sistemin zyrtar.”<sup>147</sup>

Për të krijuar një marrëdhënie konstruktive mes sistemit zyrtar dhe atij zakonor/joshtetëror të drejtësisë penale, dialogu mes autoriteteve zakonore, popullsisë lokale dhe akterëve zyrtarë të drejtësisë duhet të lehtësohet dhe të vazhdohet, për të nxitur mirëkuptimin dhe respektin e ndërsjellë, identifikimin e problemeve në marrëdhënien midis sistemit zyrtar dhe atij zakonor, si dhe përcaktimin e zgjidhjeve të mundshme.<sup>148</sup>

Marrëdhënia mes institucioneve zyrtare dhe atyre zakonore/joshtetërore të drejtësisë duhet të përkufizohet me legjislation (shih gjithashtu kreun V.2). Veç kësaj, përfaqësuesit e institucioneve zakonore/joshtetërore të drejtësisë duhet të trajnohen në zbatimin e mirëfilltë të roleve, detyrave dhe përgjegjësisë të tyre në përputhje me kornizën ligjore.

### **VII.3 Bashkëpunimi i shtuar mes institucioneve të SDP-së dhe shoqërisë civile**

Përveç përfshirjes së shoqërisë civile në përpilimin dhe reformimin e hapave të ndryshëm të RSDP-së, si dhe ngritjen e mbikëqyrjes së SDP-së nga jashtë (shih gjithashtu kapitullin VII.5), ekzistojnë disa fusha tjera të lidhura me drejtësinë ku bashkëpunimi i SDP-së me shoqërinë civile mund të çojë në përmirësim të dukshëm të ndarjes së drejtësisë. Disa prej shembujve karakteristik të paraqitur më poshtë përfshijnë aspektet e parandalimit të krimit nga fusha e punës policore në bashkësi, përkrahjen nga sektori privat ose shoqëria civile në parandalim dhe hetim të abuzimit seksual të fëmijëve në internet, si dhe përfshirjen e shoqërisë civile në fusha të ndarjes së drejtësisë penale sikurse janë programet e diversionit ose ndërmjetësimit. Fusha tjera thelbësore të angazhimit të shoqërisë civile, siç janë qasja në drejtësi dhe ndihma juridike, ndihma për viktime dhe dëshmitarë, si dhe drejtësia për të mitur, do të diskutohen në pjesën “Të drejtat e njeriut” në kapitullin VII.4.

---

<sup>147</sup> Po aty, f. 112.

<sup>148</sup> Po aty, f. 113.

### VII.3.1 Puna policore në bashkësi

Parandalimi me sukses i krimit kontribuon në masë të madhe në zvogëlimin e frikës nga krimet dhe mund ta përmirësojë cilësinë e jetesës në një komunitet. Për ta parandaluar krimin kërkohet përkushtim dhe pronësi e përbashkët e policisë dhe publikut. Një gjë e tillë mund të arrihet vetëm duke ngritur partneritete të besueshme mes policisë dhe publikut, ku i tërë shërbimi policor, të gjitha agjencitë qeveritare dhe gjithë segmentet e shoqërisë bashkëpunojnë aktivisht për t'i identifikuar dhe zgjidhur problemet. Puna policore në bashkësi është një filozofi dhe strategji organizimi që nxit përpjekje të këtilla të bazuara në partneritet dhe bashkëpunim mes policisë, agjencive qeveritare tjera dhe komunitetit.

Ndërveprimi me komunitet nënkupton që publiku t'i qaset policisë kudo dhe kurdo që të jetë nevoja. Policia duhet të ketë nivel të caktuar gatishmërie dhe burime të mjaftueshme për të reaguar në mënyrë adekuate ndaj nevojave të publikut sa u përket aksidenteve, krimeve dhe urgjencave tjera. Për të mbrojtur jetët dhe pronën e qytetarëve, mënyra më e shpejtë e komunikimit janë numrat urgjentë të telefonit që qytetarët mund t'i thërrasin për ndihmë.<sup>149</sup>

Programet ndërvepruese të përafrimit me komunitetin, siç janë krijimi i forumeve formale apo joformale për diskutim të hapur mes policisë dhe përfaqësuesve të gjithë komuniteteve, kanë posaçërisht vlerë për mbledhjen e mendimeve të publikut dhe për nxitjen e shkëmbimit të pikëpamjeve e të bashkëpunimit. Kjo mund të çojë në përfshirjen e komunitetit në programe për parandalim të krimit, përfshirë përmes ngritjes së koalicioneve për zgjidhje të problemeve, dhe në ngritjen e ndjenjës së përgjegjësisë së ndërsjellë për rritjen e sigurisë publike. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet sigurimit të përfaqësimit të një pjese sa më të madhe të shoqërisë, përfshirë pakicat dhe grupet në pozitë të cenueshme, në këto forume. Për të pasur sukses në punën e vet, policisë, veç përkrahjes nga banorët e komuniteteve lokale, do t'i nevojitet edhe përkrahja nga autoritetet lokale. Në raste të caktuara, departamente të tjera mund të jenë më të përshtatshme se policia për t'i zgjidhur problemet sociale në komunitet.<sup>150</sup>

Shembuj të mënyrave të tilla të komunikimit janë bordet këshillëdhënëse të komunitetit, punëtoritë e përbashkëta të policisë dhe komunitetit, takimet publike, ditët e hapura të policisë dhe caktimi i personave për kontakt me komunitetin nëpër stacionet policore. Këto forume bashkëveprimi ndihmojnë

<sup>149</sup> Cf. OSBE, *Udhëzues për punën policore demokratike*, (cituar në shënimin e 25-të më sipër), f. 43; dhe

<sup>149</sup> Cf. OSBE, *Praktikat e mira të ndërtimit të partneriteteve polici/publik* (cituar në shënimin e 86-të më sipër), f. 5.

<sup>150</sup> Cf. OSBE, *Udhëzues për punën policore demokratike*, (cituar në shënimin e 25-të më sipër), f. 44.

në edukimin e publikut për procedurat dhe politikat zyrtare, si dhe për të drejtat dhe përgjegjësitë e komunitetit. Ato bëjnë të mundur që veprimet policore (përfshirë shkëmbimin e përvojave personale të zyrtarëve policorë dhe pjesëtarëve të publikut) të vihen në diskutim dhe i japin mundësi popullsisë që të angazhohet aktivisht në çështje të lidhura me perceptimin e tyre të sigurisë dhe rendit publik. Gjithashtu, këto forume ia mundësojnë publikut që ta ngritë zërin për shqetësimet e tyre rreth mënyrës sesi do të duhej t’jua ruante policia lagjen sipas tyre – për shembull, kur dhe ku nevojiten patrullat e policisë. Në këto forume mund të identifikohen trendet e krimit e të prishjes së rendit dhe mund të përpilohen lista të shqetësimeve të zakonshme, duke i dhënë kështu policisë mundësi për t’i trajtuar këto probleme në mënyrë proaktive.<sup>151</sup>

### VII.3.2 Programet e diversionit

Si element i konceptit të *drejtësisë restorative*, që synon “zgjdhjen e krimit duke u përqendruar në ndreqjen e dëmit që u është shkaktuar viktimave, duke i mbajtur kryerësit përgjegjës për veprimet e tyre dhe duke angazhuar shpeshherë edhe komunitetin në zgjidhje të konfliktit”,<sup>152</sup> programi i diversionit të drejtësisë penale është procedurë alternative dhe/ose plotësuese e procedurave normale të lëndëve penale.

Programet e diversionit i mundësojnë të akuzuarit që të mos ketë dosje penale të qasshme dhe të marrë ndihmë të përshtatshme përmes rehabilitimit, këshillimit dhe/ose trajtimit, ndërsa viktimat, apo komuniteti në tërësi, përfitojnë nga donacionet ose puna pa pagesë në dobi të komunitetit për organizata të ndryshme bamirësie apo projekte të komunitetit lokal.<sup>153</sup> Për më tepër, programet e diversionit mund ta ndihmojnë sektorin e burgjeve të SDP-së për ta përballuar mbipopullimin e tepërt të burgjeve.

Në mesin e programeve të diversionit, programet e diversionit për të mitur janë posaçërisht më të zakonshme. Ato janë krijuar për t’i larguar të rinjtë nga përballja e tyre e hershme me sistemin gjyqësor për të mitur. Këto

---

<sup>151</sup> Po aty, f. 45. Për informata më të hollësishme rreth krijimit dhe ruajtjes së bashkëveprimit në formë të partneritetit mes policisë dhe publikut, shih

<sup>152</sup>SBE, *Praktikat e mira të ndërtimit të partneriteteve polici/publik* (cituar në shënimin e 86-të më sipër); në veçanti, f. 48-55.

<sup>153</sup>SBE, *Policia dhe romët e sintit: Praktikat e krijimit të besimit dhe mirëkuptimit*, Vëllimi i 9-të i serisë së botimeve të NJÇPS, Vjenë, prill 2010; dhe

<sup>154</sup>SBE, *Trafikimi i njerëzve: identifikimi i viktimave të mundshme dhe të supozuara. Një përjasje e punës policore*, Vëllimi i 10-të i serisë së botimeve të NJÇPS, Vjenë, qershor 2011.

<sup>152</sup> ZKBDK, *Doracak për programet e drejtësisë restorative*, seria e Doracakëve të drejtësisë penale, Nju Jork, 2006, f.6.

<sup>153</sup> Cf. Gjykata e ulët e Viktorisë, *Programi i diversionit i drejtësisë penale*.

programe përfshijnë pezullimin e procedurave formale penale apo atyre për të mitur të nisura ndaj kryerësit të supozuar dhe kalimin e tij/saj në ndonjë program trajtimi apo përkujdesjeje.<sup>154</sup>

Duhet të përpilohen kritere të veçanta për të vlerësuar nëse një rast është i përshtatshëm për diversion apo jo. Kriteret mund të përfshijnë: natyrën e veprës (nëse për të zbatohet ndonjë minimum i dënimit apo ndëshkimit); a e ka pranuar fajësinë i akuzuari dhe a ka treguar pendim); moshën e tij/saj; a ka i akuzuari ndonjë shkathtësi të veçantë nga e cila do të mund të përfitonte komuniteti; a është e pajtimit viktimi që të ketë ndonjë lloj ndërmjetësimi ose pajtimi, dhe që prokuroria të jetë e pajtimit për trajtimin e lëndës nëpërmjet diversionit. Çdo procedurë e diversionit duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.<sup>155</sup>

“Përzgjedhja e programit të diversionit si alternativë mund të bëhet para ose pas marrjes së vendimit përkitazi me rastin. Kur lënda nuk i është dërguar ende gjykatës, vendimin lidhur me programin e diversionit e marrin policia ose prokurori. Kur lënda është në shqyrtim gjyqësor, gjyqtari ose magjistrati është ai që do të nxjerrë urdhrin për diversion si alternativë ndaj kohëzgjatjes së dënimit me burgim. Në të shumtën e rasteve, polici ose prokurori ushtron kompetencën për liri të veprimit dhe vendosë që rastin ta trajtojë përmes ndonjë programi të diversionit. Ndonjëherë, diversioni mund të bëhet përmes sistemit joformal apo zakonor të drejtësisë apo nga ndonjë OJQ.”<sup>156</sup>

Përkrahja për zbatimin e programeve të diversionit duhet të vijë nga komuniteti, bizneset, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe sistemi gjyqësor. Suksesi i programeve të diversionit varet nga marrëdhëniet e punës, përkrahja, dhe angazhimin e përkushtimi afatgjatë i hisedarëve.<sup>157</sup> Akterët e shoqërisë civile mund të luajnë rol të rëndësishëm në zbatimin e programeve të diversionit, meqë ata mund të punojnë me kryerësit, t'i rehabilitojnë dhe riintegrojnë ata, si dhe t'i monitorojnë e përkrahin pjesëmarrësit në programe të diversionit.

---

<sup>154</sup> Cf. Rusell, Stiven T et al., *Krijimi i programeve të diversionit për të mitur në komunitetin tuaj*, Universiteti i Nebraskës – Linkolln, f. 1.

<sup>155</sup> Cf. ZKBDK/IAP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti* (cituar në shënimin e 9-të më sipër), f. 86; dhe

Cf. Gjykata e ulët e Viktorisë, *Programi i diversionit i drejtësisë penale* (cituar në shënimin e 153-të më sipër).

<sup>156</sup> Cf. ZKBDK/IAP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dalura nga konflikti* (cituar në shënimin e 9-të më sipër), f. 86; dhe

<sup>157</sup> Cf. Rusell, Stiven T et al., *Krijimi i programeve të diversionit për të mitur në komunitetin tuaj*, Universiteti i Nebraskës – Linkolln, (cituar në shënimin e 154-të më sipër), f. 3.

### VII.3.3 Ndërmjetësimi në çështjet penale

Duke vënë re shfrytëzimin e ndërmjetësimit për çështjet penale si “opsion me pjesëmarrje, elastik, përfshirës, që i jep zgjidhje problemit, si plotësues ose si alternativë në vend të ndjekjes penale tradicionale”, në vitin 1999, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (KiE) miratoi një rekomandim lidhur me ndërmjetësimin në çështjet penale. Ata kanë nënvizuar ca parime të përgjithshme të ndërmjetësimit, përfshirë këtu edhe të drejtat e viktimave dhe të kryerësve, si dhe bazën ligjore, përfshirjen e autoriteteve të drejtësisë penale në ndërmjetësim, rolin, kërkesat, përgjegjësitë dhe detyrat e shërbimeve të ndërmjetësimit. Sipas rekomandimit të KiE-së, OJQ-të dhe komunitetet lokale mund të japin kontribute potencialisht thelbësore në ndërmjetësimet në çështje penale; përpjekjet e nismave publike dhe private duhet të kombinohen dhe të bashkërendohen, “Ndërmjetësit duhet të punësohen nga të gjitha shtresat e shoqërisë dhe në përgjithësi duhet t’i njohin mirë zakonet e vendit dhe komunitetet lokale”. Gjithashtu, ata duhet të vijojnë fillimisht trajnime përpara se të marrin detyrën, si dhe gjatë punës, me synimin të arritjes së “një shkalle të lartë zotësie, duke pasur parasysh shkathtësitë për zgjidhje konflikti, kërkesat e veçanta për të punuar me viktimat dhe kryerësit, si dhe njohuritë bazë të sistemit të drejtësisë penale.”<sup>158</sup> Sa i përket marrëdhënies mes ndërmjetësve dhe autoriteteve të drejtësisë penale, rekomandimi përcakton:

- “vendimi për kalimin e çështjes penale për ndërmjetësim, si dhe vlerësimin e rezultatit të një procedure ndërmjetësimi, duhet t’u rezervohet autoriteteve të drejtësisë penale [...];
- shfajësimet e bazuara në marrëveshjet e ndërmjetësuara duhet të kenë të njëjtin status me vendimet gjyqësore dhe nuk duhet të lejojnë ndjekjen penale për të njëjtat fakte (ne bis in idem) [...];
- shërbimeve të ndërmjetësimit duhet t’u jepet autonomi e mjaftueshme në kryerjen e detyrave të tyre [...];
- shërbimet e ndërmjetësimit duhet të monitorohen nga një organ kompetent[...];
- pavarësisht nga parimi i konfidencialitetit, ndërmjetësi duhet t’u përcjellë autoriteteve përkatëse ose personave përkatës çdo informacion që ka të bëjë me krime të rënda që pritet të ndodhin

---

<sup>158</sup> Këshilli i Evropës, *Rekomandimi nr. R (99) 19 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare lidhur me ndërmjetësimin në çështjet penale*, f. 1f.

së shpejti, informacion ky që mund të dalë gjatë procesit të ndërmjetësimit [...];

ndërmjetësi duhet t'u raportojë autoriteteve të drejtësisë penale për hapat e marrë dhe rezultatin e ndërmjetësimit [...];

duhet të bëhen rregullisht këshillime mes autoriteteve të drejtësisë penale dhe shërbimeve të ndërmjetësimit për të arritur një mirëkuptim të përbashkët [...].<sup>159</sup>

### *Shembuj të skemave të ndërmjetësimit*

#### *Diversioni i rasteve të lehta përmes ndërmjetësimit*

Siç shtjellohet në "Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti" të ZKBDK/Institutit Amerikan të Paqes (IAP), në vitin 2008, Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut ka nisur programin e ndërmjetësimit në fshat në tre rrethe të Malauit. Programi trajnoi një grup mësuesish, të cilët më pas i trajnuan 350 ndërmjetës me njohuri të mira ose mesatare të shkrim-leximit të cilët e flisnin rrjedhshëm gjuhën e vendit, për t'ju ndihmuar komuniteteve të rrethinave të tyre në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre të përditshme dhe për t'i ngritur kapacitetet e tyre për t'i larguar rastet e lehta jashtë sistemit zyrtar. Juristët shërbejnë si urë lidhëse mes ndërmjetësve të fshatrave dhe gjykatave, policisë e shërbimit të burgjeve dhe i lehtësojnë referimet e përbashkëta. Ato raste që nuk arrijnë të zgjidhen me ndërmjetësimit mund të procedohen sërish për arbitrazh joformal me kryepleq të fshatrave apo për shqyrtim gjyqësor nga gjykata e ulët.

Ky program po përsëritet në Sierra Leone, si përgjigje ndaj rekomandimeve të qeverisë dhe Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin, për t'ju sjellë drejtësi të dorës së parë komuniteteve të atjeshme të dala nga konflikti duke ua bërë të mundur që mosmarrëveshjet e tyre t'i shqyrtojnë vet.<sup>160</sup>

#### *Skemat e ndërmjetësimit në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së*

Në Francë, ndërmjetësimi penal është institucionalizuar me ligj në

<sup>159</sup> Po aty, f. 1f.

<sup>160</sup> ZKBDK/IAP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dalura nga konflikti* (cituar në shënimin e 9-të më sipër), f. 87.

vitin 1993, dhe është ndryshuar e plotësuar në vitin 2004.<sup>161</sup> Ai është masë alternative në vend të procedurave penale. Ndërmjetësimi zbatohet vetëm për raste të lehta. Ndërmjetësimi pezullon veprimin e autoriteteve publike.<sup>162</sup>

Qëllimi i ndërmjetësit – zyrtar i policisë gjyqësore, delegat apo ndërmjetës i caktuar nga prokurori, (zakonisht zyrtar në pension i xhandarmërisë dhe policisë së shtetit, ose anëtar i Institutit Kombëtar për Ndhimë Viktimave dhe Ndërmjetësim) – është që t'i afrojë palët për të siguruar kompensimin e lëndimeve që i ka pësuar viktimja, për t'i dhënë fund ngatërresës së shkaktuar nga vepra penale dhe për të kontribuar në riklasifikimin e kryerësit. Palëve u lejohet që të marrin avokat për t'ju ndihmuar, po qe se kanë dëshirë. Me ndihmën e ndërmjetësit penal, palët do të provojnë që të arrijnë një marrëveshje miqësore (kompensimin e dëmeve dhe interesit, kërkim falje etj.). Palëve u lejohet që ta refuzojnë përpjekjen për ndërmjetësim.

Ndërmjetësimin penal para hapjes së procedurës gjyqësore mund ta nisë vetëm prokurori. Ndërmjetësi vepron si “një i deleguar nga prokurori” dhe, si i tillë, mund ta përpilojë dhe nënshkruajë “procesverbalin zyrtar” (“kërkesën”) me palët. Procesverbali zyrtar njihet si vendim apo aktgjykim zyrtar dhe është i përmbarueshëm.

Ndërmjetësi verifikon pajtueshmërinë e kushteve të marrëveshjes dhe i dërgon prokurorit një raport lidhur me rezultatin e ndërmjetësimit. Rezultati pozitiv i ndërmjetësimit bën të mundur që rasti të mbyllet pa qenë nevoja për ta pushuar ndjekjen penale publike.

Në rast të refuzimit të procedurës së ndërmjetësimit, apo mospajtit rreth mënyrave të kompensimit, prokurori vendos të ndërmarrë veprim gjyqësor lidhur me ankesën: procedurë gjyqësore apo mbyllja e rastit.

Në Itali, ndërmjetësimi ka qenë fillimisht në dispozicion vetëm për kryerësit e mitur të veprave penale (1988), por, më vonë, kriteret e pranueshmërisë u zgjeruan për t'i përfshirë edhe madhorët e përballur me akuza për krime më të lehta (që dënohen me më pak se katër vite burgim). Që rezultati i ndërmjetësimit të pranohet nga gjyqtari, duhet të plotësohen disa kushte, duke përfshirë këtu ndreqjen dhe kompensimin e plotë të dëmit të shkaktuar. Shërbimet

<sup>161</sup> Cf. Legifrance, *Ligji nr. 93-2 i 4 janarit 1993 për reformën e procedurës penale*; dhe Legifrance, *Ligji nr. 2004-204 i 9 marsit 2004, për ta përshtatur drejtësinë përballë zhvillimeve të kriminalitetit (1)* ; dhe WikiMediation, *Ndërmjetësimi penal në Francë*

<sup>162</sup> Cf. Legifrance, *Kodi i procedurës penale*, neni 41 dhe D. 15-1.



e ndërmjetësimit ofrohen nga organizata jofitimprurëse, të cilat duhet të nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi me organin përkatës të vetëqeverisjes lokale. Në praktikë, në Itali përzgjedhja e ndërmjetësimit si procedurë alternative vazhdon të jetë mjaft e kufizuar.

Në Rumani, legjislati kombëtar e ka zbatuar ndërmjetësimin në të drejtën penale. Nenet 67-70 të Ligjit 192/2006 përmbajnë dispozita të veçanta lidhur me ndërmjetësimin në çështjet penale. Ndërmjetësimi mund të nisë në fazën e ndjekjes penale apo gjatë procesit gjyqësor. Gjithashtu, ai mund të zbatohet para se të jetë paraqitur ankesa, meqë ligji për ndërmjetësimin përcakton se palët mund t'i drejtohen kësaj mënyre alternative të zgjidhjes së konfliktit në çdo kohë. Ndërmjetësimin mund ta autorizojnë autoritetet e ndjekjes penale apo gjykata e shkallës së parë.

Ndërmjetësimi gjen veçanërisht vend për zbatim në ato lëndë penale tek të cilat, sipas ligjit, tërheqja e ankesës fillestare apo arritja e pajtimit mes palëve heqin përgjegjësinë penale. Megjithatë, ndërmjetësimi nuk përjashtohet si opsion as në lëndët e tjera penale, veçanërisht kur në kuadër të procedurës penale adresohet edhe ndonjë padi civile.

Meqë ndërmjetësimi është procedurë opcionale, pala e dëmtuar, kryerësi, apo cilido pjesëmarrës tjetër në procedurë penale, nuk mund të detyrohen që ta pranojnë ndërmjetësimin. Gjatë ndërmjetësimit, çdo palë duhet t'i jepet e drejta në ndihmë juridike dhe në shërbime të përkthimit. Edhe të miturve, ashtu siç është përcaktuar në kodin penal, duhet t'ju sigurohen të drejtat e tyre.

Nëse ndërmjetësimi niset pasi të ketë filluar ndjekja apo shqyrtimi gjyqësor penal, hetimet penale pezullohen. Pezullimi nuk mund të zgjasë më gjatë se tre muaj nga data e nënshkrimit të kontratës për ndërmjetësim. Pezullimi mbaron atëherë kur procedura e ndërmjetësimit përmbyllet në cilëndo prej mënyrave të përcaktuara me ligj, edhe në qoftë se nuk ka mbaruar periudha tremujore. Afati tremujor zbatohet për ato raste në të cilat ndërmjetësimi nuk ka arritur të finalizohet brenda afatit përkatës.<sup>163</sup>

Në Taxhikistan, ndërmjetësimi kryhet nga këshillat tradicionale të pleqve. Kusht kryesor për zbatimin e pajtimit në Kodin e Procedurës Penale është gatishmëria e kryerësit për t'ia kompensuar në tërësi dëmin që ia ka shkaktuar viktimës.<sup>164</sup>

<sup>163</sup> Cf. Sustac, Zeno Daniel, *Ndërmjetësimi në të drejtën penale*, 2008.

<sup>164</sup> Cf. OSBE ODIHR, Forumi i III-të i eksperteve mbi drejtësinë penale për Azinë Qendrore. 17-18 qershor 2010, Dushanbe, Taxhikistan, raporti përfundimtar, 2010, f. 22f.

*Doracaku i ZKBDK-së i parimeve themelore dhe praktikave premtuese për alternativat ndaj dënimit me burg është burim i dobishëm njohurish mbi diversionin para shqyrtimit gjyqësor. Diversioni para fillimit të shqyrtimit gjyqësor mund të jetë sidomos i përshtatshëm për fëmijët në kuptim të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, që përcakton se “paraburgimi duhet të shërbejë si mjet i fundit”.<sup>165</sup> Qasje tjetër për ta lehtësuar barrën e SDP-së, për t’i larguar lëndët nga sistemi përmes diversionit dhe për ta pajisur sistemin me një sërë sanksionesh konstruktive është zbatimi i programeve të drejtësisë restorative. ZKBDK jep një sintezë gjithëpërfshirëse të mësimëve që janë nxjerrë gjatë zbatimit dhe vlerësimit të modeleve dhe programeve të reja të ndryshme të drejtësisë restorative.<sup>166</sup>*

### ***VII.3.4 Parandalimi, hetimi dhe ndjekja penale e abuzimit seksual të fëmijëve në internet***

Bashkëpunimi mes institucioneve të drejtësisë penale, shoqërisë civile dhe sektorit privat, sikurse është industria e internetit, ka fituar rëndësi të madhe në kontekst të parandalimit, hetimit dhe ndjekjes penale të abuzimit seksual të fëmijëve në internet. Në disa shtete pjesëmarrëse janë krijuar linja kontakti përmes internetit, ku përdoruesit e internetit mund ta raportojnë në mënyrë anonime çfarëdo përmbajtje në internet për të cilën dyshojnë se është e paligjshme. Më pas, analistë të specializuar vlerësojnë dhe gjurmojnë paligjshmërinë e faqeve të raportuara të internetit dhe ua përcjellin agjencive të zbatimit të ligjit informatat përkatëse rreth faqeve dhe përmbajtjes së dyshimtë. Linjat e kontaktit përmes internetit u ndihmojnë edhe ofruesve të shërbimeve të internetit dhe kompanive për “hosting” për të luftuar abuzimin me rrjetet e tyre, përmes shërbimit “njofto dhe ndalo qasjen” të tyre, që i lajmëron rreth përmbajtjes kriminale ashtu që të mund ta heqin atë nga rrjetet e tyre.

### ***Shembuj të përfshirjes së sektorit privat në luftimin e abuzimit seksual në internet***

*Fondacioni për vëzhgimin e internetit në Mbretërinë e Bashkuar*

Fondacioni për vëzhgimin e internetit (FVI) u themelua nga industria e internetit në vitin 1996, për të siguruar linja kontakti të

<sup>165</sup> ZKBDK/IAP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti* (cituar në shënimin e 9-të më sipër), f. 86.

<sup>166</sup> Për më shumë informacione rreth programeve të drejtësisë restorative, shih: ZKBDK, *Doracak për programet e drejtësisë restorative* (cituar në shënimin e 152-të më sipër).

drejtpërdrejtë në internet për publikun dhe profesionistët e TI-së në Mbretërinë e Bashkuar për raportim të përmbajtjes kriminale në internet në mënyrë të sigurt dhe të fshehtë nëse hasin në aso lloj përmbajtjeje. Raportimet mund të bëhen në faqen e internetit të FVI-së. Një marrëveshje për shërbime e lidhur mes Asociacionin e Zyrtarëve Udhëheqës Policorë (AZUP) dhe FVI-së përvijon proceset e menaxhimit të përmbajtjes kriminale në internet të vendosur në kompani “hostingu” në Mbretërinë e Bashkuar.<sup>167</sup> Gjithashtu, statusi i FVI-së si autoritet përgjegjës sa i përket raportimit, trajtimit dhe luftimit të pamjeve nëpër internet të abuzimit të fëmijëve është përcaktuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur midis Shërbimit Mbretëror Prokurorial dhe AZUP-it. “Raportimeve që i merr FVI-ja, në pajtim me procedurat e kësaj të fundit, mund t’ju referohet gjatë ndjekjes penale [...] Nëse është e qartë se në Mbretërinë e Bashkuar është vendosur përmbajtje potencialisht kriminale, FVI do të punojë me ofruesin përkatës të shërbimit të internetit dhe me policinë e Mbretërisë së Bashkuar për ta ruajtur përmbajtjen si provë dhe për ta hequr më pas atë nga interneti, si dhe për të ndihmuar, kudo që të jetë e mundshme, në zbulimin e kryerësve të cilët janë përgjegjës për shpërndarjen apo posedimin e përmbajtjes që përbën vepër penale [...] Shërbimi policor do ta mbajë gjithmonë përgjegjësinë për hetimin e veprave penale të dyshuara/pohimeve.”<sup>168</sup>

### *Task Forca Virtuale Globale*

Meqë abuzimi seksual i fëmijëve në internet përbën krim global, është me rëndësi jetike që ai të luftohet në shkallë globale. Kështu, nëntë agjenci të zbatimit të ligjit nga anekënd bota kanë krijuar Task Forcën Virtuale Globale (TVG) për luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve në internet në tërë botën. Gjithashtu, ata mëtojnë të ndërtojnë një partneritet ndërkombëtar efektiv të agjencive të zbatimit të ligjit, organizatave joqeveritare, institucioneve akademike dhe industrisë, për të ndihmuar në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual në internet. Përdoruesit e internetit mund t’i raportojnë aktivitetet e papërshtatshme apo të paligjshme në internet drejtpërdrejt te TVG-së ose disa agjenci tjera të zbatimit të ligjit, vegëzat e kontaktit të të cilave janë gjithashtu të disponueshme në faqen e internetit të TVG-së.<sup>169</sup>

<sup>167</sup> Për më shumë informacione rreth FVI-së, shih: <http://www.iwf.org.uk/>

<sup>168</sup> Cf. AZUP/FVI, Marrëveshje për shërbime midis Shoqatës së udhëheqësve policorë (SHUP) dhe Fondacionit për vëzhgimin e internetit (FVI), 2010, f. 4f.

<sup>169</sup> Për më shumë informacione rreth TVG-së, shih: <http://www.virtualglobaltaskforce.com/>

## VII.4 Aspektet e të drejtave të njeriut

Përgjithësisht, një sistem i drejtë, efektiv dhe efikas i drejtësisë penale shërben për t'i mbrojtur të drejtat e individëve në siguri personale, jetë dhe liri, dhe siguron qasje në drejtësi dhe barazi para ligjit. Për më tepër, ai respekton të drejtat themelore të viktimave, dëshmitarëve, si edhe ato të të dyshuarve dhe kryerësve, duke përfshirë në veçanti të drejtat e kryerësve të mitur dhe grupeve tjera në pozitë të cenueshme. Fushat e veçanta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut ku kërkohet bashkëpunim efektiv mes institucioneve të ndryshme të SDP-së dhe me shoqërinë civile janë përkrahur në vijim.

### VII.4.1 Qasja në drejtësi/sigurimi i ndihmës juridike

Element kyç i aspektit të të drejtave të njeriut të qasjes në drejtësi është e drejta në ndihmë juridike efektive për personat e ndaluar, arrestuar, të dyshuar apo të akuzuar, apo me aktakuzë të ngritur për vepër penale. Sistemi i ndihmës juridike që funksionin mirë mund:

- t'i mbrojë ata nga arrestimi apo ndalimi arbitrar apo i paligjshëm, si dhe nga tortura;
- të ulë kohëzgjatjen e ndalimit nëpër stacione policore dhe qendra të paraburgimit; dhe
- t'ju sigurojë të drejtën në mbrojtje efektive dhe ndihmë për ta kuptuar procesin e drejtësisë penale dhe të drejtën në proces të drejtë gjyqësor dhe të drejtat e tyre në procedurë (p.sh. e drejta për të heshtur, e drejta për t'u informuar, procedura para gjyqtarit).

“Faza e hetimit dhe, në veçanti, orët dhe ditët e para të mbajtjes policore, janë periudhë vendimtare për procesin e drejtësisë penale si tërësi, meqë i përcaktojnë përmasat dhe cilësinë e provave të mbledhura kundër të dyshuarit dhe aftësinë e tij/saj për t'u mbrojtur, se a do të zbatohet masa e paraburgimit në procedurë paraprake apo jo, a do të zbatohen masa të diversionit, dhe kur do të nisë shqyrtimi gjyqësor i rastit. Këto vendime mund të kenë ndikim domethënës te individit dhe rezultati i procesit. Për shembull, fakti se a do të ndihmohet individit gjatë kohës së paraburgimit para shqyrtimit gjyqësor apo jo mund të ketë ndikim në gjendjen e tij/saj sociale, ekonomike dhe shëndetësore, si dhe në atë të familjes dhe komunitetit të tij/saj.

Gjithashtu, abuzimet ka më së shumti të ngjarë të ndodhin mu në këtë fazë – imponimi i pranimit të fajësisë, kërkesat për rryshfet apo thjesht mospërfillja

e procedurave ligjore që rezulton në ndalime të paligjshme. Ky është gjithashtu edhe momenti i përballjes së parë të viktimave dhe dëshmitarëve me sistemin e drejtësisë penale. Mënyra e trajtimit, dhe e informimit të tyre për të drejtat e tyre, mund të jetë përcaktor i gatishmërisë së tyre, dhe të të tjerëve, për të bashkëpunuar me policinë për rastin në fjalë dhe për t'i raportuar në përgjithësi krimet. E drejta për të marrë ndihmë juridike të pavarur dhe me kohë njihet si një prej masave mbrojtëse procedurale që mëtojnë zvogëlimin e rrezikut nga tortura dhe keqtrajtimit në vende të ndalimit.”<sup>170</sup>

Policia, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të sigurojnë që e drejta në ndihmë juridike të ofrohet dhe të mos ndalohej arbitrarisht. Mbikëqyrësit e policisë, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të marrin veprim të përshtatshëm në lidhje me dështimin e policisë dhe autoriteteve gjyqësore për t'iu përmbajtur detyrimeve të tyre dhe për të respektuar të drejtat e të dyshuarit. Në kontekst të legjislacionit të zbatueshëm, prokurorëve dhe gjyqtarëve do t'ju duhet të përcaktojnë edhe nëse provat e mbledhura duke bërë shkelje të detyrave policore dhe/ose të drejtave të personave të ndaluar, të arrestuar, të dyshuar a të akuzuar, apo me aktakuzë të ngritur për kryerje të veprës penale, duhet të pranohen dhe të merren parasysh me rastin e përcaktimit të paraburgimit para shqyrtimit gjyqësor apo fajësisë/pafajësisë.

Qasja në ndihmë juridike është gjithashtu vendimtare për viktimat dhe dëshmitarët në procedurë penale në kuptim të marrjes së informatave dhe përkrahjes adekuate, dhe të kuptojnë procesin e drejtësisë penale, duke përfshirë të drejtat e tyre procedurale<sup>171</sup> (për informata më të hollësishme, shih faqet 130-137).

Shtetet duhet të marrin masa për t'ju kërkuar shoqatave të juristëve, apo odave të avokatëve dhe institucioneve të tjera të partneritetit, që të përpilojnë lista të avokatëve dhe juristëve të caktuar për ta përkrahur sistemin e ndihmës juridike. Në sistemet e ndihmës juridike mund të përfshihen mbrojtësit publikë, avokatët privatë, skemat e ndihmës pa pagesë, odat e avokatëve dhe juristët.

“Policia, prokurorët dhe gjyqtarët janë përgjegjës për të siguruar që gjithsecilit që paraqitet para tyre, e që nuk mund t'i përballojë shpenzimet për avokat dhe/ose është në pozitë të cenueshme, t'i sigurohet qasje në ndihmë juridike.”<sup>172</sup>

---

<sup>170</sup> ZKBDK/UNDP, *Dokument koncepti. Doracak dhe program i trajnimit mbi qasjen e hershme në ndihmë juridike për politikëbërësit dhe profesionistët*, 2012, f. 3.

<sup>171</sup> Për më shumë informata, shih: Kombet e Bashkuara, *Parimet dhe udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi qasjen në ndihmë juridike në sistemet e drejtësisë penale* (cituar në shënimin e 81-të më sipër), Udhëzimet 7 dhe 8, f. 13f.

<sup>172</sup> Po aty, paragrafi 23, f. 7.

Gjithashtu, shtetet duhet t'i ndajnë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për sistemin e ndihmës juridike, si dhe duhet t'i ngritin njohuritë e njerëzve rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre të parapara me ligj duke shfrytëzuar mënyra të përshtatshme, në mënyrë që të parandalohet sjellja kriminale dhe viktimizimi.

“Shtetet nuk duhet të ndërhyjnë në mënyrën se si organizohet mbrojtja e përfituesit të ndihmës juridike apo në pavarësinë e ofruesit të ndihmës juridike”,<sup>173</sup> por duhet të “sigurojnë dhe promovojnë ofrimin e ndihmës juridike në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale për personat e ndaluar, të arrestuar a të burgosur, të dyshuar a të akuzuar, apo me aktakuzë të ngritur për kryerje të veprës penale, si dhe për viktimat e krimit”.<sup>174</sup> Prandaj, shtetet duhet të “promovojnë bashkërendimin mes agjencive të drejtësisë dhe profesionistëve tjerë sikurse shërbimet shëndetësore apo sociale dhe mbrojtësit e viktimave, në mënyrë që të maksimizohet efektshmëria e sistemit të ndihmës juridike, pa i paragjykuar të drejtat e të akuzuarit”, dhe “të ngritin partneritete me odat e avokatëve apo shoqatat e juristëve për të siguruar ndihmë juridike në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale”.<sup>175</sup>

#### *VII.4.2 Ndihma për viktimat*

SDP duhet të parandalojë viktimizimin, t'i mbrojë dhe ndihmojë viktimat, si dhe t'i trajtojë ato me dhembshuri dhe me respekt për dinjitetin e tyre. Kur përgatitë dosjet e rasteve, policia duhet t'i deklarojë lëndimet dhe humbjet që i ka pësuar viktimat, në mënyrë sa më të qartë dhe sa më të plotë që të jetë e mundshme.

Viktimat duhet të jenë në gjendje që t'i marrin me kohë informatat mbi vendimet lidhur me rastin e tyre dhe për rezultatin e hetimit. Gjithashtu, viktimat duhet të kenë qasje edhe në mekanizma gjyqësorë apo të tjerë, për të kërkuar ndreqje të dëmit që e kanë pësuar dhe për shqyrtim të serishëm me kohë përmes procedurave formale apo joformale të shpejta, të drejta dhe të qasshme.

SDP duhet të marrë masa për t'i minimizuar shqetësimet e viktimave, për ta mbrojtur privatësinë e tyre, sa herë që të jetë nevoja, dhe për t'ju ofruar siguri atyre dhe familjeve të dëshmitarëve të tyre nga kërcënimet dhe hakmarrja (shih pjesën për mbrojtjen e dëshmitarëve më poshtë). Veç kësaj, SDP duhet t'ju sigurojë qasje në ndihmë të specializuar për trajtimin e çfarëdo traume emocionale dhe problemesh tjera të shkaktuara nga viktimizimi, duke

<sup>173</sup> Po aty, paragrafi 16, f. 6.

<sup>174</sup> Po aty, paragrafi 55 (a), f. 16.

<sup>175</sup> Po aty, paragrafi 55 (c) dhe (d), f. 16.

mbajtur parasysh situatën personale dhe nevojat e tyre të menjëhershme, moshën, përkatësinë gjinore, aftësinë e kufizuar apo shkallën e pjekurisë.<sup>176</sup>

### *Shembuj të skemave të ndihmës për viktimat*

#### *Përkrahja për viktimat e dhunës seksuale në Mbretërinë e Bashkuar*

Në Mbretërinë e Bashkuar, Këshilltarët e pavarur për çështje të dhunës seksuale (KPDHS) punojnë në një kuadër të përbërë prej shumë agjencive, për të dhënë këshilla të specializuara e praktike dhe përkrahje emocionale për viktimat e dhunës seksuale. Ata luajnë rol të rëndësishëm në përkrahjen e viktimave gjatë procesit të drejtësisë penale, si dhe në ndihmën që u japin për t'ju qasur kujdesit dhe shërbimeve shëndetësore në të cilat kanë të drejtë. KPDHS-të i përkrahin viktimat gjatë procesit të marrjes në pyetje, i informojnë rreth zhvillimeve në lidhje me rastet e tyre dhe i shoqërojnë kur japin dëshmi në gjykatë. Përfshirja e KPDHS-ve i kursen policisë dhe prokurorisë kohë për të përgatitur raste të forta dhe, gjithashtu, për t'ju shtuar viktimave vetëbesimin që të përballen me kryerësit dhe/ose të mos i tërheqin dëshmitë e tyre.<sup>177</sup>

#### *Mekanizmat kombëtarë të referimit (MKR) për viktimat e trafikimit të njerëzve (TNJ)*

Në kontekst të luftimit të TNJ, MKR-të janë strukturë e rëndësishme bashkëpunimi për SDP-të dhe shoqërinë civile. MKR-ja përkufizohet si kuadër bashkëpunimi përmes së cilit akterët shtetërorë i përmbushin detyrimet e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të trafikuar, duke i bashkërenduar përpjekjet e tyre në formë të një partneriteti strategjik me shoqërinë civile. Synim themelor i MKR-së është të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar dhe të sigurojë një formë efektive të referimit të viktimave të trafikimit të shërbimet e nevojshme. Në thelb të çdo MKR-je qëndron procesi i gjetjes dhe

<sup>176</sup> Cf. OSBE, *Udhëzues për punën policore demokratike*, (cituar në shënimin e 25-të më sipër), f. 30f.; Këshilli i Evropës, *Pozita e viktimave në kuadrin e së drejtës penale dhe procedurës penale* (cituar në shënimin e 96-të më sipër), nenet 1-4;

Këshilli i Evropës, *Ndihma për viktimat e krimeve* (cituar në shënimin e 96-të më sipër), nenet 2 dhe 3. Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të pushtetit* (cituar në shënimin e 96-të më sipër); dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Udhëzime në lidhje me çështje të drejtësisë, të cilat përfshijnë fëmijët viktimat dhe dëshmitarët të krimit* (cituar në shënimin e 96-të më sipër).

<sup>177</sup> Zyra për reformën e drejtësisë penale, *Puna e përbashkët për t'u dhënë fund dhe për të sjellë drejtësi* (cituar në shënimin e 109-të më sipër), f. 39.

identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit, të cilat zakonisht quhen “persona që supozohet se janë trafikuar”. Në këtë proces angazhohen gjithë organizatat e ndryshme të përfshira në MKR, të cilat duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për të siguruar që viktimave t’u ofrohet ndihmë duke i referuar në shërbime të specializuara. Në vitin 2004, OSBE ODIHR ka botuar një *Doracak mbi mekanizmat kombëtarë të referimit: Bashkimi i përpjekjeve për mbrojtjen e të drejtave të personave të trafikuar*, që jep udhëzime rreth zhvillimit të MKR-ve. Krijimi i MKR-ve në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së është element kyç i nismave të OSBE-së kundër trafikimit të njerëzve.<sup>178</sup>

Që nga viti 2007, koordinatori i projektit të OSBE-së në Ukrainë (KPU) ka përkrahur përpjekjet e Qeverisë së Ukrainës për ta përmirësuar kuadrin normativ dhe legjislativ kundër trafikimit, përfshirë dispozitat për ndihmë personave të trafikuar. Përmes ligjit ukrainas për luftimin e trafikimit të njerëzve, të hartuar me përkrahjen e KPU-së dhe të miratuar nga Parlamenti i Ukrainës në shtator të vitit 2011, qeveria ka ngritur një MKR të udhëhequr nga shteti. MKR-ja, që përbëhet prej shumë agjencive dhe është e ngarkuar me detyrën e lehtësimit të identifikimit të viktimave të trafikimit dhe përmirësimit të qasjes së tyre në ndihmë, është krijuar dhe testuar në dy rajone të Ukrainës (Donetsk, Cernivtsi) në kuadër të një projekti të PKU-së. Në vitin 2013, PKU, në bashkëpunim me Ministrinë e Ukrainës për Politika Sociale, e cila në vitin 2012 ka marrë përsipër rolin e Koordinatorit Kombëtar për Anti-Trafikim, ka vazhduar përpjekjet për të siguruar që ky mekanizëm të përhapet në nivel kombëtar.

### *Raportimi i abuzimit të fëmijëve*

Deri tani, shumë Shtete pjesëmarrëse kanë ngritur mekanizma të raportimit të obligueshëm për abuzim të fëmijëve, ku raportuesit e mandatuar – zakonisht profesionistë të tillë si personeli mjekësor apo edukatorët të cilët gjatë punës kanë kontakt të shpeshtë me fëmijët – janë të detyruar me ligj që t’ia raportojnë autoritetit përgjegjës rastet e dyshuara të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve (në shumicën e juridiksioneve, departament i policisë lokale dhe/ose shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve). Pasi të jetë kompletuar raporti, autoriteti përgjegjës duhet ta verifikojë atë dhe, nëse ka

<sup>178</sup> OSBE, *Trafikimi i njerëzve: Identifikimi i viktimave të mundshme dhe të supozuara* (cituar në shënimin e 151-të më sipër), f. 36.

Cf. OSBE ODIHR, *Mekanizmat ndërkombëtarë të referimit: Bashkimi i përpjekjeve për mbrojtjen e të drejtave të personave të trafikuar: Doracak praktik*, Varshavë, 2004, f. 15f.; dhe

OSBE ODIHR, *Zhvillimet e tanishme të MKR-ve në rajonin e OSBE-së*, Varshavë, tetor 2008, f.2.



të ngjarë që të ketë ndodhur abuzimi, cakton një menaxher rasti i cili do ta vlerësojë situatën dhe do të vendosë nëse fëmija do të jetë i sigurt në shtëpinë e tij/saj apo duhet që të largohet nga aty. Pra, fjala është për një skemë me përfshirje të shumë akterëve që kërkon bashkëpunim pa vështirësi mes tyre. Për shembull, roli i agjencive të zbatimit të ligjit do të duhej të përfshinte hartimin e planit të sigurisë dhe hetimit e abuzimit të dyshuar.

Pothuajse të gjitha shtetet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës caktojnë profesione të caktuara, ushtruesit e së cilave janë të mandatuara me ligj që të raportojnë keqtrajtimin e fëmijëve. Këta individë mund të përfshijnë: punëtorët social; mësuesit dhe personeli tjetër shkollor; mjekët dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë; profesionistët e shëndetit mendor; ofruesit e kujdesit për fëmijë; mjekët ligjorë apo hetuesit; përpunuesit komercialë të materialeve filmike apo fotografive; këshilluesit për abuzim me substanca narkotike; zyrtarët sprovues dhe të lirimit me kusht; zyrtarët për dhunë në familje; pjesëtarët e klerit; dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit. Veç kësaj, shumë shtete i obligojnë të gjithë personat për ta raportuar abuzimin apo neglizhencën, pavarësisht profesionit të tyre. Raportuesit obligativ duhet të dorëzojnë raporte nëse kanë dyshime apo arsye për të besuar se ndonjë fëmijë është abuzuar apo neglizhuar. “Komunikimi i privilegjuar” ose, thënë ndryshe, njohja me ligj e së drejtës për komunikim konfidencial zakonisht konfirmohet vetëm për komunikimet avokat/klient dhe klerik/i penduar. Në të shumtën e rasteve, shtetet i mohojnë privilegjet mjek-pacient dhe burrë-grua.<sup>179</sup> Në përgjithësi, këto raportime pranohen dhe verifikohen nga shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, dhe nëse i plotësojnë kriteret sipas përkufizimit ligjor të shtetit për abuzim apo neglizhencë, personat që e bëjnë raportimin referohen te shërbimet e tjera të komunitetit apo agjencitë e zbatimit të ligjit për ndihmë shtesë. Nëse për sigurinë e fëmijës është i domosdoshëm autoriteti i gjykatës për të miturit, atëherë iniciohet veprim gjyqësor.<sup>180</sup>

<sup>179</sup> Cf. Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shërbime Shëndetësore dhe Humane et al. *Portali i informatave për mirëqenien e fëmijës. Raportuesit e detyrueshëm të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës: Përmbledhje e ligjeve shtetërore*, Uashington DC, prill 2010

<sup>180</sup> Për veprime të veçanta gjyqësore dhe përfshirje të agjencive të zbatimit të ligjit në raste të llojeve të caktuara të abuzimit, siç janë abuzimi seksual apo abuzimi i rëndë fizik, shih Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shërbime Shëndetësore dhe Humane et al., *Portali i informatave për fëmijë, Si funksionon sistemi i mirëqenies së fëmijëve*, Uashington DC, maj 2012, f. 4-7.

Gjithashtu, ndihma për viktimat mund të përfshijë sigurimin e mekanizmave të këshillimit për viktimë, duke u dhënë viktimave mundësi për t'u këshilluar me autoritetin e ndjekjes penale para përmbylljes së gjithë bisedimeve për marrëveshjen për pranim të fajësisë apo vendimeve përfundimtare, siç janë pushimi apo hedhja poshtë e rasteve apo zbutjes së pikave të aktakuzës. Këshillimet me viktimat janë gjithashtu të rëndësishme në kontekstin më të gjerë të mbrojtjes së viktimave/dëshmitarëve nga kërcënimi apo shqetësimi, si për shembull, para vendimit për lirim me kusht apo nxjerrjes së urdhrin për “ndalim të kontaktit”. Megjithatë, të drejtat e viktimave për t'u këshilluar me prokurorinë para arritjes së çfarëdolloj marrëveshjeje për pranim të fajësisë apo nxjerrjes së vendimit përfundimtar nuk e kufizon apo ndryshon kompetencën apo lirinë e veprimit të prokurorisë për të hyrë në çfarëdo marrëveshjeje.

“Shërbimet e policisë, drejtësisë, shëndetësisë, sociale dhe personeli tjetër i interesuar duhet të vijojnë trajnime për rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të viktimave, dhe t’ju jepen udhëzime për të siguruar që atyre t’u jepet ndihmë e duhur dhe në kohë (shih gjithashtu kapitullin VII.7).”<sup>181</sup>

### VII.4.3 Ndhimja/mbrojtja e dëshmitarëve

Mbrojtja e jetës dhe sigurisë personale të dëshmitarëve të krimit, familjarëve dhe personave të tjerë të afërt me ta është element thelbësor i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ky është gjithashtu një parakusht për procedurë penale efektive, meqë dëshmitarët do të ngurrojnë shumë për t’i dhënë informatat përkatëse qoftë gjatë hetimit, qoftë në gjykatë, nëse kanë frikë nga akte të hakmarrjes apo kërcënimit.

Për t’i mbrojtur dëshmitarët e krimit nga aktet e kërcënimit apo hakmarrjes, gjyqësori, në bashkëpunim me policinë, duhet të vendosë masa të përshtatshme ligjore dhe të krijojë programe të veçanta të mbrojtjes së dëshmitarëve.<sup>182</sup> “Programet e mbrojtjes së dëshmitarëve duhet të ofrojnë metoda të ndryshme të mbrojtjes: këto mund të përfshijnë ndërrimin e identitetit, zhvendosjen në vend tjetër, ndihmën në gjetje e një pune të re, caktimin e rojeve të sigurimit dhe formave tjera të mbrojtjes fizike për

<sup>181</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të pushtetit* (cituar në shënimin e 96-të më sipër), neni 16

<sup>182</sup> Cf. OSBE, *Udhëzues për punën policore demokratike*, (cituar në shënimin e 25-të më sipër), f. 30f. Për studimin gjithëpërfshirës lidhur me masat e mbrojtjes së dëshmitarëve, shih gjithashtu: ZKBDK, *Praktikat e mira për mbrojtjen e dëshmitarëve në procedurë penale që ka të bëjë me krimin e organizuar*, Nju Jork, 2008

dëshmitarët, familjarët e tyre dhe personat e tjerë të afërt me ta.”<sup>183</sup>

Mund të ketë programe të mbrojtjes së dëshmitarëve në nivel kombëtar dhe/ose rajonal. Në vendet që kanë programe në të dyja nivelet, “përgjegjësitë e agjencive përkatëse të mbrojtjes duhet të përcaktohen qartazi, mirëpo, në kushte ideale, procesi i tyre i vendimmarrjes do të duhej të ishte i centralizuar në nivel kombëtar me qëllim të sigurimit të njëtrajtësisë së kritereve për praninë në program dhe të masave të zbatuara.”<sup>184</sup>

“Kompetenca për t’i pranuar apo hequr dëshmitarët nga programi i mbrojtjes së dëshmitarëve i besohet zakonisht ndonjë autoriteti jashtë njësisë për mbrojtje të dëshmitarëve. Ky autoritet [...] ka mandatin për ta mbikëqyrur zbatimin e programit, për të vendosur përkitazi me ndarjen e buxhetit dhe për të dhënë udhëzime politike.”<sup>185</sup>

“Autonomia organizative është parim i qenësishëm për zbatimin me sukses të programit të mbrojtjes së dëshmitarëve. Njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve duhet të jetë e ndarë nga agjencitë e hetimit dhe autoriteti prokurorial, si dhe duhet të gëzojë “izolim” nga shërbimet policore në kuptimin operativ. Informatat duhet të ndahen me njësitë e tjera policore vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, dhe me nismë të njësisë. Kjo mund të ndodhë, për shembull, në ndonjë rast ku nga policia kërkohet që t’i përkrahë operacionet e njësisë në aspektin logjistik apo të kontribuojë në vlerësimin e seriozitetit të kërcënimit ndaj jetës së ndonjë dëshmitari.”<sup>186</sup>

Për programe të suksesshme të mbrojtjes së dëshmitarëve kërkohet gjithashtu bashkëpunim i ngushtë mes agjencive qeveritare dhe sektorit privat, për t’ju siguruar dëshmitarëve gamën e gjerë të shërbimeve të nevojshme (p.sh. dokumente të reja identifikimi, banim, përkrahje financiare, kujdes mjekësor, shkollim për fëmijët).<sup>187</sup>

Përveç programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve, ndihma për dëshmitarë mund të përfshijë edhe aspekte që nuk janë të lidhura me sigurinë, siç janë përkrahja për grupet në pozitë të cenueshme (p.sh. fëmijët, të moshuarit dhe personat me probleme të shëndetit mendor) dhe për të huajt të cilët nuk e flasin a kuptojnë gjuhën e shtetit pritës. Qëllimi është që ata të përgatiten për

---

<sup>183</sup> Këshilli i Evropës, *Kërcënimi i dëshmitarëve dhe të drejtat e palës mbrojtëse* (cituar në shënimin e 96-të më sipër), nenet 14-15; shih gjithashtu nenin 51; dhe

Këshilli i Evropës, *Mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë* (cituar në shënimin e 97-të më sipër), nenet 1, 2 dhe 8-28.

<sup>184</sup> ZKBDK, *Praktikat e mira për mbrojtjen e dëshmitarëve në procedurë penale që ka të bëjë me krimin e organizuar* (cituar në shënimin e 182-të më sipër), f. 46.

<sup>185</sup> Po aty, f. 60.

<sup>186</sup> Po aty, f. 53.

<sup>187</sup> Po aty, f. 54f.

të dhënë dëshmi të besueshme gjatë hetimit dhe në gjykatë, duke “mbajtur parasysh situatën e tyre personale dhe nevojat e menjëhershme, moshën, përkatësinë gjinore, aftësinë e kufizuar dhe shkallën e pjekurisë, si dhe duke respektuar plotësisht integritetin e tyre fizik, mendor dhe moral”<sup>188</sup> Në raste të caktuara, do të duhet të krijohen shërbime dhe përkrahje e posaçme kundrejt përkatësisë gjinore dhe moshës së dëshmitarit dhe natyrës së ndryshme të veprave penale të caktuara që janë në shqyrtim në procedurë penale, siç është abuzimi seksual.<sup>189</sup>

### *Shembuj të skemave të mbrojtjes së dëshmitarëve*

#### *Elementët kyç të programit të Italisë për mbrojtjen e dëshmitarëve*

Nëse masat standarde të mbrojtjes së dëshmitarëve (p.sh. vëzhgimi dhe shoqërimi në shtëpi/vend të punës) janë joadekuate, dhe individi ndodhet në rrezik serioz, mund të zbatohet një program i masave të veçanta.

Programin e mbrojtjes e përcakton Komisioni Qendror (zëvendësministri i Brendshëm, dy gjyqtarë dhe pesë zyrtarë policorë), me kërkesë të prokurorit publik, për një periudhë prej gjashtë deri në 60 muaj. Masat e veçanta të mbrojtjes mund të zbatohen edhe për personat që bashkëbanojnë në mënyrë të përhershme me dëshmitarin, apo personat që ndodhen në rrezik për shkak të raportit të tyre me dëshmitarin.

Sistemi i mbrojtjes bazohet në parimin e “kamuflimit”, d.m.th. arritjen e anonimitetit të plotë. Personat zhvendosen në ndonjë vendbanim të ri e të sigurt dhe pajisen me dokument të përkohshëm të identifikimit, i cili është i vlefshëm vetëm për atë kohë sa zgjat periudha e mbrojtjes. Në raste posaçërisht të ndjeshme, rregulloret përcaktojnë edhe ndërrim të përhershëm të identitetit. Mund të caktohen edhe masa të ndihmës për ta bërë më të lehtë riintegrimin social dhe për të siguruar përkrahje materiale (p.sh. akomodim, pagesa për transferin, kujdes shëndetësor, ndihmë juridike dhe psikologjike dhe mëditje për ata që nuk janë në gjendje të punojnë).

Shërbimi Qendror i Mbrojtjes dhe 19 njësitet operacionale lokale janë përgjegjës për zbatimin e programit nëpërmjet, *mes tjerash*:

<sup>188</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Udhëzime në lidhje me çështje të drejtësisë, të cilat përfshijnë fëmijët*

*viktima dhe dëshmitarë të krimit* (cituar në shënimin e 96-të më sipër), neni 10.

<sup>189</sup> Po aty, neni 17

ndihmës së drejtpërdrejtë për personat nën mbrojtje; kontakteve me agjenci për të lehtësuar marrëdhëniet e tyre me njerëz të tjerë (shkollë, shëndetësi, punë etj.); dhe ndihmës për policinë lokale në kuptim të ofrimit të sigurisë për personat në mbrojtje.

Personat nën mbrojtje zotohen që: t'i respektojnë rregullat e sigurisë dhe të bashkëpunojnë aktivisht në zbatimin e masave të mbrojtjes; të merren në pyetje dhe të kontrollohen; apo të jenë të disponueshëm për çfarëdolloj veprimesh të cilat duhen ndërmarrë; faktet lidhur me procedurën të mos ia zbulojnë askujt tjetër përveç autoriteteve të zbatimit të ligjit e atyre gjyqësore dhe mbrojtësit; dhe të mos e kontaktojnë asnjë person të përfshirë në veprimtari kriminale.

Programi ndërpritet kur pushojnë së ekzistuari kushtet që personi të vazhdojë të mbahet në mbrojtje, apo në rast të: mosrespektimit të detyrimeve, kryerjes së veprave penale, kthimit të paautorizuar në vendin e origjinës, apo kur zbulohet identiteti a vendqëndrimi i ri. Gjithashtu, personi nën mbrojtje mund ta lë programin me anë të një dorëheqjeje me shkrim.

Programi mund të përfshijë masa për lehtësimin e riintegritit social pas mbarimit të bashkëpunimit. Për dëshmitarët, këto masa zgjasin për një periudhë deri dhjetëvjeçare dhe garantojnë standard të njëjtë jetese për personin sikurse para pranimit në program. Dëshmitarët marrin një shumë të hollash si kompensim për të ardhurat e humbura, mund të marrin kredi të siguruara dhe t'i shesin patundshmëritë e tyre me çmim tregu; nëse janë shërbyes civilë, atyre u ruhet vendi i punës me pushim me pagë.<sup>190</sup>

### *Strukturat për mbrojtjen e dëshmitarëve në Mbretërinë e Bashkuar*

Në nivelin kombëtar, Agjencia për krim të rëndë të organizuar (AKRO), e ngritur sipas Ligjit të vitit 2005 për krim të rëndë të organizuar dhe policinë, ka të themeluar një Njësi për Mbrojtje të Dëshmitarëve. Veç kësaj njësie, është themeluar edhe Byroja për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në kuadër të Zyrës për Punë të Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar. Kjo Byro nuk ka kapacitet operativ, mirëpo siguron përkrahje dhe shërbime qendrore për Njësinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve, siç janë qasja në banim social, përfitime dhe kujdes shëndetësor për dëshmitarët e mbrojtur.

<sup>190</sup> Cf. ZKBDK, *Doracak për rastet e krimit të organizuar. Përmbledhje e rasteve bashkë me komantarë dhe mësimet e nxjerra*, Nju Jork, tetor 2012, ff. 50f.

Byroja shërben gjithashtu si pikë e vetme kontakti për marrëdhënie dhe operacione ndërkombëtare.

Në nivelin rajonal, është Agjencia Skoceze e Zbatimit për Krim dhe Droga ajo që siguron mbrojtje të dëshmitarëve për gjithë forcat policore në Skoci. Në Angli, Irlandën Veriore dhe Uellsh, mbrojtja e dëshmitarëve bëhet në nivel lokal, dhe në kuadër të disa forcave policore janë ngritur programe të dedikuara për mbrojtje të dëshmitarëve. Ato që nuk e kanë programin e vet të mbrojtjes së dëshmitarëve ua kalojnë rastet forcave policore fqinje.<sup>191</sup>

#### *Autoritetet iniciuese dhe vendimmarrëse*

Në Mbretërinë e Bashkuar, hetuesit mund të aplikojnë drejtpërdrejt tek autoriteti i mbrojtjes, i cili më pas përcakton nëse do ta pranohet dëshmitarin në program apo jo.

Në Gjermani, në nivelet federale dhe shtetërore, vendimi për t'i pranuar apo për t'i larguar dëshmitarët nga programet merret bashkërisht nga Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe prokurori publik.

Në Sllovaki, hetuesi penal apo prokurori mund të përgatisin dhe të dorëzojnë një propozim me shkrim për përfshirjen e personit në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe për zbatimin e masave urgjente. Pasi të fillojë shqyrtimi gjyqësor, këtë nismë mund ta ndërmarrë edhe kryetari i panelit të gjyqtarëve. Ligji nr. 256/1989 për mbrojtjen e dëshmitarëve e lejon autoritetin për mbrojtje të dëshmitarëve që t'i rishqyrtojë vendimet e veta lidhur me pranimin apo refuzimin për t'u pranuar në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Procesi shihet si një kompromis midis mungesës së plotë të mjeteve juridike dhe ankesës zyrtare, dhe mund të iniciohet me kërkesë të hetuesit penal, prokurorit apo gjyqtarit.<sup>192</sup>

#### *Përkrhja për dëshmitarët me aftësi të kufizuar në mësimnxënie në Mbretërinë e Bashkuar*

Në Liverpool, "një punëtor social nga Njësia për Përkrhje të Hetimeve pranë Këshillit të Qyteti të Liverpulit punon me dëshmitarët të cilët kanë aftësi të kufizuar në mësimnxënie. Njësia bashkëpunon ngushtë me Policinë e Mersejsajdit dhe Shërbimin Mbretëror

<sup>191</sup> Cf. ZKBDK, *Praktikat e mira për mbrojtjen e dëshmitarëve në procedurë penale që ka të bëjë me krimin e organizuar* (cituar në shënimin e 182-të më sipër), f. 47.

<sup>192</sup> Po aty, f. 59f.

Prokurorial, për të siguruar që njerëzit me aftësi të kufizuar në mësimnxënie të konsiderohen si dëshmitarë të besueshëm. Që nga viti 1998, modeli i kësaj njësie për përkrahje, përgatitje dhe profilizim të dëshmitarëve u ka ndihmuar 25 dëshmitarëve të prokurorisë, zakonisht viktime të abuzimit seksual, që të japin dëshmi. Modeli i përkrahjes, përgatitjes dhe profilizimit të dëshmitarëve përfshin punën me dëshmitarin përgjatë një periudhe prej rreth 10-12 javësh. Gjatë kësaj kohe, dëshmitari mëson shkathtësi të reja dhe fillon t'i kuptojë proceset e dhënies së dëshmisë. Në fund të kësaj faze përgatitore, hartohet profili i dëshmitarit dhe i njëjti i dërgohet gjykatës.<sup>193</sup> Pas zbatimit me sukses të tij në Liverpul, ky model është zbatuar në pjesë të ndryshme të vendit. Gjithashtu, ai është përshtatur edhe për personat e moshuar dhe për personat me probleme të shëndetit mendor.

#### *VII.4.4 Menaxhimi i integruar i kryerësve të veprave penale*

Shkëmbimi i informatave në kuadër të skemave të menaxhimit të integruar të kryerësve duhet të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare, d.m.th. informatat duhet të shkëmbehen në pajtim me ligjin, për qëllime të saktësuar, të jenë adekuate, përkatëse dhe të mos jenë të tepruara, dhe nuk mund të mbahen më shumë se sa që ka nevojë. Koncept bazë i menaxhimit të integruar të kryerësve është që të punohet me ata kryerës të cilët janë të motivuar për të mos kryer më vepra penale, ashtu që agjencitë e drejtësisë penale të mund ta zvogëlojnë barrën mbi sistemin dhe të përqendrohen në përpjekjet e tyre për t'i kapur dhe dënuar kryerësit të cilët përbëjnë rrezik të madh për komunitetet gjegjëse.

Skema e përfshinë punën e kryer bashkërisht nga policia, zyrtarët sprovues dhe partnerët tjerë kyç për të siguruar kombinim të intervenimeve rehabilituese, mbështetje për respektim të procedurave dhe zbatim të fuqishëm për zvogëlimin e numrit të rasteve të kryerjes së serishme të veprave dhe të dëmit të shkaktuar ndaj komuniteteve nga një grup i caktuar i kryerësve të vazhdueshëm të veprave penale.

#### *VII.4.5 Drejtësia për të mitur*

Drejtësia për të mitur është një fushë tjetër e procesit të drejtësisë penale ku akterë të ndryshëm të SDP-së kërkohen që të bashkëpunojnë për së

<sup>193</sup> Zyra për Reformën e Drejtësisë Penale, Puna e përbashkët për ta çrrënjësuar krimin dhe për të sjellë drejtësi (cituar në shënimin e 109-të më sipër), f. 40.

afërmi për përmbushjen e obligimeve të të drejtave të njeriut. Akterët dhe hisedarët kyç që kanë të bëjnë me drejtësinë penale zakonisht përfshijnë policinë, prokurorinë dhe gjykatat. Përveç kësaj, ata mund të përfshijnë një gamë të gjere të agjencive dhe akterëve si: punëtorët social dhe zyrtarët sprovues; autoritetet e pushtetit lokal; punonjësit që kujdesen për fëmijët dhe të rinjtë në institucionet e kujdesit dhe rehabilitimit; zyrtarët e burgjeve; ofruesit e shërbimeve që ofrojnë programe alternative për prokurorinë për fëmijët që kanë rënë ndesh me ligjin (ofruesit e shërbimeve të diverzionit); dhe punonjësit nga komuniteti. Për më tepër, për sa i përket proceseve të drejtësisë restorative dhe paneleve të përbëra nga personat laikë, qytetarët e zakonshëm mund të përfshihen në procesin e drejtësisë penale në rastet kur fëmijët janë të akuzuar për vepra penale.<sup>194</sup>

Parimet kyçe që duhet të udhëheqin zhvillimin dhe zbatimin e drejtësisë penale janë si në vijim:

- Fëmijët duhet të mbahen të ndarë nga të rriturit kurdo që privohen nga liria.
- Privimi i lirisë duhet të përdoret vetëm si mjet i fundit, dhe vetëm për periudhën më të shkurtër të mundshme.
- Fëmijët që kanë rënë ndesh me ligjin duhet të trajtohen në mënyrë të njëtrajtshme me promovimin e ndjenjës së dinjitetit dhe vlerës të fëmija, gjë që e përforcon respektin e fëmijës për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të tjerëve. Duhet të merret në konsideratë mosha e fëmijës dhe rëndësia e promovimit të riintegritit të tij/saj dhe inkurajimi i tij/saj për të marr rol konstruktiv në shoqëri.
- Duhet të vendosen masa për trajtimin e fëmijëve pa pasur nevojë që të shkohet nëpër procedura gjyqësore (diversioni, shih edhe kapitullin VII.3.2) me kusht që të drejtat e njeriut dhe garancitë ligjore të respektohen plotësisht.<sup>195</sup>

## VII.5 Llogaridhënia dhe Mbikëqyrja

Llogaridhënia nënkupton që institucionet e SDP-së – që nga sjellja e praktikuesve të një institucioni të drejtësisë penale deri te strategjitë për menaxhimin e procesit të drejtësisë penale; procedurat e emërimit apo menaxhimi i buxhetit – duhet të jenë të hapura për monitorim nga institucione të ndryshme të mbikëqyrjes.

---

<sup>194</sup> Cf. UNODC , ‘Çështjet e ndërthurura. Drejtësia për të mitur’ (cituar më lartë në shënimin 20 m ë lartë), p.1.

<sup>195</sup> Po aty, f. 4 dhe 9.



Legjislativi është përgjegjës për përkufizimin e kufijve të kornizave në bazë të së cilave veprojnë institucionet e SDP-së. Ekzekutivi (presidenti dhe apo kryeministri, ministrinë relevante, këshilltarët kombëtar të sigurisë, komisionet parlamentare) janë përgjegjëse për implementimin e kornizës së SDP-së; dhe gjyqësori e legjislativi janë përgjegjëse për të vlerësuar nëse korniza është zbatuar si duhet.

Përveç këtyre tre shtyllave mbikëqyrëse të shtetit, ekzistojnë struktura të ndryshme të jashtme joshtetërore që mund të luajnë rol në mbikëqyrjen e SDP-ve, si komisionet për të drejtat e njeriut, bordet shqyrtuese për ankesa nga qytetarët, ombudspersonët e pavarur, grupet e avokimit dhe mediat.<sup>196</sup>

Organizatat e shoqërisë civile mund të bëjnë lloje të ndryshme të aktiviteteve të mbikëqyrjes, si: hartimi i informatave dhe raportimi i shkeljeve të drejtave të njeriut dhe formave tjera të sjelljeve të pahijshme nga institucionet e SDP-së; shqyrtimi i ngarkesës me lëndë; monitorimi dhe raportimi i kushteve në vendet e paraburgimit dhe burgimit; marrja pjesë në gjykime dhe komentimi rreth tyre; dhe analizimi e raportimi për trendët e performancës së drejtësisë penale. (shembuj të aktiviteteve të tilla janë dhënë në paragrafët në vijim.)

### VII.5.1 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e policisë

Përveç inspektorateve të brendshme të policisë, institucionet e mbikëqyrjes së policisë mund të përfshijnë: Ekzekutivin (kontrollin policor, kontrollin financiar dhe mbikëqyrjen horizontale nga agjencitë qeveritare), legjislativin (deputetët e parlamentit, komisionet parlamentare për hetim) dhe gjyqësorin si dhe komisionet e të drejtave të njeriut, bordet e shqyrtimit të ankesave të qytetarëve dhe ombudspersonët e pavarur.

Hapat e reformës strukturore dhe organizative në nivelin strategjik dhe menaxherial për ta shtuar llogaridhënien e policisë mund të përfshijnë: zhvillimin e organogramëve dhe definimin e detyrave dhe përgjegjësi; sigurimin e pajisjeve (si ato themelore të zyrës, TI, intervistim dhe pajisje për vëzhgim dhe vetura); përmirësimin e personelit të përzgjedhjes dhe rekrutimit; dhe trajnimin e hetuesve lidhur me ligjet e aplikueshme, intervistimin dhe vëzhgimin, trajtimin e duhur, ruajtjen dhe mbajtjen e dosjeve dhe të dhënave konfidenciale, si dhe shkrimin e raporteve dhe përgatitjen e dosjeve të rastit (shih edhe kapitullin VII.1).

---

<sup>196</sup> Cf. OSCE, *libër udhëzues për punën policore demokratike*, (cituat më lartë në shënimin9), f. 39; dhe UNODC, *Doracaku për Llogaridhënien, Mbikëqyrjen dhe Integritetin e Policisë*, Seritë e Doracakut për Drejtësinë Penale, Nju Jork, 2011, në veçanti f. 93. Për shqyrtim tërësor lidhur me aspektet e mbikëqyrjes, shih gjithashtu:

<sup>^</sup>ngli, Madeline I., *Qeverisja dhe Mbikëqyrja e Sektorit të Sigurisë: Shënim lidhur me praktikat aktuale*, Henry L. Stimson Center, Uashington D.C., 12 dhjetor 2009.

Për ta përmbushur mandatin e tyre të mbikëqyrjes në mënyrë efektive, institucionet e brendshme dhe të jashtme kanë nevojë për burime të mjaftueshme, kompetenca ligjore dhe pavarësi nga ndikimi i ekzekutivit.<sup>197</sup>

Nevojiten kriteret kryesore strukturore në vijim për të pasur mekanizma efikas dhe efektiv të mbikëqyrës:

- Mekanizmat e jashtëm të mbikëqyrjes janë të autorizuar me ligj që të pranojnë ankesa nga çdo person.
- Policia kërkohet me ligj që t'ia raportojë mekanizmit përkatës të jashtëm mbikëqyrës të gjitha vdekjet e individëve në ndalim policor dhe vdekjet e shkatuara nga veprimet e policisë, për mos raportime dhe vonesa, duhet të shqiptohen dënime.
- Mekanizmi, kërkohet që t'i regjistrojë dhe gjurmojë ankesat dhe abuzimet dhe të mbajë të dhëna tërësore.
- Ky mekanizëm është i autorizuar që të bëjë hetime përkitazi me ankesat e pranuar.
- Ky mekanizëm përkatës, ka kompetenca që ta detyrojë policinë që të bashkëpunojë, përmes hetimeve që do t'i ndërmerr dhe ka kompetenca të plota të hetimit të ngjashme me ato të hetuesve policor.
- Ky mekanizëm, ka kompetenca që rastet t'i referojë për ndjekje penale te prokurori publik dhe të sugjerojë masa disiplinore për departamentin policor. Prokurorit do t'i duhet që t'i përgjigjet këtij mekanizmi brenda një afati të caktuar. Në rastet kur prokurori nuk do të ngritë aktakuzë, ai/ajo do të duhet që të jep shpjegim me shkrim te ky mekanizëm.
- Ky mekanizëm është në gjendje që forcës policore dhe qeverisë t'i propozojë masa të përgjithshme të reformimit lidhur me punën e policisë.<sup>198</sup>

Një element kyç mbikëqyrjes së jashtme efektive është marrëdhënia dinamike ndërmjet policisë, shoqërisë civile dhe organeve të mbikëqyrjes. Andaj, është e një rëndësie kritike që të bëhet vetëdijesimi i shoqërisë civile lidhur me të drejtat e tyre dhe shërbimet e sigurisë dhe drejtësisë që janë në dispozicion për ta, dhe të zhvillohen kapacitetet e organizatave të shoqërisë

---

<sup>197</sup> Cf. OSCE, *Libër udhëzues për punën policore demokratike*, (cituar më lartë në shënimin25), f. 39-42; dhe UNODC, *Doracaku për Llogaridhënien, Mbikëqyrjen dhe Integritetin e Policisë* (cituar më lartë në shënimin196), f. 93-99.

<sup>198</sup> CF. UNODC, *Doracaku për Llogaridhënien, Mbikëqyrjen dhe Integritetin e Policisë* (cituar më lartë në shënimin196), f. 69; kritere tjera janë përmendur në f. 70 të Doracakut.

civile për të ndërmarrë funksionin e tyre mbikëqyrës. Përveç sigurimit të burimeve, kompetencave ligjore dhe pavarësisë, atyre duhet t'u bëhen me dije procedurat specifike të mbikëqyrjes, përfshirë funksionet e monitorimit dhe mbikëqyrjes. Përveç kësaj, përmes përballjeve pozitive me institucionet e SDP-së, shoqëria civile duhet ta zhvillojë besimin në punën e strukturave të mbikëqyrjes dhe të ndjehet se ka besim/siguri për të bashkëpunuar me këta mekanizma të mbikëqyrjes.<sup>199</sup>

“Rritja e pjesëmarrjes së grave në mbikëqyrje ndihmon për t'u siguruar që ato janë – dhe perceptohen se janë – përfaqësuese, gjë që mund ta rrisë besimin e publikut dhe përgjegjësinë e mbikëqyrjes përballë brengave të qytetarëve. Përfshirja e shoqërisë civile me ekspertizë në çështjet gjinore, përfshirë organizatat e grave, organizatat e burrave dhe ekspertët gjinor, mund ta forcojë si sigurinë formale ashtu edhe atë joformale të mekanizmave të mbikëqyrjes.”<sup>200</sup>

Analiza e përgjithshme si nga organet e brendshme të mbikëqyrjes ashtu edhe bordet e jashtme të qytetarëve, mund të zbulojnë modele, pririje dhe probleme në rastet/ankesat e parashtruara para çdo organi. Informacioni i tillë, mund të gjenerojë ndryshim të politikave dhe rekomandimeve, si dhe miratim të strukturës së trajnimit dhe stimulimit, dhe të iniciojë veprime korrigjuese dhe reforma.

### VII.5.2 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e gjyqësorit

Mekanizmat formal të gjyqësorit mund të përfshijnë, komisionet e shërbimit gjyqësor, zyrën nacionale të avokatit të popullit apo komisioneve për të drejtat e njeriut.

Shoqëria civile mund të kontribuojë, për shembull, përmes pjesëmarrjes në komitetet lokale me përfaqësues të agjencive të drejtësisë për të shikuar ngarkesën me lëndë, dosjet individuale, apo gjendjen e të paraburgosurve,<sup>201</sup> apo përmes monitorimit të gjykimeve.

#### *Shqyrtimet e ngarkesës me lëndë*

<sup>199</sup> Cf. Hansen et al., *Tranzicioni në një rend të drejtë – Krijimi i pronësisë vendore pas konfliktit* (cituar më lartë në shënimin 51) f. 63ff.; dhe

<sup>200</sup> UNODC, *Doracak për Llogaridhënie dhe Policisë, Mbikëqyrja dhe Integriteti* (cituar më lartë në shënimin 196), f. 101-109.

<sup>201</sup> Valasek, Kristin, “Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia”, Mjeti 1, në: Bastick, Megan/Valasek, Kristin (eds.), *Libri praktik për çështjet gjinore dhe reformën e sektorit të sigurisë*, DCAF/ ODIHR/ Institutit ndërkombëtar për kërkim dhe trajnim për avancimin e gruas, Gjenevë 2008, f.10.

<sup>201</sup> Cf. UNODC/USIP, *Reforma e Drejtësisë Penale në shtetet pas konfliktit* (cituar më lartë në shënimin 9), f. 88f

Në rastet kur ekziston ngarkesë e dukshme me lëndë dhe kur burgjet janë të mbipopulluara, “zakonisht shumë pak mund të përfitohet me ndjekjen e rasteve më të lehta penale. Mirëpo, kjo nuk nënkupton që ato duhet të hedhen, por duhet të trajtohen në mënyra alternative.”<sup>202</sup> Grupet e shoqërisë civile dhe ndihmës juridike mund ta mbështesin SDP-në në zvogëlimin e ngarkesës me lëndë duke e përmbushur njëkohësisht një funksion të rëndësishëm mbikëqyrës duke i shqyrtuar lëndët individuale dhe statusin e të paraburgosurve dhe duke i bërë rekomandime prokurorit të përgjithshëm qoftë për hudhjen e akuzave në rastet e duhura<sup>203</sup> ose për lirimin e të dyshuarit me dorëzani apo në me masa tjera në pritje të gjykimit, duke e pasur para sysh që legjislacioni ia lejon një diskrecion të tillë prokurorit. Grupet e shoqërisë civile dhe ndihmës juridike, gjithashtu mund ta mbështesin SDP-në duke i vizituar burgjet dhe duke i kontrolluar të paraburgosurit për të identifikuar ata që kanë qëndruar më gjatë se që duhet apo janë mbajtur pa nevojë, dhe duke i referuar rastet e tyre në gjykata për ndërmarjen e veprimeve.<sup>204</sup> Për më tepër, ato gjithashtu mund të vendosin që t’i referojnë disa raste në sistemin zakonor/traditional gjyqësor kur një gjë e tillë është e mundshme; rastet tjera do të mund të zgjidheshin përmes programeve të diversionit (shih edhe kapitullin VII.3.2). Rastet tjera që nuk janë trajtuar në mënyrë alternative do të mbeteshin për t’u trajtuar nga gjykatat.

Këshilltarët e RSDP-së duhet të punojnë me agjencitë e drejtësisë dhe të konsultohen me këshilltarët vendor, grupet e shoqërisë civile dhe të ndihmës juridike, për të zhvilluar një proces të shoshitjes që e përcakton se cilat raste duhet të referohen apo të trajtohen përmes masave të diversionit. Një hap kyç në krijimin e një procesi të shoshitjes është arritja e marrëveshjes ndërmjet akterëve vendor dhe ndërkombëtar lidhur me kriteret që duhet përdorur për të vendosur se si do të trajtohen rastet.<sup>205</sup>

### *Monitorimi i objekteve të paraburgimit*

Një mekanizëm i rëndësishëm i mbikëqyrjes së jashtme të SDP-së, që kërkon bashkëpunim ndërmjet SDP-së dhe shoqërisë civile, është monitorimi i objekteve të paraburgimit nga organizatat e shoqërisë civile. Këto aktivitete të monitorimit mund të bëhen në objektet e policisë dhe qendrat e paraburgimit gjatë gjitha fazave të procedurës penale. Memorandumet e mirëkuptimit (MiM) ndërmjet institucioneve të SDP-së dhe organizatave të shoqërisë civile duhet të përkufizojnë modalitetet në bazë të së cilave do të bëhen vizitat monitoruese, ku përshkruhen përgjegjësitë dhe detyrat e personelit të SDP-ve dhe monitoruesve të objekteve të paraburgimit.

---

<sup>202</sup> Po aty, f 85.

<sup>203</sup> Po aty, f 87.

<sup>204</sup> Po aty, f 88.

<sup>205</sup> Po aty, f 85.

Monitoruesit, në bazë të marrëveshjeve që i bëjnë, lejohen që t'i vizitojnë këto objekte të paraburgimit me apo pa njoftim paraprak me qëllim të vërtetimit të asaj se a janë duke u zbatuar si duhet standardet dhe normat e të drejtave të personave që mbahen në paraburgim dhe praktikat më të mira në trajtimin e duhur të të paraburgosurve.

### *Shembuj të instrumenteve për monitorimin e objekteve të paraburgimit*

#### *Monitorimi i objekteve të paraburgimit nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK)*

Në bazë të konventave të Gjenevës, KNKK, ka mandat për t'i vizituar si të burgosurit e luftës ashtu edhe civilët e internuar gjatë konfliktit të armatosur. "Nëse është e mundur, KNKK gjithashtu i viziton personat e paraburgosur në situata tjera të dhunës. Vizitat e KNKK-së në objektet e paraburgimit synojnë që të sigurojnë që të paraburgosurit, pavarësisht arsyes për arrestimin dhe paraburgimin e tyre, të trajtohen me dinjitet dhe humanizëm, në pajtim me normat dhe standardet ndërkombëtare. Delegatët e KNKK-së punojnë me autoritetet për të parandaluar abuzimin dhe për ta përmirësuar si trajtimin e të paraburgosurve ashtu edhe kushtet në të cilat ata mbahen."<sup>206</sup>

#### *Monitorimi i objekteve të paraburgimit në Kirgizstan*

Në Kirgizstan, Qendra e OSBE-së në Bishkek (QiB) e ka lehtësuar nënshkrimin e një memorandumit të mirëkuptimit nga Zyra e Avokatit të Popullit, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Shërbimi Shtetëror për Ekzekutimin e Dënimeve (ShShED), Ministria e Drejtësisë, dhe 14 organizata kyçe dhe organizata lokale të shoqërisë civile (12 OJQ lokale të specializuara në monitorimin e objekteve të mbajtjes, Fondacioni Soros në Kirgizstan dhe Freedom House Kirgizstan). MiM-ja i lejon vizitat e paparalajmëruara në objektet e paraburgimit nga monitoruesit vendor për të drejtat e njeriut dhe zyrtarët e Avokatit të Popullit. QiB e ka lehtësuar monitorimin e përbashkët të objekteve të paraburgimit që menaxhohen nga MPB-ja dhe Shërbimi Shtetëror për Ekzekutimin e Dënimeve në kuadër të Qeverisë së Republikës Kirgize në tërë shtetin. Raporti i parë vjetor që i analizonte rezultatet e monitorimit dhe që jepte rekomandime të detajuara për të gjithë akterët relevant, u paraqit në dhjetor të vitit 2012.

<sup>206</sup> Komiteti ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq, Vizita e të paraburgosurve.

## *Monitorimi i Gjykimeve*

Monitorimi i gjykimeve bëhet në bazë të *Dokumentit të Kopenhagës së CSCE-së* në të cilin të gjitha shtetet pjesëmarrëse janë zotuar që t'i pranojnë monitoruesit e gjykatave si masë e ndërtimit të besimit dhe për ta siguruar transparencën në zbatimin e zotimeve të tyre për procedura gjyqësore të drejta dhe të lira, siç është paraparë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike.<sup>207</sup>

Monitorimi i gjykimeve mund të shërbejë për përmirësimin e administrimit efektiv dhe të drejtë të drejtësisë apo të jep vërejtje për mangësitë serioze. Me kalimin e kohës, monitorimi i gjykimit e bënë vetëdijësimin për të drejtën për gjykim publik brenda gjyqësorit dhe tek akterët tjerë të drejtësisë. Monitorimi i gjykimit mund t'i nxisë akterët e drejtësisë që t'i përmirësojnë praktikën e tyre, inkurajojë ekzekutivin që të sigurojë burimet e nevojshme për tejkalimin e mangësive në procesin e drejtësisë dhe ta inkurajojë legjislativin që të miratojë apo ndryshojë e plotësojë legjislacionin me qëllim që praktikën e drejtësisë t'i sjellë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut. Monitorimi i gjykimit në kuptimin e ngushtë, do të përqendrohet vetëm në procedurat publike të gjykatave dhe sjelljen e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe zyrtarëve tjerë gjyqësor të pranishëm nëpër gjykata. Monitorimi i gjykimeve në një aspekt më të gjerë gjithashtu do t'i adresojë mangësitë e institucioneve tjera të drejtësisë penale, siç është policia, organet e administratës gjyqësore dhe burgjet, standardi i performancës i së cilave në procesin e drejtësisë penale, mund të vjen në pah gjatë gjykimit.<sup>208</sup>

## *Shembull i një instrumenti të monitorimit të gjykimit*

### *Projekti i monitorimit të gjykimit në Kirgizstan*

Mes nëntorit 2004 dhe shtatorit 2006, ODIHR-i në bashkëpunim me Qendrën e OSBE-së në Bishkek dhe Gjykatën Supreme të Kirgizstanit, kanë ndërmarrë një projekt të monitorimit të gjykimeve në Kirgizstan. Pas përzgjedhjes dhe trajnimit nga OSBE/ODHIR në

<sup>207</sup> *Dokumenti i Kopenhagës, Takimi i Konferencës për Dimensionin Njerëzor të CSCE-së, Kopenhagë, 29 qershor 1990, paragrafi 12 dhe*

<sup>c</sup>f. CSCE, *Dokumenti i takimit të Kopenhagës nga konferenca për Dimensionin Njerëzor e CSCE-së, Kopenhagë, 29 qershor 1990, paragrafi 12; dhe*

<sup>p</sup>akti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (cituar më lartë në shënimin 82).

<sup>208</sup> Cf. ODIHR, *Monitorimi i gjykimit. Doracak referimi për praktikuesit, Botimi i rishikuar 2012, Varshavë, 2012, f. 16f.*

bazë të Doracakut të ODHIR-it për monitorimin e gjyqimeve, 19 persona me arsimim të lartë ligjor apo përvojë në të drejtat e njeriut, nga shkurti 2005 deri në prill të vitit 2006, kanë marrë pjesë në 1,134 seanca gjyqësore të shkallës së parë në 821 raste penale, në 26 distrikte dhe tri gjykata rajonale, të udhëhequra nga gjithsej 105 gjyqtarë.

Qëllimi kryesor i projektit ishte vlerësimi deri në të cilën masë praktika gjyqësore në rastet penale në Kirgizstan i plotësonte standardet ndërkombëtare për proces të drejtë gjyqësor, procesimi dhe analizimi i rezultateve të monitorimit, dhe zhvillimi i rekomandimeve me qëllim të përmirësimit të mëtutjeshëm të legjislacionit ekzistues të procedurës penale dhe zbatimit të legjislacionit në pajtim me standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë. Monitorimi është përqendruar veçanërisht në standardet e gjykimit të drejtë, si: sa të hapura janë seancat e gjykatës për publikun; prezumimi i pafajësisë; respektimi i parimit të barazisë së palëve në procedurë dhe procedurave akuzatore; dhe qasja te gjyqtarët, përfshirë të drejtën për ta mbrojtur vetën përmes avokatit mbrojtës.

Për të siguruar raportim të sistematizuar dhe të njëtrajtshëm, monitoruesit e gjyqimeve e kanë përdorur *Formularin e Raportimit për Monitorim të Gjyqimeve* të zhvilluar nga ODIR.<sup>209</sup> Për të promovuar qëndrueshmëri dhe pronësi vendore të nismave të monitorimit të gjykimit, ODHIR që atëherë ka ofruar ndërtim të kapaciteteve për organizatat joqeveritare kirgize dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut të përfshirë në monitorim, në bazë të mjeteve metodologjike që kanë shërbyer si bazë për *Doracakun e monitorimit të gjyqimeve të ODHIR-it*.<sup>210</sup>

<sup>209</sup> Gjetjet dhe rekomandimet e projektit për monitorimin e gjyqimeve, si dhe Formulari për raportimin e monitorimit të gjyqimeve dhe doracaku për monitorim të gjyqimeve, zhvilluar nga ODHIR, mund të gjenden në raportin në vijim: OSBE ODHIR/Qendra në Bishkek, *Rezultatet e monitorimit të gjyqimeve në Republikën e Kirgize. 2005-2006*

<sup>210</sup> OSCE ODIHR, *Monitorimi i gjyqimeve: Doracak referimi për praktikuesit*, Varshavë 2008. Një version i rishikuar i dokumentit është publikuar në vitin 2012, shih shënimin 208. Për më tepër, në vitin 2012, ODHIR e ka publikuar një *Përmbledhje ligjore të së drejtave për proces të rregullt gjyqësor*; e cila e plotëson *Doracakun e referimit. Përmbledhja ligjore* siguron përshkrim tërësor të drejtave për një proces të rregullt të kombinuara me listat praktike të kontrollimit të bazuara në përvojën e operacioneve të monitorimit të gjyqimeve nga OSBE-ja. Për më tepër informata, shih OSCE ODHIR, *Përmbledhja ligjore e gjykimit të drejtë ndërkombëtar*, Varshavë 2012

### VII.5.3 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e sistemit të burgjeve

“ Në sistemin e burgjeve, duhet të ketë mekanizma të pavarur të inspektimit. Në shumë shtete, një organ i vizitorëve të burgjeve lejohet që të ketë qasje për të kryer inspektime periodike. Këshilltarët duhet të diskutojnë me autoritetet e burgut lidhur me përfitimet e një mekanizmi të tillë si mjet i fuqishëm i avokimit për reformimin e burgut dhe përmirësimin e kushteve të burgut në të gjitha aspektet. Inspektimi i rregullt i burgjeve është kriter i Rregullave standarde minimale për trajtimin e të burgosurve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Rregulli 55).”<sup>211</sup> Inspektimet e burgjeve janë esenciale për përmirësimin e kushteve të jetesës së të burgosurve dhe në veçanti për parandalimin e abuzimeve dhe zvogëlimin e korrupsionit, të cilat kanë gjasa të jenë të pranishme në masë të madhe në shtetet që dalin nga konflikti.

### VII.5.4 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e shërbimeve joshtetërore të sigurisë

Llogaridhënia e shërbimeve private civile të sigurisë do të mund të forcohej përmes sistemeve të licensimit dhe mbikëqyrjes nga policia.<sup>212</sup> Shtetet gjithashtu mund të “marrin në konsideratë inkurajimin e OJQ-ve relevante për të luajtur rolin e tyre në mbikëqyrjen e shërbimeve private civile të sigurisë, *ndër të tjera*, duke identifikuar dhe parandaluar çfarëdo abuzimi të kryer nga personeli dhe ofruesit e shërbimeve private të sigurisë [...]. Pa paragjykim ndaj procedurave të zakonshme të sistemit të drejtësisë penale, shtetet mund ta shqyrtojnë mundësinë për nënshttrimin e shërbimeve private civile të sigurisë dhe personelit të tyre ndaj procedurave që kanë të bëjnë me pranimin dhe hetimin e ankesave ndaj tyre. Për ta arritur këtë ato mund të shqyrtojnë mundësinë e:

- (a) Krijimit të mekanizmave për pranimin dhe hetimin e paanshëm të ankesave nga cilido person kundër personelit dhe ofruesve të shërbimeve private të sigurisë;
- (b) Përcaktimit të llojit të ankesave që ato mekanizma do të mund t’iu nënshtrohen;
- (c) Shfrytëzimit të një organi të paanshëm për të përcaktuar fajësinë dhe dënimet për ankesat më të rënda dhe krijimit të procesit të

---

<sup>211</sup> UNODC/USIP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet që dalin nga konflikti* (cituar më lartë në shënimin 9), f. 101.

<sup>212</sup> Cf. UNODC, *Shërbimet civile të sigurimit privat* (cituar më lartë në shënimin 13), f. 7; dhe Angli, *Qeverisja dhe mbikëqyrja e sektorit të sigurisë* (cituar më lartë në shënimin 196), f. 25



duhur të apelit;

- (d) Publikimit të dispozitave të tilla ekzistuese;
- (e) Garantimit që rastet e rënda do të ndiqen në kuadër të sistemit të drejtësisë penale [...].<sup>213</sup>

### ***VII.5.5 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e ofruesve zakonor/tradicional të drejtësisë***

Llogaridhënia dhe mbikëqyrja e ofruesve zakonor/tradicional të drejtësisë duhet të sigurohet nga Ministria e Drejtësisë. Kjo arrihet përmes zhvillimit të procedurave për përcjelljen e vendimeve të tyre dhe regjistrimit të tyre në kuadër të Ministrisë dhe duke u siguruar që vendimet e ofruesve zakonor/tradicional të drejtësisë të mund të apelojnë në gjykatat e rregullta<sup>214</sup>dhe t'i nënshtrohen kontrollimit për pajtueshmëri me të drejtën kombëtare dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Për më tepër, mekanizmat për monitorim dhe vlerësim duhet të themelohen për ta siguruar cilësinë e shërbimeve joshtetërore të ndihmës juridike.<sup>215</sup>

### ***VII.5.6 Ballafaqimi i llogaridhënies dhe mbikëqyrjes me SDP-në***

Siç u përmend më lart, gjyqësori është përgjegjës për të vlerësuar nëse institucione të ndryshme të SDP-së janë duke e zbatuar si duhet kornizën për veprimet e tyre, p.sh. detyrat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Policia duhet t'i respektojë urdhrat e gjykatës përkitazi me arrestimin dhe lirin e individëve dhe të kërkojë autorizim nga gjyqtari hetues për përdorimin e masave të caktuara hetimore.

Për më tepër, "gjyqësori është mjeti kryesor i llogaridhënies ligjore për sjellje të pahijshme të forcave të sigurisë. Roli i tij është që të shqyrtojë rastet e ngritura nga shërbimet e sigurisë dhe punonjësit individual, të mbrojtë të drejtat e njeriut, përkrahë sundimin e ligjit, monitorojë kompetencat e posaçme të shërbimeve të sigurisë, të vlerësojë kushtetutshmërinë, sigurojë mjete efektive juridike, dhe rishikojë politikat e ofruesve të sigurisë dhe

---

<sup>213</sup> UNODC, *Raporti mbi takimin e grupit të ekspertëve për shërbimet e sigurisë* (cituar më lartë në shënimin 142), ff. 4-6

<sup>214</sup> Cf. Angli, *Menaxhimi i sektorit të sigurisë: Shënim për praktikatat aktuale*, Qendra Henry L. Stimson, Uashington D.C., 12 dhjetor 2009, f. 5.

<sup>215</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Parimet dhe udhëzimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për qasjen në ndihmën juridike në sistemet e drejtësisë penale* (cituar më lartë në shënimin 81), Par 70 (c), f. 20.

drejtësisë në kontekstin e ndjekjeve.”<sup>216</sup> Në rastet kur policia e gjen vetën e tyre nën hetime penale (dhe procedura civile), duhet të ekzistojnë mekanizma për të siguruar që marrëdhëniet e afërta rutinore ndërmjet policisë dhe prokurorisë në procedurat standarde penale, të mos e minojnë pavarësinë dhe paanësinë e prokurorit kur ai të merret me sjelljet e pahijshme të policisë.<sup>217</sup>

Natyrisht, mekanizmat duhet krijuar edhe për të siguruar integritetin e gjyqësorit.<sup>218</sup>

Në fund, SDP-ja duhet të sigurojë që nuk ka ndërhyrje politike në çështjet operative të cilat do institucion të SDP-së. Ndërhyrja politike mund të jetë e pranueshme vetëm për sa i përket emërimit të pozitave më të larta në SDP.

### *Matja e performancës*

Edhe llogaridhënia e SDP-së gjithashtu sigurohet përmes matjes transparente të performancës së SDP-së. Tregues specifik të performancës së institucioneve të ndryshme të SDP-së mund të përfshijnë të dhënat cilësore si: perceptimin publik të cilësisë së ofrimit të shërbimit; qasjen në siguri dhe drejtësi; nivelin e besimit të publikut në institucionet e SDP-së; dhe të dhënat nga anketat e viktimizimit. Kur të bëhen anketa publike, është me rëndësi që të mos neglizhohen individët e marginalizuar pasi që ata mund të përballen me barrierat më të mëdha për qasjen në drejtësi derisa viktimizohen në masë disproporcionalisht më të madhe.<sup>219</sup>

Besueshmëria dhe vlefshmëria e të dhënave sasiore siç janë veprat penale të raportuara dhe shkallët e dënimeve, vihen shpesh në pikëpyetje,<sup>220</sup> andaj dhe

---

<sup>216</sup> Cf. Angli, *Menaxhimi i sektorit të sigurisë* (cituar më lartë në shënimin 196), f. 24; shih gjithashtu

<sup>KAZh, KAZh OBZhE Doracak për reformën në sistemin e sigurisë</sup> (cituar më lartë në shënimin 19628), f. 113.

<sup>217</sup> Cf. UNODC, *Doracaku për Llogaridhënen, Mbikëqyrjen dhe Integritetin e policisë* (cituar më lartë në shënimin 196), p. 99; dhe

<sup>Uiser, Dominique, Qeverisja e Policisë: Praktikrat më të mira të Bashkimit Evropian, DCAF, COGINTA, 2011, f. 32</sup>

<sup>218</sup> Këta mekanizma duhet të jenë në pajtim me *Parimet Bangalore për sjelljen gjyqësore* të Organizatës së Kombeve të Bashkuara; *Udhëzimet për rolin e Prokurorëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*; dhe *Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit* të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Për më shumë informata shih edhe UNODC, *Udhëzues Burimor për Forcimin e Integritetit dhe Kapaciteteve Gjyqësore*, Nju Jork 2011.

<sup>219</sup> Cf. Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Treguesit e Sundimit të Ligjit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Udhëzues për zbatim dhe Mjetet e Projektit*, DPKO/OHCHR, Nju Jork 2011, ff. 3f.

<sup>220</sup> Për shembull, shkalla e ulët e krimit mund të jetë rezultat i mungesës së raportimit të krimeve nga publiku për shkak të pritjeve të ulëta të reagimit të duhur nga SDP, derisa rritja e shkallës së raportimit mund të jetë rezultat i rritjes së motivimit të popullatës për raportimin e krimit për shkak të rritjes së besimit në SDP-të. Për më tepër, shkallët e larta të dënueshmërisë mund të jenë rezultat i dënimeve të bazuara në pranimin e fajësisë që mund të jetë nxjerrë përmes torturës.

nuk duhet të përdoren si tregues kyç për performancën e SDP-së.

Për sa i përket qasjes tërësore të reformës së SDP-së, një masë specifike për të adresuar ballafaqimin ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së do të ishte zhvillimi i standardeve të përbashkëta të performancës dhe masave të realizimit për proceset e ngritjes së akuzave në bazë të ligjit.<sup>221</sup> Një sistemi i menaxhimit të lëndëve i cili është në gjendje që ta tregojë numrin e lëndëve të shqyrtuara dhe atyre të përfunduara do të mund të ishte i dobishëm për identifikimin e vendeve ku po pengohet rrjedha e lëndëve në procesin e drejtësisë penale dhe mbajtjen përgjegjëse të akterëve individual të SDP-së për punën e tyre (shih edhe kapitullin VII.1.2).<sup>222</sup> Mirëpo, përqendrimi i tepërt në statistika, prapë, mund të ketë pasoja negative për tërë procesin e drejtësisë penale. Për shembull, treguesi i performancës “shkalla e zvogëlimit të lëndëve” e cila e matë performancën e ndjekjes duke u përqendruar në numrat e shfaqësimeve, mos-vazhdimin apo hudhjen e lëndëve, mund ta detyrojë prokurorin që të kërkojë më shumë prova nga policia se që është e nevojshme, gjë që përfshinë më tepër punë me dokumente dhe vonim apo hudhje të akuzave. Ndikimi i një lloji të tillë të rrezikut nga shërbimi i prokurorisë mund të shpie edhe në konflikt me policinë.<sup>223</sup> Përveç kësaj, ndërprerja e hetimeve penale, për shkak të mungesës së provave apo paraqitja e alternativave tjera ndaj ndjekjes (për shembull programet e diversionit apo proceset e ndërmjetësimit (shih edhe kapitullin VII.3)), nuk duhet të konsiderohen automatikisht si dështim profesional nga prokurori, dhe të shpijnë në vlerësim negativ të performancës.<sup>224</sup>

### *Shembull i Instrumentit të matjes së performancës së SDP-së*

#### *Treguesit e Sundimit të Ligjit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*

Në vitin 2011, Organizata e Kombeve të Bashkuara i ka lansuar *Treguesit e Sundimit të Ligjit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara* si mjet për monitorimin e ndryshimeve në performancë dhe karakteristikat e institucioneve nacionale të drejtësisë penale.

<sup>221</sup> Cf. Berry, *Zvogëlimi i burokracisë në punën policore* (cituar më lartë në shënimin105), f. 15.

<sup>222</sup> Cf. USAID Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm, *Auditimi i Programit të Drejtësisë së USAID/Haiti* (cituar më lartë në shënimin116), f. 9f.

<sup>223</sup> Cf. Flanagan, SirRonnie, *Rishikimi i Raportit përfundimtar të Punës së Policisë*, 2008, f. 60.

<sup>224</sup> Cf. OSCE ODIHR, *Forumi i III-të i ekspertëve të drejtësisë penale për Azinë Qendrore* (cituar më lartë në shënimin164), f. 9 dhe 22

Ky dokument gjithëpërfshirës udhëzues i paraqet 135 tregues për matjen e këtyre ndryshimeve në tri institucione të SDP-së – polici, gjyqësi dhe burgje. Përveç performancës së tri institucioneve të SDP-së, udhëzimet gjithashtu sigurojnë tregues për matjen e: integritetit, transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të SDP-së; trajtimit të anëtarëve të grupeve të cenueshme nga institucionet e SDP-së; dhe nivelit të kapaciteteve të institucioneve të SDP-së për kryerjen e funksioneve të tyre. Udhëzimet gjithashtu sigurojnë informata për atë se si të bëhen vlerësime dhe si të sigurohen formularët për bërjen e anketave.<sup>225</sup>

## VII.6 Ndryshimet në SDP

Të gjitha ndryshimet strukturore dhe organizative në nivel menaxherial dhe operativ, në pajtim me ligjet e reja, politikat dhe rregulloret, do të kenë pak ndikim pa një *kulturë*<sup>226</sup> të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve të SDP-së.

Në shumë shtete, veçanërisht në shoqëritë që dalin nga konflikti dhe shtetet në tranzicion, ekziston nivel i lartë i mosbesimit ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së, i nxitur nga mungesa e mirëkuptimit dhe vlerësimit të rolit, përgjegjësive dhe nevojave të institucioneve tjera të SDP-së,<sup>227</sup> pikëpamjet e ndryshme për esencën e rendit dhe ligjit,<sup>228</sup> dhe perceptimi i dyanshëm i jokompetencës, mosreagimit e bile edhe korrupsionit.<sup>229</sup>

Nëse kërkesa për rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit i sfidon marrëdhëniet e kompetencave ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së, duhet të pritret rezistencë nga ana “humbëse”. Policia apo prokurorët

<sup>225</sup> Cf. Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Treguesit e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Udhëzues për Implementim dhe mjete të zbatimit* (cituar më lartë në shënimin 219). Ndonëse këta 135 tregues janë shumë të rëndësishëm dhe të dobishëm për matjen e performancës dhe karakteristikave tjera të tri institucioneve kryesore të SDP-së, ato nuk i adresojnë ndërveprimet ndërmjet tri institucioneve të SDP-së që do të mund t'i identifikonin vendet ku ngushtohet rrjedha e lëndëve në procesin e drejtësisë penale.

<sup>226</sup> Në pajtim me përkufizimin e dhënë në *Doracakun e DCAF-it për integritetin e policisë*, kultura duhet të përkufizohet këtu si “model i supozimeve themelore (vlerave, parimeve themelore) që një grup i individëve i kanë zhvilluar duke i zgjidhur problemet e përshtatjes me botën e jashtme si dhe duke e integruar botën e tyre”; DCAF, *Doraku për Integritetin e Policisë*, Gjenevë 2012, f. 59.

<sup>227</sup> Cf. Qendra për Qeverisje Ndërkombëtare dhe Inovacion, *Afganistan, Monitorimi i reformës së sektorit të sigurisë*, Nr.4, shtator 2010, f.12.

<sup>228</sup> Cf. Downes, Mark/Keane, Rory, *Reforma e sektorit të sigurisë i ka zbatuar: Nëntë mënyrë për të kaluar nga politikat në zbatim*, Instituti ndërkombëtar për paqe, Dokumentet për politika, Nju Jork/Vjenë, Shkurt 2012, f. 6.

<sup>229</sup> Cf. Qendra për Qeverisje Ndërkombëtare dhe Inovacion, *Afganistani* (cituar më lartë në shënimin 227), f. 12.

gjithashtu mund të ngurojnë që t'i pranojnë ndryshimet, veçanërisht nëse përgjegjësitë për hetime janë transferuar nga njëra organizatë te tjetra.

Për më tepër, interpretimet e caktuara të doktrinës së ndarjes së pushteteve që e mbështesin kërkesën e gjyqësorit për pavarësi nga qeveria ekzekutive, shpesh e pengojnë frymën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet gjykatave dhe institucioneve tjera të SDP-së.<sup>230</sup>

Kultura e punës e institucioneve të SDP-së jo vetëm që duhet të ndryshohet për sa i përket qëndrimeve të bashkëpunimit të brendshëm të SDP-së, por edhe për sa i përket ndërveprimit me publikun. Ndonëse agjencitë policore shpesh e promovojnë publikisht idenë e partneritetit ndërmjet publikut dhe policisë në retorikën e punës së policisë në komunitet, 'realiteti i një ndërveprimi të tillë është që ata janë asimetrik, ku policia vepron më tepër nga perspektiva e marrëdhënieve me publikun se sa nga ajo e angazhimit të publikut'.<sup>231</sup> Mirëpo, për ta inkurajuar publikun që ta ndajë përgjegjësinë për rritjen e cilësisë së jetesës së komunitetit duke ofruar kështu mbështetje aktive për policinë në përpjekjet e saj për të kontrolluar dhe parandaluar krimin, policia duhet të synojë ndërtimin e partneritetit të vërtetë me publikun, të karakterizuar me reagim në baza të barabarta nga të dy partnerët (shih edhe kapitullin VII.3). Andaj, policia duhet të pajtohet për të pasur një dialog me dy kahje me publikun, në bazë të njohurive të këmbëza dhe vendimmarrjes së barabartë dhe vendosjes së prioritetëve të drejtave – të barabarta përderisa ligjet nacionale dhe nevojat operative i lejojnë ato në mënyrë të arsyeshme.<sup>232</sup> Gatishmëria për ta pranuar publikun si partner të jashtëm gjithashtu varet nga ndryshimi në mentalitetin dhe qëndrimet e policisë në drejtim të asaj që të mos reagojnë tepër ndaj kritikave të publikut lidhur me punën e tyre policore<sup>233</sup> dhe bëra më të hapur dhe miratimi i parimeve demokratike të llogaridhënies dhe transparencës në punën policore. Do të ketë më pak arsye për kritika të publikut nëse mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve dhe zyrtarëve policor theksohen në nismat për ndryshimin e kulturës së punës.

Ndryshimi i kulturës së punës së institucioneve të SDP-së mund të jetë detyrë sfiduese. Institucionet e SDP-së, në përgjithësi, janë shpesh qenësisht konservatore; për më tepër, rolet e ndara në shoqëri, aranzhimet organizative dhe qëndrimet e punës së personelit të SDP-së mund të jenë

<sup>230</sup> Cf. Berry, *Njësitë e drejtësisë penale dhe ndërtimi i rasteve* (cituar më lartë në shënimin100), p. 1.

<sup>231</sup> Greene, Jack R., *Kryerja e punës policore përmes të drejtave të njeriut*, Idetë në Fondacionin Amerikan të punës policore, nr.13, dhjetor 2010, f. 14.

<sup>232</sup> Cf. OSCE, *Praktikat e mira në ndërtimin e partneriteteve ndërmjet policisë dhe publikut* (cituar më lartë në shënimin 86), f. 22, 54 dhe 65.

<sup>233</sup> Cf. Greene, *Puna policore përmes të drejtave të njeriut* (cituar më lartë në shënimin231), f. 14.

të rrënjosura thellë dhe të vështira për t'u ndryshuar.<sup>234</sup>

Ndryshimi i kulturës së punës së institucioneve të SDP-së kërkon qasje të menaxhimit të shëndoshë e cila i merr në konsideratë si në vijim: rezistencën e qenësishme ndaj ndryshimit si nga individët ashtu edhe nga organizatat; identifikimin dhe mbështetjen e shtytësve të ndryshimit si dhe vënien nën kontroll të plan-prishësve potencialë; komunikimin mes gjitha institucioneve të SDP-së përkitazi me nevojën për ndryshim dhe përfitimet potenciale për të gjithë akterët për sa i përket rolit të akterëve të ndryshëm të SDP-së në zbatimin e ndryshimeve. Kjo e fundit do të përfshijë edhe nxjerrjen e procedurave standarde të veprimit dhe ofrimin e trajnimit për vënien e tyre në funksion.<sup>235</sup>

Ndryshimi i kulturës së punës do të kërkojë koalicion efektiv dhe të fuqishëm ndërmjet institucioneve të SDP-së të cilat do ta promovojnë ndryshimin, qartësojnë vizionin, dhe krijojnë ndjenjën e urgjencës.

### *Shembull i menaxhimit të ndryshimit kulturor në polici*

#### *Ndryshimet kulturore në policinë e Serbisë*

Strategjia e re për zhvillim e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë e miratuar në vitin 2011, në mënyrë të hollësishme i thekson, ndër të tjera, ndryshimet organizative dhe ndryshimet në menaxhim, duke paraparë:

- Menaxhim të ri strategjik dhe qasje të re të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Një partneritet të ri me akterët shtetëror, në veçanti prokurorët dhe doganat, dhe shërbimet private të sigurisë dhe shoqërinë civile;

<sup>234</sup> Cf. UNODC/USIP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti* (citar më lartë në shënimin 9), f. 73;

<sup>M</sup>arenin, Otwin, “Qëllimi i demokracisë në programet ndërkombëtare të asistencës policore”, *Puna policore: Revistë ndërkombëtare e Strategjive dhe Menaxhimit Policor*, Vëll. 21 botimi: 1 1998, ff.159-177, këtu f. 160; dhe

<sup>U</sup>NDP, *Reforma e sektorit të drejtësisë dhe sigurisë. Qasja programatike e BCPR-së*, Nëntor 2002, ff. 16f.

<sup>235</sup> Cf. UNODC/USIP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti* (citar më lartë në shënimin 9), f. 30f. dhe 50; dhe

<sup>O</sup>ECD, *OECD DAC Doracaku për Reformën e Sistemit të Sigurisë* (citar më lartë në shënimin 28), f. 82.

- Shtim t ë punës së policisë në komunitet; dhe
- Themelim të sistemeve të shëndosha të transparencës, kontrollit të brendshëm dhe auditimit, dhe kontrollit civil.

Për t'i arritur këto synime të vendosura lartë, Kabineti i Ministrit, në veçanti përmes Byrosë së tij për planifikim strategjik, e ka filluar procesin e ndryshimit të kulturës organizative në Ministri. Në partneritet me OSBE-në, DCAF-in Qeveritë e Suedisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, janë duke u zbatuar disa projekte për menaxhim strategjik, komunikim horizontal, dhe menaxhim të burimeve njerëzore, ku që të gjitha synojnë krijimin e një kornize normative dhe kulturore për reformim.

Një kulturë e re e punës që promovon rëndësinë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të udhëheqësive të ndryshme të SDP-së, përfshirë qëndrimet dhe sjelljen e personelit të tyre, mund të jetë efektive vetëm kur të bëhet pjesë përbërëse e jetës së përditshme dhe kur të njihet si vlerë themelore për tërë SDP-në. Për ta arritur këtë, menaxherët duhet të udhëheqin me shembullin e tyre personal.<sup>236</sup>

## VII.7 Trajnimi dhe zhvillimi profesional

Siç është cekur më lartë, masat e reformës strukturore dhe organizative për përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet institucioneve të ndryshme të SDP-së do të kenë ndikim afatgjatë vetëm nëse plotësohen me masat për ndryshimin e kulturës së punës brenda institucioneve të ndryshme të SDP-së. Për ta ndryshuar kulturën, përfshirë qëndrimet dhe sjelljen e praktikuesve të SDP-së, nxjerrja e politikave, kodeve të mirësjelljes dhe PSV-ve, dhe artikulli i rregullt dhe i vazhdueshëm i vlerave përkatëse nga menaxhmenti duhet të plotësohet me trajnim të vazhdueshëm dhe trajnim në punë si dhe aktivitete të zhvillimit profesional. Në procesin e zhvillimit profesional, mbikëqyrësit, përmes monitorimit, inkurajimit, shpërblimit dhe veprimit disiplinor, mund t'i shtojnë dhe mbajnë ndryshimet e tilla te personeli i tyre dhe të sigurojnë sjelljet e duhura. Përqendrimi në sjelljet në punë në vend të sjelljeve në klasë e bënë të mundshme që të ndikohen sjelljet e personelit në situata të vërteta jetësore. Ndryshimi i vlerave dhe

<sup>236</sup> Cf. Coxhead, John, *Përmirësimi i performancës në çështjet e racës dhe diversitetit*, Lambard Academic Publishing, 2009, Kapitulli 6.

qëndrimeve, përfshirë stereotipet që shpesh janë thellë të rrënjosura tek të rriturit, është veçanërisht sfidues dhe kërkon trajnues të shkathët dhe procese afatgjata.<sup>237</sup>

Për sa i përket qasjes tërësore të RSDP-së në fushën e trajnimit, praktikuesit e SDP-së duhet të pajisen me njohuri për kodet e procedurës penale të cilat i rregullojnë rolet dhe paraqesin rregullat, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme të SDP-së. Kjo është esenciale për vetëdijesimin lidhur me nevojat e të gjithë akterëve të SDP-së që ndërveprojnë me njëri tjetrin për ta bërë procesin e drejtësisë efektiv dhe efikas. Përkitazi me ndryshimin e kulturës së punës, ushtrimet e ndërtimit ekipor ndërmjet agjencive gjatë ngjarjeve të përbashkëta trajnuese gjithashtu mund të ketë vlerë të madhe.

Për më tepër, mund të merret në konsideratë ndonjë strategji për t'i caktuar policët dhe prokurorët si “pjesëmarrës në trajnim” apo “vizitues profesional” për periudha të shkurtra nëpër departamentet e hetimeve të institucioneve tjera të drejtësisë penale.<sup>238</sup> Do të ishte ideale sikur hetuesit policor dhe prokurorët të marrin diploma që gërshetojnë edhe punën policore dhe atë ligjore si pjesë e arsimimit të tyre akademik.

### *Shembulli i arsimimit të kombinuar të punës policore dhe ligjore*

#### *Arsimim ligjor për policët hetues në Bullgari*

Në Bullgari është e detyrueshme që të gjithë hetuesit të kenë nivel masteri në drejtësi dhe ta kalojnë një provim para komisionit të Ministrisë së Drejtësisë. Me këtë njohuri të perspektivës gjyqësore lidhur me procesin e drejtësisë penale, hetuesit policor mund t'i përshtatin më mirë masat e tyre hetimore me nevojën për ndjekje, gjë që mund ta rrisë bashkëpunimin në masë të madhe.

<sup>237</sup> Cf. OSCE, *Udhëzues për punën policore demokratike* (cituar më lartë në shënimin25), ff. 50 dhe 57; dhe

<sup>238</sup> Cf. Berry, *Njësitë e drejtësisë penale dhe ndërtimi i rasteve* (cituar më lartë në shënimin151), f. 80-84.

<sup>238</sup> Cf. Berry, *Njësitë e drejtësisë penale dhe ndërtimi i rasteve* (cituar më lartë në shënimin100), f. 4.



Trajnimi duhet gjithashtu të adresojë kriteret për rritjen e bashkëpunimit të SDP-së me ofruesit jo-shtetëror të sigurisë dhe drejtësisë si dhe me shoqërinë civile. Për ta rritur këtë vetëdije te akterët e procesit të drejtësisë penale, do të ishte e dobishme që të ofrohet trajnimi i tillë për pjesëmarrës të përzier të përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme të SDP-së, shoqërisë civile dhe ofruesve jo-shtetëror të sigurisë dhe drejtësisë.

### *VII.7.1 Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të SDP-së*

Temat e përgjithshme të ndërthurura të trajnimit për bashkëpunim dhe bashkërendim ndërmjet institucioneve të SDP-së do të mund të përfshinin menaxhimin e përgjithshëm dhe trajnimin për zhvillim ekzekutiv si dhe metodat e bashkëpunimit ndërmjet agjencive, përfshirë ndërtimin e rasteve që duhet të shkojnë në gjykim.<sup>239</sup> Kjo e fundit gjithashtu duhet të përfshijë zhvillimin e të kuptuarit të përgjithshëm të veprave penale dhe klasifikimin e rasteve nga hetuesit policor dhe prokurorët për të shmangur papajtueshmëritë dhe dallimet në raportimin dhe përgatitjen e dosjeve të lëndëve. Standarde të ndryshme në mbledhjen e provave dhe sekustrimin e pasurive e në veçanti në vlerësimin e provave, mund të kontribuojnë në hutinë rreth mbledhjes së provave, dhe në dyshimet dhe keqkuptimet ndërmjet policisë dhe prokurorëve. Policia, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të trajnohen për t'i kuptuar elementet e të provuarit, siç janë përkufizuar nga e drejta penale, gjë që është e nevojshme për ndjekjen e veprave penale, kryerjen e hetimeve dhe analizimin e provave të mbledhura në pajtim me këto elemente.<sup>240</sup>

Rekomandohet trajnim i përbashkët i specializuar për praktikuesit e drejtësisë penale për trajtimin e veprave specifike penale, si sulmi seksual, dhuna në familje, trafikimi i personave, drogat e paligjshme dhe prekusorët e tyre, krimet ekonomike, krimet financiare, përfshirë shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, korrupsionin dhe krimin kibernetik. Njësi të specializuara në kuadër të policisë dhe prokurorisë që janë të përkushtuara për luftimin e krimeve specifike, përfshirë çështjet ligjore dhe faktike që janë të veçanta për këtë lloj specifik të veprës penale, që kanë pranuar trajnim të përbashkët të specializuar, janë dëshmuar si efektive në gjenerimin e rasteve të cilësisë së lartë që kanë rezultuar në ndëshkime dhe dënime

---

<sup>239</sup> Cf. Hudzik, John K., “Planifikimi gjithëpërfshirës i drejtësisë penale” (cituar më lartë në shënimin 123), p. 10; dhe UNDP, *Reforma në sektorin e sigurisë dhe drejtësisë* (cituar më lartë në shënimin 234), f. 23.

<sup>240</sup> Cf. Moskowitz, *Sfidat dhe prioritetet në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të trafikimit me njerëz* (cituar më lartë në shënimin 124), f. 5.

adekuate.<sup>241</sup>

Bashkëndimi dhe bashkëpunimi në fushën e trajnimit gjithashtu duhet të kërkohet në rastet ku përgjegjësitë për hetuesit janë transferuar nga një agjenci e SDP-së në një tjetër, për shembull, nga prokuroria te policia. Hetuesit nga agjencia që më parë ka qenë e mandatuar për t'i bërë hetimet duhet t'ua bartin shkathësitë dhe njohurinë e tyre hetuesve të agjencisë që tani e ka mandatin për t'i bërë hetimet. Kjo gjithashtu mund të përfshijë mentorim të kolegëve nga agjencia tjetër për një kohë të caktuar.

Me qëllim të luftimit efektiv të krimit të organizuar transnacional dhe zbatimit të UNTOC-së dhe konventave tjera për luftimin e krimit të organizuar (shih edhe kapitullin V.1), është gjithashtu e rëndësishme që të sigurohen nisma të përbashkëta të trajnimit për institucione të ndryshme të SDP-së nga shtete të ndryshme.

*Shembuj të hetimeve të përbashkëta të specializuara për luftimin e krimit të organizuar*

#### *Krimi Kibernetik*

Në vitin 2008, Misioni i OSBE-së në Mal të Zi e ka ndihmuar Drejtorinë Malazeze të Policisë në zhvillimin profesional dhe ndërtimin e kapaciteteve në sektorin penal të policisë duke siguruar program të trajnimit themelor për krimin kibernetik që përqendrohej në mashtrimet me kartelat e kreditit. Trajnimi është mbajtur për dhjetë zyrtarë policor nga Departamenti i Krimeve Ekonomike dhe Divizioni për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit si dhe tre prokurorë nga Prokuroria e Malit të Zi.

Në vitin 2011, SPMU-ja e OSBE-së në bashkëpunim me Njësinë për Sundimin e Ligjit pranë Misionit të OSBE-së në Serbi, kanë qenë nikoqire të "Punëtorisë rajonale për forenzikën kompjuterike dhe provat dixhitale për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët në Evropën Juglindore" në Beograd, Serbi. Punëtorja për mbikëqyrësit policor, prokurorët e nivelit të apelit dhe gjyqtarët përbëhej nga një hyrje në krimet kompjuterike, forenzika kompjuterike, dhe provat kibernetike. Kjo ngjarje i bashkoi 25 ekspertë të drejtësisë penale nga vendet në rajon. Trajnimi u mbajt nga ekspertët e hetimeve të krimeve kibernetike nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe

---

<sup>241</sup> Po aty, f. 16.

Ministria e Drejtësisë në Serbi, Shoqata e Prokurorëve në Serbi, dhe Instituti për Kërkime të Krimeve Kibernetike (nga Kolone, Gjermani). Trajnimi iu dha pjesëmarrësve një hyrje në krimet kibernetike, forenzikën kompjuterike dhe provat kibernetike. Kursi u dizajnuar për menaxherët policor të cilët i mbikëqyrin hetimet kibernetike, prokurorët që janë përgjegjës për trajtimin e ankesave që kanë të bëjnë me provat elektronike dhe gjyqtarët që i trajtojnë provat kibernetike dhe krimet e internetit. Punëtorja u financua nga qeveria Norvegjeze dhe u zbatua në bashkëpunim me Njësinë për Sundim të Ligjit pranë Misionit të OSBE-së në Serbi.<sup>242</sup>

### *Hetimet financiare*

Në vitin 2008, Zyra e OSBE-së në Baku e ka lehtësuar trajnimin e përfaqësuesve relevant të qeverisë së Azerbajxhanit dhe një numri të shteteve pjesëmarrëse. Departamenti i sundimit të ligjit i asaj Zyreje e kishte mbajtur një punëtorë dy-ditore për vetëdijesimin e organeve të zbatimit të ligjit për legjislacionin aktual dhe mekanizmat ndërkombëtar për luftimin e shpëlarjes së parave; 21 gjyqtarë dhe dhjetë prokurorë kanë marr pjesë në këtë punëtorë.

Në vitin 2009, Zyra e koordinorit të aktiviteteve ekonomike dhe mjedisore pranë OSBE-së dhe koordinori i projektit të OSBE-së në Uzbekistan e ka mbështetur Bankën Botërore dhe qeverinë uzbeke në mbajtjen e një punëtorie nacionale të trajnimit për zyrtarët e Njësisë së Inteligjencës Financiare të Uzbekistanit (NJIF) në Tashkent. Objektivi i kësaj punëtorie ishte ndërtimi i kapaciteteve të NJIF-it të Uzbekistanit dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet NJIF-it dhe autoriteteve kompetentë të zbatimit të ligjit dhe atyre prokuroriale si dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të NJIF-it. Ngjarja treditore ishte organizuar në bashkëpunim me Bankën Aziatike për Zhvillim dhe Grupin Euroaziatik për Luftimin e Shpëlarjes së Parave (EAG), dhe ishte vijuar nga 30 ekspertë nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe institucioneve të Uzbekistanit. Diskutimet u përqendruan në qeverisjen e NJIF-it dhe pavarësinë operative, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave të NJIF-it, bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet NJIF-ve, pezullimin e transaksioneve të dyshimta, standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për bashkëpunimin ndërmjet agjencive në shtet si dhe u trajtuan një sërë rastesh për studim.

<sup>242</sup> OSBE, *Raporti vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për Aktivitetet që ndërlidhen me policinë në vitin 2011*, Vjenë 2012, f. 19

Në vitin 2010, Misioni i OSBE-së në Mal të Zi, në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Podgoricë, e ka organizuar një seminar treditor për metodat e reja të hetimit të metodave të shpëlarjes së parave dhe krimin financiar. Policë të lartë, inspektor tatimor, punonjës të Drejtorisë për luftimin e shpëlarjes së parave dhe zyrtarë të lartë nga Zyra e Prokurorit Publik kanë marrë pjesë në këtë seminar, i cili u udhëhoq nga ekspertë nga *Guardia di Finanzia* e Italisë. Pjesëmarrësit morën shumë informata nga fusha e luftimit të shpëlarjes së parave dhe hetimeve penale financiare dhe ekonomike.<sup>243</sup>

#### *Trafikimi me qenie njerëzore*

Në vitin 2006, Prania e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me SPMU-në e OSBE-së, e ka mbajtur një program trajnimi dyjavor në kuadër të kornizës së Planit të Veprimit të OSBE-së për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Ky ishte program trajnimi i organizuar nga shumë agjenci, përfituesit e së cilit përfshinin agjenci të zbatimit të ligjit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Akademinë Policore, Shërbimin e Prokurorisë, OJQ-të që kanë programe kundër trafikimit. Theksi i këtij trajnimi ishte në të mësuarit se si të merret informacioni në qasjen me shumë agjenci, si të arrihet ndjekja pa u mbështetur në dëshminë e viktimës. Më tepër se 20 persona janë trajnuar nga ekspertët e siguruar nga SPMU-ja.

Në vitin 2011, Qendra e OSBE-së në Astana, Kazakistan, e ka organizuar “Punëtorinë e katërt vjetore për promovimin e zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit gjyqësor si reagim ndaj trafikimit me njerëz dhe kontrabandimit me migrantë në Azinë qendrore” në Almaty, Kazakistan. Ngjarja është bashkëorganizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kazakistanit, Organizata ndërkombëtare për migrim (IOM) UNODC, Ambasada e SHBA-ve në Kazakistan, Qendra e OSBE-së në Bishkek, dhe Zyra e OSBE-së në Tagjikistan. Punëtorja i ka bashkuar më tepër se 70 prokurorë të lartë, zyrtarë policor, përfaqësues të ministrive të huaja dhe OJQ.<sup>244</sup>

#### *Trafikimi i drogës*

Në vitin 2007, SPMU-ja e OSBE-së e ka organizuar një konferencë rajonale në Bishkek, Kirgizstan lidhur me “Rritjen e zbatimit të ligjeve dhe bashkëpunimin gjyqësor në rrugët e drogës së Azisë

<sup>243</sup> OSBE, *Raporti vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet që ndërlihen me policinë në vitin 2010*, Vjenë 2011, f. 50

<sup>244</sup> OSBE, *Raporti vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet që ndërlihen me policinë në vitin 2011* (cituar më lartë në shënimin 242), f. 99.

Qëndrore”. Ngjarja është organizuar në bashkëpunim të ngushtë me UNODC-në, me mbështetjen e Qendrës së OSBE-së në Bishkek dhe operacionet tjera të OSBE-së në rajon. Pjesëmarrësit ishin ekspertë nga UNODC-ja, Organizata e Traktatit të Sigurisë Kolektive (OTSK) dhe përfaqësues nga Kina, Kazakistani, Mongolia, Federata Ruse, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Uzbekistani. Ekspertët i përqëndruan diskutimet e tyre në instrumentet ligjore ndërkombëtare, standardet, legjislacionet kombëtare dhe sfidat praktike që ndërlidhen me përmirësimin e bashkëpunimit transnacional ndërmjet gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë. Punëtorja shërbeu për tri qëllime kryesore: krijimin e lidhjeve personale ndërmjet autoriteteve relevante të zbatimit të ligjit dhe atyre gjyqësore që merren me ndihmë të ndërsjellë në shtetet e prekura nga trafikimi i heroinës nga Afganistani; shpërndarjen e informatave për kriteret specifike ligjore dhe procedurale të secilit shtet; dhe identifikimin e problemeve që ndërlidhen me bashkëpunimin e brendshëm dhe atë transnacional.

Në vitin 2011, Misioni i OSBE-së në Kosovë e ka kryer një ushtrim të dërgesës së kontrolluar ku përfshiheshin agjenci të drejtësisë penale nga vendet në rajon.. Qendra koordinuese e operacionit ishte vendosur në selinë qendrore të Policisë së Kosovës.<sup>245</sup> Ushtrimi praktik i dërgesës së kontrolluar është kryer për herë të parë në Kosovë dhe i ka rritur kapacitetet e zyrtarëve të policisë, doganave dhe gjyqësorit në luftimin e trafikimit të drogës dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal. Si rezultat i kësaj, agjencitë e përfshira në ushtrimin e dërgesës së kontrolluar e kanë shtuar shkëmbimin e informatave të ndërsjella si dhe besimin te njëra tjetra.<sup>246</sup>

### *VII.7.2 Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të SDP-së, agjencive tjera qeveritare, ofruesve joshtetëror të sigurisë dhe drejtësisë, dhe shoqërisë civile*

Siç është përmendur më lart, aktivitetet trajnuese lidhur me luftimin e fushave specifike të krimit të organizuar mund të ofrohen edhe për anëtarët e agjencive tjera qeveritare, shoqërinë civile dhe sektorin privat të cilët luajnë rol të rëndësishëm në parandalimin e këtyre veprave penale (përmes

<sup>245</sup> Të gjitha referencat për Institucionet/liderët e Kosovës i referohen Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes.

<sup>246</sup> OSBE, *Raporti vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet që ndërlidhen me policinë në vitin 2011* (cituar më lartë në shënimin 242), f. 48.

vetëdijesimit), ose të cilët i mbështesin viktimat e këtyre krimeve (përmes identifikimit të viktimave dhe llojeve tjera të mbështetjes), si në rastet e trafikimit të drogës, trafikimit me qenie njerëzore dhe abuzimit të fëmijëve në internet.

Mirëpo, shumica e aktiviteteve të trajnimit të përbashkët mund të përqendrohen në fushat e bashkëpunimit që synojnë përmirësimin e sigurisë së përgjithshme dhe ndjenjave të sigurisë së popullatës, adresimin e të drejtave të njeriut (shih edhe kapitullin VII.7.3) dhe mundësimin e mbikëqyrjes publike të SDP-së (shih edhe kapitullin VII.7.4).

Këto tri aktivitete trajnuese, mund të jenë mjet i rëndësishëm për rritjen e besimit të ndërsjellët dhe thyerjen e stereotipeve dhe mosbesimitin e krijuar ndërmjet grupeve, dhe për promovimin e marrëdhënieve efektive ndërpersonale dhe ndërkulturore. Ato sigurojnë mundësi për shkëmbim të përvojave dhe pikëpamjeve të akterëve të ndryshëm, gjë që mund ta rrisë vetëdijen dhe mirëkuptimin e tyre për nevojat dhe brengat e grupeve tjera. Gatishmëria për të ndarë përvojat dhe pikëpamjet është parakusht për identifikimin e problemeve të komunitetave dhe për zhvillimin dhe zbatimin e përbashkët të nismave për zgjidhjen e problemeve. Këto aktivitete trajnuese gjithashtu mund të bëjnë vetëdijesimin tek të gjitha grupet e përfshira lidhur me rolet e tyre dhe të drejtat dhe përgjegjësitë që ata i kanë në këtë proces të zgjidhjes së problemeve.

Shkathësitë teknike të zhvilluara në trajnim, mund të përqendrohen në komunikim, ndërtim të besimit, ndërmjetësim të konflikteve, diversitet kulturor dhe zhvillim të qasjeve kreative për adresimin e brengave të komunitetit dhe zgjidhje të problemeve.

Aktivitetet e përbashkëta trajnuese gjithashtu mund të përqendrohen në zhvillimin e një bashkëpunimi të shëndoshë me mediat, përfshirë udhëzimet për kontaktim me mediat, duke krijuar role të përkufizuara qartë për zëdhënësit dhe duke siguruar trajnim për zyrtarët lidhur me mediat.<sup>247</sup>

Për më tepër, bashkëpunimi duhet të përfshijë ligjërues mysafir nga shoqëria civile dhe institucionet tjera relevante jashtë SDP-së në trajnimet për zyrtarët e drejtësisë penale në përgjithësi. Andaj, institucionet e SDP-së duhet të zhvillojnë partneritete me një gamë të gjerë të grupeve të shoqërisë civile për të identifikuar përfaqësuesit e moshës ose gjinisë së caktuar dhe segmenteve tjera të komuniteteve të cilat do të mund të bartnin pikëpamjet e ndryshme që i kanë komunitetet e tyre.<sup>248</sup>

---

<sup>247</sup> Cf. OSBE, *Praktikat e mira në ndërtimin e partneriteteve ndërmjet policisë dhe publikut* (cituar më lartë në shënimin 86), ff. 46f., 54, 58, dhe 65f.

<sup>248</sup> Cf. *Policia dhe komunitetet rom e sinti: Praktikat e mira në ndërtimin e besimit dhe mirëkuptimit* (cituar më lartë në shënimin 151), f. 80

### VII.7.3 Aspektet e të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të janë pjesë përbërëse e të gjitha llojeve të trajnimeve bazike, të avancuara dhe specializuara apo programeve arsimore për personelin e SDP-së.<sup>249</sup> Këto të drejta dhe liri përfshijnë:

- Të drejtën në jetë;
  - Lirinë nga tortura dhe keqtrajtimi;
  - Të drejtën për liri dhe siguri;
  - Lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit;
  - Lirinë e shprehjes;
  - Lirinë e asocimit dhe tubimit paqësor;
  - Të drejtën për proces të rregullt gjyqësor
  - Të drejtën për të punuar, për t'u arsimuar dhe për të marr pjesë në komunitet;
  - Presumimin i pafajësisë
  - Të drejtat e personave të arrestuar, pakicave, grave dhe fëmijëve;
- dhe
- Respektimin e jetës private dhe informacionit.<sup>250</sup>

Njohuria për legjislacionin e të drejtave të njeriut, politikat, procedurat dhe shkathtësitë për zbatimin e tyre në mënyrën e duhur në praktikë duhet të jetë parakusht për pjesëmarrjen në trajnime të avancuara dhe specializuara. Për më tepër, të gjithë ofruesit e trajnimeve dhe moderatorët duhet të kenë ekspertizë nga arsimimi në fushën e të drejtave të njeriut.

Në vitet e fundit, disa dokumente të dobishme të trajnimit janë zhvilluar nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe OJQ për të drejtat e njeriut të cilat ofrojnë udhëzime për përfshirjen e aspekteve të drejtave të njeriut në plan-programet për trajnimet rreth SDP-së.

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka dizajnuar module trajnimi për të

---

<sup>249</sup> Cf. OSCE ODIHR, *Udhëzimet për arsimim nga fusha e të drejtave të njeriut për zyrtarët e zbatimit të ligjit*, Varshavë, shtator 2012, f. 3.

<sup>250</sup> Cf. OSCE, *Praktikat e mira për trajnimin bazik të policisë – Aspektet e planprogramit nga këshilltari i lartë për policinë i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së*, Seritë e publikimeve të SPMU-së Vëll. 5, Vjenë, Tetor 2008, f. 31.

drejtat e njeriut për personelin e institucioneve të ndryshme të SDP-së, përfshirë policinë, gjykatat, sistemin e burgjeve, zyrat e avokatit të popullit, parlamentet dhe subjektet tjera zyrtare të ngarkuara me çështjet e sigurisë. Në vitin 2002, Task Forca për zhvillimin e strategjive gjithëpërfshirëse të sundimit të ligjit për operacionet paqësore e Komitetit Ekzekutiv të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (ECPS), e ka nxjerr një raport i cili paraqiste përpjekjet trajnuese për policinë, gjyqësorin dhe burgjet. Në raportin e hartuar për ECPS-në, Task Forca i ka diskutuar më tepër se 50 module trajnimi dhe doracakë të krijuar nga agjencitë e OKB-së apo departamente të fushës së sundimit të ligjit.<sup>251</sup>

Në vitin 2012, ODIHR-i në bashkëpunim me TND/SPMU të OSBE-së, i ka zhvilluar *Udhëzimet për arsimim nga fusha e të drejtave të njeriut për zyrtarët e zbatimit të ligjit*. Udhëzimet janë menduar të shërbejnë si masë për matjen e cilësisë së hartimit të programeve dhe si burim për ata që i iniciojnë dhe realizojnë programe arsimore në pajtim me praktikat më të mira për të drejtat e njeriut për zyrtarët e sundimit të ligjit. Dokumenti i sugjeron gjashtë fusha kryesore që duhet të ekzistojnë për të pasur program arsimor të suksesshëm për të drejtat e njeriut: qasje të bazuara në të drejtat e njeriut në të gjitha proceset dhe synimet; kompetenca themelore; plan-program; procese të mësimdhënies/mësimnxënies dhe procese të të mësuarit; vlerësim, dhe përfundimisht, zhvillim profesional dhe mbështetje të stafit trajnues/arsimor.<sup>252</sup>

Për më tepër, ODIHR, në bashkëpunim me TNTD/SPMU, ka zhvilluar modul praktik të trajnimit për hetimet në pajtim me të drejtat e njeriut për zyrtarët që e zbatojnë ligjin dhe ata që veprojnë kundër terrorizmit.<sup>253</sup>

Gjithashtu ekziston nevojë që të gjithë akterët e SDP-së të pajisen me njohuri dhe shkathtësi për adresimin e duhur të drejtësisë gjinore dhe dhunës së bazuar në gjini me qëllim që të reagojnë në mënyrë efektive në hetimet kundër terrorizmit duke demonstruar edhe ndjeshmëri të duhur gjinore. Kjo fushë në veçanti kërkon bashkëpunim me agjenci qeveritare dhe joqeveritare (p.sh. shërbimet shëndetësore, juristët, këshillat e fshatrave, grupet e grave dhe strehimoret, ndihmë juridike të lëvizshme (mobile); praktikuesit e SDP-së duhet të jenë të përgatitur që të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me

---

<sup>251</sup> UNODC/USIP, *Reforma e drejtësisë penale në shtetet e dala nga konflikti* (cituar më lartë në shënimin9), f. 75.

<sup>252</sup> Cf. OSCE, *Raporti vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet që ndërliken me policinë në vitin 2011* (cituar më lartë në shënimin 242), f. 48; dhe  
<sup>253</sup> OSCE ODIHR, *Udhëzimet për arsimimin në fushën e të drejtave të njeriut për zyrtarët e zbatimit të ligjit* (cituar më lartë në shënimin 249).

<sup>253</sup> OSCE ODIHR, *Të drejtat e njeriut në hetimet kundër terrorizmit – Doracak praktik për Zyrtarët e zbatimit të ligjit*, Varshavë, 2013, që pritet të dalë.



këta akterë të ndryshëm të shoqërisë civile.<sup>254</sup>

Pas një qasje tërësore për RSDP-në, strukturat ekzekutive të OSBE-së ofrojnë trajnim të përbashkët për institucione të ndryshme të SDP-së me theks të veçantë në mbrojtjen e të drejtave në njeriut në një numër të fushave të drejtësisë penale ku viktimat e të drejtave të njeriut dhe kryerësit janë veçanërisht të cenueshëm ndaj shkeljeve.

*Shembuj të trajnimit të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në procesin e drejtësisë penale*

### *Dhuna në Familje*

Në vitin 2011, Misioni i OSBE-së në Moldavi i ka kryer një numër seminaresh trajnuese për “Luftimin e dhunës në familje” për policë, prokurorë, gjyqtarë dhe avokatë. Seminaret janë përqendruar në të drejtat e njeriut të viktimave, mekanizmat ligjor dhe praktikat më të mira që e sigurojnë mbrojtjen e tyre, dhe ndjekjen e duhur të kryerësve. Pjesëmarrësit në këto punëtori gjithashtu kanë mësuar se si ta përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet shumë agjencive për zgjidhjen e rasteve të dhunës në familje. Rastet nga Moldavia dhe praktika gjyqësore lidhur me dhunën në familje e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ishin përfshirë në këtë program. Seminaret ishin realizuar në partneritet me Institutin Nacional të Drejtësisë dhe ekspertë të shquar ligjor, psikologë dhe punëtorë social.<sup>255</sup>

### *Të drejtat e njeriut në hetimet e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore*

Në vitin 2011, Përfaqësuesi i posaçëm njëherë edhe koordinator për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore i OSBE-së (PS/TQNj) ka folur në një kurs ndërkombëtar të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë me temën “Sistemet penale, rrjedhat e migrimit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar”, të organizuar nga Këshilli Gjyqësor i Italisë në Romë, Itali. Pjesëmarrësit ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga Shqipëria, Franca, Italia dhe Rumania, si dhe përfaqësues

<sup>254</sup> UNDP, *Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Timor-Leste*, Projekt dokument , Nju Jork 2008, ff. 26f.

<sup>255</sup> Cf. OSCE, *Raporti vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet që ndërlihen me policinë në vitin 2011* (cituar më lartë në shënimin 242), f. 80.

nga Eurojusti dhe OJQ të ndryshme. PS/TQNj ka ligjëruar për standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe nevojën për një qasje shumë-disiplinare për identifikimin dhe asistencën e personave të trafikuar.

#### *Të drejtat e njeriut gjatë paraburgimit*

Në vitin 2001, një projekt për reformë ligjore dhe gjyqësore i Njësisë së OSBE-së në Taxhikistan i ka theksuar zbrazëirat në fushat që duhet përmirësuar në Kodin e ri të Procedurës Penale (KPP) dhe zbatimin e tij nga policia, prokurorët dhe gjyqtarët. Vëmendje e veçantë iu është kushtuar fushave të cilat parashohin mbrojtje shtesë për individët gjatë periudhës së paraburgimit dhe hetimit në procedurën paraprake. Projekti i implementuar nga OJQ-ja Qendra për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, ka ofruar trajnim për më tepër se 100 prokurorë nga i gjithë vendi lidhur me parandalimin e torturës, të drejtat e procesit të rregullt dhe garancitë e të drejtave të njeriut në ndjekjen e rasteve të terrorizmit dhe ekstremizmit. Në kuadër të projektit, përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë mbajtur takime të rregullta me avokatët mbrojtës për të identifikuar rastet e torturës, keqtrajtimit dhe për t'i gjurmuar elementet procedurale që kanë çuar deri te ato shkelje të drejtave të njeriut.

#### *VII.7.4 Llogaridhënia dhe mbikëqyrja*

Anëtarët e, SDP-së, ofruesit jo-shtetërorë të sigurisë dhe drejtësisë si dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të informohen për kodet e mirësjelljes dhe PSV-të e shërbimeve të ndryshme të sigurisë dhe drejtësisë në mënyrë që të vetëdijesohen për të drejtat, detyrimet dhe obligimet e tyre për të siguruar llogaridhënie dhe mbikëqyrje.

#### *Shembuj të trajnimit për çështje të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes*

##### *Trajnim kundër korrupsionit në Kosovë*

Në vitin 2011, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka ofruar kurse trajnimi që kishin për qëllim përmirësimin e shkathtësive të hetimit dhe promovimin e agjencisë së përbashkët që punon në Kosovë për luftimin e korrupsionit. Është realizuar një kurs i avancuar, i cili

përfshinte pjesëmarrës nga Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), Doganat, Agjencinë Kundër Korrupsionit, Task-Forcën për Luftimin e Korrupsionit si dhe prokurorë dhe gjyqtarë. Në përgjithësi, kursi i trajtonte teknikat e posaçme për hetimin e korrupsionit, hetimet e udhëhequra nga inteligjenca, trajtimin e dëshmitarëve dhe informatorëve, si dhe testimin e integritetit, që është një kompetencë e re që iu është dhënë IPK-së. Përfshirja e prokurorëve dhe gjyqtarëve është konsideruar si e rëndësishme dhe do të vazhdohet kështu edhe në nismat trajnuese të mëtejshme.

Për më tepër, Misioni i OSBE-së në Kosovë, i mbështetur nga ekspertë nga Policia e Kosovës, Zyra e Prokurorit Publik dhe Asociacioni i Gazetarëve, kanë dizajnuar dhe realizuar kurse trajnimi përkitazi me rolin e mediave si mekanizëm mbikëqyrës, të cilat janë mbajtur në gjashtë rajone të Kosovës. Kurset e adresojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe komunikimit të mirë ndërmjet përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, prokurorëve dhe mediave. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit diskutuan për kornizën ligjore dhe rregulloret e zbatuara gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Temat e trajnimit gjithashtu adresuan, mungesën e shkathtësive të komunikimit dhe kuptimin konceptual të rolit të sektorit të sigurisë përballë publikut. Në fund të secilës punëtori, pjesëmarrësve iu është dhënë nga një fjalor i termeve të përdorura shpesh nga të gjitha institucionet, me qëllim të përmirësimit të komunikimit.

### *Trajnim për monitorimin e gjykimeve në Kirgizstan*

Në kuadër të projektit të ODHIR-it për monitorimin e gjykimeve në Kirgizstan (shih edhe Kapitullin VII.5.2), 26 individë me arsimim të lartë ligjor apo përvojë në të drejtat e njeriut, janë trajnuar për t'u bërë monitorues të gjykimeve nga OSBE/ODHIR në bazë të *Doracakut për monitorimin e gjykimeve* të ODHIR-it, duke u përqendruar në qëllimet e procedurës së monitorimit të gjykimit, si dhe parimin e paanësisë në raportim dhe mosndërrhyrje gjatë gjykimit. Si pjesë e trajnimit, është organizuar një simulim i gjykimit me përfshirjen e një gjyqtari nga Gjykata Supreme dhe personelin e Prokurorisë së Përgjithshme.<sup>256</sup>

<sup>256</sup> Cf. OSCE ODIHR/Qendra në Bishkek, *Rezultatet e monitorimit të gjykimeve në Republikën e Kirgizstanit, 2005-2006* (cituar më lartë në shënimin 134), f.14f.



## VIII. Vlerësimi dhe rishikimi i RSDP-së

Vlerësimet janë në pajtim me funksionin e të mësuarit dhe llogaridhënies, me qëllim të vlerësimit të efektivitetit, efikasitetit dhe rëndësisë së aktiviteteve specifike për zbatimin e reformave. Qëllimi i tij është që të; kontribuojë në përmirësimin e taktikave, procedurave dhe teknikave; të shqyrtojë nëse duhet vazhduar apo ndërprerë projektet dhe programet; dhe siguroar llogaridhënie tek akterët dhe taksapaguesit për shpenzimet dhe përdorimin e burimeve të pakta.<sup>257</sup> Siç është përmendur në kapitullin IV, vlerësimet duhet të analizojnë se deri në çfarë mase janë plotësuar standardet e reformës, ashtu siç janë përkufizuar në fazën e zhvillimit të strategjisë. Kriteret e vlerësimit duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të gjurmueshme.

Realizimi i një RSDP-je tërësore, është përpjekje afatgjatë dhe kërkon vlerësime ciklike, që duhet të jenë të lidhura me ciklin e politikave, duke ia mundësuar nivelit strategjik që në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme ta përmirësojë cilësinë e shërbimeve të SDP-së. Kornizat e referimit që e mbështesin kornizën organizative, siç është Modeli i Fondacionit të Evropës për Menaxhim të Cilësisë (EFQM), nga Fondacioni i Evropës për Menaxhim të Cilësisë dhe modeli i Menaxhimit të Plotë të Cilësisë (TQM) nga Korniza për Vlerësim të Përbashkët, do të mund të ishin mjetet e duhura për ta përcjellë këtë qasje.<sup>258</sup> Vlerësimet përfundimtare nuk duhet të ndërmerren para se programet e implementimit ta kenë mundësinë për të pasur sukses. Kur të prezantohet RSDP-ja me theks në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e ndërveprimeve të SDP-së, programeve duhet t'iu vendoset afat dy deri pesë vite, varësisht nga sfidat me të cilat ballafaqohet procesi i implementimit. Përveç kësaj, duhet të jeni të vëmendshëm për tu siguroar që çdo kornizë e monitorimit dhe vlerësimit të përmbajë një gamë të gjerë si të treguesve cilësor ashtu edhe atyre sasior. Kjo do ta mundësojë që ndryshimet në fusha specifike të interpretohen në një kontekst më të gjere.

Për ta shmangur çfarëdo perceptimi të vlerësimeve të njëanshme apo konflikti të interesit, dhe për ta shtuar besueshmërinë e vlerësimeve, vetë-vlerësimeve nga institucione të ndryshme të SDP-së, institucionet duhet të plotësohen me vlerësime të pavarura të jashtme.<sup>259</sup>

---

<sup>257</sup> Cf. OSCE, *Praktikat e mira në ndërtimin e partneriteteve ndërmjet policisë dhe publikut* (cituar më lartë në shënimin 86), f. 58; dhe OECD, *DAC Standardet e cilësisë së vlerësimit*, Paris 2006, f. 6.

<sup>258</sup> Cf. OSCE, *Praktikat e mira në ndërtimin e partneriteteve ndërmjet policisë dhe publikut* (cituar më lartë në shënimin 86), f. 58f.

<sup>259</sup> Cf. OECD, *DAC Parimet për vlerësimin e asistencës për zhvillim*, OECD/GD(91)208, Paris 1991, para. 11.

## VIII.1 Kriteret për vlerësim

Kriteret e përgjithshme për vlerësimin e procesit të zbatimit të RSDP-së, në pajtim me kriteret e *Komitetit për Zhvillim dhe Asistencë* (DAC) të OECD-së për vlerësim të asistencës për zhvillim, janë: rëndësia, efikasiteti, efektiviteti, ndikimi dhe qëndrueshmëria<sup>260</sup> e nismave për reformim.

### *Kriteret e DAC-së për vlerësimin e Asistencës në RSDP*

**Rëndësia:** masa në të cilën masat për zbatimin e RSDP-së janë të përshtatshme për prioritetet dhe politikat e grupit të synuar, pranuesve dhe donatorëve.

Pyetjet që duhet adresuar:

- Deri në çfarë mase janë objektivat e programit ende të vlefshme?
- A janë aktivitetet dhe rezultatet e programit në pajtim me qëllimin e përgjithshëm dhe arritjen e objektivave të veta?
- A janë aktivitetet dhe rezultatet e programit në pajtim me ndikimet dhe efektet e synuara?

**Efektiviteti:** Masa në të cilën projektet i arrijnë objektivat e tyre.

Pyetjet që duhet adresuar:

- Deri në çfarë mase janë arritur objektivat / a ka gjasa që të arrihen objektivat?
- Cilët kanë qenë faktorët kryesor që kanë ndikuar në arritjen apo mosarritjen e objektivave?

**Efikasiteti:** Matja e rezultatit cilësor dhe sasior në lidhje me rezultatet. Kjo kërkon krahasimin e qasjeve alternative për arritjen e rezultateve të njëjta, dhe verifikimin nëse është miratuar procesi më efikas.

Pyetjet që duhet adresuar:

- A kanë qenë aktivitetet efikase për nga kostoja e tyre?

<sup>260</sup> Cf. OECD, *DAC Standardet e cilësisë së vlerësimit* (cituar më lartë në shënimin 257), f. 6.

- A janë arritur aktivitetet me kohë?
- A është zbatuar programi apo projekti në mënyrën më efikase të mundshme?

*Ndikimi:* Ndryshimet pozitive dhe negative të prodhuara nga nisma e RSDP-së, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të planifikuara apo të paplanifikuara.

Pyetjet që duhet adresuar:

- Çfarë rezultati ka dalë nga programi apo projekti?
- Çfarë ndryshimi real ka bërë aktiviteti për përfituesit?
- Sa persona janë prekur?

*Qëndrueshmëria:* matja për të parë nëse përfitimet e një aktiviteti kanë gjasa të vazhdojnë edhe pas financimit të donatorit, dhe tërheqjes së këshillave dhe mbikëqyrjes nga jashtë.

Pyetjet që duhet adresuar:

- Deri në çfarë mase kanë vazhduar përfitimet e programit apo projektit pas ndërprerjes së financimit nga donatorët?
- Cilët kanë qenë faktorët kryesor që kanë ndikuar në arritjen apo mosarritjen e qëndrueshmërisë së programit apo projektit?

Përfundimisht, si kriter për vlerësimin e suksesit të nismave në kuadër të institucioneve të ndryshme të SDP-së dhe për të vlerësuar ndikimin në procesin e drejtësisë penale në përgjithësi do të ishte masa e ndryshimeve strukturore dhe organizative, përfshirë: krijimin e kornizës ligjore që e lehtëson bashkëpunimin dhe bashkërendimin e ngushtë brenda SDP-së; zhvillimin e strukturave të komunikimit dhe bashkërendimit, përfshirë sistemet për mbledhjen dhe procesimin e integruar të të dhënave; ndarjen dhe sigurimin e burimeve dhe trajnimit; krijimin e mekanizmave transparent, të drejtë dhe efektiv të llogaridhënies; dhe në veçanti performanca e institucioneve të ndryshme të SDP-së dhe perceptimi i publikut për SDP-në në pajtim me kriterin e përshkruar në Kapitullin VII.5.

Publiku duhet të informohet për rezultatet e vlerësimit, si pozitiv ashtu edhe negativ. Kjo mund ta mobilizojë edhe më tutje pjesëmarrjen e shoqërisë civile, forcojë përfshirjen e saj në proceset e RSDP-së dhe përfundimisht ta rrisë besimin e tyre në SDP.

Në bazë të vlerësimit të procesit të zbatimit dhe rezultateve të tij, procesi

i rishikimit duhet të fillohet, duhet t'i përfshijë të gjithë akterët dhe të përqendrohet në të gjitha fazat e procesit të zbatimit. Çdo aktivitet strategjik, strukturor, organizativ dhe operativ që nuk është dëshmuar i suksesshëm në përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të procesit të drejtësisë për një periudhë të gjatë duhet të ridizajnohet në mënyrë të thukët.

## VIII.2 Shtrirja Gjeografike e nismave të RSDP-së

Nismat e RSDP-së janë shpesh të centralizuara dhe të përqendruara në institucionet që veprojnë nga kryeqyteti apo qytetet kryesore. Duke qenë se qasja në siguri dhe drejtësi, shpesh mund të jetë problem shumë më serioz në zonat rurale, është me rëndësi që RSDP-ja të zbatohet edhe në zonat rurale.

Nëse programet e pilotuara për implementimin e hapave të caktuar të reformës (p.sh. zbatimin e mekanizmave të caktuar të komunikimit apo sistemeve të menaxhimit të dosjeve të lëndëve në disa rajone/qytete të caktuara) janë dëshmuar si të suksesshme, ato duhet të zgjerohen me programe shtesë në vende të ndryshme në tërë shtetin. Ky zgjerim do të varet në ekzistimin e burimeve për zbatim (p.sh. numrin e koordinatorëve të projektit; numrin e praktikuesve të SDP-së dhe menaxherët e trajnuar për rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit; buxhetin për blerjen e pajisjeve të kërkuara). Praktikuesit e SDP-së të përfshirë në fazën e pilotimit duhet të përdoren si ekipi kryesor i këshilltarëve që ua sqarojnë strategjinë kolegëve të tyre në departamente/degë tjera dhe në rajone tjera gjeografike.

Mirëpo, gjithmonë duhet mbajtur mend që larmia rajonale mund të ndikojë në zbatimin e strategjive në mënyra të ndryshme; ajo që ka funksionuar në një rajon në ndërveprime të caktuara të SDP-së, mund të mos funksionojë në rajonet tjera. Praktikant më të mira të një programi të pilotuar prapëseprapë duhet t'u përshtaten në mënyrën më të mirë një mjedisi tjetër.<sup>261</sup>

## VIII.3 Qëndrueshmëria dhe faza e daljes

Ekzistojnë dy kriteret bazë për qëndrueshmërinë e SDP-së: (i) të kuptuarit e duhur, pranimi dhe funksionalizimi nga të gjithë akterët shtetëror i konceptit të procesit tërësor të integruar të drejtësisë penale; dhe (ii) pranimi dhe mbështetja e qasjes tërësore nga akterët shtetëror, përfshirë bazën e shkruar

---

<sup>261</sup> Cf. OSCE, *Praktikat e mira në ndërtimin e partneriteteve ndërmjet policisë dhe publikut* (cituar më lartë në shënimin 86), f. 62f.



ligjore për reformë që e lehtëson edhe institucionalizimin e një qasjeje të re dhe disponueshmërinë e financimit të duhur.<sup>262</sup>

Nëse procesi i rishikimit të zbatimit të reformës zbulon që disa standarde të caktuara të reformës janë arritur dhe nëse është arritur nivel i duhur i qëndrueshmërisë së të arriturave të reformës, asistenca ndërkombëtare e reformës mund të zvogëlohet gradualisht me rritjen e nivelit të qëndrueshmërisë. Një qasje fleksibile do të lejojë përfundim progresiv të fushave të përfshirjes së reformës aty ku një gjë e tillë është e duhur. Në rastet kur organizatat ndërkombëtare kanë pasur mandat ekzekutiv apo përgjegjësi për krijimin e infrastrukturës dhe ofrimin të trajnimit, bartja e kësaj përgjegjësie nga këshilltarët ndërkombëtar tek kolegët e tyre vendor, duhet të planifikohet në mënyrë të thukët, duke i marr para sysh kornizat reale kohore dhe dorëzimin e duhur të pajisjeve, informatave, dokumenteve dhe planprogramit të nevojshëm.<sup>263</sup>

---

<sup>262</sup> Cf. OSCE, *Zbatimi i programeve që ndërliken me policinë* (cituar më lartë në shënimin 52), f. 52.

<sup>263</sup> Po aty, f. 51.



## **IX. Qasjet e integruara të RSDP-së që përdoren nga organizatat ndërkombëtare që ofrojnë asistencë në procesin e reformave**

Konsultimet e ngushta të strukturave ekzekutive të OSBE-së me akterët tjerë ndërkombëtar të përfshirë në RSDP janë shumë të rëndësishme për të zhvilluar synime dhe strategji tërësore dhe plotësuese të procesit të reformës dhe për të paraqitur deklarata koherente dhe të përbashkëta të synimeve dhe pritjeve për homologët e tyre vendor.

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i ngushtë gjithashtu ndihmon për t'i shmangur filozofitë kontradiktore të projektit dhe zbatimin e metodologjive që mund të shpijnë në huti të konsiderueshme dhe frustrim tek përfutuesit e programit – institucionet e SDP-së, agjencitë tjera shtetërore dhe joshtetërore, dhe shoqëria civile.

Në aspektin e burimeve të pakta financiare dhe njerëzore, bashkëpunimi mund të ndihmojë në ndërtimin e sinergjive, të delegojë dhe ndajë detyrat, dhe të shmangë dyfishimin e përpjekjeve dhe dhurimit të pajisjeve të papërshtatshme.

Andaj, aktivitetet e asistencës ndërkombëtare për RSDP-së, duhet të bashkërendohen si në nivel bilateral ashtu edhe atë multilateral, duke përfshirë organizata ndërkombëtare, institucione kërkimore dhe shtete donatore.

Qasja tërësore dhe shumëdisiplinare për RSDP duhet të përfshijë edhe akterët e asistencës së zhvillimit politik dhe ekonomik.

Bashkërendimi mund të përfshijë shkëmbim të informatave lidhur me aktivitetet e planifikuara, që mund të rezultojnë në zhvillimin e një matrice të aktiviteteve dhe në miratimin dhe harmonizimin e aktiviteteve të ndryshme të njëra tjetrës.

Takimet shumëpalëshe në nivel strategjik dhe operativ, mund të mbahen në baza informuese *ad hoc* si dhe në kuadër të kornizës së takimeve apo konferencave të rregullta zyrtare.

### *Shembuj të mekanizmave ndërkombëtar të bashkërendimit*

Në fushën e reformës policore, strukturat ekzekutive të OSBE-së e kanë lehtësuar shkëmbimin e informatave dhe bashkërendimin e aktiviteteve duke zhvilluar dhe mirëmbajtur baza të dhënave dhe matrica për projektet e reformës policore në shtetet e tyre nikoqire

dhe duke i mbështetur në mënyrë aktive bazat e të dhënave ndërkombëtare të asistencës teknike për policinë siç është Mekanizmi automatik i asistencës së donatorëve (ADAM) që është një bazë e të dhënave e zhvilluar nga UNODC. Përveç mirëmbajtjes së matricës së trajnimeve, Zyra e OSBE-së në Taxhikistan e ka krijuar edhe një platformë joformale të bashkërendimit të quajtur “vakti i mëngjesit për zbatuesit e ligjit”, ku përfaqësues nga agjencitë e drejtësisë dhe sigurisë si dhe nga OJQ-të rregullisht takohen për t’i diskutuar çështjet që ndërlidhen me reformën e drejtësisë penale.

Strukturat ekzekutive të OSBE-së gjithashtu i kanë mbështetur mekanizmat bashkërendues të asistencës për policinë në nivele rajonale dhe ndërkombëtare, si Këshilli Rajonal i Bashkërendimit (RCC) në Sarajevë.

Për më tepër, ekzistojnë mekanizma të themeluar si duhet të bashkërendimit ndërmjet OSBE-së dhe UNDOC-ut për sa i përket promovimit dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare dhe zbatimit të strategjive kundër krimit të organizuar, siç është “Strategjia Ylber”. Ky lloj i bashkëpunimit sistematik duhet të fuqizohet dhe të pranohet vëmendje të përkushtuar nga zyrat në terren për të siguruar bashkërendim efektiv.<sup>264</sup>

Është e qartë që pranuesit e asistencës ndërkombëtare të RSDP-së duhet të përfshihen në planifikimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve ndërkombëtare të reformimit, veçanërisht për të ushqyer marrjen e pronësisë mbi procesin e reformës (shih edhe kapitullin IV). Bashkërendimi në emër të anës pranuese do të mund të lehtësohet përmes zyrave të bashkërendimit apo grupeve drejtuese në kuadër të grupeve nacionale kryesore, apo nga agjencia udhëheqëse nga radhët e akterëve ndërkombëtar të përzgjedhur nga qeveria nikoqire që do ta merrnin detyrën dhe do të fuqizoheshin me bashkërendimin e aktiviteteve të të gjitha agjencive të jashtme dhe akterëve të përfshirë. Zyra bashkërenduese, grupi drejtues apo agjencia udhëheqëse do të mund të organizonin takime shumëdisiplinare të të gjithë akterëve relevant në baza mujore apo së paku baza të rregullta për t’i diskutuar aktivitetet dhe nismat që janë në proces e sipër për të siguruar zvogëlim të dyfishimit dhe rritje të efektivitetit. Këto takime gjithashtu duhet të përdoren për heqjen e barrierave ndaj nismave që ballafaqohen me sfida.<sup>265</sup>

<sup>264</sup> Cf. OSCE, Raport nga Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së, lidhur me aktivitetet që ndërlidhen me Policinë të Strukturave Ekzekutive deri në fund të vitit 2009, prill 2010, f. 35f. dhe 81.

<sup>265</sup> Cf. OSCE, *Zbatimi i programeve që ndërlidhen me policinë* (cituar më lartë në shënimin 52), f. 21f.

## **X. Qasjet e integruara të RSDP në kuadër të organizatave ndërkombëtare për asistencë në reforma**

Është e natyrshme që qasja tërësore për reformën policore në kuadër të RSDP kërkon një qasje të integruar në kuadër të organizatave që ofrojnë asistencë, ku departamentet e ndryshme të misioneve dhe në kuadër të selive/sekretariateve të organizatave që janë relevante për qasjen tërëqeveritare (d.m.th. organet e zbatimit të ligjit, sundimit të ligjit, demokratizimit, të drejtave të njeriut, zhvillimit ekonomik, mjedisit dhe medias) sigurojnë koordinim të ngushtë, sinkronizim dhe plotësim të aktiviteteve të tyre gjatë fazave të planifikimit, vlerësimit, zbatimit dhe shqyrtimit. Gjithashtu, në fazat e ndryshme të reformës duhet të përfshihen edhe njësitë e tjera administrative, si Burimet Njerëzore dhe Administrimi Financiar, si dhe Çështjet Ligjore dhe Zyrat për Komunikim.

Qasjet e tilla të integruara nuk duhet të bazohen vetëm në raportet personale, por edhe në strukturat e institucionalizuara, të përbëra nga kryesuesit e departamenteve si dhe zyrtarë të lartë të projekteve dhe administratës. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi i brendshëm i misionit gjithashtu do të rritet përmes zhvillimit të sistemeve të integruara të informatave të misionit të cilat kanalizojnë raportimin e brendshëm, përmirësojnë rrjedhën e informatave dhe ofrojnë qasje në të dhënat përkatëse për të gjitha njësitë e caktuara.

Nëse është e mundur, misionet në terren duhet të themelojnë njësi të bashkërendimit dhe vlerësimit të projektit, të cilat do t'u ofronin menaxherëve të projektit mbështetje gjatë procesit të zbatimit të projektit, duke siguruar standard të lartë të cilësisë së projektit në tërë misionin.

Duhet t'i kushtohet vëmendje edhe krijimit të njërive për RSDP, ose së paku pozitive të zyrtarit ndërlidhës në misionet në terren, të cilët do të bashkërendonin dhe lehtësonin RSDP në shtetet e tyre, si dhe do të komunikonin ngushtë me homologët përkatës në selitë/sekretariatet kryesore të tyre (p.sh. Selia e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork ose Sekretariati i OSBE-së në Vjenë). Këta zyrtarë/njësi për ndërlidhje duhet të vendosen në nivel strategjik në Zyrën e Shefit të Misionit për të siguruar ndikim të mjaftueshëm politik dhe burokratik për të mundur qasje të bashkërenduar dhe plotësuese të departamenteve përkatëse të misionit. Zyrtarët/njësitë për ndërlidhje gjithashtu do të jenë përgjegjës për të marrë parasysh çështjet e ndërlidhura si integrimi gjinor, të drejtat e njeriut dhe llogaridhënia në të gjitha projektet RSDP. Për më tepër, njësitë/zyrtarët për ndërlidhje duhet të jenë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e progresit

të RSDP, si dhe për modifikimin e qasjeve sipas nevojës.<sup>266</sup> Rrjeti i këtyre zyrtarëve ndërlidhës për RSDP duhet të mbështetet dhe mbahet përmes një pike kontakti /zyre në selitë/sekretariatet kryesore të organizatave, përgjegjëse për hartimin e politikave dhe udhëzimeve të RSDP për të gjitha misionet RSDP, duke ofruar asistencë dhe/apo udhëzime për misionet në terren.<sup>267</sup>

Një kërkesë themelore për qasje të qëndrueshme dhe koherente tërësore nga ana e organizatave ndërkombëtare është, së pari, që departamentet e ndryshme të misionit të binden për nevojën për të aplikuar qasje tërësore ndërsektoriale të RSDP, si dhe të jenë të gatshme t'i integrojnë projektet e tyre të reformave në një qasje ndërdimensionale të misionit; dhe së dyti, që të jenë të vetëdijshëm për nevojat specifike dhe kornizave kontekstuale të institucioneve të ndryshme të SDP në shtetin e tyre pritës, si dhe departamenteve të tjera përkatëse të misionit, përkatësisht. Prandaj, përgatitjet e hollësishme të përbashkëta të stafit të misionit janë të domosdoshme për ta përcjellë këtë njohuri.

### **Shembuj të kurseve për përgatitje të misioneve të përbashkëta për ekspertë të RSDP**

Më 2011, Grupi i OKB-së për Koordinim dhe Resurse të Sundimit të Ligjit ka zhvilluar një Trajnim për Sundimin e Unifikuar të Ligjit të Kombeve të Bashkuara i projektuar për t'i mundësuar stafit të fushave të sundimit të ligjit të Kombeve të Bashkuara si policia, drejtësia penale, burgjet, RSS dhe reforma ligjore, drejtësia gjinore, drejtësia tranzicionale, etj., për të aplikuar një qasje të sundimit të ligjit të mbarë sistemit të Kombeve të Bashkuara. Modulet fillestare të trajnimit mbuluan parimet dhe vlerat themelore të sundimit të ligjit, normat dhe standardet e Kombeve të Bashkuara për sundimin e ligjit, udhëzimet për planifikim dhe vlerësim, si dhe bashkërendimin dhe zhvillimin e strategjisë.<sup>268</sup>

Qendra Gjermane për Operacionet Ndërkombëtare Paqësore, në bashkëpunim me Akademinë Suedeze Folke Bernadotte, ofron kurse

---

<sup>266</sup> Cf. Hänggi, Heiner/Scherrer, Vincenza, "Misionet e Integruara të OKB-së dhe Reforma e Sektorit të Sigurisë: Rruga përpara", në Hänggi/Scherrer, Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Misionet e Integruara të OKB-së: Përvojat nga Burundi, Republika Demokratike e Kongos, Haiti dhe Kosova, DCAF, Gjenevë, 2007, f. 239.

<sup>267</sup> Hänggi, Heiner/Scherrer, Vincenza, Përvojat e fundit të Misioneve të Integruara të OKB-së në Reformat e Sektorit të Sigurisë (RSS): Rishikim dhe rekomandime, DCAF, Raport përfundimtar, Gjenevë 2007, f. 19.

<sup>268</sup> Kolegji i stafit të sistemit të Kombeve të Bashkuara, KB, Trajnim i unifikuar i sundimit të ligjit; dhe Njësia për sundim të ligjit e Kombeve të Bashkuara, Trajnim me përfshirje të të gjitha sistemeve të KB për sundim të ligjit i nisur në Turin.

tërësore të sundimit të ligjit për njerëzit që kanë për qëllim të punojnë në misionet në terren të sundimit të ligjit, duke grumbulluar zyrtarë policorë, prokurorë, gjyqtarë, zyrtarë korrektues, etj., si dhe duke ngritur vetëdijesimin e tyre për qasjen tërësore për RSDP.<sup>269</sup>

Në kuadër të OSBE-së, duhet t'i kushtohet vëmendje edhe zhvillimit të një kornize strategjike të OSBE-së për RSDP, duke përfshirë udhëzimet për zbatim, përmes së cilave strukturat e ndryshme ekzekutive/aplikuesit e RSDP do të mund t'i trajtonin në mënyrë koherente komponentët e ndryshëm të RSDP, varësisht nga konteksti specifik.

---

<sup>269</sup> Cf. Qendra për Operacione Ndërkombëtare Paqësore (ZIF), “Sundimi i Ligjit”, në: Pasqyrë të Kurseve të Trajnimeve të ZIF 2012, f. 15; dhe Akademisë Folke Bernadotte, “Kurs i Specializuar i Sundimit të Ligjit” në: Kurset e Akademisë Folke Bernadotte 2012, f. 16.

## Referenca

### Dokumente

- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (85) 11 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për the Pozitën e viktimës në kuadër të së drejtës dhe procedurës penale, Strasburg, 1985.
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (97) 13 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare që ka të bëjë me Kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes, Strasburg, 1997.
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (99) 19 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare që ka të bëjë me Ndërmjetësimin në çështje penale, Strasburg 1999.
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2001) 10 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kodin Evropian të Etikës Policore, Strasburg, 2001.
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2005) 9 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, Strasburg, 2005.
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2006) 8 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Ndihmën për viktimat e krimit, Strasburg, 2006.
- Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Rekomandimi 1713 (2005), Mbikëqyrja demokratike e sektorit të sigurisë në shtetet anëtare, Strasburg, 23 qershor 2005, në: <http://www.assembly.coe.int/ASP/Doc/XrefViewPDF.asp?FileID=17360&Language=EN>
- Legifrance, Loi n° 93-2 du 4 janvier 1993, portant réforme de la procédure pénale, 1993, në: <http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=LEGITEXT000006080750>
- Legifrance, Loi n° 2004-204 du 9 mars 2004, portant adaptation de la justice aux évolutions de la criminalité, 2004, në: <http://www.legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=JORFTEXT000000249995>
- Legifrance, Code de procédure pénale, në: <http://www.legifrance.gouv.fr/affichCode.do?cidTexte=LEGITEXT000006071154>
- OSBE, Strategjia e OSBE-së për trajtimin e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe stabilitetit në shekullin 21, Takimi i Njëmbëdhjetë i Këshillit Ministror, Mastrikt, 1 dhe 2 dhjetor 2003, në: <http://www.OSBE.org/mc/17504> (10 gusht 2011).



OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 5/06, Krimi i organizuar, Takimi i Katërbëdhjetë i Këshillit Ministror, Bruksel, 5 dhjetor 2006, në: <http://www.OSBE.org/mc/23060> (10 gusht 2011).

OSBE, Korniza Strategjike e OSBE-së për Aktivitetet që kanë të bëjnë me policinë, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 1049, Takimi Plenar 922, Vjenë, 26 korrik 2012, në: <http://www.OSBE.org/pc/92559> (6 gusht 2012).

Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, Udhëzime për drejtësinë në rastet që përfshijnë fëmijë viktime dhe fëmijë dëshmitarë të krimit, Vjenë, 25 maj 2005, në: <http://www.unrol.org/files/V0582605.pdf> (25 prill 2012).

Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Qasjen në Ndhimë Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale, Vjenë, 25 prill 2012, në: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/LTD/V12/528/23/PDF/V1252823.pdf?OpenElement> (6 korrik 2012).

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut, Koment i Përgjithshëm nr. 32, neni 14: E drejta në barazi para gjykatave dhe tribunaleve dhe në gjykim të drejtë, U.N. Doc. CCPR/C/GC/32 (2007), Gjenevë 2007, në: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G07/437/71/PDF/G0743771.pdf?OpenElement> (11 mars 2012).

Kombet e Bashkuara, Politika për komponentët e drejtësisë në Operacionet Paqësore të Kombeve të Bashkuara, UNDPKO, Departamenti për Mbështetje në Terren, Ref. 2009.30,1 dhjetor 2009.

## **Bibliografia**

Aromaa, Kauko *et al.*, Krimet dhe Drejtësia Penale në Evropë dhe Amerikë Veriore 1995-1997: Raport për Anketën e Gjashtë të Kombeve të Bashkuara për Trendet e Krimit dhe Sistemet e Drejtësisë Penale, Instituti Evropian për Parandalimin dhe Kontrollin e Krimit, e lidhur me Kombet e Bashkuara (HEUNI), Seria e Publikimeve nr. 40, Helsinki 2003.

Komisioni i Auditimit, Bordet Lokale të Drejtësisë Penale. Mbështetje për ndryshimin e menaxhimit, Londër 2003, në: <http://www.audit-commission.gov.uk/SiteCollectionDocuments/AuditCommissionReports/NationalStudies/20030702localcriminaljusticeboardsreport.pdf> (12 qershor 2012).

Auld, Sir Robin Ernest, "Sistemi i Drejtësisë Penale", në: Auld, Sir Robin Ernest, Shqyrtim i Gjykatave Penale të Anglisë dhe Uellsit, Ministria e

- Drejtesisë, Kapitulli 8, f. 315-366, shtator 2001, në: <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/+http://www.criminal-courts-review.org.uk/chpt8.pdf> (23 nëntor 2011).
- Ball, Nicole/Fayemi, Kayode (eds.), Qeverisja e Sektorit të Sigurisë në Afrikë: Doracak, Qendra për Demokraci dhe Zhvillim, Kapitulli 4. Zhvillimi dhe Zbatimit i Politikave, 2004, në: [www.ssrn.org/ssg\\_a/index3.cfm?id=83&p=17](http://www.ssrn.org/ssg_a/index3.cfm?id=83&p=17) (7 mars 2012).
- Berry, Jan, Njësitë e Drejtësisë Penale dhe Ngritja e Rastit. Ulja e burokracisë në polici, mars 2010, në: <http://library.npia.police.uk/docs/homeoffice/reducing-bureaucracy-criminal-justice-units.pdf> (12 dhjetor 2011).
- Berry, Jan, Ulja e burokracisë në polici. Raporti i plotë, nëntor 2009, në: <http://www.policessupers.com/uploads/news/reducing-bureaucracy-policing.pdf> (12 dhjetor 2011).
- Biles, David/McKillop, Sandra (eds.), Planifikimi dhe Koordinimi i Drejtësisë Penale, Procedurat e konferencës së mbajtur më 19-21 prill 1993, Canberra, Instituti Australian i Kriminologjisë, Canberra 1994, në: <http://aic.gov.au/en/publications/previous%20series/proceedings/1-27/24.aspx> (15 gusht 2011).
- Blank, J.L.T. (ed.), Ofrimi dhe performanca publike. Amsterdam 2000.
- Qendra për Operacione Ndërkombëtare Paqësore (ZIF), "Sundimi i Ligjit", në: Pasqyrë e Trajnimeve ZIF 2012, p. 15, në: [http://archiv.zif-berlin.org/fileadmin/uploads/training/dokumente/ZIF\\_Course\\_Overview\\_2012.pdf](http://archiv.zif-berlin.org/fileadmin/uploads/training/dokumente/ZIF_Course_Overview_2012.pdf) (5 shtator 2012).
- Qendra për Inovacion të Qeverisjes Ndërkombëtare, Afganistan, Monitorues i Reformave të Sektorit të Sigurisë, nr. 4, shtator 2010, në: <http://www.cigionline.org/publications/2010/9/security-sector-reform-monitor-afghanistan> (10 dhjetor 2011).
- Coxhead, John, Përmirësimi i performancës në çështje të racës dhe diversitetit, Lambard Academic Publishing, 2009.
- Cushman, R.C., Udhëzimet për zhvillimin e Komitetit Koordinues për Drejtësi Penale, Departamenti i Drejtësisë, SHBA, Instituti Kombëtar Korrektues, janar 2002, Uashington D.C., <http://static.nicic.gov/Library/017232.pdf>.
- DCAF/OSBE ODIHR/UN-INSTRAW, Vlerësim i sektorit të sigurisë. Monitorimi dhe vlerësimi i çështjeve gjinore, Shënim praktik 11, Kutia e veglave për çështje gjinore dhe RSS, Gjenevë 2008.
- DCAF, Shënim udhëzues për zbatim: Në vijim të vlerësimit të sigurisë dhe drejtësisë, Ekipi Ndërkombëtar Këshillëdhënës për Sektorin e Sigurisë

- (ISSAT), Shënime udhëzuese për zbatim të ISSAT, Online, Mbështetje për kapacitetin RSS të Bashkësisë Ndërkombëtare, Gjenevë, 2010, në: <http://issat.dcaf.ch/content/download/1180/8960/file/ISSAT%20Assessment%20OGN%204%20Follow%20On.pdf>.
- DCAF, Shënim udhëzues për zbatim: Procedimi i propozimit të vlerësimit të sektorit të sigurisë, Ekipi Ndërkombëtar Këshillëdhënës për Sektorin e Sigurisë (ISSAT), Shënime udhëzuese për zbatim të ISSAT, Online, Mbështetje për kapacitetin RSS të Bashkësisë Ndërkombëtare, Gjenevë, 2010, në: <http://issat.dcaf.ch/content/download/440/2794/file/ISSAT%20Assessment%20OGN%201%20Processing%20the%20Proposal%20FINAL.pdf>.
- DCAF, Mjetet për integritetin policor, Gjenevë 2012.
- DeNicola, Christopher, Reforma e procedurës penale në Bosnje dhe Hercegovinë: ndërmjet minimalizmit organik dhe maksimalizmit ekstrinsik, 2010, në: <http://laworgs.depaul.edu/journals/RuleofLaw/Documents/DeNicola-Final.pdf> (10 mars 2013).
- DFID, Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Menaxhimi i Shpenzimeve Ushtarake: Rreziqet e larta për donatorët, kthimet e larta për zhvillim, Raport për simpoziumin ndërkombëtar sponsorizuar nga Departamenti i MB për Zhvillim Ndërkombëtar, Londër, shkurt 2000, në: <http://www.effectivepeacekeeping.org/sites/effectivepeacekeeping.org/files/04/DfID%20RSS%20and%20Military%20Expenditures.pdf>.
- Dodik, Bozidarka, "Hetimi prokurorial – Përvojat e Bosnje dhe Hercegovinës", në: Petrovic, Ana/Jovanovic, Ivan, Trendet e reja në të drejtën serbe të procedurës penale dhe perspektivat rajonale. Aspektet normative dhe praktike, Misioni i OSBE-së në Serbi, Beograd, 2012, f. 25-46.
- Downes, Mark, Dokument për takimin e OSBE-së për 'Reformën policore në kuadër të reformës së përgjithshme të sistemit të drejtësisë penale', OSBE, Vjenë, shtator 2011.
- Downes, Mark/Keane, Rory, Aplikimi i reformës së sektorit të sigurisë: nëntë mënyra për të kaluar nga politika në zbatim, Instituti Ndërkombëtar për Paqe, Analizë e Politikave, Nju Jork/Vjenë, shkurt 2012.
- England, Madeline L., Menaxhimi i sektorit të sigurisë: Shënim për praktikën aktuale, Qendra Henry L. Stimson, Uashington, D.C., 12 dhjetor 2009, në: [http://www.stimson.org/images/uploads/research-pdfs/Stimson\\_Management\\_of\\_security\\_sector\\_FINAL\\_12dec09\\_1.pdf](http://www.stimson.org/images/uploads/research-pdfs/Stimson_Management_of_security_sector_FINAL_12dec09_1.pdf) (10 dhjetor 2011).
- England, Madeline L.; Qeverisja dhe mbikëqyrja e sektorit të sigurisë: Shënim për praktikën aktuale, Qendra Henry L. Stimson, Uashington,

D.C., 12 dhjetor 2009, në: [http://www.stimson.org/images/uploads/research-pdfs/Stimson\\_Governance\\_oversight\\_security\\_Sector\\_FINAL\\_12dec09\\_1.pdf](http://www.stimson.org/images/uploads/research-pdfs/Stimson_Governance_oversight_security_Sector_FINAL_12dec09_1.pdf) (12 dhjetor 2011).

Forumi evropian për siguri urbane, Udhëzime për auditimet e sigurisë lokale – Përmbledhje e praktikës ndërkombëtare, Paris 2007, në: [http://efus.eu/files/fileadmin/efus/secutopics/EFUS\\_Safety\\_Audit\\_e\\_WEB.pdf](http://efus.eu/files/fileadmin/efus/secutopics/EFUS_Safety_Audit_e_WEB.pdf) (11 mars 2012).

Flanagan, Sir Ronnie, Rishikimi i veprimtarisë policore. Raport përfundimtar, 2008, në: [http://www.polfed.org/Review\\_of\\_Policing\\_Final\\_Report.pdf](http://www.polfed.org/Review_of_Policing_Final_Report.pdf) (3 mars 2012).

Florence, Curtis, et al. Efektiviteti i ndarjes anonime të informatave dhe përdorimi i tyre në partneritet të shërbimit shëndetësor, policisë dhe qeverisjes lokale për parandalimin e lëndimeve nga dhuna: Studim eksperimental dhe analizë kohore, Huluntim i BMJ, 2011, në: <http://www.bmj.com/content/342/bmj.d3313> (6 dhjetor 2012).

Akademia Folke Bernadotte/Swedish Contact Group, Reforma e Sektorit të Sigurisë. Kornizë Vlerësuese, Stokholm.

Akademia Folke Bernadotte, “Kurs i specializuar i sundimit të ligjit” në: Kurset e Akademisë Folke Bernadotte 2012, p. 16, në: [http://folkebernadotteacademy.se/PageFiles/2498/Kurskatalog\\_2012.pdf](http://folkebernadotteacademy.se/PageFiles/2498/Kurskatalog_2012.pdf) (5 shtator 2012).

Glanfield, Laurie, “Planifikimi Strategjik për Sistemin e Drejtësisë Penale”, në: Biles, David/McKillop, Sandra (eds.), Planifikimi dhe bashkërendimi i drejtësisë penale, Procesi i konferencës së mbajtur më 19-21 prill 1993, Canberra, Instituti Australian i Kriminologjisë, Canberra 1994, f. 19-31, në: <http://aic.gov.au/en/publications/previous%20series/proceedings/1-27/24.aspx> (15 gusht 2011).

Greene, Jack R., Policimi përmes të drejtave të njeriut, Idetë në policimin amerikan, Fondacioni i Policisë, numër 13, dhjetor 2010, në: <http://www.policefoundation.org/content/policing-through-human-rights> (15 tetor 2012).

Hansen Annika S./Wiharta, Sharon/Claussen Bjorn R./Kjeksrud, Stian, Tranzicioni në rend të drejtë – krijimi i pronësisë vendore pas konfliktit. Udhëzues për praktikues, Publikimet e Akademisë Folke Bernadotte, Stokholm 2007, në: [http://www.sipri.org/research/conflict/publications/handbook\\_high](http://www.sipri.org/research/conflict/publications/handbook_high) (1 nëntor 2010).

Hänggi, Heiner/Scherrer, Vincenza, Përvojat e kohëve të fundit të Misioneve të Integruara të Kombeve të Bashkuara në Reforma të Sektorit të Sigurisë (RSS): Rishikim dhe rekomandime, DCAF, Raport

përfundimtar, Gjenevë 2007.

Hänggi, Heiner/Scherrer, Vincenza, "Misionet e Integruara të OKB-së dhe Reforma e Sektorit të Sigurisë: Rruga përpara", in Hänggi/Scherrer, Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Misionet e Integruara të OKB-së: Përvojat nga Burundi, Republika Demokratike e Kongos, Haiti dhe Kosova, DCAF, Gjenevë, 2007, në: <http://www.dcaf.ch/DCAF-Migration/KMS/Chapter-Section/UN-Integrated-Missions-and-Security-Sector-Reform-The-Way-Ahead> (3 nëntor 2012).

Harris, Frank, Roli i ngritjes së kapaciteteve në reformat policore, Misioni i OSBE-së Kosovë, Departamenti për Edukim dhe Zhvillim të Policisë, Prishtinë 2005, në: <http://polis.OSBE.org/library/f/2643/527/OSBE-SRB-RPT-2643-EN-527> (11 mars 2011).

Hartog, Merijn (ed.), Reforma e Sektorit të Sigurisë në Azinë Qendrore: Hulumtimi i nevojave dhe mundësive, Qendra për Studime Evropiane të Sigurisë, Groningen 2010, në: <http://www.cess.org/publications/papers/view/?id=27> (13 shtator 2011).

Holm, Tor Tanke/Monk, Richard/Rumin, Serge, Raport i OHR për Misionin Pasues të Policisë në MOKBBH dhe Task Forca Ndërkombëtare e Policisë së OKB-së, Sarajevë, nëntor 2001.

Hudzik, John K., "Planifikimi gjithëpërfshirës i drejtësisë penale: Sukseset, dështimet dhe mësimet e nxjerra nga përvoja amerikane", në: Biles, David/McKillop, Sandra (eds.), Planifikimi dhe bashkërendimi i drejtësisë penale, Procesi i konferencës së mbajtur më 19-21 prill 1993, Canberra, Instituti Australian i Kriminologjisë, Canberra 1994, f. 1-16, në: <http://aic.gov.au/en/publications/previous%20series/proceedings/1-27/24.aspx> (15 gusht 2011).

Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Haiti: Reforma e drejtësisë dhe kriza e sigurisë, Informatë e shkurtër e politikave, Amerikë Latine /Caribbean Briefing Nr. 14, Port-au-Prince/Bruksel, 2007, në: [http://www.crisisgroup.org/~media/Files/latin-america/haiti/b14\\_haiti\\_justice\\_reform\\_and\\_the\\_security\\_crisis.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/latin-america/haiti/b14_haiti_justice_reform_and_the_security_crisis.pdf) (12 korrik 2011).

Interpol, Dokument faktit i bazave të të dhënave, COM/FS/2012-02/GI-04 në: <http://www.interpol.int/INTERPOL-expertise/Databases> (12 dhjetor 2012).

Kantor, Ana/Persson, Mariam, Të kuptuarit e vigjilantizmit. Ofruesit joformal të sigurisë dhe Reforma e Sektorit të Sigurisë in Liberi, Akademia Folke Bernadotte, Stokholm, 2009, në: [http://folkebernadotteacademy.se/Documents/RSS/Liberia\\_A5\\_folder%20Final%20version.pdf](http://folkebernadotteacademy.se/Documents/RSS/Liberia_A5_folder%20Final%20version.pdf) (16 gusht 2011).

- Instituti kosovar për hulumtim dhe zhvillim të politikave, Trekëndëshi i brishtë. Bashkërendimi ndërmjet policisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve në procedurën penale në Kosovë, Hulumtim i politikave 2010/01, Prishtinë, shkurt 2010, në: [http://www.kipred.net/web/upload/The\\_Fragile\\_Triangle.pdf](http://www.kipred.net/web/upload/The_Fragile_Triangle.pdf) (12 janar 2012).
- Kuhry, Bob, Performanca e sektorit publik. Krahasim ndërkombëtar i arsimit, kujdesit shëndetësor, rendit dhe ligjit dhe administratës publike, Zyra e planifikimit social dhe kulturor, Hagë, shtator 2004.
- Gjykate e Qarkut në Viktoria, Programi i Diversionit të Drejtësisë Penale, në: <http://www.magistratescourt.vic.gov.au/jurisdictions/criminal-and-traffic/criminal-justice-diversion-program> (25 gusht 2012).
- Marenin, Otwin “Synimi i demokracisë në programet e asistencës ndërkombëtare të policisë”, në: Policimi: Revista Ndërkombëtare e Strategjive dhe Menaxhmentit të Policisë, Vëllimi 21 Iss: 1 1998, f.159–177.
- Marenin, Otwin, Rikthimi i sistemeve të policisë në shtetet e prekura nga konfliktet: Procesi, problemet, prospektet, Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) Analizë e rastit nr. 7, Gjenevë, qershor 2005, në: [http://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/FDC4C830C3E160C7C12577B90034B714-DCAF\\_Jun2005.pdf](http://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/FDC4C830C3E160C7C12577B90034B714-DCAF_Jun2005.pdf) (5 gusht 2010).
- Moskowitz, Albert, Sfidat dhe prioritete në ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore, Analizë e prezantuar në Forumin për “Hulumtim dhe të Dhëna të Trafikimit me qenie njerëzore”, nëntor 2008, në: [http://www.artipproject.org/artip-project/documents/Paper\\_J&P-Challenges-TIP\\_22Oct08\\_fnl.pdf](http://www.artipproject.org/artip-project/documents/Paper_J&P-Challenges-TIP_22Oct08_fnl.pdf) (20 janar 2012).
- OECD, DAC Parimet për vlerësimin e asistencës për zhvillim, OECD/GD(91)208, Paris 1991, në: <http://siteresources.worldbank.org/EXTGLOREGPARPRO/Resources/DACPrinciples1991.pdf> (17 nëntor 2007).
- OECD, Reforma dhe qeverisja e sistemit të sigurisë. Dokument reference DAC, Komiteti për Asistencë në Zhvillim (DAC) Udhëzimet dhe Referenca, Paris 2005, në: <http://www.oecd.org/dataoecd/8/39/31785288.pdf> (12 tetor 2012)
- OECD, Standardet për Cilësinë e Vlerësimit DAC, Paris 2006, në: <http://www.oecd.org/dataoecd/30/62/36596604.pdf> (17 nëntor 2007).
- OECD, Doracak i OECD DAC për reformën e sistemit të sigurisë. Mbështetja e sigurisë dhe drejtësisë, Paris, 2007.
- Zyra për reformë të drejtësisë penale, Puna e përbashkët për uljen e krimit

- dhe ndarjen e drejtësisë. Plani strategjik për 2008-2011, nëntor 2007, në: <http://www.official-documents.gov.uk/document/cm72/7247/7247.pdf> (20 gusht 2012).
- Zyra për politika dhe menaxhment/Divizioni për zhvillim dhe planifikim të politikave dhe menaxhimin e drejtësisë penale, Plani gjithëpërfshirës për sistemin e drejtësisë penale të shtetit Kënektikat, mars 2007, në: <http://www.ct.gov/opm/LIB/opm/cjppd/cjabout/rptcompplan/RptCompPlan03072007.pdf> (15 gusht 2011).
- OSBE, Doracak për policimin demokratik, nga Këshilltari i lartë i policisë për Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së, Publikimet SPMU Vëllimi 1, Botimi i dytë, Vjenë, maj 2008, në: [http://polis.OSBE.org/library/details?doc\\_id=2658](http://polis.OSBE.org/library/details?doc_id=2658) (1 qershor 2011).
- OSBE, Udhëzues reference për procedurën penale, Publikimet SPMU Vëllimi 2, Vjenë, dhjetor 2006, në: [http://polis.OSBE.org/library/details?doc\\_id=3071](http://polis.OSBE.org/library/details?doc_id=3071) (1 qershor 2011).
- OSBE, Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Raporti i projektit, Publikimet SPMU Vëllimi 3, Vjenë, dhjetor 2007, në: [http://polis.OSBE.org/library/details?doc\\_id=3800&lang\\_tag=&q=](http://polis.OSBE.org/library/details?doc_id=3800&lang_tag=&q=) (1 qershor 2011).
- OSBE, Praktikat e mira në ndërtimin e partneriteteve polici-publik, Publikimet SPMU Vëllimi 4, Vjenë, maj 2008, në: [http://polis.OSBE.org/library/details?doc\\_id=3335](http://polis.OSBE.org/library/details?doc_id=3335) (1 qershor 2011).
- OSBE, Praktikat e mira në trajnimet themelore të policisë – Aspektet e planit dhe programit punuar nga Këshilltari i Lartë i Policisë i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Publikimet SPMU Vëllimi 5, Vjenë, tetor 2008, në: [http://polis.OSBE.org/library/details?doc\\_id=3555](http://polis.OSBE.org/library/details?doc_id=3555) (1 qershor 2011).
- OSBE, Zbatimi i programeve policore. Mësimet e nxjerra në Evropën juglindore, Publikimet SPMU Vëllimi 7, Vjenë, dhjetor 2008, në: <http://polis.OSBE.org/library/f/3562/2667/OSBE-AUS-SPM-3562-EN-Implementation%20of%20PRP%20%E2%80%93%20LL%20Report.pdf> (1 qershor 2011).
- OSBE, Udhëzues në përdorimin e treguesve në OSBE, Njësia mbështetëse për programim dhe vlerësim, Vjenë, mars 2009.
- OSBE, Mbështetje e OSBE-së në avancimin e kapaciteteve mjekoligjore për Policinë e Serbisë në periudhën 2004-2009. Raport përmbyllës. Programi mjekoligjor i vendeve të ngjarjes, Misioni i OSBE-së në Serbi, Departamenti i zbatimit të ligjit, Beograd 2010.

- OSBE, Policia dhe komunitetet rom dhe sinti: Praktikat e mira në ndërtimin e besimit dhe mirëkuptimit, Publikimet SPMU Vëllimi 9, Vjenë, prill 2010, në: [http://polis.OSBE.org/library/details?doc\\_id=3682](http://polis.OSBE.org/library/details?doc_id=3682) (1 qershor 2011).
- OSBE, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së për aktivitetet policore të Strukturave ekzekutive të OSBE-së deri në fund të vitit 2009, Vjenë, prill 2010, në: <http://polis.OSBE.org/library/f/3681/2981/OSBE-AUS-RPT-3681-EN-Report%20on%20police-related%20activities%20of%20OSBE%20executive%20structures%20up%20to%20the%20end%20of%202009.pdf> (19 gusht 2011).
- OSBE, Menaxhimi i projektit në OSBE. Doracak për menaxherët e programit dhe projekteve, Vjenë, 2010.
- OSBE, Raporti Vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet policore më 2010, Vjenë 2011, në: <http://www.OSBE.org/spmu/81657> (10 qershor 2012).
- OSBE, Trafikimi me qenie njerëzore: Identifikimi i viktimave të mundshme dhe të supozuara. Qasje e policimit në komunitet, Publikimet SPMU Vëllimi 10, Vjenë, qershor 2011, në: [http://polis.OSBE.org/library/details?doc\\_id=3803](http://polis.OSBE.org/library/details?doc_id=3803) (1 korrik 2011).
- OSBE, Raporti Vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për aktivitetet policore më 2011, Vjenë 2012, në: <http://www.OSBE.org/spmu/92700> (8 gusht 2012).
- OSBE, Komisionari i Lartë për Pakicat Kombëtare, Rekomandimet për Policim në shoqëritë shumetnike, Hagë.
- Misioni i OSBE-së Kosovë, Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve. Seminar, Prishtinë, 2010.
- OSBE ODIHR, Mekanizmat kombëtar të referimit: Përpjekje të përbashkëta për mbrojtjen e të drejtave të personave të trafikuar. Doracak praktik, Varshavë, 2004.
- OSBE ODIHR/Qendra në Bishkek, Rezultatet e gjykimit në Republikën Kirgize, 2005-2006, në: <http://www.OSBE.org/odihr/29615> (28 tetor 2012).
- OSBE ODIHR, Kundër-terrorizmi, mbrojtja e të drejtave të njeriut. Doracak, Varshavë 2007, në: <http://www.OSBE.org/odihr/29103> (10 tetor 2012).
- OSBE ODIHR, Zhvillimet aktuale të NRM në Rajonin e OSBE-së, Varshavë, tetor 2008, në: <http://www.OSBE.org/odihr/36611> (25 prill 2012).
- OSBE ODIHR, Forumi i III i ekspertëve për drejtësinë penale për Azinë qendrore. 17-18 qershor 2010, Dushanbe, Taxhikistan, Raport



- përfundimtar, 2010, në: <http://www.OSBE.org/odihr/81134> (21 janar 2012).
- OSBE ODIHR, Pasqyrë juridike për gjykimet e drejta ndërkombëtare, Varshavë 2012, në: <http://www.OSBE.org/odihr/94214?download=true> (21 dhjetor 2012).
- OSBE ODIHR, Monitorimi i gjykimeve. Doracak referencë për praktikuesit, botimi i reviduar 2012, Varshavë, 2012, në: <http://www.OSBE.org/odihr/94216> (24 tetor 2012).
- OSBE ODIHR, Udhëzimet për edukim të drejtave të njeriut për zyrtarët e zbatimit të ligjit, Varshavë, shtator 2012, në: <http://www.OSBE.org/odihr/93968> (10 tetor 2012).
- OSBE ODIHR, Të drejtat e njeriut në hetimet kundër terrorizmit – Doracak praktik për zyrtarët e zbatimit të ligjit, Varshavë, 2013.
- Zyra e prokurorit e Republikës së Bullgarisë, Raport përmbledhës i punës së Zyrës së Prokurorit për gjashtëmuorin e parë të vitit 2012 [ОБОБЩЕНА ИНФОРМАЦИЯ, ЗА ОБРАЗУВАНЕТО, ДВИЖЕНИЕТО И РИКЛЮЧВАНЕТО НА ПРЕПИСКИТЕ И ДЕЛАТА В ПРОКУРАТУРАТА НА РЕПУБЛИКА БЪЛГАРИЯ , за I шестмесечие на 2012 г. /Изготвена на основание чл. 142, ал. 3 ЗСВ/], në: [http://www.prb.bg/uploads/documents/docs\\_2969.pdf](http://www.prb.bg/uploads/documents/docs_2969.pdf) (10 tetor 2012).
- Radulovic, Drago, “Koncepti i hetimeve në procedurat penale duke pasur parasysh legjislacionin e ri të procedurës penale “, në: Petrovic, Ana/ Jovanovic, Ivan, New Trendet në së drejtën e procedurës penale të Serbisë perspektivat rajonale. Aspektet normative dhe praktike, Misioni i OSBE-së në Serbi, Beograd, 2012, f. 11-24.
- Rausch, Colette (ed.), Luftimi i krimeve të rënda në shoqëritë e dala nga lufta. Doracak për politikëbërësit dhe praktikuesit, Instituti Amerikan për Paqe Press, Uashington D.C., 2006.
- Russell, Stephen T. et al., Krijimi i masave të diversitetit për të mitur në komunitetin tuaj, Universiteti i Nebraskës – Linkoln, 1998, në: <http://digitalcommons.unl.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1566&context=extensionhist> (12 dhjetor 2012).
- Schweizerischer Bundesrat, Botschaft zur Vereinheitlichung des Strafprozessrechts (StPO), 21. dhjetor 2005.
- Schweizerischer Bundesrat, Botschaft zum Bundesgesetz über die Organisation der Strafbehörden des Bundes (Strafbehördenorganisationsgesetz, StBOG), 10. shtator 2008.
- Sharshenova, Aijan, Ofruesit joshtetërorë të sigurisë në Kirgizistan: Druzhina,

Analizë hulumtuese, Qendra për Hulumtime Sociale, Universiteti Amerikan i Azisë Qendrore, Kirgizistan, maj 2011.

Ständerat, Bericht der Kommission für Rechtsfragen vom 3. Juni 2009: 08.066 s Strafbehördenorganisationsgesetz; Wahl des Bundesanwalts oder der Bundesanwältin und Aufsicht über die Bundesanwaltschaft, qershor 2009, në: [http://www.parlament.ch/afs/data/d/bericht/2008/d/bericht\\_s\\_k25\\_0\\_20080066\\_0\\_20090603.htm](http://www.parlament.ch/afs/data/d/bericht/2008/d/bericht_s_k25_0_20080066_0_20090603.htm) (10 tetor 2012).

Stodiek, Thorsten, "Forcat policore ndërkombëtare në operacionet paqësore", në: Harvey Langholtz/Boris Kondoch/Alan Wells (eds.), Paqeruajtja ndërkombëtare: Libri vjetor i operacioneve ndërkombëtare paqësore, Vëllimi 9, 2005, f. 93-107.

Sustac, Zeno Daniel, Ndërmjetësimi në të drejtën penale, 2008, në: <http://www.mediate.com/articles/sustacZ3.cfm> (10 nëntor 2012).

Swedish Contact Group, Kornizë vlerësuese e sektorit të sigurisë, Akademia Folke Bernadotte, Stokholm (pa datë).

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Sundimi i ligjit, Sektori i reformave të drejtësisë dhe bashkëpunimi zhvillimor, Analiza e konceptit SDC, Berne, 2008, në: [www.sdc.admin.ch/ressources/resource\\_en\\_170419.pdf](http://www.sdc.admin.ch/ressources/resource_en_170419.pdf) (19 shtator 2011).

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut, Koment i Përgjithshëm nr. 32, neni 14: E drejta në barazi para gjykatave dhe tribunaleve dhe në gjykim të drejtë, U.N. Doc. CCPR/C/GC/32 (2007), Gjenevë 2007.

Programi Ndërkombëtar për Kontrollin e Drogave, OKB, Modeli i UNDCP për mbrojtje të dëshmitarëve 2000, 2000, në: [http://www.unrol.org/files/lap\\_witness-protection\\_2000.pdf](http://www.unrol.org/files/lap_witness-protection_2000.pdf) (20 tetor 2012).

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së/Këshilli i Sigurimit, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për ndërtimin e paqes në situata të menjëhershme pas konfliktit, A/63/881-S/2009/304, 11 qershor 2009.

Njësia e Sundimit të Ligjit në OKB, Trajnim i përgjithshëm i OKB-së për sundimin e ligjit, i pilotuar në Torino, në: [http://www.unrol.org/article.aspx?article\\_id=159](http://www.unrol.org/article.aspx?article_id=159) (11 maj 2012).

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Sundimi i Ligjit dhe drejtësia tranzicionale në shoqëritë e konfliktit dhe të dala nga konflikti. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, S/2004/616, 23 gusht 2004.

Kolegji i stafit të sistemit të Kombeve të Bashkuara, Trajnimi i unifikuar i OKB-së për sundimin e ligjit, në: <http://www.unssc.org/home/category/themes/peace-and-security/rule-law-and-peacebuilding> (11 maj 2012).

- Kombet e Bashkuara, Shënim udhëzues i Sekretarin e Përgjithshëm. Qasja e OKB-së për drejtësinë për fëmijë, Nju Jork, shtator 2008, në: [http://www.unrol.org/files/RoL\\_Guidance\\_Note\\_UN\\_Approach\\_Justice\\_for\\_Children\\_FINAL.pdf](http://www.unrol.org/files/RoL_Guidance_Note_UN_Approach_Justice_for_Children_FINAL.pdf) (10 shtator 2011).
- Kombet e Bashkuara, Shënim udhëzues i Sekretarin e Përgjithshëm. Qasja e OKB-së për Asistencë të Sundimit të Ligjit, Nju Jork, prill 2008, në: <http://www.unrol.org/files/RoL%20Guidance%20Note%20UN%20Approach%20FINAL.pdf> (10 shtator 2011).
- Kombet e Bashkuara, Politika për komponentët e drejtësisë në Operacionet Paqësore të Kombeve të Bashkuara, UNDPKO, Departamenti për Mbështetje në Terren, Ref. 2009.30, 1 dhjetor 2009.
- Kombet e Bashkuara, Grupi i bashkërendimit dhe resurseve të sundimit të ligjit, Plani i përbashkët strategjik 2009-2011, Nju Jork, shkurt 2009, në: <http://unrol.org/files/RoLCRG%20Joint%20Strategic%20Plan.pdf> (11 qershor 2011).
- Kombet e Bashkuara, Treguesit e Kombeve të Bashkuara të Sundimit të Ligjit. Udhëzues për zbatim dhe mjetet e projektit, DPKO/OHCHR, Nju Jork 2011, në: [http://www.un.org/en/events/peacekeepersday/2011/publications/un\\_rule\\_of\\_law\\_indicators.pdf](http://www.un.org/en/events/peacekeepersday/2011/publications/un_rule_of_law_indicators.pdf) (20 janar 2012).
- UNDP, Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Drejtësisë. Qasja programatike e BCPR, nëntor 2002, në: [http://pksoi.army.mil/doctrine\\_concepts/documents/UN/jssrprogramaticapproach.pdf](http://pksoi.army.mil/doctrine_concepts/documents/UN/jssrprogramaticapproach.pdf) (10 nëntor 2011).
- UNDP, Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Drejtësisë Tranzicionale. Qasja programatike e krizës pas konfliktit, mars 2003, në: [www.undp.org/cpr/documents/jssr/ssr/UNDP\\_2003\\_JRSS\\_Approach.doc](http://www.undp.org/cpr/documents/jssr/ssr/UNDP_2003_JRSS_Approach.doc) (16 gusht 2011)
- UNDP, Fuqizimi i sundimit të ligjit në situatat e konfliktit dhe pas konfliktit, Programi global i UNDP për drejtësi dhe siguri 2008-2011, Nju Jork 2008, në: [http://www.undp.org/cpr/documents/jssr/rule\\_of\\_law\\_final.pdf](http://www.undp.org/cpr/documents/jssr/rule_of_law_final.pdf) (15 qershor 2011)
- UNDP, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Timorin Lindor, Dokumenti i Projektit, Nju Jork 2008, në: <http://www.unrol.org/files/Project%20Document%20UNDP%20in%20Timor%20Leste.pdf> (15 qershor 2011).
- Departamenti i Shtetit i SHBA-së; Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit, Departamenti Amerikan i Shtetit, Vegla e radhitjes së vlerësimeve të sektorit të drejtësisë penale. Projekt ndërinstitucional i Qeverisë së SHBA për vlerësimin e kapacitetit të sistemeve të drejtësisë penale ndërkombëtare, Versioni 1.0, Uashington D.C. 2006.

- Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shërbime Shëndetësore dhe Humane et al. Portali i informatave për mirëqenien e fëmijës. Raportuesit e detyrueshëm të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës: Përmbledhje e ligjeve shtetërore, Uashington, D.C., prill 2010.
- Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shërbime Shëndetësore dhe Humane et al., Portali i informatave për fëmijë, Si funksionon sistemi i mirëqenies së fëmijëve, Uashington, DC, maj 2012, në: <http://www.childwelfare.gov/pubs/factsheets/cpswork.pdf> (24 tetor 2012).
- Instituti Amerikan për Paqe, Modeli i Kodit Penal, Kodet modele për drejtësinë penale pas konfliktit, Vëllimi I, Uashington, D.C., 2007.
- Instituti Amerikan për Paqe, Modeli i Kodit Penal, Kodet modele për drejtësinë penale pas konfliktit, Vëllimi II, Uashington, D.C., 2008.
- Instituti Amerikan për Paqe/Instituti për operacionet e paqeruajtjes dhe stabilitetit të Armatës së SHBA-së, Parimet udhëzuese për stabilizim dhe rindërtim, Uashington D.C., 2009, në: [http://www.usip.org/files/resources/guiding\\_principles\\_full.pdf](http://www.usip.org/files/resources/guiding_principles_full.pdf) (13 shtator 2011).
- UNHCR, Raporti CORI për Kirgizistanin, Kirgizistan Jugor, i porositur nga UNHCR, dhjetor 2010, në: <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/4e1d60a32.pdf> (20 shtator 2012).
- UNODC, Mjetet e vlerësimit të drejtësisë penale, Nju Jork, 2006.
- UNODC, Doracak për programet e drejtësisë restorative, Doracak i drejtësisë penale, Nju Jork, 2006, në: [http://www.unodc.org/pdf/criminal\\_justice/06-56290\\_Ebook.pdf](http://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/06-56290_Ebook.pdf) (10 mars 2012).
- UNODC, Praktikrat e mira për mbrojtjen e dëshmitarëve në procedurat penale që përfshijnë krimin e organizuar, Nju Jork, 2008, në: <http://www.unodc.org/documents/organized-crime/Witness-protection-manual-Feb08.pdf> (15 nëntor 2012).
- UNODC, Promovimi i sundimit të ligjit dhe sigurisë njerëzore në Evropën juglindore. Program rajonal 2009-2011.
- UNODC, Shërbimet private civile të sigurisë: Roli, mbikëqyrja dhe kontributi i tyre në parandalimin e krimit dhe sigurinë e komunitetit, Dokument analize për takimin e grupit të ekspertëve për shërbimet private civile të sigurisë, UNODC/CCPJ/EG.5/2011/CRP.1, Vjenë, 24 gusht 2011, në: [http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Expert-group-meeting-Bangkok/IEGMCivilianPrivateSecurity/UNODC\\_CCPCJ\\_EG.5\\_2011\\_1\\_English.pdf](http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Expert-group-meeting-Bangkok/IEGMCivilianPrivateSecurity/UNODC_CCPCJ_EG.5_2011_1_English.pdf) (26 gusht 2011)
- UNODC, Doracak për llogaridhënien e policisë, Mbikëqyrja dhe

- integriteti, Doracak i drejtësisë penale, Nju Jork, 2011, në: [http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/PoliceAccountability\\_Oversight\\_and\\_Integrity\\_10-57991\\_Ebook.pdf](http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/PoliceAccountability_Oversight_and_Integrity_10-57991_Ebook.pdf) (10 maj 2012).
- UNODC, Raport për takimin e grupit të ekspertëve për shërbimet private civile të sigurisë i mbajtur në Vjenë nga 12 deri 14 tetor 2011, UNODC/CCPCJ/EG.5/2011/2, Vjenë, 28 tetor 2011, në: [http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Expert-group-meeting-Bangkok/IEGMCivilianPrivateSecurity/English\\_V11868142.pdf](http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Expert-group-meeting-Bangkok/IEGMCivilianPrivateSecurity/English_V11868142.pdf) (30 tetor 2011).
- UNODC, Udhëzues i resurseve për fuqizimin e integritetit gjyqësor dhe kapacitetet, Nju Jork 2011, në: [http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/ResourceGuideonStrengtheningJudicialIntegrityandCapacity/11-85709\\_ebook.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/ResourceGuideonStrengtheningJudicialIntegrityandCapacity/11-85709_ebook.pdf) (20 mars 2013).
- UNODC, Pasqyrë e rasteve të krimeve të organizuara. Përmbledhje e rasteve me komentare dhe mësimet e nxjerra, Nju Jork, tetor 2012, në: [http://www.unodc.org/documents/organized-crime/EnglishDigest\\_Final301012\\_30102012.pdf](http://www.unodc.org/documents/organized-crime/EnglishDigest_Final301012_30102012.pdf) (11 nëntor 2012).
- UNODC, Doracak për trajnime për hapësirën urbane policore, Doracak i drejtësisë penale, Nju Jork 2013.
- UNODC/UNDP, Dokument koncepti. Doracak dhe plan-program për trajnime për politikë-bërësit dhe praktikuesit për qasje të hershme në ndihmë juridike, 2012.
- UNODC/UNECE, Doracak për anketat e viktimizimit, Gjenevë 2010, në: [http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Crime-statistics/Manual\\_on\\_Victimization\\_surveys\\_2009\\_web.pdf](http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Crime-statistics/Manual_on_Victimization_surveys_2009_web.pdf) (25 prill 2012).
- UNODC-UNHABITAT, Doracak hyrës për policimin e hapësirave urbane, Publikimet e Kombeve të Bashkuara, Nju Jork 2011, në: [http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/11-80387\\_ebook.pdf](http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/11-80387_ebook.pdf) (3 mars 2012).
- UNODC/Instituti Amerikan për Paqe, Reforma e drejtësisë penale në shtetet e pas konfliktit. Udhëzues për praktikuesit, Nju Jork, shtator 2011, në: <http://www.unrol.org/files/UNODC%20Ebook%20-%20Criminal%20Justice%20Reform%20in%20post-conflict%20states.pdf> (20 tetor 2011)
- Zyra e USAID e Inspektorit të Përgjithshëm, Auditimi i programit të drejtësisë USAID/Haiti, Raport auditimi nr. 1-521-07-008-P, San Salvador, 2007, në: [http://www.usaid.gov/ht/docs/eqdocs/budget\\_documents/office\\_of\\_the\\_inspector\\_general\\_reports/1-521-07-008-p.pdf](http://www.usaid.gov/ht/docs/eqdocs/budget_documents/office_of_the_inspector_general_reports/1-521-07-008-p.pdf) (10 qershor 2011).
- Valasek, Kristin, "Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe çështjet gjinore", Vegla 1, në: Bastick, Megan/Valasek, Kristin (eds.), Gjinia dhe Reforma e

Sektorit të Sigurisë, DCAF/ ODIHR/ Instituti ndërkombëtar për hulumtime dhe trajnime për avancimin e grave, Gjenevë 2008.

Wisler, Dominique, Qeverisja policore: Praktikrat më të mira të BE-së, DCAF, COGINTA, 2011, në: <http://www.dcaf.ch/Publications/Police-Governance-European-Union-Best-Practices> (10 qershor 2012).

Banka Botërore, Raport i Zhvillimit Botëror 2011, Konflikti, siguria dhe zhvillimi, Uashington, DC 2011, në:

[http://wdr2011.worldbank.org/sites/default/files/pdfs/WDR2011\\_Full\\_Text.pdf](http://wdr2011.worldbank.org/sites/default/files/pdfs/WDR2011_Full_Text.pdf) (26 prill 2011).

# **Shtojca 1: Konventat, Udhëzimet dhe Zotime kryesore ndërkombëtare të aplikueshme për qeverisjen e funksionimit të SDP në Hapësirën e OS-BE-së**

## **Instrumentet dhe dokumentet e Kombeve të Bashkuara**

Kombet e Bashkuara, Karta e Kombeve të Bashkuara, San Francisko, 26 qershor 1945.

Kombet e Bashkuara, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Paris, 10 dhjetor 1948.

Kombet e Bashkuara, Rregullat standarde minimale për trajtimin e të burgosurve, Gjenevë, 30 gusht 1955.

Kombet e Bashkuara, Konventa plotësuese për zhdukjen e skllavërisë, tregtisë me skllavër, dhe institucioneve dhe praktikave të ngjashme me skllavërinë, Gjenevë, 7 shtator 1956.

Kombet e Bashkuara, Konventa unike për drogat narkotike, Nju Jork, 30 mars 1961.

Kombet e Bashkuara, Konventa për veprat penale dhe aktet tjera të kryera në mjete fluturuese, Tokio, 14 shtator 1963.

Kombet e Bashkuara, Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Nju Jork, 21 dhjetor 1965.

Kombet e Bashkuara, Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, Nju Jork, 16 dhjetor 1966.

Kombet e Bashkuara, Protokolli që ka të bëjë me statusin e refugjatëve, Nju Jork, 30 janar 1967.

Kombet e Bashkuara, Konventa për substancat psikotropike, Vjenë, 21 shkurt 1971.

Kombet e Bashkuara, Konventa për shtypjen e akteve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil, Montreal, 23 shtator 1971.

Kombet e Bashkuara, Kodi i sjelljes për zyrtarët e zbatimit të ligjit, Nju Jork, 17 dhjetor 1979.

Kombet e Bashkuara, Konventa ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve,

Nju Jork, 17 dhjetor 1979.

Kombet e Bashkuara, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, Nju Jork, 18 dhjetor 1979.

Kombet e Bashkuara, Konventa kundër torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese, Nju Jork, 10 dhjetor 1984.

Kombet e Bashkuara, Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit, Nju Jork, 29 nëntor dhe 13 dhjetor 1985.

Kombet e Bashkuara, Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të autoritetit, Nju Jork, 29 nëntor 1985.

Kombet e Bashkuara, Rregullat standarde minimale për administrimin e drejtësisë për të mitur, Nju Jork, 29 nëntor 1985.

190

Kombet e Bashkuara, Konventa për shtypjen e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar, Rome, 10 mars 1988.

Kombet e Bashkuara, Trupi i parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave në çfarëdo forme të paraburgimit apo burgimit, Nju Jork, 9 dhjetor 1988.

Kombet e Bashkuara, Konventa kundër trafikimit të paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotropike, Vjenë, 20 dhjetor 1988.

Kombet e Bashkuara, Parimet për parandalimin efektiv dhe hetimin e përmbarrimeve jashtëligjore, arbitrare dhe të përshpejtuara, Gjenevë, 24 maj 1989.

Kombet e Bashkuara, Konventa për të drejtat e fëmijës, Nju Jork, 20 nëntor 1989.

Kombet e Bashkuara, Parimet themelore për rolin e avokatëve, Havanë, 27 gusht to 7 shtator 1990.

Kombet e Bashkuara, Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga zyrtarët e zbatimit të ligjit, Havanë, 27 gusht to 7 shtator 1990.

Kombet e Bashkuara, Udhëzimet për rolin e prokurorëve, Havanë, 27 gusht to 7 shtator 1990.

Kombet e Bashkuara, Bashkëpunimi ndërkombëtar për parandalimin e krimit dhe drejtësinë penale në kontekst të zhvillimit, Nju Jork, 14 dhjetor 1990.

Kombet e Bashkuara, Traktati model për transferimin e procedurave në raste penale, Nju Jork, 14 dhjetor 1990.

Kombet e Bashkuara, Traktati model për asistencë të përbashkët në raste



- penale, Nju Jork, 14 dhjetor 1990.
- Kombet e Bashkuara, Traktati model për transferimin e mbikëqyrjes së të dënuarve më kusht apo të liruar me kusht, Nju Jork, 14 dhjetor 1990.
- Kombet e Bashkuara, Rregullat për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria, Nju Jork, 14 dhjetor 1990.
- Kombet e Bashkuara, Rregullat standarde minimale për masat jondaluese, Nju Jork, 14 dhjetor 1990.
- Kombet e Bashkuara, Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punonjësve imigrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, Nju Jork, 18 dhjetor 1990.
- Kombet e Bashkuara, Konventa për shënjimimin e eksplozivëve për qëllim të zbulimit, Montreal, 1 mars 1991.
- Kombet e Bashkuara, Deklarata për të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare apo etnike, fetare dhe gjuhësore, Nju Jork, 18 dhjetor 1992.
- Kombet e Bashkuara, Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj gruas, Nju Jork, 20 dhjetor 1993.
- Kombet e Bashkuara, Udhëzimet për parandalimin e krimit urban, Nju Jork, 24 korrik 1995.
- Kombet e Bashkuara, Konventa që ka të bëjë me statusin e refugjatëve, Gjenevë, 28 korrik 1995.
- Kombet e Bashkuara, Konventa ndërkombëtare për shtypjen e bombardimeve terroriste, Nju Jork, 15 dhjetor 1997.
- Kombet e Bashkuara, Konventa ndërkombëtare për shtypjen e financimit të terrorizmit, Nju Jork, 9 dhjetor 1999.
- Kombet e Bashkuara, Plani i Veprimit për zbatimin e deklaratës për parimet udhëzuese për uljen e kërkesës për drogë, Nju Jork, 2 shkurt 2000.
- Kombet e Bashkuara, Protokolli opsional i Konventës për të drejtat e fëmijës për përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura, Nju Jork, 25 maj 2000.
- Kombet e Bashkuara, Protokolli opsional i Konventës për të drejtat e fëmijës për shitjen e fëmijëve, prostitucionit me fëmijë dhe pornografisë së fëmijëve, Nju Jork, 25 maj 2000.
- Kombet e Bashkuara, Modeli i UNDCP i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, 2000.
- Kombet e Bashkuara, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të

- organizuar ndërkombëtar dhe protokollet e saj, Nju Jork, 15 nëntor 2000.
- Kombet e Bashkuara, Protokollin për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit me qenie njerëzore, posaçërisht të grave dhe vajzave, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, Nju Jork, 15 nëntor 2000.
- Kombet e Bashkuara, Parimet e hetimit dhe dokumentimit efektiv të torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese, Nju Jork, 4 dhjetor 2000.
- Kombet e Bashkuara, Protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve dhe përbërësve të tyre dhe municionit, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, Nju Jork, 31 maj 2001.
- Kombet e Bashkuara, Udhëzimet për parandalimin e krimit, Shtojca e: Rezolutës ECOSOC 2002/13, Veprimi për promovimin e parandalimit efektiv të krimit, Nju Jork, 24 korrik 2002.
- Kombet e Bashkuara, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, Merida/Nju Jork, 31 tetor 2003.
- Kombet e Bashkuara, Konventa ndërkombëtare për shtypjen e akteve të terrorizmit bërthamor, Nju Jork, 13 prill 2005.
- Kombet e Bashkuara, Udhëzime për drejtësinë në rastet që përfshijnë fëmijë viktime dhe fëmijë dëshmitarë të krimit, Vjenë, 25 maj 2005.
- Kombet e Bashkuara, Ndryshimi dhe plotësimi i Konventës për mbrojtjen fizike nga materialet bërthamore, Nju Jork, 2005.
- Kombet e Bashkuara, Protokollin i vitit 2005 i Konventës për shtypjen e veprimeve të paligjshme ndaj sigurisë së lundrimit detar, Londër, 14 tetor 2005.
- Kombet e Bashkuara, Protokollin i vitit 2005 i protokollit për shtypjen e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së platformave fikse të vendosura në praninë kontinentale, Londër, 14 tetor 2005.
- Kombet e Bashkuara, Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore, Shtojca e: Rezolutës së ECOSOC 2006/22, Fuqizimi i parimeve themelore të sjelljes gjyqësore, Nju Jork, 2006.
- Kombet e Bashkuara, Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja e detyruar, Nju Jork, 20 dhjetor 2006.
- Kombet e Bashkuara, Deklarata politike dhe plani i veprimit për bashkëpunimin ndërkombëtar drejt Strategjisë së integruar dhe balancuar për luftimin e problemit botëror të drogës, Vjenë, 12 mars 2009.

Kombet e Bashkuara, Deklarata e Salvadorit për strategjitë gjithëpërfshirëse për sfidat globale: Parandalimi i krimit dhe sistemet e drejtësisë penale dhe zhvillimi i tyre në botën në ndryshim , Kongresi i dymbëdhjetë i Kombeve të Bashkuara për parandalimin e krimit dhe drejtësinë penale, Salvador, 12-19 prill 2010.

Kombet e Bashkuara, Parimet dhe udhëzimet për qasjen në ndihmë juridike pa pagesë në sistemet e drejtësisë penale, Vjenë, 25 prill 2012.

## **Dokumentet e CSCE, Vendimet dhe planet e veprimit të Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Përhershëm të OSBE-së**

CSCE, Akti Përfundimtar, Helsinki, 1 gusht 1975.

CSCE, Dokumenti i Takimit të Kopenhagës të Konferencës për Dimensionin Njerëzor të CSCE, Kopenhagë, 29 qershor 1990.

CSCE, Samiti i CSCE në Paris, Karta e Parisit për një Evropë të re, Paris, 19-21 nëntor 1990.

CSCE, Kodi i sjelljes për aspektet politiko-ushtarake të sigurisë, Budapest, 3 dhjetor 1994.

OSBE, Samiti i OSBE-së në Stamboll, Karta për siguri evropiane, 19 nëntor 1999.

OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 1, Luftimi i terrorizmit, Takimi i nëntë i Këshillit të Ministrave në Bukuresht, 4 dhjetor 2001.

OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 9, Aktivitetet policore, Takimi i nëntë i Këshillit të Ministrave në Bukuresht, 4 dhjetor 2001.

OSBE, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 448, themelimi i pozitës së deleguar të Këshilltarit të Lartë për Polici në Sekretariatit e OSBE-së, Takimi Plenar 371, Bukuresht, 4 dhjetor 2001.

OSBE, Këshilli i Ministrave, Deklarata për trafikimin me qenie njerëzore, Takimi i dhjetë i Këshillit të Ministrave, Porto, 7 dhjetor 2002.

OSBE, Këshilli i Ministrave, Karta e OSBE-së për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, Takimi i dhjetë i Këshillit të Ministrave, Porto, 7 dhjetor 2002.

OSBE, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 557, Plani i veprimit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, Takimi plenar 462, Vjenë, 24 korrik 2003.

- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 2/03, Luftimi i trafikimit me qenie njerëzore, Takimi i njëmbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Mاستrikt, 1 dhe 2 dhjetor 2003.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 3/03, Plani i veprimit për përmirësimin e gjendjes së komunitetit rom dhe sinti në hapësirën e veprimit të OSBE-së, Takimi i njëmbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Mاستrikt, 1 dhe 2 dhjetor 2003.
- OSBE, Strategjia e OSBE-së për trajtimin e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe stabilitetit në shekullin 21, Takimi i Njëmbëdhjetë i Këshillit Ministror, Mاستrikt, 1 dhe 2 dhjetor 2003.
- OSBE, Dokumenti strategjik i OSBE-së për dimensionin ekonomik dhe mjedisor, Takimi i njëmbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Mاستrikt, 1 dhe 2 dhjetor 2003.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 14/04, Plani i Veprimit për promovimin e barazisë gjinore, Takimi i dymbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Sofje, 7 dhjetor 2004.

193

- OSBE, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 685, Shtojca e Planit të veprimit të OSBE-së për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore: trajtimi i nevojave të posaçme të viktimave fëmijë të trafikimit në kuptim të mbrojtjes dhe ndihmës, Takimi plenar 562, Vjenë, 7 korrik 2005.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 3/05, Luftimi i krimit të organizuar ndërkombëtar, Takimi i trembëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Lubjanë, 6 dhjetor 2005.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 5/05, Luftimi i rrezikut nga drogat e paligjshme, Takimi i trembëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Lubjanë, 6 dhjetor 2005.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 3/06, Luftimi i trafikimit me qenie njerëzore, 21 qershor 2006 (për ndryshimin e Vendimit nr. 2/03 të Takimit të njëmbëdhjetë të Këshillit të Ministrave në Mاستrikt).
- OSBE, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 758, Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar kundër drogës, Takimi plenar 641, Bruksel, 5 dhjetor 2006.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 5/06, Krimi i organizuar, Takimi i katërbëdhjetë i Këshillit Ministror, Bruksel, 5 dhjetor 2006.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 15/06, Luftimi i shfrytëzimit seksual të fëmijëve, Takimi i katërbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Bruksel, 5 dhjetor 2006.

- OSBE, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 810, Zbatimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, Takimi plenar 689, Vjenë, 22 nëntor 2007.
- OSBE, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 813, Luftimi i rrezikut të drogave të paligjshme dhe pararendësve, Takimi plenar 690, Madrid, 30 nëntor 2007.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 4/07, Angazhimi i OSBE-së me Afganistanin, Takimi i pesëmbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Madrid, 30 nëntor 2007.
- OSBE Vendimi i Këshillit Ministror nr. 9/07, Luftimi i shfrytëzimit seksual i fëmijëve në internet, Takimi i pesëmbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Madrid, 30 nëntor 2007.
- OSBE, Vendimi i Këshillit Ministror nr. 5/08, Avancimi i reagimeve të drejtësisë penale ndaj trafikimit me qenie njerëzore përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, Takimi i gjashtëmbëdhjetë i Këshillit të Ministrave, Helsinki, 5 dhjetor 2008.
- OSBE, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 914, Avancimi i mëtejme i aktiviteteve të OSBE-së që kanë të bëjnë me policinë, Takimi plenar 784, Athinë, 2 dhjetor 2009.
- OSBE, Samiti në Astana, Deklarata komemorative në Astana: Drejt një komuniteti të sigurisë, Astana, 2 dhjetor 2010.
- OSBE, Vendimi i Këshillit të Përhershëm nr. 1049, Korniza Strategjike e OSBE-së për Aktivitetet që kanë të bëjnë me policinë, Vjenë, 26 korrik 2012.

## **Dokumentet e Këshillit të Evropës**

- Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut/Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (1950).
- Këshilli i Evropës, Konventa evropiane për ekstradime (1957); dhe protokollet e saj shtesë;
- Këshilli i Evropës, Konventa evropiane për asistencën reciproke juridike në rastet penale dhe protokollet e saj shtesë (1959);
- Këshilli i Evropës, Karta Sociale Evropiane (1961).
- Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rezoluta 690 (1979) për Deklaratën për Policinë (1979).

- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (85) 4 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për dhunën në familje (1985).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (85) 11 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për the Pozitën e viktimës në kuadër të së drejtës dhe procedurës penale (1985).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (87) 15 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare që rregullon përdorimin e të dhënave personale në sektorin e policisë (1987).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (87) 19 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për organizimin e parandalimit të krimit (1987).
- Këshilli i Evropës, Konventa evropiane kundër shpëlarjes, kontrollit, sekuestrimit dhe konfiskimit të mjeteve të realizuara nga krimi (1990).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (91) 11 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare që ka të bëjë me shfrytëzimin seksual, pornografinë dhe prostitucionin dhe trafikimin e fëmijëve dhe të rinjve (1991).
- Rekomandimi i Këshillit të Evropës (1996) 8, Evropa në kohët e ndryshimit – Politika e krimit dhe e drejta penale.
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (97) 13 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare që ka të bëjë me Kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes (1997).
- Këshilli i Evropës, rezoluta (97) 24 e Komitetit të Ministrave për njëzet parimet udhëzuese për luftën kundër korrupsionit (1997).
- Këshilli i Evropës, Konventa e së drejtës penale për korrupsionin, Seria e traktateve evropiane – nr. 173 (Strasburg, 1999).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (99) 19 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare që ka të bëjë me Ndërmjetësimin në çështje penale (1999).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (2000) 10 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për kodet e sjelljes për zyrtarët publikë (2000).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (2000) 11 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për veprime kundër trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit seksual (2000).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2000) 19 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për rolin e prokurorisë publike në sisteme të drejtësisë penale (2000).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2000) 20 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për rolin e intervenimit të hershëm psikologjik

- në parandalimin e krimit (2000).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2001) 10 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kodin Evropian të Etikës Policore (2001).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2001) 16 për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual (2001).
- Këshilli i Evropës, Konventa për krimet kibernetike, Budapest, 23.11.2001 (2001).
- Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian kundër racizmit dhe mostolerancës (ECRI), Rekomandimi i përgjithshëm i politikave nr. 7 për legjislacionin vendor për luftimin e racizmit dhe diskriminimit racor (2003).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2003) 21 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare që ka të bëjë me partneritetin në parandalimin e krimit (2003).
- Këshilli i Evropës, Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor apo degradues (CPT), Standardet CPT. Nenet “materiale” të Raporteve të përgjithshme të CPT (2004).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2005) 9 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë (2005).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2005) 10 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për “Teknikat e posaçme të hetimit” që kanë të bëjnë me krimet e rënda duke përfshirë aktet e terrorizmit (2005).
- Këshilli i Evropës, të drejtat e njeriut dhe lufta kundër terrorizmit – Udhëzimet e Këshillit të Evropës (2005).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2006) 8 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Ndihmën për viktimat e krimit (2006).

## **Dokumenti i Interpolit**

Interpol, Kushtetuta e Interpolit, Vjenë 1956, si dhe modifikimet pasuese.

## **Shtojca 2: Pyetje të përgjithshme për aplikimin e Kornizës së Kapacitetit dhe Integritetit (KKI) të zhvilluar në Qendrën e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF)**

Pyetjet në vijim janë të grupuara në katër kategori, të cilat i shqyrtojnë mungesat e brendshme dhe të jashtme të kapacitetit, si dhe mungesat e brendshme dhe të jashtme të integritetit. Ato ndihmojnë në analizimin e mangësive institucionale në lidhje me nevojat e veçanta të identifikuara nga qytetarët vendorë.<sup>270</sup>

1. A është mungesa e kapacitetit të brendshëm shkaktar i asaj që akteri nuk i ofron shërbimet për plotësimin e nevojave të popullatës apo pse akteri drejtpërdrejt i shkakton këto nevoja? Ju lutem cekni llojet e mungesave të kapacitetit të brendshme të cilat aplikohen:

1.1. Mangësitë në kornizën normative të akterit

- Norma kundërthënëse apo mospërfshirje të normave?
- Kundërthënie ndërmjet rregullave formale dhe normave kulturore?
- Të tjera?

1.2. Mangësitë në mandatin e akterit

- A është ofruesi përgjegjës për ofrimin e shërbimit përkatës?
- Cilat shërbime do të mund t'i plotësonin nevojat?
- Në çfarë mase është duke i plotësuar nevojat akteri, nëse po?

---

<sup>270</sup> Për pasqyrën e pyetjeve të KKI shih: Downes, Dokument për takimin e OSBE-së për 'Reformën policore në kuadër të reformës së përgjithshme të sistemit të drejtësisë penale' (shënimi 43), f. 11-15.



### 1.3. Mangësitë në kuptim të burimeve njerëzore

- Nivel joadekuat i stafit? Të shqyrtohet për çdo kategori përkatëse të stafit.
- Bilanc joadekuat i stafit programatik kundrejt atij administrativ mbështetës?
- Piramidë joadekuate e stafit (zyrtarë të rinj-menaxhment-udhëheqës)?
- Procedura joadekuate të punësimit? Të shqyrtohet për çdo kategori përkatëse të stafit.
- Mangësitë në kuptim të shkathtësive dhe/apo mungesës së trajnimeve? Identifikoni këto mangësi dhe nevojat përkatëse për trajnime për çdo kategori të punës.
- A janë mangësitë e shkaktuara nga mungesa e zotimit apo kompetencës së udhëheqësisë?
- A janë masat stimuluese në kuptim të pagave dhe perspektivës së karrierës joadekuate? Krahasoni me kostot mesatare të jetesës.

### 1.4. Pengesat apo mangësitë buxhetore

- Buxheti vjetor joadekuat për t'i mbuluar kostot operationale të ofrimit të shërbimit?
- Proces joadekuate për hartim të buxhetit?
- Buxheti nuk korrespondon me shpenzimet reale?
- Kostot rrjedhëse nuk mbulohen në buxhet apo nuk sigurohen me kohë?

### 1.5. Mangësitë e pajisjeve. Listoni pajisjet në dispozicion, siguroni shifrat numrat përkatës dhe tregoni ku nevojiten riparime.

- Pajisje të pamjaftueshme?
- Pajisje joadekuate?
- Pajisje në nevojë për riparime?
- Probleme me mirëmbajtje?

### 1.6. Mangësi në infrastrukturë. Përgatitni një inventar dhe tregoni se ku nevojiten riparime apo përmirësime.

### 1.7. Mungesa e sigurisë

- Mungesa e sigurisë për stafin, viktimat, dëshmitarët apo kryerësit?

- Mbrojtje e pamjaftueshme e dëshmive mjeko-ligjore?
- A menaxhohen procedurat, pajisjet, infrastruktura dhe resurset njerëzore të ashtu që të garantojnë siguri?

#### 1.8. Mangësitë organizative

- Rregulla dhe procedura tejet të ndërlikuara të cilat ngadalësojnë operacionet apo kufizojnë qasjen në shërbime?
- Sistemet joefektive apo joefikase të menaxhimit të brendshëm (struktura e menaxhimit, sistemet e informimit, menaxhimi i performancës, etj.)?
- Shpërndarje nënoptimale e resurseve dhe ngarkesës së punës (mendoni për njësitë e punës, shpërndarjen gjeografike dhe funksionale të burimeve njerëzore dhe pajisjes)?

## 2. A mungesat e kapacitetit të jashtëm shkak pse akterët nuk i ofrojnë shërbimet për plotësimin e nevojave të popullatës apo pse akteri i shkakton drejtpërsëdrejti këto nevoja?

Natyrë e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet akterëve të ndryshëm të zinxhirit të drejtësisë penale ka ndikim të konsiderueshëm në performancën e akterëve të saj. Dobësitë, mangësitë apo pengesat në zinxhirë mund të minojnë aftësinë e tërë sistemit në ofrimin e shërbimeve policore, të drejtësisë dhe korrektuese, si dhe mund të bëhen burim i mosefikasitetit apo keqpërdorimit. Pikët e tabelës së vendimeve të UNODC<sup>271</sup> mund të përdoret për t'i identifikuar marrëdhëniet formale ndërmjet akterëve në zinxhirin e drejtësisë penale.

### 2.1 Procedurat joadekuate të bashkëpunimit ndërmjet akterit dhe akterëve të tjerë të zinxhirit penal

- Mungesa e qartësisë në përgjegjësitë e tyre përkatëse?
- Dyfishim i përgjegjësive apo boshllëqeve që krijojnë paqartësi ligjore (p.sh. vendimet kundërthënëse, apo mungesa e hierarkisë së normave)?
- Procedurat tejet të ndërlikuara të bashkëpunimit dhe zvarritjet e paarsyeshme ligjore?
- Sisteme të vështira të përcjelljes së rasteve dhe sistemet e mbajtjes së regjistrave?

<sup>271</sup> Shih f. 54 të këtij Udhëzuesi

## 2.2 Mungesa bashkëpunimit të vërtetë ndërmjet akterit dhe akterëve të tjerë në zinxhirin e drejtësisë penale

- Bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe shërbimit të prokurorisë në rrjedhën e hetimeve penale: Kush është udhëheqës? A janë përcaktuar dhe pajtuar prioritetet në mënyrë të qartë dhe a janë hetuesit dhe akterët e tjerë të policisë në dijeni për to?
- Bashkëpunimi ndërmjet policisë, shërbimit të prokurorisë, sistemit korrektues dhe gjykatave për të shmangur paraburgimin e zgjatur: A ka sistem të përbashkët për përcjelljen e të dyshuarve individualë gjatë kalimit të tyre nëpër zinxhirin e drejtësisë penale? Nëse po, a është ai sistem i përshtatshëm? A respektohet?
- Bashkëpunimi ndërmjet policisë, shërbimit të prokurorisë, gjykatave dhe sistemit korrektues për zbatimin e vendimeve të gjykatave, p.sh. për të siguruar paraburgim, për të shmangur ikjet dhe zbatuar vendimet e dëmshpërblimit?
- Bashkëpunimi në çështjet që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut që përfshijnë zyrtarë të policisë, drejtësisë, korrektues apo zyrtarë të tjerë të qeverisë?

## 2.3 Udhëzime të jashtme, menaxhimin ose mbështetje joefektive apo joefikase e ofruar nga akterët përkatës qeveritarë. Ju lutem t'i kushtoni vëmendje të veçantë:

- Sistemeve të informimit;
- Proceseve të vendimmarrjes;
- Menaxhimit të burimeve të jashtme siç janë proceset buxhetore apo të punësimit

## 3. A është mungesa e integritetit të brendshëm shkaktar i asaj që akteri nuk i ofron shërbimet për plotësimin e nevojave të popullatës apo pse akteri drejtpërdrejt i shkakton këto nevoja? Ju lutem cekni llojet e mungesave të integritetit të brendshëm të cilat aplikohen.

### 3.1 Mungesa e respektimit për normat dhe vlerat themelore nga stafi SDP?

- Sjellje joadekuate profesionale?
- Njohuri joadekuate e standardeve përkatëse të të drejtave të njeriut?

- Përfshirje në shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën (identifikoni pretendimet)?

3.2 Rregullat dhe procedurat joadekuate për të siguruar që respektohen këto norma dhe vlera?

- A janë procedurat e punësimit dhe emërimit transparente dhe të drejta, dhe të bazuara në kriteret siç janë aftësitë, integriteti dhe merita?
- A përcaktojnë kodet e sjelljes norma dhe vlera të qarta dhe specifike?
- A janë procedurat disiplinore dhe të ankesave të drejta? A ofrojnë mbrojtje nga vendimet arbitrare dhe a përfshijë mekanizma të ankimit?
- A ekzistojnë procese të verifikimit, janë të efektshme dhe a i përmbushin standardet themelore të procesit të rregullt?
- A sigurojnë transparencë të mjaftueshme rregullat dhe procedurat? Fokusi në: qasjen e publikut në gjykime, raportet publike për sjellje të pahijshme, raportet publike për buxhetet dhe shpenzimet dhe qasshmëria e procedurave (tarifat, të drejtat dhe detyrimet), etj.

3.3 Mungesa e përfaqësimit adekuat të një apo disa grupeve të popullatës?

- Gjinnor;
- Etnik;
- Fetar;
- Rajonal, etj.

3.4 Mungesa e strukturave dhe mekanizmave adekuatë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe grupeve të cënueshme (p.sh. politikat e favorshme për fëmijë)?

3.5 Ndërhyrjet politike apo të tjera në zinxhirin e drejtësisë penale? Ju lutem kategorizoni llojin dhe burimin e ndërhyrjes, si dhe për secilën kategori mundohuni të vlerësoni shpeshhtësinë dhe pasojat e këtyre ndërhyrjeve:

- Hierarkia;
- Zyrtarët e nivelit të njëjtë;
- Akterë të tjerë në zinxhirin e drejtësisë penale

4. A është mungesa e integritetit të jashtëm brendshëm shkaktar i asaj që akteri nuk i ofron shërbimet për plotësimin e nevojave të popullatës apo pse akteri drejtpërdrejt i shkakton këto nevoja? Ju lutem cekni llojet e mungesave të integritetit të jashtëm të cilat aplikohen

4.1 A është llogaridhënia e jashtme dhe procedurat e mbikëqyrjes (parlamentare, politike, e pavarur, joformale) joefektive apo joefikase? Ju lutem saktësoni dhe kushtoni vëmendje të posaçme:

- Llogaridhënies buxhetore;
- Procedurave formale për hetimin e pavarur të rasteve të sjelljes së pahijshme të pretenduar;
- Procedurave për të kërkuar llogari politike nga akterët;
- Mundësisë për qytetarët për të nisur hetime ndaj sjelljes së pahijshme të pretenduar apo administrimit të gabuar të drejtësisë;
- Mekanizmave të pavarur mbikëqyrës siç janë bordet e pavarur të mbikëqyrjes, komisionet gjyqësore, komisionet e pavarura të të drejtave të njeriut, zyrat e avokatit të popullit, etj.;
- Proceseve të jashtme të verifikimit;
- Mbikëqyrja nga mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.

4.2 Mungesa e kapacitetit dhe/apo integritetit nga ana e organeve të jashtme të mbikëqyrjes?

4.3 Ndërhyrja e jashtme në funksionimin e akterëve apo drejtpërsëdrejti në procedurën e zinxhirit të drejtësisë penale? Ju lutem identifikoni dhe kategorizoni burimet e ndërhyrjes, dhe përshkruani llojin (ryshfet, kërcënim, përfitim politik, etj.), shpeshësinë dhe pasojat e ndërhyrjes:

- Akterët politikë;
- Forcat e sigurisë;
- Grupet sociale/fetare/etnike

## **Publikimet TNTD/SPMU**

Vëllimi 1 Udhëzues për policimin demokratik, punuar nga Këshilltari i Lartë i Policisë i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Publikimet SPMU Vëllimi 1, Botimi i dytë, Vjenë, maj 2008.

Vëllimi 2 Udhëzues reference për procedurën penale, Publikimet SPMU Vëllimi 2, Vjenë, dhjetor 2006.

Vëllimi 3 Avancimi i bashkëpunimit policor, prokurorisë dhe gjyqtarëve në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Raport i projektit, Publikimet SPMU Vëllimi 3, Vjenë, dhjetor 2007.

Vëllimi 4 Praktikrat e mira në ndërtimin e partneriteteve publik-polici, punuar nga Këshilltari i Lartë i Policisë i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Publikimet SPMU Vëllimi 4, Vjenë, maj 2008.

Vëllimi 5 Praktikrat e mira në trajnimet themelore të policisë – Aspektet e planit dhe programit punuar nga Këshilltari i Lartë i Policisë i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Publikimet SPMU Vëllimi 5, Vjenë, tetor 2008.

Vëllimi 6 Прекурсоры наркотических средств [Doracak i prekursorëve], Publikimet SPMU Vëllimi 6, Vjenë, nëntor 2008.

Vëllimi 7 Zbatimi i programeve policore. Mësimet e nxjerra në Evropën juglindore, Publikimet SPMU Vëllimi 7, Vjenë, dhjetor 2008.

Vëllimi 8 Udhëzues i dërgimit të kontrolluar për shtetet e Evropës juglindore, Publikimet SPMU Vëllimi 8, Vjenë, janar 2009.

Vëllimi 9 Policia dhe komunitetet rom dhe sinti: Praktikrat e mira në ndërtimin e besimit dhe mirëkuptimit, Publikimet SPMU Vëllimi 9, Vjenë, prill 2010.

Vëllimi 10 Trafikimi me qenie njerëzore: Identifikimi i viktimave të mundshme dhe të supozuara. Qasje e policimit në komunitet, Publikimet SPMU Vëllimi 10, Vjenë, qershor 2011.

Vëllimi 11 Reforma policore në kuadër të reformës së sistemit të drejtësisë penale, Publikimet TNTD/SPMU Vëllimi 11, Vjenë, korrik 2013.

Vëllimi 12 Udhëzues trajnimesh i resurseve policore, OSBE: Trafikimi me qenie njerëzore, Publikimet TNTD/SPMU Vëllimi 12, Vjenë, korrik 2013.

Publikimet mund të porositen drejtpërsëdrejti nga DKT/NjçSP (spmu@OSBE.org) apo të shkarkohen nga faqja e internetit POLIS në adresën: <http://polis.OSBE.org/library>



- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) punon për **stabilitet, prosperitet dhe demokraci** në 57 shtete përmes dialogut politik për vlerat e përbashkëta dhe punës praktike që sjell ndryshimin e qëndrueshëm.

Sekretariati i OSBE-së  
Departamenti kundër Kërcënimeve Transnacionale  
Njësia për Çështje Strategjike Policore  
Wallnerstrasse 6  
A-1010 Vienna, Austria

Tel: +43-1 514 36 6942  
Fax: +43-1 514 36 6266  
E-mail: [spmu@OSBE.org](mailto:spmu@OSBE.org)  
<http://www.OSBE.org/spmu>  
<http://polis.OSBE.org>



Organization for Security and  
Co-operation in Europe